

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Disertacion

Përgatitur

nga

Sofia Delijorgji

Për marrjen e gradës shkencore «DOKTOR»

Specialiteti: Leksikologji dhe semantikë

RRETH INTERFERENCAVE LEKSIKO-SEMANTIKE TË GREQISHTES NË SHQIPE

Mbrohet më dt. / / 2011 para jurisë:

1. Kryetar _____
2. Anëtar (oponent) _____
3. Anëtar (oponent) _____
4. Anëtar _____
5. Anëtar _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE BALLKANIKE

DOKTORATË

RRETH INTERFERENCAVE
LEKSIKO-SEMANTIKE TË
GREQISHTES NË SHQIPE

Disertanti
Ma. Sofia Delijorgji

Udhëheqësi
Prof. as. dr. Valter Memisha

Tiranë, maj 2011

PASQYRA E LËNDËS

PASQYRA E LËNDËS	3
HYRJE	6
NDËRTIMI DHE PËRMBAJTJA E PUNIMIT	9
OBJEKTI DHE QËLLIMI I STUDIMIT	11
METODIKA DHE METODAT E PUNËS	12
BAZA TEORIKE E PUNIMIT	14
KREU I	16
SHQIPJA DHE GREQISHTJA – GJUHË NË KONTAKT TË DREJTPËRDREJTË GJEOGRAFIK DHE HISTORIK	16
1. VËSHTRIM HISTORIK I MARRËDHËNIEVE TË SHQIPES ME GREQISHTEN ...	16
A. Vështrim i shkurtër i historisë së gjuhës shqipe.....	18
B. Vështrim i shkurtër i historisë së gjuhës greke	21
2. INTERFERENCAT LEKSIKORE E SEMANTIKE NDËRMJET GREQISHTES DHE SHQIPES	26
A. HUAZIME LEKSIKORE (INTERFERIME) SHQIPE NË GREQISHTE	27
B. HUAZIME LEKSIKORE (INTERFERIME) GREKE NË SHQIPE	31
C. HUAZIME NDAJSHTESORE (INTERFERIME) GREKE NË SHQIPE	34
3. KLASIFIKIMI HISTORIK I HUAZIMEVE GREKE NË SHQIPE.....	35
4. KLASIFIKIMI GJEOGRAFIK I HUAZIMEVE (INTERFERIMEVE) GREKE NË SHQIPE.....	40
A. HUAZIME GREKE NË MBARË SHQIPEN	40
B. HUAZIME GREKE NË TË FOLMET JUGORE TË SHQIPES	43
KREU II.....	47
STRUKTURA LEKSIKO – SEMANTIKE E HUAZIMEVE GREKE NË SHQIPE	47
1. HUAZIMET GREKE FJALË NË SHQIPE	47
2. HUAZIMET GREKE NJËSI FRAZELOGJIKE NË SHQIPE.....	52
3. HUAZIMET NGA LEKSIKU TERMINOLOGJIK GREK.....	67
KREU III.....	71
FUSHAT KONCEPTORE DHE GJUHËSORE TË HUAZIMEVE GREKE NË SHQIPE	71
1. FUSHAT KRYESORE KONCEPTORE LEKSIKORE TË HUAZIMEVE GREKE NË GJUHËN SHQIPE	71
2. FUSHAT KRYESORE SEMANTIKE TË HUAZIMEVE GREKE NË GJUHËN SHQIPE.....	79
3. FUSHAT KRYESORE NDAJSHTESORE	82
KREU IV	83
ZHVILLIMET LEKSIKORE TË HUAZIMEVE GREKE NË SHQIPE.....	83

1. ZHVILLIME LEKSIKORE NGA HUAZIMET GREKE NË SHQIPE (GRUPET FJALËFORMUESE KRYESORE)	83
2. ZHVILLIME LEKSIKORE TEK HUAZIMET SHQIPE NË GREQISHTE	96
3. KRIJIMI I EMËRTIMEVE TË PATHJESHTA NGA HUAZIMET GREKE.....	100
4. KRIJIMI I NJËSIVE FRAZELOGJIKE SI ZHVILLIME SEMANTIKE NË SINTAGMA	101
KREU V	105
ZHVILLIMET SEMANTIKE TË HUAZIMEVE GREKE NË SHQIPE.....	105
1. ZHVILLIME SEMANTIKE NË HUAZIMET NGA GREQISHTJA.....	105
(Dukuria e polisemisë si zhvillime të brendshme kuptimore)	105
2. RELACIONET SEMANTIKE TEK HUAZIMET GREKE NË SHQIPE	124
KREU VI	130
PASQYRIMI LEKSIKOGRAFIK I HUAZIMEVE GREKE NË FJALORËT E GJUHËS SHQIPE.....	130
2. HUAZIMET GREKE NË FJALORËT DYGJUHËSH (ME SHQIPEN GJUHË TË PARË).....	139
A. HUAZIMET GREKE NË FJALORËT SHQIP – GREQISHT	139
B. HUAZIMET NË FJALORË TË TJERË DYGJUHËSH (SHQIPJA GJUHË E PARË)	143
KREU VII.....	145
KONTAKTET BASHKËKOHORE TË SHQIPES ME GREQISHTEN	145
A. GJENDJE BILINGUE NË GREQI DHE HAPËSIRAT E INTERESIMIT LEKSIKO-SEMANTIK.....	145
B. GJENDJA BILINGUE NË ZONAT MINORITARE NË SHQIPËRI	146
KREU VIII.....	148
QËNDRIMI NDAJ HUAZIMEVE NË DITËT E SOTME.....	148
KREU IX	150
SHTOJCË	150
1. LISTIME TË HUAZIMEVE GREKE NË SHQIPE TË NXJERRA NGA PUNIMET E STUDIUESVE TË NDRYSHËM.....	150
a. 1. Foljet në shqipen standarde, nxjerrë prej “Studimeve gjuhësore” të E. Çabej	150
2. Folje nga Studimet etimologjike të E. Çabejt (që nuk përfshihen në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, 1980).....	151
3. Folje, të nxjerra nga Fjalori etimologjik i Gustav Meyerit	152
Fjalorth i huazimeve greke të shqipes (Λεξικό των ελληνικών δανείων της αλβανικής) të nxjerra nga studimi i Dh. Q. Qiriazit	155
Toponomastikë.....	166
Onomastikë	166
Toponomastikë.....	166
2. LISTIME TË HUAZIMEVE SHQIPE NË GREQISHTE TË NXJERRA NGA PUNIMET E STUDIUESVE TË NDRYSHËM	167
(Λεξικό των ελληνικών δανείων της αλβανικής) të nxjerra nga studimi i Dh. Q. Qiriazit	167
I. Emra	167
<i>Tiparet morale të njeriut</i>	169
<i>Tiparet fizike të njeriut</i>	171
<i>Sëmundjet</i>	173
<i>Lidhjet farefisnore</i>	173
Gjendja sociale e njerëzve	173
<i>Organizimi shoqëror e shtetëror</i>	174

<i>Sistemi financiar</i>	174
<i>Terminologji ushtarake</i>	174
<i>Lodra</i>	174
<i>Zejtari</i>	174
<i>Tregtia</i>	175
<i>6. Bujqësia</i>	176
<i>Të ndryshme</i>	177
<i>Kafshë shtëpiake</i>	177
<i>Kafshë të egra</i>	178
<i>Sende, lëndë</i>	178
<i>Fenomenet e natyrës</i>	178
<i>Sipërfaqja e tokës</i>	178
<i>Folklori</i>	179
<i>Emra konkretë dhe abstraktë</i>	179
<i>II. Folje</i>	180
<i>III. Ndajfolje</i>	182
<i>IV. Pjesëza</i>	182
PËRFUNDIME	183
PROBLEME	194
BIBLIOGRAFIA	196

HYRJE

Gjuha greke dhe ajo shqipe bëjnë pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane, e gjuhëve gjenetike të afërta, të cilat qysh në kohërat e vjetra janë folur në trevat që nga India në Evropë. Kjo familje përfshin gjuhë të gjalla e të vdekura, të cilat kanë afri dhe bashkëpërkime (konkordanca) të shumta midis tyre. Sa më thellë të hyjmë në të kaluarën, aq më të dukshme janë afritë dhe bashkëpërkimet midis këtyre gjuhëve. Kjo familje gjuhësore ndahet në shumë degë e nëndegë. ***Greqishtja dhe shqipja formojnë degë të veçanta dhe nuk kanë lidhje motërzimi me asnjë gjuhë tjetër.***

Gjuhët e kësaj familjeje, por edhe gjuhët e tjera hyjnë me njëra-tjetrën në marrëdhënie të ndryshme, të lidhura me faktorë historikë, gjeografikë, kulturorë etj. Marrëdhëniet e shqipes me greqishten ***janë shumë komplekse dhe shtrihen në një periudhë shumë të gjatë kohore***; ato kanë nisur ndoshta që në fazën paraetnike të këtyre gjuhëve në djepin parabolkanik të tyre dhe kanë vijuar pa ndërprerje në periudhën etnike deri në ditët tona. Nga ana tjetër këto marrëdhënie janë zhvilluar në rrethana historike dhe kulturore nga më të ndryshmet, duke filluar nga kontaktet e thjeshta të fqinjësisë deri te simbioza e përzierjet etnike në disa vise si pasojë e shpërnguljeve dhe e shtegtimeve të popullive.¹

Studimet e shumta të bëra dy shekujt e fundit kanë nxjerrë në pah afritë e këtyre dy gjuhëve në rrafshin indoevropian. Studimet për greqishten nuk kanë pasur probleme të diskutueshme, sidomos historinë e saj të 3000 vjetëve të fundit. Ato kanë ndjekur zhvillimin e saj të shkallëshkallshëm në të gjitha nënsistemet, kalimin në greqishten e re dhe faktorët apo veçoritë e këtij kalim. Por studimet kanë qenë shumë të rëndësishme sidomos për shqipen, sepse ***për origjinën, për tipin e saj gjuhësor dhe për vendin që zë në familjen gjuhësore indoevropiane***, ka pasur dhe ka ende diskutime², të cilat dalin nga kuadri i studimeve dhe interpretimeve shkencore, duke rënë pre shumë shpesh e nacionalizmave dhe shovinizmave të ngushtë.³

¹ S. Mansaku, *Probleme të historisë së gjuhës shqipe në dritën e marrëdhënieve të saj me greqishten*, në "Seminarin ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare", Prishtinë, 2004, 22/2, f. 109

² Në shekullin XIX shumë autorë (A. Shljaher, G. Shtier, Dh. Kamarda etj.) e vendosën shqipen midis greqishtes dhe latinishtes, por më afër greqishtes. Këta autorë dolën në këtë formulim të gabuar, sepse nuk mundën të dallonin huazimet që ka shqipja nga greqishtja dhe nga latinishtja, nga fjalët e fondit të trashëguar dhe i vështuan huazimet si fjalë të trashëgimisë indoevropiane. Shih më gjerë S. Mancaku, *Probleme të historisë së gjuhës shqipe në dritën e marrëdhënieve të saj me greqishten*, në "Seminarin ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare", Prishtinë, 2004, 22/2, f. 109

³ Edhe sot e kësaj dite shumë gjuhëtarë sllavë (sidomos të vendeve që janë fqinj me Shqipërinë) e mohojnë autoktoninë e shqiptarëve dhe vazhdimësinë e banimit të tyre të pandërprerë në trojet ku gjenden sot. Ky qëndrim shtrihet drejtpërdrejt në fushën e historisë së gjuhës shqipe, duke i mëshuar, pa argumentet të qëndrueshme shkencore, idesë se shqiptarët, nuk janë vendës në trojet e sotme, por janë ardhës nga brendësia e Ballkanit dhe kjo lidhet me kohët e vona, sidomos pas dyndjeve sllave në Ballkan (ndërmjet

Seit Mansaku, një nga studiuesit bashkëkohorë më në zë të historisë së gjuhës shqipe, duke sintetizuar arritjet shkencore të shumë fushave kërkimore dhe të albanologëve shqiptarë dhe të huaj, thekson se “Tashmë është pranuar nga të gjithë studiuesit që shqipja është një degë më vete në familjen e gjuhëve indoevropiane, që nuk ka asndonjë lidhje afrie të veçantë, aq më pak ndonjë lidhje derivacioni (prejardhjeje) me asnjë nga gjuhët motra të kontinentit tonë. Dihet gjithashtu që në ndarjen e madhe të gjuhëve indoevropiane në *satem (lindore)* dhe në *kentum (perëndimore)*, shqipja bën pjesë në të grupin e parë (*satem*) dhe në ndarjen tjetër, në gjuhë veriore dhe jugore, shqipja është afruar më shumë me gjuhët indoevropiane veriore (gjuhët gjermanike dhe balto-sllave. Megjithatë nuk kanë munguar përpjekjet për të gjetur në gjuhën shqipe edhe elemente të gjuhëve *kentum*”⁴.

Kur pohojmë se shqipja është gjuhë indoevropiane, nuk duhet kuptuar që gjithë pasuria e saj leksikore është trashëgimi e fondit të vjetër indoevropian. ***Gjatë historisë, marrëdhëniet me popujt e tjerë kanë sjellë edhe ndikime në gjuhë.*** Historia e gjuhës dhe etimologjia i ndajnë elementet e huazuara nga elementet vetjake.

Prof. J. Thomai thekson se “duke veçuar fjalët e huazuara, në leksikun e gjuhës sonë mbetet shtresa leksikore vetjake, vendëse, dhe nga burimi leksikun e gjuhës shqipe e ndajmë në dy shtresa: shtresa *vetjake* dhe shtresa *e huazuar*”⁵.

U mëshuam këtyre fakteve, ***të vendit dhe të tipit gjuhësor të shqipes, të shtresë vetjake dhe të shtresës së huazuar të leksikut të saj***, sepse vetë objekti i temës së punimit tonë lidhet pazgjidhshmërisht me këto. Ne do të ndalemi gjerësisht në problemet që lidhen ***me interferencat leksiko-semantike të greqishtes në shqipe***, me huazimet që shqipja ka marrë nga gjuha greke (duke nënkuptuar këtu edhe ato huazime që shqipja i ka trashëguar nga nëna e vet, ilirishtja jugore, d.m.th., që kanë hyrë në gjuhë para se shqipja të diferencohet si gjuhë e veçantë).⁶

Dukuritë e ndryshme që shfaqen gjatë procesit të huazimit dhe që mund t’i përkasin rrafshit leksiko-semantik, por edhe atij fonetik, sintaksor, fjalëformues etj., nuk mund të analizohen dhe të interpretohen nëse nuk dimë edhe llojin e lidhjeve dhe të marrëdhënieve ndërmjet këtyre dy gjuhëve, sepse ***“detyra e parë që shtrohet para studiuesve që merren me marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-greke, është të dallojnë lidhjet e afri në rrafshin indoevropian nga marrëdhëniet e huazimit”***⁷.

shekullit XI-XII pas lindjes së Krishtit). Që ky është një problem i nxehtë, e tregon dhe botimi i “Enciklopedisë maqedonase” në këtë fillim shekulli nga Akademia e Shkencave të Maqedonisë, ku shqiptarët dhe gjuha shqipe paragjykohehin në skajshmëri.

⁴ S. Mansaku, *Probleme të historisë së gjuhës shqipe në dritën e marrëdhënieve të saj me greqishten*, në “Seminarin ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2004, 22/2, f. 110

⁵ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, 273-274

⁶ Prof. E. Çabej pohon se “Për sa u takon fjalëve prej burimi të huaj, që ndeshen në shqipen e dokumentuar, këto duhen ndarë në dy grupe të mëdha: a) fjalë prej burimi të huaj që shqipja i ka trashëguar nga “nëna” e saj; b) fjalë prej burimi të huaj që shqipja i ka huazuar drejtpërdrejt nga gjuhët e tjera, me të cilat ka pasur marrëdhënie historike. Pra, ***huazime të vetë shqipes janë vetëm fjalët prej burimi të huaj të grupit të dytë, kurse ato të grupit të parë janë huazime të “nënës” së shqipes dhe si të tilla duhen konsideruar si fjalë të trashëguara, por prej burimi të huaj.*** Kuptohet vetiu se si cak kohor për veçimin e këtyre dy grupeve fjalësh prej burimi të huaj, do të merret ajo periudhë, kur u krye shndërrimi cilësor nga ilirishtja në shqipe, d.m.th. përafërsisht periudha midis shekujve IV-VI të erës sonë. *Shih më gjerë E. Çabej, Studime gjuhësore*, IV Prishtinë, 1977, f. 326

⁷ S. Mansaku, *Probleme të historisë së gjuhës shqipe në dritën e marrëdhënieve të saj me greqishten*, në “Seminarin ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2004, 22/2, f. 109

Ne kemi marrë në shqyrtim një lëndë të bollshme leksikore dhe semantike (që përfshin në vetvete qindra e mijëra fjalë dhe njësi frazeologjike) dhe e kemi parë atë në shumanshmërinë e vet, duke u mbështetur në kritere të mirëfillta gjuhësore, por edhe jashtëgjuhësore. ***Huazimet nga greqishtja formojnë një grup paradigmatic të mëvetësishëm, brenda shtresës së huazimeve të shqipes.*** Ato kanë tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve, duke përfshirë këtu jo vetëm gjuhëtarë apo albanologë, si historianë, arkeologë, etnologë etj. Ne kemi synuar trajtimin e tyre në një rrafsh sinkronik, përmes kundrimeve leksikore e semantike, pa rënë në trajtime etimologjike (këto janë lënë jashtë objektit të studimit tonë, sepse trajtimi i tyre është para nga studiues shumë të shquar).

Ne kemi shfrytëzuar një literaturë të bollshme në të dy gjuhët⁸, një numër të madh fjalorësh njëgjuhësh dhe dygjuhësh (shqip-greqisht dhe greqisht-shqip). Në shumë analiza apo përfundime na ka ardhur në ndihmë edhe profesioni e kualifikimi im si pedagogje e greqishtes dhe vetë greqishtja si gjuhë amtare.

Për realizmin e studimit kam pasur në vazhdimësi përkrahjen dhe mbështetjen e stafit akademik universitar, ndaj ndjehem e detyruar që me këtë rast të falënderoj gjithë profesoratin e Departamentit të Gjuhëve sllave dhe ballkanike, të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, për ndihmën e dhënë, për vërejtjet e sugjerimet shkencore e shoqërore të vazhdueshme dhe që kanë pasur vendin e vetë në ecurinë e përgatitjes së tezës.

Së fundi, dëshiroj të falënderoj, gjithashtu, udhëheqësin shkencor të punimit të paraqitur, prof. dr. ***Valter Memisha***, për seriozitetin e këmbënguljen e treguar dhe si dhe për kërkesat me të cilat e ndërtoam punën tonë disavjeçare dhe me të cilat na drejtoi për ta kryer atë me sukses.

⁸ Ne kemi një literaturë të jashtëzakonshme shkencore në greqishte, që zbulon studimet e panumërta që janë bërë për këtë gjuhë, në të gjitha rrafshet dhe për një periudhë shumë të gjatë kohore. Ato fillojnë që gati para 3.000 vjetësh. Por duhet të theksojmë se në këtë literaturë shkencore shumë voluminoze për shumë shekuj ***gati - gati mungojnë (për të mos thënë nuk ekzistojnë) studime të veçanta, sidomos ato nga gjuhëtarë të mirëfilltë për marrëdhëniet e greqishtes me shqipen.*** Kjo gjendje është kapërcyer në shekullin XX, sepse si do të shohim gjatë shtjellimit të punimi, ato janë shtuar, madje janë dhe studime serioze. E kundërta ndodh me studimet në shqipe. ***Ato u kanë kushtuar dhe vazhdojnë t'u kushtojnë një vend të posaçëm marrëdhënieve të gjuhës shqipe me greqishten.***

NDËRTIMI DHE PËRMBAJTJA E PUNIMIT

Punimi monografik *Rreth interferencave leksiko-semantike të greqishtes në shqipe* është konceptuar në nëntë kapituj, të paraprirë nga një *Hyrje* si dhe të ndjekur nga *Përfundime e Bibliografia e veprave të shfrytëzuara* si më poshtë:

Hyrja përbën pjesën paraqitëse të punimit, të punës së bërë për realizimin e tij, të bazës teorike, të literaturës së shfrytëzuar, si edhe të burimeve të lëndës. Paraqitja e qëllimit dhe e objektit të studimit, metodologjia e ndjekur, si edhe përbërja e kapitujve janë pjesë e këtij kreu.

Në kreun e parë jemi ndalur në çështjen *Shqipja dhe greqishtja gjuhë në kontakt të drejtpërdrejtë gjeo-historik*, duke trajtuar nënçështje të tilla, si *Vështrim historik i marrëdhënieve të gjuhës shqipe me gjuhën greke (Vështrim i shkurtër i historisë së shqipes, Vështrim i shkurtër i historisë së greqishtes); Interferencat gjuhësore: gjuhët të hapura në dhënie e në marrje (Huazime shqipe në greqishte; Huazime leksikore greke në shqipe; Huazime ndajshitesore greke në shqipe); Klasifikimi historik i huazimeve greke në shqipe; Klasifikimi gjeografik i huazimeve greke në shqipe (Huazimet në mbarë shqipen, Huazimet në dialektin jugor dhe në të folmet jugore)*

Kundrimi ka qenë paraqitës, përshkrues, duke i dhënë përparësi mendimit shkencor tashmë të qëndrueshëm për studimet në greqishte dhe në shqipe për marrëdhëniet ndërmjet dy gjuhëve dhe për karakterin dhënës e marrës të tyre. Klasifikimet taksonomike të shumta e të larmishme kanë synuar jo vetëm të japin informacion të ri, jo vetëm të sistemojnë atë të njohur në funksion të tematikës sonë, por edhe të lehtësojnë gjithë fthillimet dhe shtjellimet në vazhdimësi, në kapitujt e tjerë.

Në kreun e dytë, punimi ndalet në çështjen *Struktura leksiko – semantike e huazimeve greke në shqipe*, si dhe në nënçështje, si *Huazimet greke fjalë në shqipe; Huazimet greke njësi frazeologjike në shqipe; Huazimet nga leksiku terminologjik grek.*

Lënda e bollshme, e vjelë nga burime të shumta, si botime leksikografike, botime monografike, punime të pjesshme, vjelje të drejtpërdrejta sidomos në zona minoritare greqishtfolëse në Shqipëri, tregojnë se gjuhët, shqipja e greqishtja, huazojnë fjalë, terma, por jo kuptime. Kuptimet janë zhvillime të brendshme të huazimeve pasi kanë hyrë në gjuhën përkatëse.

Në kreun e tretë, punimi ndalet në çështjen *Fushat konceptore dhe gjuhësore të huazimeve greke në shqipe*, si dhe në nënçështje të tilla, si *Fushat kryesore konceptore leksikore; Fushat kryesore semantike të huazimeve; Fushat kryesore ndajshitesore.*

Ky kapitull është me peshë jo të vogël, sepse lidhet drejtpërdrejt me tematikën, klasifikimet janë leksikore dhe semantike dhe lënda e sjellë krijon mundësi për studime të tjera të mëvonshme më të plota në rrafshin morfologjik, socio-linguistik, dialektologjik, historik etj.

Në kreun e katërt, të titulluar *Zhvillime leksikore nga huazimet greke në shqipe* punimi është ndalur në tri nënçështje kryesore si, *Zhvillime leksikore nga huazimet*

greke në shqipe (grupet fjalëformuese kryesore); Krijimi i emërtimeve të pathjeshta; Krijimi i njësive frazeologjike.

Këtu është trajtuar përshtatja morfologjike e huazimeve greke me strukturën gramatikore të shqipes si dhe zhvillimet e shumta që kanë ndodhur në rrafshin leksikor, duke treguar se huazimet fjalë kanë shërbyer dhe vazhdojnë të shërbejnë në shqipe si tema aktive dhe prodhuese për fjalë të reja. Njësitë e sapokrijuara nuk janë tashmë huazime, por fjalë të leksikut të shqipes.

Në kreun e pestë të punimit me titull **Zhvillime semantike të huazimeve greke në shqipe**, janë parë dukuri të larmishme dhe me shumë interes, si *Zhvillime semantike në huazimet nga greqishtja (Dukuria e polisemisë si zhvillim i brendshëm kuptimor); Zhvillime semantike e leksikore në huazimet shqipe në greqishte; Relacionet kryesore semantike të huazimeve greke në shqipe (Dukuria e sinonimia, Dukuria e antonimia; Dukuria e taksonomisë).*

Kurse në kreun e gjashtë, të titulluar **Pasqyrimi leksikografik i huazimeve greke në fjalorët e gjuhës shqipe** jemi ndalur në një vështrim të shpejtë për vendin që zënë huazimet nga greqishtja në fjalorët e shqipes, duke i përqasur edhe me leksikun vetjak (vendës) të shqipes. Tri janë sythet që menduam të paraqesim brenda këtij kreu: *Pasqyrimi në fjalorët shpjegues; pasqyrimi në fjalorët dygjuhësh shqip – greqisht; pasqyrimi në fjalorët greqisht – shqip.*

Kreu i shtatë, **Kontaktet bashkëkohore të shqipes me greqishten**, del nga kuadri i problemit qendror dhe ndalet në probleme shumë të rëndësishme sot dhe trajton praninë e shumë faktorëve politikë, ekonomikë, psikologjikë, shoqëror etnikë etj. që mundësojnë hyrjen e huazimeve të reja nga greqishtja në gjuhën shqipe. Nënçështjet kryesore janë: *Kontaktet e sotme kulturore, shkencore, ekonomike etj. ndërmjet popujve dhe krijimi i gjendjeve bilingue (dygjuhësore); gjendja bilingue (dygjuhësore) në zonat minoritare në Shqipëri; gjendja bilingue (dygjuhësore) e shqiptarëve në Greqi; ndikime të shqipes në mjediset gjuhësore greke; interferime leksikore e semantike në të folur dhe statusi gjuhësor i tyre.*

Kreu i tetë i titulluar **Qëndrimi ndaj huazimeve greke**, trajton një problem shumë ky sot, sidomos kur proceset e globalizimit janë shumë evidente.

Në kreun e nëntë, që e kemi titulluar **Shtojcë (Fjalorth)** punimi ndalet në dy çështje kryesore, në *Listime me huazime greke shqipe, nxjerrë nga punimet e studiuesve të ndryshëm; Listime huazimesh shqipe në greqishte etj.* Kjo shtojcë, në formë fjalorthi (në të cilin kemi dhënë një numër të madh të fjalëve shqipe (si huazime) që kanë hyrë në greqishten veriore apo në të folmet minoritare greke në Shqipëri, si dhe të fjalëve greke (si huazime) në të folmet kufitare në Shqipëri, por edhe në ngulimet shqiptare apo në popullsinë shqiptare që banon a që punon në Greqi), jep lëndë që do t'u shërbejë edhe të tjerëve, sepse ajo ka vlerë dokumentuese për huazimet shpesh gjuhësore (krahas atyre historiko-kulturore) dhe ndihmon shumë studimet për dendurinë, shpërndarjen, për interefrimet etj.

Te **Përfundimet** kemi dhënë një sintezë të të gjitha dukurive që zbulohen gjatë trajtimit të tyre në kapituj dhe sytha të veçantë, si dhe probleme e çështje të hapura e të shtruara për shtjellime dhe interpretime të mëtejshme.

Punimi ka arritur në gjendjen e tij përfundimtare, edhe duke shfrytëzuar një **Literaturë shkencore të plotë**, të rekomanduar apo të gjetur personalisht, që përfshin rreth 300 autorë dhe vepra, në greqisht, shqip, anglisht, italisht, frëngjisht. Ajo është dhënë e plotë në fund të punimit.

OBJEKTI DHE QËLLIMI I STUDIMIT

Tema e punimit *Rreth interferencave leksiko-semantike të greqishtes në shqipe*, si u shprehëm pak më lart, bën objekt trajtimi dhe analize një anë të veçantë të patrajtuar më parë në studimet gjuhësore, qoftë në ato të gjuhës greke, qoftë në ato të gjuhës shqipe. Nëse për huazimet nga greqishtja kemi punime shkencore (por edhe amatore) të përmasave të ndryshme, që i shohin ato sipas kohës së hyrjes në shqipe (a në ilirishten jugore si nënë e shqipes), duke bërë edhe periodizimin historik të tyre, sipas fushave konceptore e leksiko-semantike, sipas llojit morfemor (si fjalë, si morfema, si ndërtime sintaksore etj.) etj., *këto huazime nuk janë parë mirëfilli, në mënyrë tërësore dhe drejtpërdrejt në rrafshin semantik, qoftë në atë të tipologjisë kuptimore, qoftë në atë të tipologjisë së lëvizjes kuptimore.*

Duke bërë objekt punimi për doktoraturë këtë anë të rëndësishme të këtyre huazimeve, ne kemi synuar të ndalemi në të gjitha dukuritë që lidhen me rrafshin semantik, por njëkohësisht duke mos u shkëputur asnjëherë nga lidhjet dhe marrëdhëniet me rrafshet e tjera gjuhësore që jo vetëm i mbartin, por edhe i zbulojnë të gjitha zhvillimet dhe ndryshimet semantike.

Gjithashtu, duke u ndalur në këtë aspekt shumë të rëndësishëm të gjuhës shqipe, ne jemi përpjekur të themi fjalën tonë edhe për përballjen e dy gjuhëve shqipes me greqishten, ndërmjet tyre në ditët e sotme, jo thjesht si gjuhë me status të ndryshëm ndërkombëtar, por si gjuhë që kanë krijuar situata bilingue (dygjuhësie) në të dy vendet: *greqishtja* për emigrantët shqiptarë në Greqi është *gjuhë buke* (kurse shqipja është *gjuhë zemre*) dhe *shqipja* për minoritarët grekë në Shqipëri është *gjuhë buke* (kurse greqishtja është *gjuhë zemre*).

METODIKA DHE METODAT E PUNËS

Nën drejtimin e udhëheqësit shkencor së pari shestuam jo vetëm tematikën dhe problematikën e temës **Rreth interferencave leksiko-semantike të greqishtes në shqipe**, por shestuam dhe metodikën e punës për realizimin e saj. Kështu në fillim u morëm me nxjerrjen e lëndës leksikore dhe frazeologjike të huazuar në shqipe nga greqishtja, duke iu drejtuar burimeve të ndryshme.

Këtu do të veçonim, *Studimet gjuhësore* të prof. E. Çabej, ku kemi një numër të konsiderueshëm të huazimeve greke sidomos ato që nuk i takojnë kohës së sotme, *fjalorët njëgjuhësh të shqipes* (*Fjalori i gjuhës shqipe, 1954; Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1980; Fjalori i shqipes së sotme, 1984 / 2002, Fjalori i gjuhës shqipe, 2006*), *Fjalorët dygjuhësh greqisht - shqip dhe shqip - greqisht* (duke u mbështetur sidomos te *Λεξικόν Αλβανο - Ελληνικόν* (*Fjalor shqip – greqisht*) i K. Kristoforidhit, Tiranë, 1961, tek N. Γκίνη, *Αλβανο - Ελληνικό Λεξικό* (*Fjalor shqip – greqisht*), Ιωαννινών, 1998; N. Γκίνη, *Έλληνο - Αλβανικό Λεξικό* (*Fjalor greqisht - shqip*), Ιωαννινών, 1993; K. Παπαφίλη, *Λεξικό Αλβανο - Ελληνικό* (*Fjalor shqip – greqisht*), Αθήνα, 1997; K. Παπαφίλη, *Λεξικό Έλληνο - Αλβανικό* (*Fjalor greqisht - shqip*), Αθήνα, 1997; H. Sinani, *Fjalor greqisht-shqip* (*Έλληνο – Αλβανικό Λεξικό*), Tiranë, 2001, si dhe te shumë fjalorë të tjerë dhe punime të ndryshme të botuara në të dy vendet⁹.

Për të bërë analiza të sakta sidomos semantike dhe fjalëformuese (për të parë çerdhet paradigmatiche fjalëformuese ku fjala e huazuar shërben si temë semantike dhe si temë fjalëformuese për dhjetëra e dhjetëra njësi të reja) jemi ndalur te lënda që gjendet jo vetëm në fjalorët njëgjuhësh dhe dygjuhësh të shqipes, por edhe në fjalorë njëgjuhësh të greqishtes si: *Λεξικό της Κοινής Νεοελληνικής*, Θεσσαλονίκη, 1998; *Λεξικόν της νέας ελληνικής γλώσσας*, Αθήνα, 1998; Πελεκάνος, *Λεξικό της Νέας Ελληνικής Γλώσσας*, Αθήνα, 1998; Σ. Κουμανούδη, *Λεξικόν Λάτινο- Ελληνικόν*, Αθήνα, 1972; Τεγόπουλος – Φυτράκης, *Ελληνικό Λεξικό*, Αθήνα, 1992 etj.

Por bazën kryesore të punës sonë me fjalorët e greqishtes e përbën vepra madhore e Jorgo Babinjotit, *Fjalor i gjuhës së re greke* (*Γ. Μπαμπινιώτης; Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*)¹⁰, si dhe Fjalori etimologjik i greqishtes i N. Andriotit (N. Ανδριώτη, *Ετυμολογικό λεξικό*, Selanik, 1971)¹¹.

⁹ Do të veçonim këtu edhe punimin për doktoraturë të studiuësit Dhori. Q. Qiriazi, *Ελληνικές Επιδράσεις στην Αλβανική* (I. Φωνητική και μορφολογική προσαρμογή των ελληνικών δανείων; II. Λεξικό των ελληνικών δανείων της αλβανικής), Θεσσαλονίκη, 2001

¹⁰ Γ. Μπαμπινιώτης; *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας, με σχόλια για τη σωστή χρήση των λέξεων ερμηνευτικό, ετυμολογικό, ορθογραφικό, συνώνυμων - αντιθετων, κύριων ονομάτων, επιστημονικών ορών, ακρωνυμίων; με αξιοποίηση του γλωσσικού αρχείου*; Αθηνών, 2002

¹¹ N. Ανδριώτη, *Ετυμολογικό λεξικό*, Selanik, 1971

Përveç vjeljes së drejtpërdrejt nga vepra studimore apo leksikografike, ne kemi bërë grumbullim lëndë edhe përmes *anketiveve* në shkollat e minoriteti grek në Shqipëri si dhe te fëmijët shqiptarë të moshës shkollare që jetojnë dhe arsimohen në Greqi (përgjithësisht fëmijët e emigrantëve ekonomikë).

Meqenëse ne jemi marrë me huazimet nga greqishtja në shqipe, të pasqyruar në fjalorë të ndryshëm a në formën e fjalorthëve në punime të ndryshme, kemi përdorur edhe *metodën e analizës semike*¹², duke përqasur shumë njësi leksikore, semantike dhe njësi frazeologjike nga të dy gjuhët.

Gjithashtu, në një koncept të gjerë, në kemi përdorur edhe *metodën e përqasjes gjuhësore* (të përballjes dhe të krahasimit të njësive leksikore e semantike)¹³.

Metoda distribucionale dhe ajo komponenciale nuk janë përdorur, edhe pse ato mund të lidheshin me analizat semantike që të çonin të elemente të kulturës, të etnosit, të psikologjisë etj., të njërës popull apo tjetrit.

Për trajtimi shkencor të lëndës në kemi përdorur *metodën induktive*, të analizës së përimituar të lëndës leksikografike a të regjistruar.

Metoda induktive, që na ka çuar në nxjerrjen e përfundimeve të ndryshme e interesante, u gërshetua shumë shpesh me *rrugën deduktive*, sepse shumë zgjidhje ne i kemi pasur të gatshme sidomos për trajtimet diakronike, që nuk kanë qenë si objekt trajtimi në punimin tonë.

¹² Në analizat semantike që bëhen në ditët e sotme, përdoren tri metoda kryesore: *metoda semike, metoda distribucionale* dhe *metoda komponenciale*. Shih më gjerë J. Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009

¹³ *Metoda e përqasjes gjuhësore* lidhet drejtpërdrejt me *gjuhësinë përqasëse*. Kur krahasohen gjuhë pa lidhjeje gjinore për të gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre. Gjithashtu, ajo i sheh gjuhët jo historikisht, po në të njëjtën prerje kohore, me qëllim që të zbulojë përbashkësitë në strukturën e tyre. Shih më gjerë R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2008, f. 14-15. Ne këtu jemi në një koncept më të gjerë të metodës së përqasjes, duke i parë përmes së saj dukuritë në dy gjuhë me lidhje të afërta.

BAZA TEORIKE E PUNIMIT

Për realizimin e studimit jemi mbështetur në një literaturë të pasur në disa gjuhë, por sidomos ***në shqipe*** dhe ***në greqishte***. Duke pasur në dorë rreth 280 vepra dhe autorë, jemi mbështetur në parime e kritere shkencore studimi të njohura dhe të zbatuara me sukses deri tani në trajtimet leksikore e semantike në gjuhësinë botërore (si dhe në atë greke dhe shqiptare). Për pasojë, duke pasur një teori që ndërton vetë shkencën e leksikologjisë e të semantikës leksikore, por edhe të disiplinave gjuhësore si sociolinguistika, etnolinguistika, dialektologjia etj., e kemi pasur më të lehtë të trajtonim koncepte gjuhësore, si *leksik vendës* dhe *leksik i huazuar*, *fjalë* dhe *njësi frazeologjike*, *kuptim* dhe *lëvizje kuptimore*, *lëvizje e jashtme* dhe *lëvizje e brendshme kuptimore*, *semë* dhe *polisememë*, *temë motivuese* dhe *temë e motivuar*; *situatë monolingue* dhe *situatë bilingue*, *dygjuhësia familjare* dhe *dygjuhësi e emigracionit*, *dygjuhësia gjeopolitike* dhe *dygjuhësia tekno-ekonomike*, *gjeobilinguizmi* dhe *huazimi*, *politikë gjuhësore* dhe *planifikim gjuhësor*, *fjalë* dhe *morfemë*, *relacion semantik* dhe *prejardhje semantike*, *barbarizëm* dhe *fjalë ndërkombëtare*, *huazim i drejtpërdrejtë* dhe *huazim i tërthortë*, *huazim shkrimor* dhe *huazim gojor*, *shumëgjuhësia te brezi i ri* dhe *dukuria e interferencave gjuhësore*, *relativizmi gjuhësor* etj.

Për hartimin e punimit jemi mbështetur mbi konceptet e teorisë e të praktikës leksikologjike, semantike e leksikografike, të përpunuara nga gjuhëtarë e veçanërisht leksikologë e semantologë grekë, shqiptarë, anglo-amerikanë etj., si J. Babinjoti¹⁴, Triandafilidhi¹⁵, Lyons¹⁶, S. Ullman¹⁷; J. Thomai¹⁸, E. Çabej¹⁹, Sh. Demiraj²⁰ etj.

Ne jemi ndalur në analiza që ***i përkasin semantikës strukturore***, pa kaluar në semantikën interpretuese, edhe për arsyen se ***semantika strukturore në gjuhësinë shqiptare është më e konsoliduara si disiplinë***. Kjo do të thotë se në këtë shkencë kemi një teori të përpunuar në mënyrë të kënaqshme dhe metoda studime që kanë dhënë fryte

¹⁴ Γ. Μπαμπινιώτης, Εισαγωγή στην Σημασιολογία, 1985

¹⁵ Νεοελληνική, Γραμματική, Αθήνα, 1992

¹⁶ J. Lyons, *Struktural semantics*, Cambridge, 1963; J. Lyons, *Semantics*, I, II, Cambridge, 1977; Lyons J., *Introduction to Theoretical Linguistics*, Camkidge, 1975

¹⁷ S. Ullman, *The Princips of semantics*, Oxford, 1963

¹⁸ J. Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009; J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2009; J. Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2001 etj.

¹⁹ E. Çabej, *Studime gjuhësore*, IV, V, Prishtinë, 1977; E. Çabej, *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në *Studime gjuhësore*, VI, Prishtinë, 1977; E. Çabej, *Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në Gadishullin Ballkanik në dritën e gjuhës dhe të emrave të vendeve*, në "BUSH, SSHSH", 1, 1962 etj.

²⁰ Sh. Demiraj, *Gramatika historike e shqipes*, Tiranë, 1986; Sh. Demiraj, *Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët*, Tiranë, 2008; Sh. Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996; Sh. Demiraj, *Gjuha amtare në Bregdetin Jugor shqiptar gjatë shekujve*, në "Himara në shekuj", Tiranë, 2004; Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988; Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe, probleme dhe disa figura të shquara të saj*, Tiranë, 2003; Sh. Demiraj, *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të shqipes*, Tiranë, 1999 etj.

të qëndrueshme. Këto na kanë udhëhequr edhe në analizat, shqyrtimet, përjasjet, krahasimet apo përgjithësimet e bëra në sytha e në kapituj të punimit apo në krejt punimin.

Gjatë punës për të parë interferencat leksiko-semantike të greqishtes në shqipe dhe të shqipes në greqishte pashmangmërisht jemi përballur edhe me hipotezën *relativizmit gjuhësor* që lidhet me pohimin e E. Sepirit (Edëart Sapir) se “*nuk mund të gjenden dy gjuhë që të jenë aq të ngjashme, saqë të konsiderohen se përfaqësojnë të njëjtin realitet shoqëror*”. Kjo hipotezë gjen mbështetje në tezën e Sosyrit mbi natyrën arbitrare të shenjës gjuhësore. Siç kemi vënë në dukje më parë, midis shënuesit dhe të shënuarit nuk ka ndonjë lidhje të brendshme ose logjike, d.m.th. shënuesi është arbitrar. Siç shihet, gjuhët mund ta analizojnë botën që na rrethon në mënyra të ndryshme, çdo gjuhë është e lirë të zgjedhë të shënuarit dhe shënuesit që do për këta të shënuar. Kjo bën që gjuhët të mos përputhen midis tyre dhe, në këtë pikë, Sepiri ka të drejtë, por nuk mund të thuhet se gjuhët nuk kanë asgjë të ngjashme midis tyre.

Hipoteza e relativizmit gjuhësor më shumë zbulohet në nënsistemin leksikor dhe pikërisht në frazeologji. Gjuha shqipe dhe gjuha greke kanë edhe shumë tipare të përbashkëta që burojnë, së pari, nga pjesa e trashëguar e gjuhës dhe këtu është fjala për ato që quhen universale gjuhësore. Por mendësia e përbashkët në një mjedis gjeo-historik tashmë të njohur, ka bërë që ndërmjet popujve të ketë shumë gjëra të përbashkëta që gjatë procesit të mbartjes së njësisive gjuhësore nga një gjuhë në tjetrën, si huazim, por së pari si përkthim, të mos ketë probleme të skajshme dhe vështirësi që mund të ndeshen me gjuhë të tjera²¹.

²¹ R. Memushaj, pohon se në variantin e saj të fortë, *hipoteza e relativizmit gjuhësor*, sipas së cilës shumë nga dallimet gramatikore dhe leksikore janë të tilla që ato që mund të thuhet në një gjuhë, nuk mund të thuhet në një gjuhë tjetër, bart një varg rrjedhimesh negative jo vetëm në aspektin teorik të problemit, por edhe në atë praktik. Vërtet që gjuhët kanë dallime, përndryshe nuk do të kishte disa mijëra syresh, por, me gjithë dallimet, ato kanë edhe shumë tipare të përbashkëta. Ngjashmëritë midis tyre burojnë, së pari, nga pjesa e trashëguar e gjuhës dhe këtu është fjala për ato që quhen universale gjuhësore; së dyti, ngaqë në çdo gjuhë gjenden fjalë, shprehje e ndërtime sintaksore të huazuara.” Kjo hipotezë bie në kundërshtim edhe me faktet e dygjuhësisë... Po t’i përmbahesh teorisë së relativizmit gjuhësor, mohohet mundësia e përkthimit nga një gjuhë në tjetrën, ashtu si mohohen edhe huazimet kulturore midis popujve me gjuhë të ndryshme, kur dihet që kulturat, ashtu si popujt, japin e marrin midis tyre.” Shih më gjerë Këtë e vërtetojnë më së miri dhe studimet e ndryshme, f.v., të akademikut shqiptar I. Kadare për Eskilin etj.

KREU I

SHQIPJA DHE GREQISHTJA – GJUHË NË KONTAKT TË DREJTPËRDREJTË GJEOGRAFIK DHE HISTORIK

1. VËSHTRIM HISTORIK I MARRËDHËNIEVE TË SHQIPES ME GREQISHTEN

Populli shqiptar dhe populli grek, përkatësisht mbartës të *gjuhës shqipe* dhe të *gjuhës greke*, janë dy nga popujt më të vjetër të Evropës. Ata janë të vendosur në jug të gadishullit të Ballkanit dhe kanë pasur e kanë kontakte të drejtpërdrejta dhe të shumanshme (historike, ushtarake, gjeografike, ekonomike, kulturore, gjuhësore, psikologjike etj.) të paktën 3.000-vjeçare²². Dihet, tashmë, roli përcaktues i popullit grek, i kulturës greke dhe i gjuhës greke në zhvillimin e kulturës së popujve të tjerë indoevropianë, dhe jo të tillë, të Evropës e të botës. Nëse për popullin grek dhe gjuhën e tij teoritë për autoktoninë janë të konsoliduara, për popullin shqiptar, për gjuhën dhe kulturën e tij, ka diskutime që shpesh janë shtruar dhe janë zgjidhur në një rrafsh shkencor dhe me objektivitet. Trojet ku shtrihet Shqipëria e sotme ka qenë arenë pushtimesh dhe luftërash të panumërta. Shqiptarët, ashtu si edhe grekët vijnë në kohët moderne me histori që i bëjnë të ndihen krenarë. Ata, pavarësisht nga përmasat, kanë dhënë ndihmesën e vetë në rrjedhat e Ballkanit a të Evropës.

Megjithatë historia dokumenton faktin se shqiptarët si vazhdues të ilirëve të jugut, *kur u bënë popull i veçantë me tiparet dhe me gjuhën e vetë*²³, kanë qenë pjesëtarë të popullsisë së Perandorisë së Bizantit dhe që nga shekulli i shtatë e deri nga shekulli XI, XII kanë qenë të pushtuar nga sllavët.

Dy shekujt e fundit, kur të dy popujt u shkëputën nga Perandoria Osmane dhe formuan shtetet e tyre (populli grek në fillim të shekullit XIX dhe populli shqiptar në fillim të shekullit XX) kanë sjellë kontakte të një gjendjeje të re. Kjo ka kushtëzuar edhe drejtimin e kontakteve gjuhësore. Shohim një rritje të ndjeshme të përpjekjeve të dijetarëve apo të dashamirëve të kulturës shqiptare për të përkthyer në shqip majat e

²² Akademik E. Çabej pohon se “Një nga gjuhët e gjalla indoevropiane është edhe gjuha shqipe, e cila u ka qëndruar rrebesheve të kohëve. Kjo tregon qartë se stërgjyshërit tanë e kanë ruajtur atë brez pas brezi si gjënë më të çmuar, të trashëguar nga të parët e vet. E duke ruajtur kështu gjuhën amtare, ata mundën t’i shpëtonin asimilimit nga ana e pushtuesve të ndryshëm, që kanë zëvendësuar njëri-tjetrin në trojet tona gjatë shekujve.” Shih më gjerë E. Çabej, Studime shqiptare, Prishtinë, IV, 1977, f. 227

²³ Akademik Sh. Demiraj, e pranon mëvetësimin e shqiptarëve dhe shkëputjen e shqipes nga ilirishtja jugore ndërmjet shekullit IV- VI p.e.s. Shih më gjerë Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 19-24

kulturës greke dhe për të sjellë në shqip historinë e popullit helen dhe sidomos për të shqipëruar letërsinë e vjetër a të re greke. Historia kontaktuese 3.000-vjeçare, me ndarje dhe me ndërthurje nga më të çuditshmet dhe nga më marramendëset, ka lënë gjurmët e veta në këto kultura, aq sa disa studiues u njohin një origjinë të përbashkët popujve dhe gjuhëve që ata flasin²⁴.

Prof. E. Çabej se “Shqiptarët paraqiten historikisht si një popull i dalë në kohë prehistorike nga vise jashtë Ballkanit dhe që erdhi e nguli në ato kohë të lashta në brigjet lindore të Adriatikut. Me këtë ata u bënë një popull i Mesdheut, hynë përgjithmonë në sferën e kulturës mesdhetare. Vendi që zuri ky popull në brigjet e Adriatikut caktoi përfundimisht edhe fatet e tij historike e bashkë me këto edhe zhvillimin që mori gjuha e tij. Ky zhvillim për periodën antike të shqipes përcaktohet në mënyrë të prerë nga kontaktet e fqinjësisë, e pikërisht më një anë nga afërsia e sferës kulturore të Helenëve, më anë tjetër nga sundimi i gjatë i Romakëve, pra gjithsesi nga rrethi i kulturës greko-latine. Me mbarimin e perandorisë romake një ngjarje historike e re u bë me rëndësi vendimtare për shqipen e për të gjithë Ballkanin, e kjo që vendosja e Sllavëve në Gadishull. I fundit proces historik i jashtëm me rëndësi për gjuhët ballkanike që ardhja e Osmanëve në shekullin e XV, sundimi i të cilëve zgjati gjer në ditët tona”²⁵.

Në Shqipëri ka një komunitet etnik grek, shkollimi i të cilit përfshin të dy hallkat e sistemit arsimor, atë parauniversitar dhe atë universitar. Kjo ka kërkuar dhe kërkon patjetër që të hartohen jo vetëm tekste mësimore, por të hartohen edhe fjalorë, të cilët janë të pazëvendësueshëm në këtë fushë.

Kontaktet ndërmjet dy popujve dy dhjetëvjeçarët e fundit kanë arritur kulmin. Veç popullsisë minoritare shqipfolëse që ka jetuar në Greqi, pas vitit 1990 drejt këtij vendi, u nisën valë të tëra emigrantësh shqiptarë, duke kapur një shifër që shpesh i kalon të 600.000 vetët. Në këtë numër kaq të madh kemi një larmi sociale njerëzish, kemi njerëz të arsimuar, të arsimuar në mënyrë të cinguar dhe të paarsimuar. Veç kësaj nga familje emigrantësh kanë lindur fëmijë që tashmë rriten në një mjedis greqishtfolës, por që në shtëpi flasin dhe mësojnë shqipen. ***Situata bilingue ka kërkuar dhe kërkon që të hartohen patjetër fjalorë greqisht - shqip dhe shqip – greqisht, të cilët për hir të së vërtetës, vitet e fundit janë shtuar ndjeshëm.***

Veç kësaj kontaktet ekonomike, ushtarake, kulturore etj., sidomos investimet e mëdha që ka bërë kapitali grek në Shqipëri, kërkon pa tjetër që të hartohen vepra që të mësohen greqishtja dhe shqipja. Dhe prapë, kjo kërkon së pari gramatika dhe fjalorë dygjuhësh.

²⁴ Studiuesi arbëresh Dh. Kamarda pranonte se shqipja është degë e greqishtes së vjetër. Studiuesi A. Kola i sheh me origjinë të përbashkët të dy popujt, atë grek dhe atë shqiptar, dhe për pasojë edhe gjuhët që ata flasin. *Shih për këtë më drejtpërdrejt* A. Kola, *Arvanitasit*, Tiranë, 2005 dhe A. Kola, *Gjuha e perëndive*, Tiranë, 2004.

²⁵ E. Çabej, *Studime shqiptare*, Prishtinë, IV, 1977, f. 186

A. Vështrim i shkurtër i historisë së gjuhës shqipe

Gjuha shqipe bën pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane. Në rrjedhën e shekujve, disa nga gjuhët indoevropiane janë zhdukur, të tjerat kanë pësuar ndryshime shumë të mëdha dhe si rrjedhim janë larguar shumë njëra nga tjetra, duke u zhvilluar si gjuhë më vete madje, në disa raste, si grupe gjuhësh të veçanta. Kështu p.sh., shqipja, greqishtja, armenishtja përbëjnë secila një gjuhë të veçantë. Por, nga ana tjetër, ne flasim për grupin e gjuhëve sllave (si, rusishtja, polonishtja, çekishtja, serbishtja, kroatishtja, bullgarishtja etj.), të gjuhëve romane (si, italishtja, frëngjishtja, spanjishtja, rumanishtja etj.) apo të gjuhëve gjermanike (si, gjermanishtja, anglishtja, danishtja, norvegjishtja, suedishtja etj.) etj.

Shqipja, si një nga gjuhët e gjalla indoevropiane, u ka qëndruar rrebesheve të kohëve. Kjo tregon qartë se stërgjyshërit e shqiptarëve e kanë ruajtur atë brez pas brezi si gjënë më të çmuar, të trashëguar nga të parët e vet. E duke ruajtur kështu gjuhën amtare, ata mundën t'i shpëtonin asimilimit nga ana e pushtuesve të ndryshëm, që kanë zëvendësuar njëri-tjetrin në trojet e tyre gjatë shekujve. Gjuha shqipe ka tërhequr prej kohësh vëmendjen e gjuhëtarëve dhe të studiuesve të ndryshëm. I pari që vërtetoi bindshëm përkatësinë e saj në familjen e gjuhëve indoevropiane, ishte gjuhëtari gjerman F. Bopp, që arriti në përfundimin se shqipja i përket familjes indoevropiane, porse “*në elementet e saj themelore nuk ka ndonjë lidhje më të ngushtë ose, aq më pak, ndonjë lidhje derivacioni me asnjërën nga gjuhët motra sanskrite (indoevropiane) të kontinentit tonë*”²⁶.

Karakteret ***indoevropian i gjuhës shqipe*** shfaqet në të gjitha nënsistemet e saj: ***në fjalor, në sistemin fonetik dhe në strukturën gramatikore***. Por këtu është rasti të bëhet një vërejtje paraprake. Kur flasim për karakterin indoevropian të gjuhës shqipe, kemi parasysh tiparet thelbësore, që ajo ka trashëguar nga një fazë e hershme indoevropiane. Natyrisht, këto tipare nuk kanë mbetur krejt të pandryshuara, ashtu siç kanë qenë mijëra vjet më parë. Ato i janë nënshtruar një ndryshimi e zhvillimi të ngadalshëm e shkallë-shkallë, gjersa kanë arritur në gjendjen e tyre të sotme.

Gjuha shqipe, ashtu si të gjithë gjuhët e tjera simotra, gjatë këtij ndryshimi e zhvillimi historik ***ka ruajtur disa tipare thelbësore të trashëguara nga një fazë e hershme indoevropiane, ka humbur disa të tilla, dhe ka zhvilluar disa tipare e elemente të reja***. Elementet e trashëguara dhe risitë në të gjitha nënsistemet janë shkruar duke plotësuar njëri-tjetrin dhe duke formuar kështu një të tërë organike.

²⁶ E. Çabej, «Hyrje në historinë e gjuhës shqipe», në *Studime gjuhësore*, III, Prishtinë, 1976, f. 13

Për origjinën e shqipes ka pasur shumë hipoteza, jo rrallë me sfond nationalist e politik, por tashmë është vërtetuar se ajo është *bijë e ilirishtes jugore*²⁷. Ideali i historisë së një gjuhe, - shkruan E. Çabej, - do të ishte që të njihej kjo gjuhë në të tërë fillin e zhvillimit të saj, duke shkuar që në fillim e gjer në fund; atëherë do të mund të ndiqej ky zhvillim nëpër etapat e tij të brendshme, si dhe do të shiheshin qartë marrëdhëniet e jashtme, lidhjet që ka pasur ajo gjuhë me gjuhët e tjera. Mirëpo, një ideal i tillë zakonisht nuk arrihet. Asnjë gjuhë e botës nuk njihet që nga fillimet e saj.²⁸

Me historinë e saj janë marrë shumë studiues shqiptarë dhe të huaj. Akademiku shqiptar, prof. E. Çabej e ndan *historinë e gjuhës shqipe* në dy periudha të mëdha: në periudhën prehistorike të gjuhës, që, si më e lashta, është edhe më e errëta nga periodat e historisë së shqipes²⁹, dhe në periudhën historike.

Edhe *periudhën historike* ky studiues në zë, e ndan përsëri në dy periudha:

- a. Periudhë parashkrimore
- b. Periudha e re, që kurse shkruhet gjuha.

Edhe *fazën (periudhën) parashkrimore* e ndan në dy periudha. Sipas tij, “brenda një periodizimi të kësaj historie gjuhësore arrihet një periudë e dytë, periudë që përfshin zhvillimin e gjuhës në kohën historike. Kjo vetvetiu ndahet në dysh: në *fazën antike* e në *fazën mesjetare*, të dyja faza të periudës paraliterare, d.m.th. të një kohe të gjuhës të padokumentuar me shkrime shqip. Megjithëse për punë të kësaj mungese shumë pjesë të kësaj periode mbeten të errëta, prapëseprapë tani historia e gjuhës paraqitet më e qartë”³⁰.

Prof. E. Çabej i mëshon faktit (i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me punimin tonë) që “nga marrëdhëniet e shqipes me dy gjuhët klasike të antikitetit (nënkupto *greqishten e vjetër dhe latinishten*, - shënimi ynë, S.D.) dhe në mesjetë me gjuhët fqinje, gjuhë përgjithësisht të njohura më mirë se shqipja në atë kohë, ndriçohet nga shumë anë edhe historia vetë e kësaj gjuhe. Gjeografikisht kjo pjesë e historisë së shqipes do të merret kryesisht me marrëdhëniet që ka pasur kjo edhe me gjuhët e tjera të Gadishullit të Ballkanit.”³¹

Me periodizimi e gjuhës shqipe është marrë edhe S. Riza³². Prof Sh Demiraj shkruan se Selman Riza, si shpreh mendimin se “poshtë-lart historia e gjuhës sonë duhet periodizuar paralelisht me historinë e popullit tonë”, shton se historia e gjuhës shqipe “duhet ndarë në tre periudhat e njohura: *të lashtësisë, të mesjetës e të kohëve të reja ose*

²⁷ E. Çabej, «Hyrje në historinë e gjuhës shqipe», në *Studime gjuhësore*, III, Prishtinë, 1976, f. 11-44

²⁸ E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në “Studime”, III, Prishtinë, 1976, f. 7

²⁹ Prof. E. Çabej shkruan se “Shqiptarët paraqiten historikisht si një popull i dalë në kohë prehistorike nga vise jashtë Ballkanit dhe që erdhi e nguli në ato kohë të lashta në brigjet lindore të Adriatikut. Me këtë ata u bënë një popull i Mesdheut, hynë përgjithmonë në sferën e kulturës mesdhetare. Vendi që zuri ky popull në brigjet e Adriatikut caktoi përfundimisht edhe fatet e tij historike e bashkë me këto edhe zhvillimin që mori gjuha e tij. Ky zhvillim për periudhën antike të shqipes përcaktohet në mënyrë të prerë nga kontaktet e fqinjësisë, e pikërisht më një anë nga afërsia e sferës kulturore të Helenëve, më anë tjetër nga sundimi i gjatë i Romakëve, pra gjithsesi nga rrethi i kulturës greko-latine”.

³⁰ Shih më gjerë E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në “Studime gjuhësore”, III, Prishtinë, 1976, f. 72

³¹ Shih më gjerë E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në “Studime gjuhësore”, III, Prishtinë, 1976, f. 72

³² S. Riza, *Fillimet e gjuhësisë shqiptar*, Prishtinë, 1996, f. 223- 352

moderne". Secilën nga këto tri periudha a i pastaj e ndan në dy faza. Kështu për periudhën e parë dallon *shqipen e lashtësisë së hershme* dhe *shqipen e lashtësisë së vonë*, periudhën e dytë e ndan në *shqipen e mesjetës së hershme* (shek. V-XII) dhe *shqipen e mesjetës së vonë* (XII-XV), ndërsa periudhën e tretë (shqipen e kohëve të reja) e ndan në *shqipen e teksteve të vjetra* (nga mesi i shek. XVI deri në mes të shek. XVIII), në *shqipen parabashkëkohore* (nga mesi i shek. XVIII deri në Rilindje) dhe në *shqipen bashkëkohore* (nga Rilindja e tËhu).

Ky periodizim, i historisë së gjuhës shqipe - thotë prof. Sh. Demiraj, -bërë sipas një kriteri që autori (S. Riza) e quan *konvencional*, nuk mbështetet në të dhëna gjuhësore. Si rrjedhim nuk del e qartë, p.sh., se në se qëndronte dallimi midis shqipes së mesjetës dhe asaj të lashtësisë.³³

Me periodizimin e shqipe janë marrë edhe albanologë të tjerë të huaj (si A.V. Desnjicakaja) apo shqiptarë (B. Bokshi) etj.³⁴

Kurse vetë akademik prof. Sh. Demiraj, që është marrë në mënyrë tërësore dhe gati shteruese me historinë e gjuhës shqipe, pranon se historia e gjuhës shqipe mund të ndahet në katër periudha kryesore³⁵:

a. Periudha e parë, (shqipja e vjetër) fillon jo më vonë se shek. VI i erës sonë deri aty nga shek. VII-VIII. Ndër të tjera gjatë kësaj periudhe është përvijuar edhe ndarja dialektore midis të folmeve veriore dhe jugore nëpërmjet proceseve divergjente të njohura: rotazmi dhe ndërrimi i *a-së* para bashkëtingëlloreve hundore në *ë* në të folmet jugore dhe hundorëzimi i *a-së* së para bashkëtingëlloreve hundore në *ë* në të folmet veriore.

b. Periudha e dytë (ose *shqipja e mesme*) vjen deri në shek. XIV-XV dhe karakterizohet nga një zhvillim konvergjent dhe pjesërisht divergjent i dy dialekteve të përvijuara kryesisht gjatë periudhës së parë. Struktura gramatikore shqipes në këtë periudhë pasurohet me forma të tilla si ato të *kohës së kryer*, të *së ardhmes*, të *habitores* si dhe me format e pashtjelluara të tipit *tue / duke punuar* dhe *pa punuar*. Ndër të tjera në këtë kohë zhvillohet në dialektin verior edhe forma e pashtjelluar e tipit *me punue*.

c. Periudha e tretë (shqipja e re) vjen deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare (d.m.th., deri në gjysmën e dytë të shek. XIX), sipas prof. Sh. Demiraj, karakterizohet nga një konsolidim i mëtejshëm i strukturës gramatikore, e cila pasurohet edhe me forma e pashtjelluara të ndërtuara me pjesëmarrjen e emrit prejpjesor asnjanes (për të punuar, me të ardhur, një të ardhur. Gjithashtu thjeshtohet më tej sistemi rasor tek emrat, mbiemrat dhe përemrat, dobësohet gjinia asnjanesë, duke u shndërruar më në fund në një gjini mbeturinore etj.³⁶

d. Periudha e katërt (shqipja e sotme) karakterizohet kryesisht nga përpjekjet për një zhvillim konvergjent të gjuhës së shkruar. Këto përpjekje që nisin qysh në kohën e Lëvizjes Kombëtare të Rilindjes, marrin një hov të madh dhe bëhen më të vetëdijshme sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, "kur u krijuan edhe kushtet objektive për zhvillimin e një gjuhe letrare të njësuar me norma të përpunuara në të gjitha

³³ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 206

³⁴ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 206-208

³⁵ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 208-210

³⁶ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 210

*nënsistemet e saj. Gjatë kësaj kove vihet re një ndikim gjithnjë e më i fuqishëm i gjuhës së shkruar mbi gjuhën e folur, çka e ka përshpejtuar procesin e afrimit ndërdialektor*³⁷.

B. Vështrim i shkurtër i historisë së gjuhës greke

Greqishtja që flitet sot nga populli grek, është pasardhëse e drejtpërdrejtë e greqishtes së vjetër. Por ajo nuk është e njëjtë me nënën e saj. Ndryshime të ngadalta, zakonisht të padukshme, e transformuan atë në rrjedhë të shekujve dhe të mijëvjeçarëve, në përputhje me ligjet që drejtojnë zhvillimin e çdo gjuhe. Duke zënë fill nga tipi i lashtë i kryehershëm i saj, ajo mori gjatë kohëve forma të larmishme derisa arriti në tipin e sotëm, që u formësua në shekujt e fundit. Për nga struktura gramatikore, ajo është vetë gjuha e lashtë që, e folur nga grekët pa ndërprerje për rreth katërmijë vjet, ndryshoi nga goja në gojë dhe nga brezi në brez, për të marrë formën që ka sot.³⁸

1. Faza më e lashtë e gjuhës greke është **protogreqishtja** (*πρωτοελληνική*). Atë e flitnin paraardhësit e grekëve, përpara se këta të fundit të quheshin kështu dhe të zbritnin e të vendoseshin në trojet greke. Ngjarja e parë e rëndësishme e historisë gjuhësore të grekëve është përfshirja në gjuhën e tyre e një numri të madh fjalësh prej gjuhëve të popujve që banonin deri atëherë në skajin jugor të Ballkanit, në mijëvjeçarin e tretë para erës sonë.

2. **Gjuha e vjetër greke** paraqitet qysh në fillimet e saj e ndarë në **dialekte** dhe në **nëndegë** të tyre. Në çdo vend flitet dhe shkruhet në një formë dialektore të veçantë. Prej këtyre të folmeve dialektore formohen **koine lokale** derisa në shekullin e pestë, në kulmin e zhvillimit politik dhe kulturor të Athinës dhe si rezultat i epërsisë së saj, fillon të mbizotërojë **dialekti atik**. Ai bëhet fillimisht gjuhë e aleatëve të Athinës dhe me kalimin e kohës shtrihet tek një numër gjithnjë e më i madh grekësh.

Dialekti atik është baza mbi të cilën u formua e para **koine** (*κοινή*) e mbarë helenizmit antik, e quajtur ndryshe edhe **koineja helenistike** ose **aleksandrine**, me kufij

³⁷ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 210

³⁸ Prof. E. Çabej pranon se “Greqishtja, e dokumentuar me shkrim qysh nga shek. XIV para erës së re, ndahet zakonisht në tri periudha: **në greqishten e vjetër**, **në greqishten e mesme** dhe **në greqishten e re**. Greqishtja e vjetër shkon përafërsisht deri në shekullin VI të erës së re, kur fillon greqishtja e mesme, e cila shkon përafërsisht deri në shekullin XII. Kurse greqishtja e re përfshin periudhën pas shekullit XII. Greqishtja e vjetër ka qenë e ndarë në këto dialekte kryesore: **dialekti dorik** ose grupi i të folmeve të greqishtes veriperëndimore. Këtu përfshihen edhe të folmet e ngulimeve dorike të Italisë, të Kretës, Rodit etj.; **dialekti eolik**, që përfshinte të folmet e ishullit Lesbo dhe ngulimeve eolike të Azisë së Vogël, të folmet e Thesalisë dhe të Beotisë; **dialekti arkado-qipriot**; **dialekti jonik-atik**, që përfshinte të folmet jonike të Azisë së Vogël, të ishujve jonikë, të ishullit Eubea dhe të Atikës; **mikenishtja** ose dialekti i mbishkrimeve të *Linearit B*, të zbuluar në Knosos, Pylos, Mikenë dhe Tebë dhe të deshifruara në 1953. Gjuha e këtyre mbishkrimeve u takon shekujve 14-13 para erës sonë.”. *Shih më gjerë* E. Çabej, *Studime gjuhësore*, Prishtinë, 1977

kohorë nga shekulli i tretë p.l.K. deri në shekullin e tretë të e.s. Ajo zë fill pas periudhës *klasike* të antikitetit grek dhe ngjizet në rrjedhë të shekujve me elemente jo vetëm të dialektit atik por edhe të dialekteve të tjera e sidomos të atij jonik. Këtë greqishte të përbashkët e flitnin si grekët ashtu edhe popullsitë jogreke të Lindjes (Azi e Vogël, Siri, Persi madje edhe Egjipt), që u helenizuan pas nënshtrimit të tyre prej Aleksandrit të Madh dhe më vonë prej pasardhësve të tij romakë. Kjo gjuhë e larguar tashmë në kohë prej epokës klasike, për shkak të shtrirjes së madhe hapësinore arriti të bëhej gjuhë ndërkombëtare e një bote të tërë dhe mjet i përbashkët komunikimi i miliona njerëzve. Rrethanat e reja dhe roli i ri bënë që ajo të bjerrë një numër tiparesh të fazës së hershme dhe të shfaqë risi të shumta.

Në *fonetikë* shumë zanore, diftongje dhe bashkëtingëllore evoluojnë dhe marrin shqiptimin që kanë sot. Theksimi ndryshon rrënjësisht dhe nga muzikor bëhet dinamik, tre theksat e lashtë e humbasin larminë dhe rolin e tyre; ritmi i gjuhës pëson ndryshime që lidhen me zhdukjen e dallimit të zanoreve të gjata dhe të shkurtra.

Si pasojë e ideve të reja politike dhe të kushteve të reja, ndryshon dhe rinovohet gjithashtu edhe *fjalori*, i cili duhet të shprehë realitetin e një bote të re, asaj greko-orientale, romake dhe të krishterë. Shumë fjalë të hershme të trashëguara ndryshojnë shpesh kuptim (p.sh. folja *βρέχω*, “njom”, merr kuptimin *ῥω*, “bie shi”); të tjera humbasin (p.sh., folja *οἴς-οἰός*); fjalë të huaja bëhen pjesë e fjalorit të greqishtes; fjalë deri atëherë me përdorim të shpeshtë hasen më rrallë dhe veniten ose ua lënë vendin (kur konceptet që ato shprehin vazhdojnë të ekzistojnë) fjalëve të tjera të burimit grek a të huaj ose fjalëve të reja të *prejardhura* që shfaqen me shumicë në vend të fjalëve të vjetra. (p.sh., *έρυθρός* zëvendësohet nga *κόκκινος*, që rrjedh prej *κόκκος*, emri i një insekti parazit të drurit të prrallit, nga i cili përgatitet ngjyrë e kuqe). Shumë fjalë, veçanërisht ato me pak rrokje ose të lakimit të tretë, zëvendësohen nga trajtat e tyre zvogëluese (*άλως > άλώνιον, κτεῖς > κτένιον*).

Në *morfoloji* kufizohet shumëllojshmëria e trajtave, që është shenjë dalluese e fazës së hershme të gjuhës. Mënjanohet përfundimisht numri dual (dy) dhe zbehet përdorimi i mënyrës dëshirore. Trajta të tëra mënyrash dhe kohësh foljore si dhe forma të tjera përdoren gjithnjë e më rrallë (*ακούσομαι; ἀκούσω; ἐφθην, ἐφθασα*). Pakësohen trajtat e parregullta emërore (*ναυς, νηός, πλοῖον, πλοίου; οὔς, ώτός, ώτίου, ώτίον, ωτίου*) dhe foljore (ήν: *ήμην, οἶδα, οἶσθα, ἴσμεν, ἴσασι: οἶδα, οἶδες, οἶδαμεν, οἶδασιν*). Lakimi atik del nga përdorimi dhe lakimi i tretë fillon të asimilohet prej lakimit të parë (*τόν βασιλέν, sipas τόν ταμίαν, τούς μήνες sipas οί μήνες, dhe më pas οί παροδίτες, τάς τιμές; ή Κλειώ - τής Κλειώς*). Foljet më *-μι* dalin tani më *-ω*. Në vend të së kryerës *έγραψας* përdoret trajta *έγραψες*, e formuar sipas *έγραφες*; në të pakryerën shkruajmë *έγραφον* (unë), por edhe *έγραφαν* (ata) në vend të *έγραφον*, sipas zgjedhimit të foljes *έλυσαν*.

Me këto ndryshime shmangen shumë parregullsi të gjuhës antike greke; kufizohet larmia e lakimeve dhe gjuha bëhet më e thjeshtë.

Në të njëjtën kohë, nga pikëpamja e *sintaksës* gjuha bëhet më pak sintetike dhe më shumë analitike. Tani përdoret një numër më i madh fjalësh për të thënë atë që më parë shprehej me më shumë mjete morfolojike. Bëhet më i shpejtë përdorimi i parafjalëve dhe i formave rasore me parafjalë.

Pjesa më e madhe e këtyre ndryshimeve, disa prej të cilave marrin fill qysh në epokën klasike, vazhduan të thellohen derisa më pas morën formë të plotë- kallëzoren më *-εσ* të lakimit të tretë të emrave (*ελάσσονες*), e gjejmë të dokumentuar qysh në shekullin e gjashtë p.e.s.: te Ksenofoni, në vend të ndajfoljes *έτι* lexojmë *άχμήν*, që është trajta pararendëse e ndajfoljes *αχόμη* të greqishtes së re: *ό όχλος άχμήν διεβαινε*.

Në këto risi të *koinesë* helenistike gjejmë caq shumë shenja pararendëse të gjuhës së re, saqë mund ta konsiderojmë me të drejtë moment shumë të rëndësishëm të historisë gjuhësore të grekëve, fillim dhe shfaqje të parë të greqishtes së sotme.

Dhiata e re është një ndër shkrimet e para që pasqyron këtë stad historik të gjuhës greke dhe, për këtë arsye, një nga burimet kryesore të saj.

Në të njëjtën periudhë, që përkon pak a shumë me fillimet e krishterimit, zë fill edhe *diglosia* (*διγλωσσία*), e cila, në forma të ndryshme, vazhdon deri në ditët tona. Njerëzit e letrave fillojnë të shkruajnë jo më në gjuhën e kohës së vet – siç ndodhte pak a shumë në antikitetin klasik e deri atëherë – por, në masën që munden, përdorin dialektin antik të shkrimtarëve të vjetër, të cilët tashmë konsiderohen klasikë dhe model për tu imituar. Ata shpresojnë se kësaj do të mund të rishkruhen vepra me shkëlqimin e atyre të epokës klasike.

Ky fenomen, që mori emrin *aticizëm*, nuk mundi të frenojë rinovimin dhe zhvillimin e gjuhës së folur, e cila vazhdonte të ndryshonte për dymijë vjet me radhë e deri më sot. Vetëm se ai arriti të mbizotëronte shpejt në gjuhën e shkruar dhe, qysh atëherë, cilido që shkruante ndikohej pak a shumë nga ideali dhe rregullat e gramatikës së lashtë, e cila konsiderohej deri edhe në shekullin tonë si e vetmja gramatikë e saktë. Në këtë mënyrë, aticizmi pati pasoja të rënda dhe shkatërrimtare në zhvillimin dhe jetën shpirtërore të kombit grek. Krahas dyzimit gramatikor që ishte pasojë e tij dhe që thellohej me kalimin e kohës, aticizmi kultivoi te çdo folës i gjuhës edhe një lloj dyzimi psikologjik: pengoi të shprehurit e lirë, veçanërisht në gjuhën e shkruar; u bë pengesë për lulëzimin dhe ndikimin e letërsisë në publikun e gjerë, krijoi një hendek midis popullit dhe shkollë, vepër e së cilës është përçmimi me anë të gjuhësi pasurive të kulturës kombëtare.

3. Një fazë interesante historisë së gjuhës greke është *greqishtja mesjetare* (330-1453 pas l.k.) që karakterizohet nga ndryshimi i ngadaltë dhe bashkëkohorizimi i gjuhës greke. Mund të themi se në shekullin e njëmbëdhjetë ajo i afrohet shumë formës së saj të sotme. Ndryshimet në shqiptim dhe sheshimi i pjesës më të madhe të parregullsive të sistemit emëror marrin trajtë të plotë. Rasa dhanore nuk përdoret më: lakimi i tretë i hershëm përzihet gjithnjë e më shumë me të parin dhe lakimi i ri shfaqet tashmë i plotë (*ὁ πατέρας – τοῦ πατέρα, ἡ πόλις – τῆς πόλης, ἡ Σαλαμίνα, οἱ ταμίες, οἱ διοίχσεις*). Në sistemin foljor zënë vend të qëndrueshëm trajtat perifrastike *θέλω γράφειν, ἔχω κατακλιθῆν*, pjesorja veprorë e kohës së tashme bëhet e palakueshme më *-οντα(ς)*. Shfaqen pjesëzat *va, aς*. Në fjalëformimin zgjerohen mundësitë shprehëse të gjuhës me prapashtesa të reja fjalëformuese dhe me fjalë të përbëra si: *καλοκτένιστος, παχυμουλαράτος, ἀκροκτύπησα, συχνοέρχομαι*.

Disa shekuj më pas, në kohën kur bie Perandoria Bizantin, *gjuha e gjallë është pothuaj identike me greqishten e sotme*.

Gjatë gjithë kësaj periudhe pjesa më e madhe e njerëzve të letrave, të ndikuar prej idealit atik, mbajnë qëndrim përbuzës ndaj gjuhës së gjallë dhe nuk denjojnë ta përdorin në shkrimet e tyre. *Gjuha e shkruar imiton sa më besnikërisht gjuhën klasike pothuaj gjatë gjithë periudhës mesjetare*. Kjo prirje forcohet në shekujt e fundit bizantinë, ndonëse bëhen përpjekje edhe në drejtim të kundërt. Në këtë mënyrë, thellohet gradualisht dallimi i gjuhës së shkruar nga gjuha e folur, e cila merr tipare bashkëkohore në përputhje me evolucionin natyror të saj.

Në periudhën e *pushtimit osman* vërejmë të forcohet nga njëra anë prirja e diferencimit të dialekteve dhe, në të njëjtën kohë, të formohen *koine lokale* të reja. Mungesa e arsimit në shekujt e parë pas rënies së Bizantit pati si pasojë varfërimin e fjalorit, i cili shfaq mangësi në shumë fusha kuptimore. Duke iu afruar fundit të kësaj

periudhe, vihet re një kthesë e rëndësishme në historinë kulturore të helenizmit të ri, dhe kjo u pasqyrua në ngjizjen e gjuhës së folur dhe të shkruar. Në Kretë fillon kultivimi i një lloj *koinëje letrare* që përfaqësohet nga veprat e *Erotókritos*, *Flijimi i Avraamit*, *Erofili* etj.

Kjo përpjekje shpresëdhënëse ndërpritet me pushimin e Kretës nga turqit më 1669, por gjallërimi rreth vitit 1800 i lëvizjes për arsim, përhapja e tipografisë, idetë e reja që vinin nga Evropa dhe, përgjithësisht, nevoja për përparim, i japin shtysë një fryme të re në rrethet intelektuale. Ajo ka për qëllim të sanksionojë si gjuhë të shkruar të mbarë kombit *koinenë popullore* në vend të gjuhës arkaike të Bizantit dhe të Kishës. Kjo gjuhë duket tashmë e formuar në elementet bazë të saj dhe përdorej sidomos në qendrat e mëdha urbane të jugut të Greqisë së atëhershme. Një zgjidhje të tillë e donin mendjet më të ndritura të intelektualëve dhe të klerikëve të kohës, e donte madje edhe Koraisi, ndonëse në një bazë disi të ndryshme nga të tjerët. Veçse rrënjët e aticizmit të vjetër nuk mund të priten kaq lehtë. Më të shumtët e njerëzve të letrave vazhdonin të mbanin qëndrim mospërfillës ndaj gjuhës popullore dhe këmbëngulnin që si gjuhë e kombit të sanksionohej gjuha arkaike. Zgjidhja që, më në fund, mbizotëroi – në thelb rrugëdalje kompromisi – ishte “pispillosja” e gjuhës së re, me fjalë të tjera purifikimi i saj që, siç besonin ideatorët e tij, do t’i çelte popullit grek rrugën drejt rilindjes së shpejtë kombëtare.

4. Në fund të shekullit të XVIII dhe fillimi i shekullit XIX kemi pamjen e *greqishtes së re* (rreth vitit 1800), e kristalizuar në sferën e kuptimeve që i përgjigjeshin nivelit të jetës dhe arsimit të atëhershëm të popullit grek, por edhe me mundësi shprehëse të pashtershme dhe plasticitet të papërsëritshëm, që duken në pasurinë *fjalëformuese* të gjuhës. Këto prirje i karakterizon kompozimi i larmishëm dhe numri i madh i prapashitesave *fjalëformuese*, që bëjnë të mundur të shprehen shkurt dhe saktë kuptime dhe ngjyime nga më të ndryshmet.

Sistemi *morfologjik*, më i rregullt dhe më i thjeshtë se ai i greqishtes së vjetër dhe mesjetare, pasurohet në disa raste me mjete të reja, siç ndodh, p.sh., me kohën e ardhme, e cila veçon veprimin e çastit, atë që do të bëhet një herë (*θα πέσεις, θα τραγουδήσω*), nga veprimi i vazhduar a i përsëritur (*θα πέφτεις, θα τραγουδώ*). Por, marrë në tërësi, sistemi morfologjik është më i thjeshtë. Prej rasave fillon të lëkundet edhe gjinorja, e cila në disa raste nuk ka shumës (nuk e formojnë, p.sh., emrat femërorë si: *οι βοσχοπούλες, οι μύτες, οι στενοχώριες*, dhe e formojnë me vështirësi emrat femërorë të huazuar: *οι γαλότσες, οι τιράντες*), por edhe në njëjës, së paku në shumë të folme lokale. Ky thjeshtim morfologjik nuk ndikon në aftësinë shprehëse të gjuhës, përderisa ajo arrin të shprehë me mjete të tjera sintaksore atë që deri dje e shprehte me trajta të veçanta. E njëjta gjë pati ndodhur edhe me greqishten e epokës klasike, e cila thjeshtoi sistemin e mëparshëm morfologjik që ishte më i pasur, pa dëmtuar ndërkaq forcën shprehëse të saj.

Gjatë shekullit XIX, sidomos në periudhën para çlirimit, në kushtet e reja të jetës intelektuale dhe politike, shënohet një epokë e re jo aq për zhvillimin ngushtësisht gramatikor, sesa për *formësimin leksikor* të gjuhës së re. Ndërsa me largimin e turqve harrohen ose lihen mënjanë shumë fjalë të huaja të shtetit deri atëherë turqishtfolës, hyjnë në përdorim qindra e qindra fjalë, sidomos nga ato që shprehin kuptime të reja. Ato janë të shumta, siç është e natyrshme të ndodhë në një komb që përpiqet të rilindë e të bëjë të vetat arritjet materiale dhe kulturore të qytetërimit të zhvilluar evropian. Kjo masë e madhe fjalësh librore që fitojnë qysh atëherë të drejtën e qytetarisë nën ndikimin e shkollës dhe të gjuhës së shkruar, çoi jo vetëm në krijimin e një leksiku me natyrë

dyfishe (popullore dhe librore), por edhe la gjurmë në fonetikë dhe në sistemin fjalëformues të gjuhës popullore deri atëherë të pakultivuar.

Gjuha e përbashkët e folur, e formuar fillimisht në qendrat urbane të Peloponezit dhe më pas në Athinë, kryeqytetin e dytë të shtetit të ri grek, shtrihet gjithnjë e më shumë e deri në ditët tona, duke ndjekur zhvillimet e jetës shoqërore dhe intelektuale si dhe zgjerimin territorial të shtetit, i cili përfshin në kufijtë e vet një numër gjithnjë e më të madh greqishtfolësish dhe, më në fund, masat e refugjatëve që pasuan katastrofën e Azisë së Vogël (1922). Dialektet e greqishtes së re kufizohen nga ana territoriale, sfera e përdorimit të tyre ngushtohet dhe humbasin pastërtinë e mëparshme duke u përzier me trajta të mbarë gjuhës.

Si gjuhë e përbashkët e shkruar u sanksionua qysh në fillim pothuaj të shekullit XIX e ashtuquajtura gjuhë *puriste*, **katharevusa** (*καθαρευουσα*), gramatika e së cilës mbështetet jo në gjuhën e folur të kombit, por në dialektin e lashtë atik. Bëjnë përjashtim këtu vetëm rastet kur trajtat e lashta gramatikore lidheshin me struktura sintaksore specifike të greqishtes së vjetër. Me purizmin gjuha e shkruar bëhet gjithnjë e më arkaike, por në të njëjtën kohë edhe më e vështirë në të mësuar e në përdorim, duke humbur kështu destinacionin e saj.

Ndërkaq, pas disa luhatjesh të fillimit, *letërsia e re*, e ndikuar prej manifestit të *Psiharisit*, braktis me vendosmëri gjuhën që mëton të bëhet mbarëkombëtare dhe ndjek shembullin e poetëve të Ishujve të Detit Jon që i mbetën besnikë gjuhës popullore, **dhimotiqi** (*δημοτική*), për të cilën arkaistët mendonin se ishte “vulgare” dhe e paaftë të shprehte kuptime të larta dhe fisnike. Në kundërshtim me sa shpresonin në fillim ithtarët e saj, *katharevusa* nuk mundi të merrte jetë në buzët e popullit grek. Në këtë mënyrë, *diglosia* e re që krijoi purizmi i shekullit XIX, me pasojat e shumëfishta dhe shkatërrimtare të saj, nxjerr gjithnjë e më shumë në pah nevojën e një reforme gjuhësore, para së gjithash në arsim, si fillimin dhe simbolin e ndryshimit dhe të rinovimit thelbësor të jetës shoqërore greke.

5. Në shek. XX greqishtja njohu zhvillim të fuqishëm dhe arritja më e madhe për kohën pranohet vendosja e variantit **dhimotiqi** (*δημοτική*) në vitin 1976 në statusin e standardit, çka nënkuptoi edhe reforma të mëdha sidomos në shkrim.

2. INTERFERENCAT LEKSIKORE E SEMANTIKE NDËRMJET GREQISHTES DHE SHQIPES

(Gjuhë të hapura në dhëniet dhe në marrjet leksiko-semantike)

Gjatë kontakteve historike, ekonomike e kulturore, populli grek dhe ai shqiptar kanë dhënë e kanë marrë ndërmjet tyre dhe *gjurmët e këtyre marrëdhënieve me drejtim përgjithësisht dykahësh pasqyrohen edhe në gjuhë*, ku dallohen, krahas shtresës së dukurive anase, edhe një shtresë elementesh të huaja, *huazimet*. R. Memushaj pranon se “Huazimet përbëjnë një dukuri të zakonshme për të gjitha gjuhët. Ato prekin të gjitha rrafshet gjuhësore: fonetikën, morfologjinë, leksikun dhe sintaksën. Por rrafshi që preket drejtpërdrejt dhe më shumë nga huazimet, është *leksiku*. Meqenëse janë një dukuri shumë e përhapur në të gjitha gjuhët, huazimet leksikore paraqesin një interes të veçantë.”³⁹

Kështu, duke iu referuar edhe studimeve të shumta sidomos të historisë së shqipes, ne flasim *për huazime të greqishtes në shqipe* dhe *për huazime të shqipes në greqishte*. Kjo tregon së pari se gjuhët janë të hapura ndaj njëra tjetrës, por karakteri dhënës dhe marrës ka kushtëzime të rëndësishme dhe të ndryshme, që lidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me statusin politik të popullit dhe të gjuhës që ai mbart, me statusin ekonomik, me statusin shoqëror, me statusin ushtarak (sidomos në historinë e hershme), me statusin kulturor, me statusin religjioz (fetar), me statusin rajonal dhe atë ndërkombëtar të gjuhës, me kohën e dokumentimit dhe me shkallën e përpunimit të saj, me funksionet stilistikore etj.

Prof. E. Çabej pranon se “Në lidhjet që kanë gjuhët në mes tyre të marrët e të dhënë janë me rëndësi të barabartë.” Duke u mbështetur në këta parametra ne pranojmë se shqipja dhe greqishtja, si gjuhë të popujve në kontakt gjeografik e historik kanë qenë të hapura ndaj njëra-tjetrës, por potencialiteti i tyre dhënës dhe marrës nuk ka qenë i njëjtë, i barabartë dhe reflektiv.

³⁹ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2008, f. 178

A. HUAZIME LEKSIKORE (INTERFERIME) SHQIPE NË GREQISHTE

Ne këtu po ndalemi jo vetëm tek pesha dhe rëndësia e këtyre huazimeve (që në fund të fundit, kur kanë zënë vend i quajmë edhe *interferime leksikore dhe semantike*), por tek ana sasiore. **Faktet gjuhësore tregojnë se shqipja, për njërin apo tjetrin arsye, për njërin apo tjetrin status ndaj greqishtes, ka marrë më shumë prej saj sesa ka dhënë.** Numri i fjalëve që shqipja u ka dhënë jo vetëm greqishtes, por edhe në gjuhëve të tjera ballkanike (rumanishtes, serbishtes etj.) është rreth 70⁴⁰.

Prof. E. Çabej thotë “se kur të vështrohen marrëdhëniet e shqipes me gjuhët fqinje në tërësinë e tyre, do të pranohet që roli dhënës i kësaj gjuhe ndaj atyre gjuhëve është çmuar disi nën shkallën reale që i përket... Më anë tjetër elementet e shqipes që kanë shkuar në gjuhët fqinje janë me rëndësi edhe për vetë historinë e kësaj gjuhe, për arsye se ato kanë ruajtur në ato idioma shpesh herë trajta më të vjetra, të cilat në gjuhën vetë që i dha, në shqipen, humbën me kohë dhe u zëvendësuan me të tjera...”⁴¹

Po ky studiues i historisë së gjuhës shqipes, duke pranuar dhe mendimet e albanologëve të tjerë, shkruan se “Ndikimi i shqipes mbi greqishten e re Gustav Majeri e çmoi me dishka më shumë se 60 fjalë. Këtë numër gjurmimet e mëpastajme e kanë shtuar. Po t’u hidhet një vështrim veprave leksikore që u botuan më vonë, shihet se ky ndikim përfshin edhe fjalë të tjera, si të mbarë gjuhës, si dialektore”⁴².

Dhe këtu do të veçojmë fjalë të tilla, si:

a. në greqishten bizantine: *rentai* (nga *rend*).

b. në greqishten e re: *cupra* (*çupë*), *vllamis* (*vëllam*); *kopella* (*kopile*); *botë* (*shtamë*), *rusem* (*zbres*), *lerë* (*zhul*), *kulpër*, *venjë* (*dëllinjë*), *dot* (*pjësëz*); *dhasos* (*dash*), *kaciqi* (*kec*), *vargër* (*dash a çjap i patredhur*), *dosa* (*dosë*), *larë* (*pullë a njollë me ngjyra të ndryshme*, *zakonisht të bardhë, që kanë shtazët në lëkurë*; në greqishte *λάρος* – *pulëbardhë*); *carkos* (*thark*), *bruc* (*bërruc*), *shark* etj.

Por *studimet e dekadave të fundit, në Greqi nxjerrin një numër shumë të madh huazimesh nga shqipja*. Këto duhen parë me shumë kujdes, sepse një pjesë shqipja mund t’i ketë huazuar vetë, madje edhe nga greqishtja.

Kështu N. Andrioti, në *Fjalorin etimologjik*, botuar në Selanik, jep si fjalë dhe ndajshitesa shqipe njësitë e mëposhtme: **αρβανίτης** o, μεσν. Αρβαν – ίτης < τσπων. Αρβανα < αλβ. Arbena (Π. φουρικ. στην Αθήνα 43, 3).

γκιώνης o, είδος πουλιού· αλβαν. gjon.

γκιόσα η, γριά γίδα· σλαβ. kozje διά της Αλβανικής (G. Meyer, N. S. 2, 65).

⁴⁰ Shih më gjerë E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në “Studime gjuhësore”, III, Prishtinë, 1976, f. 72

⁴¹ Shih më gjerë E. Çabej, *Shqipja dhe gjuhët e fqinje* në “Studime gjuhësore”, IV, Prishtinë, 1977, f. 334

⁴² Shih më gjerë E. Çabej, *Shqipja dhe gjuhët e fqinje* në “Studime gjuhësore”, IV, Prishtinë, 1977, f. 328

γκοριτσιά η, αγριαπιδιά· αλβαν. goritse (G. Meyer, N. S. 2, 65)

γούβα η, λάκκος· μεσν. γουβάς < μεταγν. κύβη (B. Φάβ. στο Λεξ. Δελτ. 2, 87 κ. εξ.). Κατά G. Meyer, Alban. Ëört. αλβαν gunë.

διάτα η, παραγγελιά· από το ρ. διατάζω υποχωρητ.).

-έζα κατάλ. τοπωνυμίων: Αγριλ – έζα, Βαλανιδ – έζα, Καλογρ – έζα, Μυγδαλ – έζα, Πρέβ – έζα, κ. τ. ό. · αλβ. κατάλ –eza (K. Άμαντ. Γλωσσ. Μελετ. 97, Π. Φουρίκ. στην Αθήνα 27, 345 και 41, 97 κέξ.). Πβ. Κατάλ. –ίζα.

-εσης κατάλ. νεοελλ. επωνύμων: Δράμ - εσης, αλβαν. κατάλ. –esi.

ζβέρκος ο, τράχηλος· αλβ, zverk (G. Meyer N. S. 2, 66).

καλαμπόκι το, αλβ. kalambok (J. Popvitsch Indog. Forsch 15, 517).

καρούτα η, σκάφη· αλβ. karrutë.

κατσίκι το, γίδι· αλβ. kts (g. Meyer, M. S. 2, 66). kec,

κούλουμα τα, γιορτή της Καθαρής Δευτέρας· από το κούμουλα < λατιν. cumulus (= σωρός) (K. A. Ρωμαίος στην Αθήνα 32, 209). Κατ' άλλους από το αλβ. colum (= καθαρός).

κράκουρα τα, βράχοι· μεσν. κράκορα < αλβ. krakurinë (:)

λάγιος επίθ., μαύρος· ίσως από το λαγός, με αρχική σημασία: «αυτός που έχει χρώμα λαγού, γκριζός». Κατά G. Meyer, N. S. 2, 68 αλβαν. laj(= ψαρός).

λέρα η, μεσν. λέρα < ρ. λερώνω (υποχωρητ.)· πβ. απλώνω – άπλα (Γ. Χατζιδ. MNE 1, 76). Σφαλερή η ερμηνεία του J. Popovič στις Südost – Forsch. 15, 517 από το αλβαν. (= τέλμα).

λιαπης ο, Αρβανίτης· αλβ. Liar (= όνομα μιας από τις 4 αλβανικές φυλές).

μαρκαλώ οχεύω, για ζώα· αλβ. marr kal (= παίρνω άλογο) (B. Σκουβαρά, Ιχνηλ. λεξ. 60).

μπαμπέσης επίθ., άπιστος· αλβ. pabesë.

μπας (και) άκλιτ., μήπως· μεσν. μπας, από τη φρ. μην πας και. Κατά G. Meyer, N. S. 2, 69 αλβ. mbase (= ίσως).

μπέσα η, εμπιστοσύνη· αλβ. besë (G. Meyer, N. S. 2, 69 κέξ.).

πίπιζα η, είδος φλογέρας· αλβαν. pipëza.

πλιάτσικο το, λεία· αλβ. plaçkë.⁴³

Siç shihet këtu ka edhe fjalë nga latinishtja (*cumul*), apo nga sllavishtja (gorricë) etj.

Studiuesi Dh. Qiriazi (punimin për doktoraturën e ka në këtë fushë, siç do të shohim shumë herë në vazhdim dhe që është marrë jo pak me huazimet shqipe në greqishte⁴⁴) shprehet se “Shtirija gjeografike e lëndës (që ka të bëjë me huazimet shqipe në greqishte, *shënimi ynë*, S.D.) mbledhur tregon se shqipja ka lënë gjurmë më të thella në të folmet e Epirit, Thesalisë dhe të Atikës, dhe disi më të kufizuara në pjesët e tjera të territorit grek. Të shënueshme janë prurjet nga zona e Thesalisë dhe e Volosit, ku, siç dihet, gjatë mesjetës dhe më vonë pati zbritje masive të elementit arbëror. Elemente të shqipes kanë depërtuar edhe në argonë e qyteteve (νάκα naka, γκέγκε

⁴³ Shih më gjerë: N. Andrioti, *Fjalor etimologjik*, Selanik, 1992

⁴⁴ Δ. Κ. Κυριάκης, *Ελληνικές Επιδράσεις στην Αλβανική (I. Φωνητική και μορφολογική προσαρμογή των ελληνικών δανείων; II. Λεξικό των ελληνικών δανείων της αλβανικής)*, Θεσσαλονίκη, 2001

gjegje) si dhe në gjuhën e homoseksualëve (kaliardá), ku janë për t'u veçuar një numër kompozitash si αστεντούπουρος (o) 'drejtor' (<arv. άστε ντούα + πουρος 'plak, i plakur'); θεομπούκουρα (ndajf.) 'shkëlqyeshëm' (< θεο 'me kuptim intensiv' + μπούκουρα < bukur)⁴⁵.

Dh. Qiriazzi pohon, gjithashtu, se vepra "Το μεγαρικό γλωσσικό ιδίωμα (Λεξικογραφική μελέτη) e studiuesit A. Σύρκου shqyrton leksikun e zonës Megara, ku ka pasur dhe ka arvanitë. Nga lënda e pasur Qiriazzi përmend këto fjalë e shprehje: **αγιέτα μου** 'shpreh 1. optimizëm 2. tallje 3. dhembje 4. gëzim'[= α γιέτα μου < a jeta ime], **βλάμης** (o) (<vllam) 1. mik 2. dashnor', **κιούρα** (η) < qurra, **κομπόρα** (η) 'lloj këmbore' < këmbora, **κοροβέσης** (o) < korovesh, **κουρίζι** (το) 1. pjesa e sipërme e rrumbullakosur e murit 2. shtylla kurrizore' shih edhe **κουρίζα** 'shtylla vertebrore e kafshëve të imta' në Epir, e padëshmuar në fjalorët e botuar deri më tash, < kurrizi, **κόχα** (η) '1. kohë e përshtatshme për mbjellje 2. (mtf.) humor, dispozicion' < koha, **κρεσέλια** (και κρισίλια) η, (< krisël), **λαγκουμία** (η) < lakmi, **λαμπότι** (το) < labot, **λαργκói** (το) < largoi 'modesti', **λιουγκούσι** (το) 'vegël hekuri për gërryerjen e drurit' < lugës, **λιούφτι** (το) 'poshtërim, sulm' < luftë, **λιοφάτα** (η) < lofatë, **μονοφρίμα** (το) < mono + frymë, **μούλοζα** (η) dhe μούλουζα < mullëza, **μούσκια** (η) 1. mushka 2. mtf. grua, **μπότσικα** (η) < boçka, **ντελίσι** (το) 'dru aromatik' < dëllinjë, **ντράδα** (η) < dra-të, **ντρόμισες** (οι) < dromca, **ονταμπίρ** ονταμπίρ 'si i ati dhe i biri' < at' e bir, **ούστρα** (η) 'kallinjë e njomë që thërmonte bujku në pëllëmbë' < ushtër, -a, **πόρδωση** (η) και πόρδωσι (το) 'zorra e trashë' < pordhësi, **πούσι** (το) 1. bryma 2. halat e thata të pishës < pushi, **ρόδιζα** (η) < rrodhe -za, **ρουσιεφίσι** (επίρ.) < rrush e fiq, **σκούμα** (το) < shkuma, **στάλη** (η) < shtalpë, **σταμπουλάρης** (o) < strumbullari (i lëmit), **τρικούγκουλο** (το) 'sëmundje me flluskave në trup', **φρίμα** (το) < fryma etj.⁴⁶

Duhet kemi shumë kujdes në analizat që bëjmë se jo të gjitha fjalët e parashtruara më sipër janë me burim shqip.

* * *

Një fushë interesante ku janë ndalur studiues si A. Spiro, Dh. Qiriazzi etj. është dhe **ajo e leksikut të shqipes në të folmet e fshehta ballkanike**, ndër të tjera edhe ato greke. Dh. Qiriazzi thotë se "Dihet që gjuhët e fshehta përdorin në masë të madhe fjalë nga leksiku i gjuhëve të tjera për të siguruar fshehtësinë në komunikim. Përveç gjuhëve të fshehta të Epirit, ku gjejmë edhe fjalë shqipe, një rast i ngjashëm, e madje me më shumë huazime nga arvanitishtja e Peloponezitet, është gjuha e muratorëve të këtij rajoni të Greqisë. Le të shohim disa prej tyre:

Krekonika : **βερδίλης**, o 'plak' dhe t. **ζβερδίλης** < i (z)verdhur, βερδίλω, η 'plakë', **γκλιουμιστρό**, το 'qumësht' < klumështor, **γκούρα**, η 'gur', **λιάγκιρα**, τα 'lakra', **λιόκι**, το 'loqe', **μπάλτα**, η 'baltë', **μπλάθρες**, οι 'bathë', **μπότα**, η 'botë', **μούλιζα**, η (dhe πούλιζα) 'pulëza', **ντέρζα**, η 'derëza', **ντρούμιζες**, οι 'dromca', ούγιε, το 'ujë', **πίγκες**, οι 'opinga', **πρεπόσι**, το 'pudens' < preposhi, **πρίφτης**, o 'prifti', **ρογκαλάω** 'rrëkëllej', **σιουραυλάω** 'shurroj', **τέριζα**, η 'derëza'.

⁴⁵ Lënda është vjelë nga H. Πετρόπουλου, Καλιαρντά, Νεφέλη, Αθήνα, 1993

⁴⁶ A. Σύρκου, Το μεγαρικό γλωσσικό ιδίωμα (Λεξικογραφική μελέτη), Νήσος, Αθήνα 2006.

Μπαραμπάτικα: βόγγιλο, το ‘fëmijë’ < i vogël-o, μπαθεκούκια ose μπάθες ‘bathëkuqe ose bathë’, μπούκουρε ‘i bukur’, νούσε, η ‘nuse, etj.’⁴⁷

Lënda ilustruese e shfrytëzuar nga ky studiues, është marrë nga punimi *Οι παραδοσιακοί χτίστες της Πελοποννήσου*, i autorit X. Γ. Κωνσταντινόπουλος.⁴⁸

Këto dhe të tjera fjalë, zakonisht kanë mbetur në leksikon periferik, dialektor të greqishtes. Këtë e tregon edhe mosparaqitja e tyre si zë i veçantë leksikografik në fjalor të tipi të madh, si ai J. Babinjotit (Γ. Μπαμπινιώτη; *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας Αθηνών*, 2002)⁴⁹, por edhe në fjalorët që janë hartuar nga leksikografë shqiptarë si N. Gjini (N. Γκίνη, *Έλληνο - Αλβανικό Λεξικό (Fjalor greqisht - shqip)*, Ιωαννίνων, 1993)⁵⁰ etj.

Populli shqiptar, për shkaqe kryesisht ekonomike dhe politike, në rrjedhë të historisë ka njohur ardhje emigruese të jashtëzakonshme. Në kohën e skllavopronarisë një pjesë jo e vogël e territorit të banuar nga stërgjyshërit e shqiptarëve, sidomos vija bregdetare e këtij territori është pushtuar nga grekët e lashtë. Prof. E. Çabej thotë se grekët e vjetër themeluan ngulime (koloni) edhe jashtë trevave të Greqisë, si p.sh., në Italinë e Jugut, në brigjet e Anadollit, në brigjet e Adriatikut dhe të Detit të Zi etj.⁵¹ Kuptohet vetiu që këto ngulime nuk janë ngritur në tokë të shkretë. Njëpërmjet këtyre ngulimeve ata vinin në kontakt me banorët vendas rreth e rrotull. Marrëdhëniet me popujt jogrekë të Ballkanit grekët e vjetër i zhvillonin jo vetëm njëpërmjet ngulimeve në brigjet lindore të Adriatikut e në brigjet perëndimore të Detit të Zi, por edhe njëpërmjet zonave kufitare brenda Gadishullit Ballkanik.

⁴⁷ Këtu ka pasaktësi për disa fjalë. Unë do të isha e mendimit se fjalë si *lakra* etj. kanë hyrë përsëri në greqishte a në këto të folme nga shqipja, edhe pse janë fjalë të greqishtes së vjetër.

⁴⁸ X. Γ. Κωνσταντινόπουλος, *Οι παραδοσιακοί χτίστες της Πελοποννήσου*, Αθήνα, 1983

⁴⁹ Γ. Μπαμπινιώτη; *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας, με σχόλια για τη σωστή χρήση των λέξεων ερμηνευτικό, ετυμολογικό, ορθογραφικό, συνωνύμων – αντιθέτων, κύριων ονομάτων, επιστημονικών ορων, ακρωνυμίων*; με αξιοποίηση του γλωσσικού αρχείου; Αθηνών, 2002)

⁵⁰ N. Γκίνη, *Έλληνο - Αλβανικό Λεξικό (Fjalor greqisht - shqip)*, Ιωαννίνων, 1993)

⁵¹ Prof. E. Çabej pohon se *zbulimet arkeologjike që janë kryer në këtë shekull ndër ne dëshmojnë sa i madh ka qenë ndikimi i kulturës greke në vendin tonë. Ky ndikim nuk ka munguar të vinte edhe prej Greqie, po kryesisht buron prej kolonive greke të Shqipërisë. Si kudo në pellg të Mesdheut, edhe në Shqipëri kolonitë greke kanë ndjekur në radhë të parë qëllime paqësore të tregtisë, pa synuar në sundimin politik të viseve përkatëse. Prandaj këto koloni kanë qenë themeluar zakonisht në bregdet, duke parapëlqyer tipin penisular (gadishullar) me një rryp toke që shërbente për t'u mbrojtur nga sulmet vendëse. Kolonitë greke të Shqipërisë janë themeluar kryesisht prej Dorasve. Nga këto Durrësi (Epidamnus, më vonë i quajtur Dyrrachium) u themelua në 685 para erës së re prej atyre të Kerkyrës (Korfuzit). Në 558 u themelua Apolonia, në 385 prej Sirakuze Leshi (Lissos). Të tjera koloni greke qenë Çrikum e Aulon afër Vlorës, pastaj Buthroton (Butrinti) e Feniki në Jugë. Grekët kishin hyrë edhe në hinterland për tregëti ku themeluan qytetin Amanita (Plloça e sotme) e Bylis (Gadishta e Mallakastrës). Në oborret e mbretërve e dinastëve ilirë ka pasur si Grekë mjekë, oficerë, shkruer etj. Në Iliri importoheshin armë, stolisje, enë e të tjera orendi prej Greqie. Shih më gjerë E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në “Studime gjuhësore”, III, Prishtinë, 1976*

B. HUAZIME LEKSIKORE (INTERFERIME) GREKE NË SHQIPE

Marrëdhëniet shekullore ndërmjet grekëve dhe popujve fqinjë të Ballkanit do të linin patjetër gjurmë edhe në gjuhët e tyre. Këtu është fjala, në radhë të parë, për gjurmët e greqishtes në gjuhët që fliteshin në pjesën perëndimore, qendrore dhe lindore të Ballkanit, d.m.th. në ilirishte, përkatësisht në maqedonishte, trakishte dhe dakishte. Por jo më pak interes paraqisnin edhe gjurmët që gjuhët fqinje kanë lënë në greqishte.⁵²

*Prania e një numri jo të vogël fjalësh me burim nga greqishtja e vjetër në shqipen e dokumentuar dëshmon qartë për kontaktet e hershme dhe të gjata ndërmjet grekëve të vjetër dhe stërgjyshërve të shqiptarëve*⁵³.

Duke pasur parasysh faktin e njohur që këto fjalë e kanë burimin te dialekti grek i dorasve, që këtej është nxjerrë përfundimi i drejtë se këto kontakte janë zhvilluar në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Me fjalë të tjera, këto fjalë kanë depërtuar në “nënë” e shqipes nëpërmjet dorasve që banonin në ngulimet greke të Bregdetit Adriatik, si dhe në pjesën veriperëndimore të Greqisë së vjetër (fjala *mokën / mokër* është një dëshmi e qartë për këtë⁵⁴). Nga ana tjetër, numri relativisht i vogël i këtyre fjalëve dëshmon se ndikimi i greqishtes së vjetër mbi “nënë” e shqipes ka qenë i kufizuar. Dhe kjo është e kuptueshme, po të kemi parasysh se ngulimet e vogla greke të Adriatikut nuk mund të ushtronin një ndikim të madh mbi popullsinë vendëse edhe më të madhe në numër. Një ndikim i tillë nuk mund të ushtrohej as nëpërmjet zonave kufitare, që në kohët e vjetra shtriheshin edhe më në jug.

Gjithashtu, për huazimet shqipe në greqishte kemi pranuar mendimin e Dh. Qiriazit i cili shprehet se “Fjalët e shqipes krijojnë raporte distribucioni komplementar

⁵² E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në “Studime ...”, III, Prishtinë, 1976; *Shiko më gjerë* edhe Sh. Demiraj, *Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët*, Tiranë, 2008

⁵³ R. Memushaj pranon se huazime të trashëguara në shqipe janë shumë fjalë nga greqishtja e vjetër, si: *lakër, presh, qershi, mokër, shpellë* etj. dhe më shumë nga latinishtja, si: *gaz, fytyrë, këmishë, kokë, shpinë, qytet, shëndet, verë* etj. Në gjuhën shqipe ka rreth 600 fjalë rrënjë prej latinishtes dhe rreth 30 huazime prej greqishtes së vjetër. Shih më gjerë R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2008.

⁵⁴ Prof. Sh. Demiraj pranon se “Midis elementeve të greqishtes së vjetër në gjuhën shqipe është pranuar edhe emri *mokën / mokër*. Kjo fjalë, e cila e ka burimin te dialekti dorik *mākhanā* (në dialektin jonik *mēkhanē*), ka hyrë qysh disa shekuj para erës së re edhe në latinisht në trajtën *machina*. Nga latinishtja kjo fjalë është trashëguar edhe në gjuhët romane, si p.sh., italisht *macchina*, frëngjisht *machine*, rumanisht *măcina* (=mëçina) “bluaj” etj. Por fjala *mokën / mokër* e shqipes nuk mund të ketë depërtuar nëpërmjet latinishtes, sepse një -a- e gjatë latine ka dhënë vetëm -a- në elementin latin të kësaj gjuhe. Si rrjedhim, është pranuar me të drejtë që evolucioni -ā->-o-, që është vërtetuar rregullisht në elementin i.e. të shqipes (khs. motër <māter), ka përfshirë edhe shtresën më të vjetër të huazimeve greke të “nënës” së shqipes. E kjo shtresë duhet të jetë disa shekuj më e hershme se shtresa më e vjetër e huazimeve latine të “nënës” së shqipes.” *Shih më gjerë* Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 107

me fjalët e greqishtes. Kështu, në Epir fjala *τσούπρα* ka kuptimin ‘vajzë’ ndërsa *κουπέλα* ‘shërbëtore’. E njëjta mund të thuhet edhe për fjalët *άνθια* dhe *λουλούδια* ku e para shënon lulet e pemës, ndërsa e dyta bimët që çelin lule, vetë lulet. Edhe në rastin e fjalëve të shqipes vështirësia e motivimit kuptimor të fjalëve nga ana e greqishtfolësve krijon premisa për riinterpretime etimologjike. Në të folmet e fshehta të Epirit fjala *δέντρος* ‘dhëndër’ u pa si e ardhur nga *δέντρο* ‘lis, dru’ e greqishtes, kur dihet që vjen nga fjala *dhëndër* e shqipes. Fjala *βλαστάρι* ‘vëlla’ vjen nga shqipja vëlla me ndikim paretimologjik nga gr. *βλαστάρι*. **Trajta e fjalëve tregon se në raste të veçanta shqipja ka qenë ndërmjetësuese e huazimeve prej gjuhësh të tjera: turk. *günah* > shq. *gjynah*, *gjynaf* > gr. Επὶ τὸ γκιουνάφι, sepse dihet që në shqipen kemi alternim të *h* dhe *f* fundore.”⁵⁵**

* * *

Kur flasim se gjuha shqipe dhe ajo greke kanë qenë të hapura ndaj njëra-tjetrës, (sidomos shqipja ndaj greqishtes), si u shprehëm më lart, kjo dukuri e ky proces kanë edhe karakteristikat e veta kohore. Në shqipen e dokumentuar fjalët ***me burim nga greqishtja e vjetër (që janë trashëguar nga nëna e saj ilirishtja)*** janë më të pakta në numër se ato që kanë depërtuar nga greqishtja e mesme dhe e reja. Por ka një ndryshim të dukshëm midis të parave dhe këtyre të dytave. Të parat kanë pësuar më shumë ndryshime, sidomos të karakterit fonetik dhe janë të mbarë shqipes. Kurse të dytat janë të përhapura më fort në të folmet jugore dhe kanë pësuar më pak ndryshime.

Ne si do ta shohim dhe në kapitujt në vazhdim do të ndalemi konkretisht edhe në këto ndryshime, kur të shohim huazimet dialektore.

Në gjuhën shqipe, përveç elementeve nga greqishtja e vjetër, të cilat ajo i ka trashëguar nga “nëna” e saj ilirishtja, kanë hyrë edhe një numër i konsiderueshëm huazimesh nga greqishtja gjatë marrëdhënieve historike. Këtu është fjala kryesisht ***për huazimet nga greqishtja e mesme dhe e reja.***

Prof. E. Çabej shkruan se këto elemente të huaja kanë depërtuar në gjuhën shqipe pas shekullit VI, d.m.th. pas asaj periudhe kur u krye procesi i gjatë i kalimit të shkallëshkallshëm nga ilirishtja në shqipe. Në përgjithësi, edhe shtresat më të vjetra të këtyre huazimeve kanë pësuar më pak ndryshime të karakterit gjuhësor se elementet greke dhe latine, që shqipja i ka trashëguar nga “nëna” e saj. Megjithatë, mund të pohohet se edhe huazimet, që kanë depërtuar drejtpërdrejt në gjuhën shqipe, sidomos ato më të vjetrat, nuk kanë mbetur të pandryshuara. ***Ato u janë nënshtruar rregullsisht të evolucionit të sistemit fonetik dhe të strukturës gramatikore që vepronin në shqipe në kohën e depërtimit të tyre në këtë gjuhë.***⁵⁶

Këto ***huazime nga greqishtja e mesme dhe e reja janë pa krahasim më të shumta se elementet nga greqishtja e vjetër.*** Dhe kjo është e shpjegueshme, po të mbahet parasysh se ndikimi i greqishtes mbi shqipen ka ardhur duke u shtuar pas vendosjes se greqishtes si gjuhë zyrtare e Perandorisë Bizantine në shekullin VII të erës

⁵⁵ E.A. Μπόγκα, Τα γλωσσικά ιδιώματα της Ηπείρου, Α', Εκδόσεις Εταιρείας Ηπειρωτικών Μελετών, Ιωάννινα, 1964.

⁵⁶ E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në Studime gjuhësore, III, Prishtinë, 1976

sonë. Këtë ndikim e ka mundësuar më tej edhe fakti që një pjesë e madhe e popullsisë së krishterë të trevave shqiptare kanë qenë ortodoksë dhe kisha ortodokse kishte si gjuhë liturgjike gjuhën greke. Edhe marrëdhëniet ndërmjet grekëve dhe shqiptarëve, sidomos në zonat kufitare, kanë ardhur duke u shtuar në rrjedhat e kohërave.

Huazimet nga greqishtja e mesme kanë pësuar më pak ndryshime se elementet nga greqishtja e vjetër. Por natyrisht edhe huazimet nga greqishtja e mesme dhe nga greqishtja e re, sidomos të parat, nuk kanë mbetur pa iu përshtatur rregullsive të sistemit fonetik dhe të strukturës gramatikore të gjuhës shqipe. P.sh. të krahasohen huazime të tilla si *kllogjër* (te Buzuku *kllogjën*) dhe *trëndafil* me trajtën e vet greqishtes *kallójer* dhe *triandáfyllo*.

Huazimet **nga greqishtja e mesme** dhe **greqishtja e re** kanë depërtuar më fort në të folmet jugore të shqipes. Por huazime nga greqishtja e mesme kanë depërtuar edhe në të folmet veriore. Të tilla janë, ndër të tjera, edhe fjalët e sferës fetare *kllogjën*, *manastir*, (te Budi e te Bardhi *munështir*) etj., si dhe fjalë sferash të tjera si: *benevrekë*, *dafne* (=dabinë), *fármëk* (=farmak), *hir*, *kállëm* (=kallam), *keq*, *qefalí*, *skile*, *trëndafil* etj.

Huazimet greke në pjesën më të madhe të tyre kanë depërtuar në shqipe nëpërmjet gjuhës së folur. Por në kohë më të reja kanë hyrë në shqipe fjalë prej burimi grek edhe nëpërmjet gjuhës së shkruar. Këtu është fjala kryesisht për terma, që janë ndërtuar nga burimi i greqishtes dhe që në shqipe kanë hyrë nëpërmjet gjuhëve romane. Është fjala për terma të tillë si: *aristokraci*, *demokraci*, *dialog*, *diametër*, *fonetikë*, *gjeografi*, *gjeometri*, *hipertoni*, *hipotoni*, *monolog*, *morfologji*, *perimetër*, *poligon*, *sintaksë* etj.

C. HUAZIME NDAJSHTESORE (INTERFERIME) GREKE NË SHQIPE

Bashkë me fjalët e huazuara kanë hyrë në gjuhën shqipe edhe disa prapashtesa prej burimit grek të cilat u janë shtuar edhe temave të fjalëve prej burimi jogrek.

Do të veçonim këtu disa prej tyre⁵⁷:

-it: gjirokastr-it, labov-it, libohov-it etj.

-jot: himar-jot, mallakstri-jot, delvinjot, sarandjot etj.

-omë: balt-omë, bur-omë, kredh-omë, zez-omë, valomë etj.

-is: kallaj-is, paj-is, përrall-is, rast-is, tigan-is, vaj-is, përsëri-is, uj(ë)-is etj.

-os: ajr-os, barr-os, breng-os, brum-os, çelnic-os, damk-os, fund-os, gjak-os, hekur-os, plag-os, tym-os, vend-os, vul-os etj.

Ne do të ndalemi më gjerë në kapituj dhe sytha të veçantë për llojin e huazimeve greke në shqipe, për rrugët e hyrjes, për fushat konceptore e leksiko-semantike ku përfshihen ato etj.

⁵⁷ Shih më gjerë E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, në “Studime gjuhësore”, III, Prishtinë, 1976, f. 191-302

3. KLASIFIKIMI HISTORIK I HUAZIMEVE GREKE NË SHQIPE

Huazimet greke kanë hyrë në gjuhën shqipe në kohë të ndryshme. Meqenëse nuk është drejtpërdrejt objekt i punimit tonë ky aspekt i këtyre huazimeve, ne po paraqesim më poshtë një vështrim të shkurtër të shtresimit të tyre kronologjik, shtresim për të cilin ka trajtime të ndryshme, herë të plota e herë të pjesshme, herë të veçanta e herë të përgjithshme⁵⁸.

Prof. E. Çabej, në kapitullin “Huazimet greke” kur trajton marrëdhëniet e shqipes në periodën e saj historike, pranon *tri shtresime të huazimeve greke* të shqipes: *huazimet greke të vjetra, huazimet mesjetare bizantine, huazimet greke të reja*, të cilat u përgjigjen përkatësisht periudhave në të cilat ai ndan edhe vetë historinë e gjuhës greke. Sipas tij “greqishtja, e dokumentuar me shkrim qysh nga shek. XIV para erës së re, ndahet zakonisht në tri periudha: *në greqishten e vjetër, në greqishten e mesme dhe në greqishten e re.*”

a. Huazimet nga greqishtja e vjetër megjithëse në një numër të vogël, rreth 30, kanë interes jo vetëm për historinë shqipes, por si do të shohim ato kanë edhe zhvillimet më të mëdha semantike, sidomos në zgjerimin strukturave kuptimore dhe në aftësitë fjalëformuese e stilistikore. Koha e hyrjes së tyre është shumë e hershme dhe shqipja i ka trashëguar këto lloj huazimesh nga nëna e saj ilirishtja. Më poshtë gati-po japim të plotë sythin për klasifikimin e huazimeve nga prof. E. Çabej⁵⁹.

Ai pohon se brenda qarkut indoevropian shqipja ka me greqishten e vjetër disa konkordanca parciais, trashëgimi e përbashkët nga një periudë e lashtë parabolkanike.

⁵⁸ Kështu në *Leksikologjia e gjuhës shqipe* e J. Thomait, sythi për huazimet greke në shqipe dhe për ato shqipe në greqishte dhe për klasifikimin e tyre është si më poshtë: “Fjalët e burimit grek në shqipe janë huazimet më të hershme. Huazime të tilla për shkaqe gjeografike ka pasur që në kohë të lashtë, po më shumë fjalë greke hynë në shqipe që nga shekulli VIII para epokës sonë, kur kolonë greke erdhën e u vendosën në trojet ilire, si në Epidamnos (Durrësi), Apolloni (Pojani) etj. Në përgjithësi fjalët nga greqishtja e vjetër u përkasin fushave shoqërore, të bimësisë etj.: fier, lakër, mokër, pjepër, presh, qershi...Huazime leksikore nga greqishtja, të kohës bizantine dhe të kohës së re, kanë hyrë sidomos në jetën shoqërore, në artizanat, në botën shtëpiake, në kopshtari etj.: avlli, fis, flamur, lajm, mëndafsh, oreks, i pastër, pronë, tipar, stolis, trastë, trëndafil... Një pjesë e madhe e huazimeve leksikore nga greqishtja ka mbetur në të folme anësore si krahinorizma; një pjesë tjetër ka dalë ose po del nga përdorimi (fjalë të vjetruara e historizma). Është dëshmuar gjithashtu se edhe shqipja ka ndikuar mbi greqishten: në greqishten e re gjenden rreth 70 fjalë të burimit shqip.” Shih J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 328

⁵⁹ E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në “Studime gjuhësore”, III, Prishtinë, 1976, f. 45 - 50

Shqiptarë e Grekë kanë më se 3000 vjet që janë fqinj në këtë pjesë të Evropës. Dhe shqipja gjatë kësaj kohe ka pasur lidhje të paprera dhe intensive me greqishten, lidhje që rrjedhin nga afërsia gjeografike e nga marrëdhëniet midis popujve.

Albert Thumbit ka qenë i pari albanolog që njohu ekzistencën e huazimeve të vjetra greke dhe për sa i përket kronologjisë së huazimeve greke mbeten në fuqi kriteret që vuri ky studiues.⁶⁰ Ai ngjitet nga shqipja e re drejt shqipes parashkrimore e hyn në prehistori dhe sheh kohën dhe rrugën e hyrjes së huazimeve..

Thumbi i zbatoi kriteret në aspekte të ndryshme: ai një shtresë relativisht të vjetër huazimesh e gjen *te fjalët greke që ka fjalori i Frano Bardhit* (Franciscus Blanchus) i vitit 1635, kurse, sipas tij, një shtrese më të vjetër i përkasin huazimet që gjenden *në dialektet e kolonive arbëreshe të Italisë*. Meqë këto janë themeluar kryesisht në shekullin XV e XVI, ato fjalë duhet të kenë hyrë në gjuhën shqipe para asaj kohe. Një tjetër kriter kronologjik ai e gjen *në përhapjen dialektore të huazimeve greke në shqipe*. Në lidhje me këtë ai shtron me të drejtë kriterin që *huazimet greke të gegërishtes janë në përgjithësi më të vjetra se ato të toskërishtes*, si p.sh.: gegërisht *kllogjën* e toskërisht *kallogjër* nga greqishtja *kalógeros*; kjo sepse në Gegëri nuk vijoi më ndikimi i greqishtes kurse në Jug vazhdoi edhe më vonë.

A. Thumbi, sipas prof. E. Çabej, ngjitet dhe në kohën antike, e pranon që shqipja ka dhe huazime të greqishtes së vjetër, një mendim që sot është i pranuar përgjithësisht. Ai pranon se në gjuhën shqipe ndeshen 21 fjalë nga greqishtja e vjetër⁶¹. Ato janë huazime të greqishtes së vjetër që në gjuhën shqipe kanë ruajtur gjendjen fonetike të greqishtes së vjetër dhe tregojnë po atë trajtim fonetik që kanë pësuar fjalët latine e fjalët e fondit autokton indoevropian të shqipes. Kështu janë marrë prej greqishtes së vjetër *lakër lakën* nga greqishtja e vjetër *lákhanon*, *mokër mokën* prej greqishtes së vjetër *mekhané*, dorisht *makhana*, nga e cila ka dalë dhe latinisht *macchina*; *prësh* nga greqishtja e vjetër *prason*, po *pras* nga greqishtja e re. Rotacizmi në *lakër*, *mokër* etj është shenjë vjetërsie.⁶²

Ndikimi i greqishtes së vjetër në gjuhën shqipe sidomos sferën e bimëve, veçanërisht të bimëve të kuzhinës e atë të pemëve. Hyjnë këtu ndër të tjera: *kerasia-qersh*, *péponon-pjepër*, *ppjepën*, *lakhanon-lakër*, *lakën*, *lapathe-lëpjetë*, *prason-prësh*.

Prof. E. Çabej pohon se “*në të tilla huazime na pasqyrohet një ndikim kulturor i shënueshëm i Greqisë së vjetër në vendin tonë. Vihet re se këto huazime janë relativisht të pakta. Aq më të shumta janë ato që kanë hyrë nga greqishtja e mesme dhe nga e reja. Në disa raste është e vështirë të bëhet një dallim i prerë midis elementeve të vjetra, të mesmevet e të rejavet.*”⁶³

Është e rëndësishme të theksojmë se prof. E. Çabej, N. Jokli, A. Thumbi, prof. Sh. Demiraj dhe të tjerë albanologë kanë treguar edhe *rrugën e hyrjes së këtyre*

⁶⁰ *Shih më gjerë* E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në “Studime gjuhësore”, III, Prishtinë, 1976 f. 47

⁶¹ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 108

⁶² *Shih më gjerë* E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në “Studime gjuhësore”, III, Prishtinë, 1976 f. 48

⁶³ *Shih më gjerë* E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në “Studime gjuhësore”, III, Prishtinë, 1976 f. 48

huazimeve në gjuhën shqipe. Ne do të ndalemi në një kapitull të veçantë për këtë, por shumë nga huazimet e vjetra kanë hyrë jo drejtpërdrejt nga greqishtja e vjetër në ilirishte, por edhe nga latinishtja në ilirishte dhe në shqipen e kryehershme.

E. Çabej pranon se “Një gjë që do vënë re në huazimet e shqipes nga greqishtja e vjetër është se përveç atyre *që kanë hyrë drejtpërdrejt nga ajo gjuhë*, ka disa të tjera që *kanë hyrë në mënyrë të tërthortë*, që në epokën greko-romake e sidomos kristiane *kaluan së pari prej greqishtes në latinishten*, e së andejmi depërtuan në shqipen e kohës antike. Kjo gjë mund të gjurmohet mirë me anë të akcentit, meqë të tilla fjalë paraqiten edhe sot me vendin e akcentit të latinishtes dhe jo të greqishtes. Kështu *kuçedër* respekton latinishten (ballkanike) *chersydrus* prej greqishtes *chérsydros*, jo këtë vetë; po ashtu *balladër* latinisht *barathrum* prej greqishtes *báraithron*, jo këtë. Përkundrazi *qersh*, *liqën*, *pjepër*, *shpellë*, *bagëm* “pagëzim” etj. pasqyrojnë greqishten *kerasia*, *lekáne*, *pepon*, *spélaion*, *baptisuma* dhe jo latinishten *cerasum*, *lacum*, *pepónem*, *spelaeum*, *baptisma*. Për ndonjë fjalë si sherp “*apium graveoleus*”, *qerm* “ledh i arës, i vatrës” mbetet e dyshimtë nëse rrjedh prej greqishtes së vjetër apo prej latinishtes”⁶⁴.

b. Grupin e dytë dhe të tretë historik të huazimeve greke në shqipe e përbëjnë *huazimet prej greqishtes së mesme* dhe huazimet prej *greqishtes së re*. Një pjesë e mirë e këtyre huazimeve bien në kohën e sundimit bizantin, i cili vazhdoi deri në kohë të mesme ndikimin grek të kohës antike. Bizanti, i cili ka bashkuar në vetvete në një tërësi të pandarë helenizmin me krishterimin dhe me botën orientale, ka ushtruar një ndikim të njëllojtë mbi popujt e Gadishullit Ballkanik në fushën sociale-ekonomike, kulturore dhe fetare.

Sipas prof. E. Çabej, “një shtresim kronologjik të greqizimeve të shqipes – a mesjetare a të reja- ne mund ta kryejmë edhe me ndihmën e akcentit. Kështu fjalët *farmëk*, *kallm*, *qefull*, që janë pjesërisht të gegërishtes e pjesërisht të arbërishtes së Italisë, janë huazime më të vjetra se format përgjegjëse *farmak*, *kallám*, *qefáll* të toskërishtes jugore.

Po japim më poshtë disa fusha kryesore tematike (konceptore) me huazime të këtyre dy periudhave:⁶⁵

Huazime që i përkasin *sferës kishtarë*. Hyjnë këtu ndër të tjera: *manastir*, te Budi *munështir*, te Bardhi po ashtu, në Kalabri *monoshtir*, në Skrapar e afër Gjirokastrës emra vendesh *Munështir*; *kallogjër*, më e vjetër *kllogjën*, *kllogjër*; *ikonë* më e vjetër *korë* me rotacizëm; *potír* qelq, te Buzuku e te Bardhi *putir*. Përkthime nga greqishtja, ndikime të kishës lindore, janë shprehjet *Ujët e Bekuar*, *Java e Madhe*, që i ka edhe Veriu, sot katolik. Gjurmë në toponomastikë janë ndër të tjera emri i lagjes *Ajazëm* në Shkodër (Ujët e Bekuar), emri i katundit *Sebaste* në veri, të cilit prej jugu i përgjigjet *Sevasteri* i Vlorës.

Huazime që u përkasin *dokeve e zakoneve*. Nga zakonet e lindjes e të martesës, të cilat janë lidhur ngushtë me kishën, po përmendim: *poganik*, *poganiqe* (festë që bëhet

⁶⁴ *Shih më gjerë* E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në “Studime gjuhësore”, III, Prishtinë, 1976 f. 48

⁶⁵ Klasifikimi në punimin tonë ka ruajtur origjinalin sipas punimit *Huazimet greke* të “Marrëdhëniet e shqipes në periodën e saj historike”. *Shih më gjerë* E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në “Studime gjuhësore”, III, Prishtinë, 1976 f. 48-49

të tretën natë të lindjes së djalit); mirat (të tri fatitë që i caktojnë fatin foshnjës të tretën natë të lindjes), *prikë* te Budi *përqi*. Edhe shprehja *vë kurorë*, e përhapur në gjithë Ballkanin, sipas N. Joklit është një përkthim nga greqishtja e kishës bizantine. Veçanërisht i madh është ndikimi bizantin në zakonet e dasmës te Shqiptarët e Salaminës në Greqi, sikundër ka vënë re dietari grekoshqiptar Petros Furikis (1878-1936). Në zakonet e vdekjes hyn këtu *fron*, *thron* (vigu i vdekjes) te ortodoksët e Jugut e në kolonitë arbëreshe të Italisë, p.sh., të Milosao-ja i De Radës.

Huazime që i përkasin **jetës shoqërore**. Le të përmendim ndër të tjera *gjini*, *gjiri*, *gjeni*, *gjëri* (edhe te Buzuku, Budi e Bardhi e në kolonitë e Italisë), *frati*, (bashkari, vëllazëri) (te Buzuku e te Bardhi), *qefali* (kryetar, sundimtar), *permyqyr* (kryeplak), *pronë*, *flamur*, *simahuer* (ndihmës në një vrasje), *aspër* (pare).

Huazime që u përkasin **artizanaleve (zejeve të ndryshme)**. Hyjnë këtu p.sh. *enemi* (çikrik) nga greqishtja *anemi*; *peovol* (rrjetë).

Huazime që i përkasin **jetës shtëpiake**. Le të përmendim *avlli*, *tagar* (mangall), *gaforre*, *llukanik* (suxhuk), *magjiri* (kuzhinë) .

Huazime që u përkasin **kopshtarisë, bimëve**. Khs. ndër të tjera *perivol* (kopsht), (edhe te Buzuku LIV, në toskërishten jugore, në kolonitë e Arbëreshëve të Italisë), *trëndafil*, *dhjozmë*, (mendër), *dafinë*.

Huazime që i përkasin **gjuetia**. Le të përmendim, ndër të tjera, p.sh. *skile* (dhelqër), *skifter*, *gjeraqinë*.

Huazime që i përkasin **trupit të njeriut, petkave, stolive**. Hyjnë këtu p.sh. *kurm* (trup), në dialektet e Jugut e të kolonive, *tipar*, *i pastër*, *stoli*, *stolis*, *benevrekë* që ka shtegtuar në të gjitha gjuhët ballkanike⁶⁶.

Në shqipe kanë interferuar (kanë hyrë) nga greqishtja edhe dhjetëra fjalë të tjera si *cuks* (*djeg*, *përcëllon*), *farmakos* (*helmoj*), *feks* (*shkëlqen*), *gremis* (*rrëzoj*), *honeps* (*pëlqej*), *karfos* (*ngul*), *kakaris*, *katandis* (*çoj në pikë të hallit*), *kolis* (*ngjis*), *kopanis* (*rrah rrobat me kopan kur i laj*), *kuis*, *kumbis*, *kumbisem* (*mbështes trupin ose kokën*), *lips* (*e flak tutje*, *e përzë*, *e shporr*, *e largoj*), *lajthis* (*gaboj pa dashur*, *ngatërrohem për diçka*), *llahtaris* (*frikësoj shumë dikë*), *llogaris* (*numëroj ose njehsoj diçka*, *kontrolloj me mend*), *mbodhis* (*vonoj*, *pengoj*), *miros* (*parfuj*, *lyej me vaj të bekuar*), *mirose* (*përmirësohem*), *moleps* (*ndot*, *i ngjit dikujt një sëmundje*), *nanuris* (*vë në gjumë foshnjën duke i kënduar*), *ormis* (*ndreq*, *gatit*, *rregulloj*), *pikas* (*vë re*, *zbuloj dikë që kërkon të fshihet*), *pleks* (*thur*, *gërshetoj*, *ngatërroj*), *piks* (*mpiks*, *ngjiz*), *psonis* (*blej*), *qëndis* (*qëndis një çentro*), *qeras* (*gostit dikë me pije dhe ëmbëlsira*), *qeveris* (*drejtoj*), *skalis* (*gdhend*, *punoj me daltë gurin*), *sos* (*i jap fund diçkaje*), *stis* (*ngre*), *stolis* (*zbukuroj*), *tagjis* (*ushqej*), *taks*, *taksem* (*premtoj*), *tendos* (*shtrij*), *tromaks* (*frikësoj*), *vithis*, *vithisem* (*fundos*, *humb*, *shemb*), *zalis* (*bëj që të bie të fikët*), *zilepsem* (*kam zili*) etj.

Për sa i përket shpërndarjes së huazimeve greke të shqipes sipas dialekteve, do thënë se pjesa më e madhe i përket toskërishtes, e këtu sidomos pjesës më jugore. Të pasura me elemente greke janë edhe dialektet arbëreshe të Italisë jugore e të Sicilisë, të cilat kanë dhe disa greqizma që s'i njeh as toskërishtja. Kjo pasuri vjen prej disa arsyes historike:

⁶⁶ *Shih më gjerë* E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në "Studime gjuhësore", III, Prishtinë, 1976 f. 48-49

Së pari këta kolonistë në shumicën prej tyre rrjedhin prej Shqipërisë jugore.

Së dyti një pjesë e tyre kishin shkuar më parë prej Shqipërisë në Greqi, ku morën të tjera huazime greke, e prej andej kaluan në Itali; kujtimin e Greqisë e ruajnë ata gjer sot me këngën *O e bukura Moré*.

Së treti ata kanë marrë greqizma edhe në Itali, nga dialektet greke (ose italiane) që i rrethojnë, mbeturina të fundit të kolonive të vjetra greke.

Po më të thellin ndikim të greqishtes nuk ka dyshim se e kanë ndier dialektet e shqiptarëve të Greqisë. Këto janë atje që nga shekulli XIV e XI, duke jetuar paprerë si ishuj gjuhësore brenda mjedisit grek. Elementi shqiptar është përhapur në krahina të ndryshme të kontinentit grek e të ishujve të tij.

Në mendimin gjuhësor shqiptar mbeten në fuqi kriteret që vuri Thumbi për sa i përket kronologjisë së huazimeve greke. Por siç thotë prof. E. Çabej, “veçse me pasurimin e materialit gjuhësor të shqipes, në radhë të parë me burimet e vjetra letrare, sot jemi në gjendje t’i zgjerojmë këto kritere. Thumbi më 1909 kishte parasysh vetëm fjalorin e Bardhit: Budi e Bogdani njiheshin aso kohe sa për emër. Meshari i Gjon Buzukut u zbulua në 1910. Me ndihmën e këtyre veprave literare më njëhën e me dëshminë e dialekteve arbëreshe të Italisë më tjetrën anë, që ruajnë gjer sot elementin grek që kanë marrë me vete prej Ballkanit, ne, duke kombinuar përfundimet e historisë gjuhësore me të dhënat e gjeografisë dialektore, mund të shikojmë më mirë kronologjinë e hyrjes së huazimeve greke në shqipen e përhapjen e tyre gjeografike. Kështu, në zbatim të kriterit të Thumbit, do të shikohen si mjaft të vjetra greqizmat që kanë shkuar deri në dialektet veriake, si *matërgonë, simahuer, frikë, gjeraqinë, fis, gjini, putir, potir*.”⁶⁷

⁶⁷ *Shih më gjerë E. Çabej, Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në “Studime gjuhësore”, III, Prishtinë, 1976 f. 48-49

4. KLASIFIKIMI GJEOGRAFIK I HUAZIMEVE (INTERFERIMEVE) GREKE NË SHQIPE

A. HUAZIME GREKE NË MBARË SHQIPEN

Si jemi shprehur shpesh, populli shqiptar gjatë historisë së tij mijëravjeçare ka pasur takime të pandërprera dhe marrëdhënie të drejtpërdrejta me popullin grek, që janë pasqyruar edhe në leksikon e shqipes. *Fjalët e burimit grek në shqipe janë huazimet më të hershme*. Ato ndër të tjera kanë hyrë në shqipe për shkaqe gjeografike, dhe huazime të tilla ka pasur që në kohë të lashtë, po më shumë fjalë greke hynë në shqipe që nga shekulli VIII para epokës sonë, kur kolonë greke erdhën e u vendosën në trojet ilire, si në Epidamnos (Durrësi), Apolloni (Pojani) etj.⁶⁸

Duhet të parashtrijmë këtu, se duhen dalluar huazimet (interferimet) nga greqishtja në shqipe, nga ato që quhen fjalë *ballkanike*. Xixilis, studiues grek shkruan në hyrjen e vëllimit *Το γλωσσικό ιδίωμα της Πιερίας*: “Si ballkanike karakterizojmë zakonisht një seri fjalësh që hasen në dy a më shumë gjuhë ballkanike dhe që origjina e tyre është e panjohur ose e pasigurt.

Ai dallon *një nëngrup* fjalësh ballkanike që përfshin izoglosat leksikore të shqipes dhe rumanishtes, shumë prej të cilave hasen edhe në gjuhë të tjera ballkanike – kryesisht në greqishten- dhe nuk mund e as duhet të shpjegohen gjithnjë si huazime të shqipes apo të rumanishtes në këto gjuhë. Kjo do të thotë se, jo rrallë, fjalë që deri tani konsideroheshin si të shqipes, jemi të detyruar t’i shohim në një kuadër më të gjerë ballkanik.

Një nëngrup tjetër, vazhdon Tzitzilis-i, përfshin fjalë që hasen në dy a më shumë gjuhë ballkanike dhe zakonisht konsiderohen si mbetje të gjuhëve substrate (trakishtes dhe më shpesh dako-mizishtes). Edhe për fjalët e kësaj kategorie vlen vërejtja se kërkimi i etimonit të tyre vetëm në kuadër të shqipes e të rumanishtes nuk duhet të merret si i vetëkuptueshëm.

Një kategori e tretë paraqet interes të veçantë sepse, ndërsa kemi të bëjmë me fjalë që hasen në dy a më shumë gjuhë ballkanike, prania e tyre në këto gjuhë nuk ishte evidentuar deri më sot apo, edhe kur vihet në dukje, rrallë theksohet karakteri ballkanik i atyre fjalëve. Kjo mbase është edhe arsyeja pse shumica e këtyre fjalëve nuk janë bërë objekt i analizës etimologjike⁶⁹.

⁶⁸ *Shih më gjerë për këtë*: E. Çabej, në “Studime gjuhësore”, Prishtinë, III, 1976; Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008 etj.

⁶⁹ E. Δούγα-Παπαδοπούλου Χρ. Τζιτζιλής, *Το γλωσσικό ιδίωμα της Πιερίας*, Θεσσαλονίκη 2006, f. 43-46 (cituar sipas punimit të Dh. Qiriazit, Δ. Κ. Κυριάκης, *Ελληνικές Επιδράσεις στον Αλβανική (Ι. Φωνητική*

Edhe ne në punimin tonë, u jemi larguar interpretimeve me etimologji të diskutueshme.

* * *

Huazimet greke shfaqen brenda leksikut të shqipes si një grup i mëvetësishëm paradigmatic me karakteristika të dallueshme, të cilat i përveçojnë në nëngrupe të larmishme klasifikuese. Klasifikimet e tyre mund të mbështeten edhe në kritere ndryshme, si *huazime leksikore* dhe *huazime frazeologjike*, *huazime të plota* dhe *huazime strukturore (kalke)*, *huazime leksikore* dhe *huazime semantike* apo *huazime historike* dhe *huazime bashkëkohore*, *huazime të drejtpërdrejta* dhe *huazime të tërthorta*, *huazime të ngulitura* dhe *huazime të pangulitura*, *huazime shkrimore* dhe *huazime gojore*, *huazime të gjalla* dhe *huazime fosile* etj.

Ne nuk po ndalemi në klasifikime që mbështeten në këtë shumësi kriteresh, por vetëm në një prerje, në atë të shtrirjes gjeografike të huazimeve greke, kriter i cili i grupon këto huazime ***në huazime të mbarë shqipes*** dhe ***në huazime që kanë mbetur në të folmet dialektore*** (huazime që së shumti u përkasin të folmeve jugore dhe dialektit të toskërishtes). Kjo shtrirje është e lidhur pazgjidhshmërisht me kohën e hyrjes së huazimeve në shqipe.

Huazimet greke në shqipe u përkasin tri periudhave të mëdha kohore: huazime nga greqishtja e vjetër (që shqipja i ka trashëguar nga nëna e vet (ilirishtja jugore), huazime nga greqishtja mesjetare a bizantine dhe huazime nga greqishtja e re (këtu do të përfshijmë edhe huazimet që kanë hyrë në shqipe në fundshekullin e kaluar dhe në këtë fillimshekulli).

Në përgjithësi huazime leksikore nga greqishtja e vjetër u përkasin fushave shoqërore, të bimësisë etj., si *fier*, *lakër*, *mokër*, *pjepër*, *presh*, *qersh* etj., kurse ato nga greqishtja e kohës bizantine dhe e kohës së re, kanë hyrë sidomos në jetën shoqërore, në artizanat, në botën shtëpiake, në kopshtari etj., si *avlli*, *fis*, *flamur*, *lajm*, *mëndafsh*, *oreks*, *i pastër*, *pronë*, *tipar*, *stolis*, *trastë*, *trëndafil* etj.

Përgjithësisht këto huazime i përkasin fondit të përgjithshëm leksikor të shqipes, janë bërë pjesë organike e pasurisë së shqipes dhe karakterizohen ***nga zhvillime të shumta semantike, fjalëformuese, stilistikore*** etj.

Në shqipe kanë hyrë nga greqishtja e re edhe dhjetëra fjalë të tjera, që i gjejmë në fjalorët shpjegues kombëtarë të shqipes, që tregojnë se kanë shtrirje në mbarë shqipen, por që shpesh shoqërohen me elementin *krahin*. (fjalë krahinore).

Kjo tregon së pari gjendjen e tyre, hapësirën ku shfaqen, por edhe prirjen e përdorimit, d.m.th., edhe në qoftë se kanë një hapësirë të kushtëzuar përdorimi, ato u drejtohen të gjithë përdoruesve të shqipes dhe kanë karakter normativ. Vetë pasqyrimi në këta fjalorë bëhet tregues i kësaj prirjeje. Këtu do të përmendnim fjalë të tilla, si: *anangas (ngacmoj)*; *angjinare (barishte shumëvjeçare)*, *dhjakonar (lypës, dinak)*, *mbodhis (vonoj, pengoj)*, *mbodhisem (vonohem)*, *kumbis (mbështet kokën, trupin për të fjetur)*, *kumbisem (mbështetem për të fjetur)*; *mballos (vë një mballomë)*; *pocaqi (mundim, vuajtje, mjerim, rraskapitje)*, *cimbis (pickoj)*, *cuks (djeg, përcëllon)*, *farmakos (helmoj)*, *feks (shkëlqen)*, *gremis (rrëzoj)*, *honeps (pëlqej)*, *karfos (ngul)*, *katandis (çoj në pikë të hallit)*, *kolis (ngjis)*, *kopanis (rrah rrobat me kopan kur i laj)*, *kuis (leh qeni si*

me vajtim), lips (e flak tutje, e përzë, e shporr, e largoj), lajthis (gaboj pa dashur, ngatërrohem për diçka), llahtaris (frikësoj shumë dikë), miros (parfumoj, lyej me vaj të bekuar), moleps (ndot, i ngjit dikujt një sëmundje), ormis (ndreq, gatit, rregulloj), pikas (vë re, zbuloj dikë që kërkon të fshihet), pleks (thur, gërshetoj, ngatërroj), piks (mpiks, ngjiz), psonis (blej), tromaks (frikësoj), vithis, vithisem (fundos, humb, shemb), zalis (bëj që të bie të fikët), zileps, zilepsem (kam zili) etj.⁷⁰

⁷⁰ Një pasqyrë të gjerë të këtyre huazimeve e gjejmë te punimi i J. Kume, *Për huazimet greke në shqipe*, në “Studime albanologjike, I, Gjuhë”, Tiranë, 2008

B. HUAZIME GREKE NË TË FOLMET JUGORE TË SHQIPES

Një pjesë e madhe e huazimeve leksikore nga greqishtja *ka mbetur në të folme anësore si dialektizma a si krahinorizma*, që së shumti nuk gjen pasqyrim në fjalorët shpjegues kombëtarë të shqipes, por që mund të gjenden në përdorimin e përditshëm në dialekt apo edhe të pasqyruara në fjalorët dialektorë e krahinorë. Kjo gjendje gjuhësore bie në sy në mjediset shqipfolëse në jug të Shqipërisë, që janë mbartës të dialektit të toskërishtes dhe që lidhen drejtpërdrejt gjeografikisht me popullin grek të Greqisë Veriore.

Huazimet leksikore nga greqishtja mund të jenë *të ngulitura* dhe *të pangulitura* (*barbarizma*). Shkalla e ngulitjes së fjalës së huazuar varet nga vlera që ka ajo fjalë në gjuhë; si rregull, sa më i rëndësishëm të jetë funksioni i fjalës së huazuar (sepse mund të japë një koncept të ri ose të bëjë një dallim kuptimi), aq më shumë ka nevojë gjuha për të, prandaj aq më thellë futet ajo fjalë në përbërjen leksikore të gjuhës, në sistemin fjalëformues, në sistemin semantik etj. Zakonisht, *në qoftë se huazimet i përkasin gjithë shqipes ato janë të ngulitura, kurse në qoftë se janë të shtrira vetëm në të folme anësore janë të pangulitura*.

Fjalët e huaja, *duke hyrë në gjuhën shqipe, mund të kenë pësuar edhe ndryshime në formë e në përmbajtje*. Fjalët që janë marrë nga greqishtja, ashtu si ndodh edhe me huazimet nga gjuhët e tjera i janë nënshtruar sistemit fonetik e gramatikor të gjuhës sonë, d.m.th. shkruhen e shqiptohen sipas vlerës fonike të alfabetit tonë, eptohen sipas klasave gramatikore dhe sipas rregullave përkatëse: në qoftë se janë emra, kanë trajtë të pashquar e të shquar, numrin njëjës e shumës dhe lakohen sipas rasave; po të jenë folje, marrin ato forma në mënyrë, kohë, vetë e numër sikurse foljet e tjera. Shqipja i ka marrë fjalët e huaja dhe i ka përpunuar ashtu si fjalët e veta. Fjalët e huaja vijnë të zhvillohen në truallin e gjuhës sonë, bëhen njësi të fjalorit të saj dhe u nënshtrohen kushteve konkrete historike, që përcaktojnë zhvillimin e leksikut të gjuhës shqipe në përgjithësi. J. Thomai, thekson se fjalët që kanë hyrë herët në shqipe janë përvetësuar plotësisht nga shqipja, të cilat tashti nuk i dallojmë nga fjalët e tjera të leksikut të shqipes.

Kurse një karakteristikë i huazimeve nga greqishtja në të folmet krahinore bashkëkohore është se ato ndjehen menjëherë jo si huazime, por si greqizma⁷¹, për arsye

⁷¹ Do të quhen huazime fjalët që kanë hyrë bashkë me nocionet (të ashtuquajturat *huazime historike-kulturore*), kurse fjalët që kanë hyrë nga greqishtja në shqipe kur ekzistojnë fjalët përkatëse (të ashtuquajturat huazime gjuhësore), do t'i marrim si greqizma, ashti si kemi huazime, por edhe anglicizma, italianizma. Këto huazime futen në leksikun pasiv dhe quhen ndryshe edhe *barbarizma*. Shih më gjerë R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2008, f. 137

se ndryshimet në rrafshin fonemoro- strukturor janë shumë të pakta⁷². Kështu në të folmet jugore ne ndeshim në ligjërimet e folura me dhjetëra fjalë si *mandile (shami), cukunidhe (hithër), cukunis (më djeg hithri, më përcëllon, por edhe më shndërrime kuptimore të figurshme), psonis (bëj pazar, blej), llambro (gjëra të imëta të shndritshme), lllagar (i pastër, i kulluar), lllagaros (pastroj, kulloj), dhokan (zdrukth), dhokanis (e lodh, e mërzit), papuçe (këpuçë), patom (shputa e këmbës: Sa ma ka patomën!); potis (ujit), potistir (ujitëse lulesh etj.), foti (kandil, ndriçues me vajguri), kallafatis (ha, përpj), skordhan (tarator); kalistir (vegël me presë e me veshë për të prashitur), suflaqe (pite etj. të mbushura me mish, qepë, domate, salcë etj.), proftas (arrij: nuk proftasa – nuk arrita...), palikar (trim), vromë (i pistë, grua e përdalë), mollois (tregoj, rrëfej), skupje (fshesë), skupidhe (të fshirat, mbeturina) etj.*

Më vazhdim po japim listojmë një grup fjalësh që sillen në shqipen bashkëkohore si greqizma dhe jo si huazime historiko-kulturore. Ato u përkasin të gjitha pjesëve të ligjëratës, por zakonisht më të shumta janë folje dhe emra: *Αγκούσα* / angusem (rëndesë nga ushqimi; zagushi, vapë e madhe) (u ngusa, hëngra shumë, më rëndon stomaku nga të ngrënë); *αρκούδα* / arkudhë - arushë (i fortë si arkudhë); *αφεντικό* / afendiko (padron, punëdhënës); *αναστένω* / anastisem (ditën e gjiqit kemi të anastisemi); *αρραβωνιάζω* / arravonjas (e kish arravonjasur për grua); *βασιλικός* / vasilikua – vasiliko / borzilok (Ku e shkove verën-o? Rrodhe moj vasiliko!); *βαπτίζω* / vaptis – pagëzoh (Vaftis fëmijën); *Βιολί* / violi (orkestër, saze, violitë: e përcollën me violi / me saze.); *ανακατώνω* / anakatos, nakatos (nakatos, ngatërroj botën); *βρακαζώνη* / vrakazona - qillota (pantallona për burrat të ngushta ne fund); *γέρακι* / jerak (shumë shpejt, e mora rrugën jerak); *γύψος* / ips – i lartë (atje s'kish gur, se vendi ishte ips); *δανγκάνω* dhangas – kafshoj (dhangaste / kafshonte buzën); *δασκαλεύω* dhaskaleps / mësoj – mësohem (do të jenë dhaskalepsurë të gjithë nga Perëndia); *διακονία* / dhiakoni (lupje, hile, dredhni); *εικόνισμα* / kondizmë (konizmë, vend i posaçëm zakonisht në anë të një rruge, ku ndizen qirinj në emër të një shenjtori); *εξομολογούμαι* / ksemollois – i tregoj ngjarje etj. për të shtyrë kohën etj, bëj muhabet; *κέρασμα* qerazmë (ëmbëlsirë, para etj. me të cilat qerasim mysafirin, nusen, dhëndrrin etj.: Nxjerr gliko si qerazmë); *Θάυμα* thagmë – çudi: ka ndodhur thagma); *καλημέρα* / kalimera – mirëdita (*Nuk dua t'ia dëgjoj kalimerën / nuk dua ta takoja ta dëgjoj, nuk dua të kem më lidhje me të); *ευλογώ* / vllojis – bekoj: dorë e vllojisur / dorë e bekuar); *κούφιος* / kufjo – bosh: është kufjo na trutë etj.

Dy dhjetëvjetëshat e fundit, kontaktet gjuhësore ndërmjet shqiptarëve dhe grekëve janë rritur ndjeshëm. Ato kushtëzohen nga faktorë ekonomikë, shoqërorë, politikë, kulturorë, shkencorë etj. Probleme të kulturës së gjuhës dhe të kompetencës gjuhësore – leksikore së shumti emigrantët shqiptarë i manifestojnë në Greqi, por edhe kur vijnë në Shqipëri, në qëndrimet afatshkurtra. Shpesh, **gjatë komunikimeve gjuhësore ata zbulojnë probleme që lidhen drejtpërdrejt nga zotërimi i greqishtes dhe futin fjalë greke në ligjërime që hyjnë në leksikon e shqipes, pavarësisht sesa bëhen pjesë organike e këtij leksiku.** Këtu do të veçonim fjalë të tilla si *xhaba (falas), dhuro (dhuratë), ika (i pagova ikat, sigurimet shoqërore e shëndetësore); qinito (telefon i mbartshëm, i lëvizshëm; celular); merokamë (pagesa për ditë pune), gjiros (pite të mbushura me mish të pjekur e sallatë) etj*

⁷² Shih edhe A. Spirou, *Huazime në të folmen e krahinës së Delvinës dhe të Sarandës*, në Albanohellenica, Athinë, 3, 2008, f. 85-104; A. Spiro, *Mbi drejtshkrimin shqip të emrave me prejardhje greke*, në Albanohellenica, Athinë, 1, 1999 f. 17-32

Në ndryshimet që ndodhin gjatë kalimit nga greqishtja në shqipe, *dukuria më e njohur në huazimet bashkëkohore dialektore është dukuria fonetike e rënies së tingujve të temës së fjalës*.⁷³ Rënia e tingujve ndodh zakonisht në ballë të fjalës. Kjo e ka shpjegimin se shumë nga këto fjalë (për të mos thënë që të gjitha, kanë hyrë në ligjërimin e folur ku mbizotëron ligji i ekonomisë gjuhësore, dhe rënia e tinguj është një formë e shprehjes së këtij ligji. Këtu po përmendim raste të shumta të aferezës, si: *ανακατόνω / anakatos, nakatos* (nakatos botën, ngatërron botën); *αναγκάζω / anangas* (e ka anangasur plagën); *αγκούσα / anguse* (peshë nga ushqimi: u ngusa, hëngra tej mase, më rëndon stomaku nga të ngrënët) etj.

Ndonjëherë mund të *kemi ndërrime fonemore*, si *dhokan / rrokan* (zdrukth), *dhokanis / rrokanis* (zdrukthoj, gdhend) etj.

Ndryshimet mund të jenë në rrafshin semantik, zakonisht me ndërrim kuptimi: skordhan – hudhër – tarator (gatesë me kos, hudhra, tranguj, vajulliri, kripë) etj. Kjo nuk është dukuri e panjohur në shqipe. Kështu fjala *skilo* në greqishte shënon *qenin*, kurse në shqipe *dhelprën* (duke ndryshuar kaluar në gjininë femërore) dhe ka edhe zhvillime semantike sepse shënon edhe një njeri dhelparak (dinak, si dhelpra).

Jo rrallë herë fjalët që në greqishte janë asnjane në konotacion, kur kanë hyrë në shqipe, e humbasin asnjansinë dhe fitojnë ngjyrimë, shpesh tallëse: palikar (në greqisht *trim*), *palikar* në të folmet shqipe jugore përdoret me tallje për dikë që kërkon të hiqet si trim (kemi një të ashtuquajtur *enantiosemi*, ashtu si ka ndodhur me fjalën *dhaskal*, e cila në greqishte shënon mësuesin, kurse në shqipe është e markuar me konotacion).

Ndonjëherë huazimi ka hyrë në sintagma që janë kthyer në njësi frazeologjike, si *καλημέρα / kalimera* – mirëdita (**Nuk dua t'ia dëgjoj kalimerën / nuk dua ta takoja ta dëgjoj, nuk dua të kem më lidhje me të*).

Fjalët që kanë hyrë nga greqishtja në të folmet krahinore jugore, jo vetëm u janë nënshtruar shndërrimeve sipas ligjeve fonetike e gramatikore të shqipes, por edhe kanë pasur zhvillime leksikore e semantike të mëtejshme, duke krijuar shpesh shumë fjalë të reja, si çerdhe a si vargje fjalëformuese: *nakatos - nakatosem - nakatosje, i nakatosur, vaftis - vaftisem - vaftisje, i vaftisur, anangas - anangasem - anangasje, i anangasur, vllojis - vllojisem - vllojisje, i vllojisur, dhokanis - dhokanisje - i dhokanisur* etj.

Huazimet greke në të folmet jugore i përkasin zakonisht ligjërimin gojor dhe janë karakteristike të thjeshtligjërimin, edhe pse mund të kemi fjalë a grupe fjalësh që mund të lidhen me ligjërimin shkrimor dhe me stilin fetar etj.⁷⁴

Cili është qëndrimi që duhet të mbajmë ndaj këtyre fjalëve nga greqishtja, që kanë hyrë në dialektin toskë dhe në të folmet jugore? Sipas disa studiuesve fjalët e huaja e pasurojnë gjuhën, sipas të tjerëve ato e prishin dhe prandaj duhen nxjerrë të gjitha nga përdorimi. Në këtë çështje duhet mbajtur një qëndrim i drejtë dhe i mbështetur shkencërisht.

Studiuesi J. Thomai, me të drejtë thekson se “*E vërteta është se fjalët e huaja e prishin gjuhën kur pranohen e përdoren pa nevojë*. Nuk duhet të merren e të përdoren fjalë të huaja në gjuhë kur kemi fjalët tona, ato duhen marrë veçse në ato raste kur ato

⁷³ Pohojmë edhe një herë këtu, që shqipja, por edhe gjuhët e tjera, huazojnë tema fjalësh dhe jo mbareta apo formante trajtëformuese që shërbejnë për të realizuar kuptimet gramatikore gjatë eptimit (gjatë lakimi apo zgjedhimit) të fjalëve. Sepse, siç thotë H. Pedersen, *ndikimi i gjuhëve të huaja në sistemin gramatikor të shqipes është i barabartë me zero*. Shih më gjerë Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988 f.

⁷⁴ Dh. Q. Qiriazi, *Huazimet greke në shqipen e sotme*, në Albanohellenica, 1, Athinë, 1999

sjellin një kuptim të ri, një nuancë të re, një ngjyrim emocionues a stilistik etj., që nuk e japin mjetet e vetë shqipes.”⁷⁵

Si jemi shprehur shumë nga fjalët e huazuara nga greqishtja e kanë përcaktuar tashmë vendin e tyre në leksikon e shqipes. Këtë tregon jo vetëm përdorimi i përditshëm, por edhe sepse ato kanë zënë vend nëpër vepra si fjalorët shpjegues kombëtarë, ku leksiku shihet si pasuri mbarëkombëtare.

Në ditët tona ***gjuha shqipe është e hapur ndaj gjuhëve të tjera, sidomos ndaj gjuhëve më shkallë shumë të lartë përpunimi dhe si gjuhë e kulturave me peshë botërore, si greqishtja.*** Por duhet të pranojmë se çështja e pastërtisë së leksikut të një gjuhe, kështu edhe e shqipes, lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen e gjuhës amtare, si tipar themelor i kombësisë, nga çdo përzierje e huaj, si edhe me kristalizimin e normave të gjuhës standarde në leksik. Në këtë sistem norma letrare, siç e kemi thënë më parë, është më e çlirët, sesa në fonetikë e në gramatikë. Kjo do të thotë që, përveç disa varianteve leksikore (siç janë sinonimet), gjuha standarde do të pranojë edhe fjalë të huaja, të domosdoshme për përmbajtjen e tyre dhe për kërkesat e disa fushave, si terminologjia, ligjërimit shkencor etj. Por është krejt i papërligjur vërshimi pa kufizim i fjalëve të huaja të panevojshme, siç po ndodh sot në ligjërimit e folur, por edhe në atë të shkruar.

⁷⁵ J. Thomai, *Leksikologji e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 273

KREU II

STRUKTURA LEKSIKO – SEMANTIKE E HUAZIMEVE GREKE NË SHQIPE

1. HUAZIMET GREKE FJALË NË SHQIPE


Huazimet përbëjnë një dukuri të zakonshme për të gjitha gjuhët. Ato prekin të gjitha rrafshet gjuhësore: fonetikën, morfologjinë, leksikun dhe sintaksën. Por rrafshi që preket drejtpërdrejt dhe më shumë nga huazimet, është leksiku. Struktura leksikore e një gjuhe nënkupton dy klasa të mëdha njësisish: *klasën e fjalëve* dhe *klasën e njësive frazeologjike (që janë barasvlerëse të fjalëve)*. Dhe ne në punimin tonë jemi ndalur sidomos në këto dy klasa të mëdha leksikore dhe me huazimet nga greqishtja që gjenden brenda tyre.

Marrëdhëniet huazuese, interferimet leksiko-semantike, për mendimin tonë kanë lidhje të drejtpërdrejtë me tezën e relativizmit gjuhësor. R. Hudson, shprehet se “*një aspekt i relativitetit mund të demonstrohet fare lehtë, sepse në disa gjuhë mund të individualizojmë disa njësi që, pa dyshim, shprehin kuptime që në gjuhë të tjera nuk shprehen. Kjo mund të vërehet në vështirësitë e përkthimit nga gjuha në gjuhë, që janë të lidhura me kultura të ndryshme, dhe, si rrjedhim, kanë emra për një gamë të ndryshme zakonesh, objektesh, institucionesh e kështu me radhë.*”⁷⁶

Fjala është njësia gjuhësore që huazohet më lehtë dhe më shpejt. Kështu, huazimet nga greqishtja, si ato ndërmjet gjuhësh të ndryshme në botë, janë kryesisht huazime leksikore. Por jo në të gjitha shtresat e leksikut huazohet njësoj. Huazimi tregon se popujt kanë qenë kufitarë ose kanë pasur marrëdhënie historike, ekonomike a kulturore ndërmjet tyre dhe kjo ka kushtëzuar edhe fushën ku ka hyrë fjala nga greqishtja apo nga gjuhët e tjera, jetëgjatësinë, si dhe zhvillimet e ndryshme që mund të kenë ndodhur në formën dhe në përmbajtjen e saj gjatë përdorimit në shqipe.

⁷⁶ R. Hudson, *Sociolinguistika*, Tiranë, 2002, f. 94

Marrëdhëniet historike e gjeografike ndërmjet shqipes dhe greqishtes kanë çuar që *shqipja të huazojë edhe njësi frazeologjike*. Pranohet se njësitë frazeologjike lindin dhe, dhe ashtu si edhe fjala, përdoren në ligjërimin e folur e të shkruar për të plotësuar nevojat dhe kërkesat që shoqëria i shtron gjuhës si një mjet komunikimi dhe kanë veçoritë e veta të spikatura në çdo gjuhë, madje ato zbulojnë më shumë dhe më drejtpërdrejt se gjithë grupet e tjera leksikore karakterin kombëtar të pasurisë leksikore e semantike të gjuhës. Por duhet të themi se huazimi i njësive frazeologjike nga greqishtja nuk është i përmasave të huazimit të fjalëve.



Huazimet leksikore “fjalë” nga gjuha greke mund të jenë

a. *huazime të plota*, kur fjala ka hyrë ashtu siç është në gjuhë të huaj

b. *huazime strukturore*, kur fjala në të vërtetë është shqip, por është ndërtuar sipas gjedhes së një fjale të huaj. Këto huazime strukturore quhen edhe *kalke*. *Kalket* janë fjalë të formuara me brumin e shqipes; në to është i huaj vetëm ndërtimi i fjalës. Të tilla janë edhe *ortografi / drejtshkrim, ortoepi / drejtshqiptim, ortogonal / drejtkëndësh* etj.

Huazimi *i fjalëve* nga greqishtja në gjuhën shqipe është bërë në rrethana të caktuara dhe, siç e kemi parë, në periudha kohore të ndryshme. Lloji më kuptimplotë i huazimeve është ai kur fjala ka hyrë në gjuhën tonë së bashku me konceptin *si huazime*

historiko-kulturore. Por shqipja ka huazuar edhe fjalë greke për koncepte për të cilat ka pasur fjalë të tjera në përdorim, që dalin pra **si huazime gjuhësore**⁷⁷.

Po japim një listë fjalësh me të cilën edhe jemi njohur pak a shumë, deri tani nëpër faqet e punimit: *kllogjën (kallogjër), lakër, mokër, qersh, pjepër, lëpjetë, presh, farmak, kallám, qefull, manastir, potír poganik, poganique, fron, thron, gjini, gjiri, qefili, perovol, avlli, tagar (mangall), gaforre, llukanik, trëndafil, dhjozmë (mendër), dafinë, skile (dhelbër), skifter, gjeraqinë, tipar, i pastër, stoli, stolis, benevrekë, farmakos (helmoj); feks (shkëlqen); gremis (rrëzoj); honeps (pëlqej); katandis (çoj në pikë të hallit); kolis (ngjis); kopanis (rrah rrobat me kopan kur i laj); kumbis, kumbisem (mbështes trupin ose kokën); lips, lipsem (më duhet); llahtaris (tmerroj); llogaris (numëroj, kontrolloj me mend); nanuris (vë në gjumë foshnjën duke i kënduar); ormis (ndreq, gatit, rregulloj); pleks (ngatërroj); psonis (blej); qëndis (qëndis diçka); skalis (gdhend, punoj me daltë gurin); sos (i jap fund diçkaje); stolis (zbukuroj); tendos (shtrij); tiganis (skuq në tigan); tromaks (frikësoj) etj.*

Për këto huazime, që **i përkasin zakonisht leksikut të përgjithshëm**, do të ndalemi gjerësisht pas sythit vijues, duke bërë klasifikime sipas kritereve të ndryshme dhe të njohura në studimet leksikore e semantike.

Gramatikisht, këto huazime u përkasin klasave kryesore leksiko-gramatikore: janë emra, mbiemra, folje, ndajfolje etj.

Gjuha shqipe, ashtu si edhe greqishtja, është gjuhë indoevropiane. Kjo do të thotë që shumë fjalë të fondit themelor i ka trashëguar nga nëna e vetë ilirishtja dhe kjo nga një gjuhë prej së cilës ka ardhur. Ky fond fjalësh është tepër i qëndrueshëm dhe ka mundësi të mëdha që çdo fjalë të shfaqë të gjitha vlerat që i karakterizojnë. **Por ndonjë huazim nga greqishtja, madje nga greqishtja e re, mund ta mënjanojë fjalën e vjetër shqipe dhe mund të fitojë në shqipe dhe aftësi për zhvillime të brendshme kuptimore, për formime fjalësh të reja, për përdorime stilistikore etj.** kështu ka ndodhur me fjalën shqipe **agër** dhe fjalën e huazuar nga greqishtja **gomar**.

γομάρα (η) [μεσν.] {χωρ. γεν. πληθ.} (λαϊκ.) 1. η γαϊδούρα 2. (μτφ. -υβριστ.) γυναίκα παχιά ή άξεστη, αναίσθητη.

γομάρι (το) {γομαρ-ιού | -ιών}

1. (σπάν.) το φορτίο που φορτώνεται σεζώο: *τρία – ξύλα ΣΥΝ. φορτίο*

2. (συνεκδ.) ο γάιδαρος ή το μουλάρι • (γενικότ.) το μεγάλοσωμο ζώο • (μτφ.-μειωτ.)

3. ο μεγάλοσωμος άνθρωπος .

4. άνθρωπος χωρίς αγωγή και ευαισθησία • ΦΡ. γομάρι ξεκα-πίστρωτο (εμφατ.) για άξεστο και χωρίς ευαισθησία άνθρωπο ΣΥΝ. γαϊδούρι ξεσαμάρωτο. — (υποκ.) γομαράκι (το).

⁷⁷ Prof. J. Thomai, shkruan se “huazimi leksikor më i zakonshëm dhe më i përhapur në gjuhën shqipe është *huazimi i fjalëve bashkë me sendet a me konceptet e reja*. Në qoftë se për ne bëhet i njohur një objekt ose një koncept i panjohur, atëherë në leksik hyn edhe emërtimi për të, sipas gjuhës nga e cila vjen. Kështu janë huazuar nga italishtja fjalët *bankë, bulletin, sonet...*; nga anglishtja fjalët *basketboll, boks, gol, volejball ...* Këto janë *huazime historiko-kulturore*. Kur fjalët e huazuara nuk hyjnë bashkë me sendet e me konceptet e reja, po *bashkëpërdoren si sinonime me fjalët e vendit*, kemi *huazime gjuhësore*.” *Shih më gjërë J. Thomai, Leksikologji e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 272

[ETYM. < μτυν. γομάριον, υποκ. τού αρχ. γόμος “φορτίο” < γέμω “γεμίζω”].

GOMÁR,~I *m. sh.* ~Ë, ~ËT. 1. Kafshë një-thundrake, që mbahet në shtëpi për ngarkesë, me trup me të vogël se kali, me kokë të madhe, me veshë të gjatë dhe me qime zakonisht në ngjyrë të hirtë. *Veshët e gomarit. Kërriç gomari. Ngarkoj gomarin. Palli gomari. I bie gomarit. Punon si gomar punon shumë. Duron si gomar duron shumë. Këndon si gomar këndon keq.*

2. Sasia e barrës a ngarkesa që mban kjo kafshë. *Një gomar dru. Tre gomarë drithë.*

3. *fig. thjeshtligj., shar.* Njeri i trashë nga mendja, budalla; hajvan. *Gomar i madh. Mori mendjen e atij gomari. Ç'gomar qenka! Gomar me veshë. thjeshtligj., keq.*

4. *Përd. mb.* sipas kuptimit 3 të emrit.

* **(Punonte) për shpirt të gomarit** punonte kot, i shkante munda humbur. **Sa gomarë buzëbardhë (ka)!** *iron, shih te BUZËBARDHË.* **S'çalon gomari nga veshët** *fj.u. shih te ÇALLOJ.* **S'di si (nga) lidhet gomari** *mospërf. shih te LIDHEM.* **Ia ha bukën gomari** *mospërf.* është shumë i ngathët dhe i mefshtë. **Kur të hipë gomari (derri) në fik (në majë të fikut)** *thjeshtligj.* kurrë, asnjëherë. **I kanë hedhur (i kanë shtënë) trutë e gomarit** nuk vepron sipas mendjes së tij, por bën si i thonë të tjerët, ia kanë marrë mendjen të tjerët. **I lan kokën (kryet) gomarit** *shih te LAJ.* **Nuk i shkoi gomari (kali) në udhë (në urë)** *edhe poh. shih tek UDH/Ë,~A.* **I shkon (i ka hije) si shala gomarit** *iron, shih te SHAL/Ë,~A_{II}.* **I vuri lëkurën e gomarit** *dikujt shih te LËKUR/Ë,~A.* **S'di gomari ç'është bari** *mospërf.* nuk është i zoti të vlerësojë atë që është me të vërtetë e mirë e me vlerë, nuk di dhia ç'është tagjia. **E di gomari ku e vret samari** *fj.u.* secili i di vetë punët e hallet e tij, e di i zoti ku i pikon çatia. **S'di t'i japë ujë (as) gomarit** *dikush mospërf.* është i trashë nga mendja ose fare i pazoti. **Kali humbi, gomari s'duket** *fj. u.* është rrëmujë e madhe, nuk e merr vesh i pari të dytin. **Prit gomar të mbijë bar!** mos prit kot!; s'dihet kur do të bëhet një punë a kur do të vijë dikush, mund të mos bëhet a të mos vijë kurrë; është fare e pasigurt diçka. **Punon kali, ha gomari** *fj. u. shih te KAL/Ë,~I.* **Sikur i ka ngrënë gomari bukën (macja brumin)** *shih te HA.* **I zoti e nxjerr (e qit) gomarin nga balta** *fj.u. shih te BALT/Ë,~A.* **Le gomari që na ngordhi,** po s'na lënë rehat as mizat le fatkeqësia, le halli i madh që kemi, por na shqetësojnë e na ngacmojnë edhe për gjëra të vogla. **S'ka ç'i bën gomarit, i ble samarit** *fj.u.* ia nxjerr inatin jo atij që duhet, por dikujt tjetër që nuk ka faj, gjetkë e ka inatin e gjetkë e nxjerr. **Kali ha tagjinë, gomari mbart bucelat** *fj. u. shih tek TAGJI,~A.* **Presin të ngordhë gomari (kali) që t'i marrin potkonjtë** *përb.* presin të përfitojnë ndonjë gjë nga ajo që mbetet, presin të përfitojnë nga diçka pa bërë asgjë vetë. **Ti zot, unë zot, po gomarin kush e kullot?** secili duhet të bëjë atë që i takon dhe të mos ia hedhim punën njëri-tjetrit; po të mos bëjë secili punën e vet, nuk i dilet mbanë; po të japin të gjithë urdhra nuk bëhet asnjë punë. **Bisht gomari** *bot. shih te BISHT,~I.* **Ç u ç gomari** *zool. shih te ÇUÇ,~I.* **F e r r ë (gjemb) gomari** *bot. shih te FERR/Ë,~A.* **Lule gomari** *bot. shih te LUL/E,~JA.* **Vesh gomari** *bot. veshgomar.*

GOMARAZI *ndajf. bised.* 1. *shih GOMARTHI_I.* 2. *fig.* Baras, barabar, pa u mundur e pa fituar as njëri as tjetri. *Dolën gomarazi.*

GOMÁR/E,~JA *f. sh.* ~E, ~ET. 1. Femra e gomarit, gomaricë. *Qumësht gomareje.*

2. Dru bigë. *Preu një gomare.*

3. *fig. thjeshtligj.* Grua a vajzë e trashë nga mendja, budallaqe, hajvane. *Ç'gomare paska qenë!*

4. *bot.* Dardhë gushtake, që i bën kokrrat të mëdha, me ngjyrë të verdhë në të kuqe dhe me shumë lëng; kokrrat e kësaj dardhe. *Voli gomaren.*

5. *Përd. mb.* sipas kuptimit 4 të emrit. *Dardhë gomare.*

GOMÁREZ,~A *f. sh. ~A, ~AT.* 1. Vegël e tezgjahut në trajtë bige, së cilës i vihet përsipër një peshë (zakonisht një gur), që shërben për të mbajtur të tërhequra fijet gjatë endjes, kur i mbledhin në shul; branë.

2. Këmbalec druri, mbi të cilin mbështeten drutë për t'i prerë a për t'i sharruar. *Bëri një gomarez. Sharron drurin në gomarez.*

3. *zool., krahin.* Brumbull.

GOMARI,~A *f. sh. ~, ~TË thjeshtligj.* Veprim fare pa mend në kokë, marrëzi, budallallëk. *Bëri një gomari.*

GOMARIC/Ë,~A *f. sh. ~A, ~AT.* 1. Femra e gomarit, gomare.

2. *thjeshtligj., shar.* Gomare.

GOMARÍSHT *ndajf. bised.* Si budalla; si i marrë, marrëzisht. *Sillet (flet) gomarisht.*

GOMARJÁR,~I *m. sh. ~Ë, ~ËT.* 1. Ai që punon me një gomar për të mbajtur lëndë të ndryshme.

2. Bari gomarësh.

GOMARLLË/K,~KU *m. sh. ~QE, ~QET thjeshtligj.* Gomari, marrëzi. *Gomarllëk i madh. Bëri një gomarllëk.*

GOMÁRTH,~I *m. sh. ~Ë, ~ËT bot.* Gjembaç. *Gjembat e gomarthit.*

GOMARTHI *ndajf.* 1. Në brinjë, nga ana e brinjëve (kur munden dy vetë e asnjërit nuk i prekin shpatullat plotësisht për toke). *Ranë gomarthi.*

2. Luaj gomarthi: luaj kaladibrance.

Vetëkuptohet këto interferime leksikore të leksikut të përgjithshëm, kur gjuha shqipe e kishte fjalën e saj, kanë ndodhur në rrjedhë të shekujve, dhe kur gjuha shqipe, krejt ndryshe nga greqishtja, nuk ishte e përpunuar në të gjitha nënsistemet e veta. Interferimi ndodhte edhe për shkakun se shqipja akoma nuk kishte një fjalor shpjegues që të pasqyronte dhe të kodifikonte pasurinë e saj leksikore e semantike dhe që të realizonte ndër të tjera funksionin kryesor, atë informues. Kjo mundësi intereferuese nuk është e njëlojtë sot, kur gjendja është krejt ndryshe, sepse shqipja është më e mbyllur ndaj tyre. P.sh., në të folmet dialektore përdoret fjala *gajdhur (gomar, agër)*, por shqipja standarde, e përpunuar dhe e kodifikuar, nuk e ngreh në normë këtë huazim a interferim leksikor bashkëkohor (siç bën me fjalën *pras –presh* etj.)

2. HUAZIMET GREKE NJËSI FRAZELOGJIKE NË SHQIPE

Mikrosistemi i njësive frazeologjike të greqishtes apo ai i shqipes kanë veçoritë e veta, që lidhen së pari me rrafshin e përmbajtjes e të formës, por edhe me veçori të tjera që kanë të bëjnë me burimin e me dendurinë e përdorimit, me historinë e me gjeografinë e përdorimit, me llojin e stilit dhe të ligjërimit të përdorimit, me aftësinë e njëfjalëzimit apo të fjalëformimit etj.

Para se të ndalemi *në ndikimin e frazeologjisë së greqishtes në atë të shqipes*, në karakterin dhënës të së parës dhe në atë marrës të së dytës, mendojmë të parashtrojmë dy-tre dukuri teorike, por që kanë përcaktuar dhe praktikën e punë sonë.

a. Ndërmjet semantologëve, leksikologëve, leksikografëve e vetë frazeologëve, *nuk ka një mendim të njëjtë për konceptin e njësive frazeologjike*, ndonëse shkenca e leksikologjisë e semantikës dhe veçanërisht shkenca e frazeologjisë është marrë me këtë kategori për një kohë të gjatë.⁷⁸ *Frazeologjia jo rrallë herë është konceptuar si mikrosistem me kufij pak a shumë të gjerë, pavarësisht nga specifika e njësive brenda gjuhës ku përdoren.*

Përgjithësisht, me njësi frazeologjike kuptohet një bashkim fjalësh relativisht i qëndrueshëm, i riprodhueshëm dhe me ngjyrim ekspresiv që ka si rregull një kuptim tërësor. Sipas këtij përkufizimi, *me frazeologji nënkuptohet zakonisht idiomatika, d.m.th. njësitë frazeologjike në kuptimin e ngushtë të fjalës*. Por, natyrisht, edhe kufijtë e vetë idiomatikës, jo gjithmonë janë të përcaktuar qartë. Listat e idiomave apo të njësive frazeologjike të paraqitura nga leksikologë të ndryshëm si argumentim, janë aq të ndryshme nga njëra tjetra, sa që në raste të caktuara ato përjashtojnë njëra tjetrën. Tek njësitë frazeologjike, disa gjuhëtarë fusin të gjithë togfjalëshat e qëndrueshëm, kurse disa të tjerë fusin vetëm një grup të caktuar togfjalëshash të tillë. Sipas mendimit të disave, tek njësitë frazeologjike hyjnë edhe fjalët e urta, proverbat, shprehjet e figurshme, fjalët fluturake, aforizmat etj.⁷⁹, të cilat gjuhësisht shënojnë koncepte të ndryshme dhe si emërtime nuk janë njësi sinonimike.

⁷⁸ M. I. Fomina, *Gjuha e sotme ruse: Leksikologjia*, Moskë, 1990

⁷⁹ Në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980) për këto njësi ka përcaktime të ndryshme: *Njësi frazeologjike* tog i qëndrueshëm fjalësh ose thënie a shprehje e qëndrueshme që ka tiparet dalluese të frazeologjisë. *Tipat e njësive frazeologjike. Togfjalësh frazeologjik. Shprehje (përngjitje) frazeologjike. Fjalor frazeologjik.* (FRAZEOLOGJË, ~A gjuh. Tërësia e togjeve dhe e thënieve a e shprehjeve të qëndrueshme të një gjuhe, të cilat janë të pandashme nga ana leksikore, kanë kuptim tërësor, të njësishtëm, të mëvetësishëm e gjithnjë të figurshëm, riprodhohen në ligjërime si një-si të gatshme dhe kryejnë funksionin e një fjale a të një fjalie të vetme. *Frazeologjia gjuhësore. Frazeologjia e gjuhës shqipe. Gjuhë me frazeologji të pasur. Mbledhja e frazeologjisë. Studimi (klasifikimi, botimi) i frazeologjisë.*) *Fjalë fluturake* thënë a shprehje, që përmban një mendim a gjykim përgjithësues të spikatur dhe që njihetj e përdoret gjerësisht.

b. Greqishtja është gjuha e një kulture të lashtë dhe si e tillë ajo ka zhvilluar që herët prirjen për përdorimin gjerësisht të frazeologjisë. Për më tepër, në të është përfutur një sistem i zhvilluar i njësive frazeologjike që bën të mundur përdorimin e tyre me ngjyrim të ndryshme stilistikore. Por, për të interpretuar lëndën që kemi marrë në shqyrtim, ne jemi mbështetur te mendimi teorik botëror, por më shumë në mendimin teorik për frazeologjinë në gjuhën shqipe, sesa në atë të greqishtes. Arsyeja mendojmë që është se shqipja, e krahasuar me shumë të gjuhë të tjera, është shumë e pasur me njësi frazeologjike dhe ka tashmë një traditë frazeografike të vlerësueshme, Ajo kështu, i afrohet greqishtes, një nga gjuhët më të vjetra indo-evropiane dhe me shkallë shumë të lartë përpunimi, e cila jo vetëm ka fjalorë frazeologjikë të veçantë, por edhe studimet në rrafshin teorik, leksiko-semantik mirëfilli për *frazeologjinë* (jo ato për *shprehjet popullore* a për *fjalët fluturake*) i ka të një nivelin si ato të rusishtes, të anglishtes, të italishtes të frëngjishtes etj.⁸⁰

Thelbi specifik i njësisë frazeologjike gjendet te kuptimi, te natyra dhe te rruga e formimit të saj që e bën njësinë frazeologjike të qëndrueshme, të mëvetësishme dhe një entitet gjuhësor të pavarur. Pranohet se përgjithësisht njësitë frazeologjike janë formuar nga shndërrimi i figurshëm i shkallëshkallshëm i togfjalëshave të lirë, proces ky bukur i gjatë, duke u parë si njësi që hyjnë të gatshme në ligjërim, që kanë si veçori parësore kuptimin e figurshëm të leksikalizuar etj. Sipas studiuesit J. Thomai, “si veçori të këtij shndërrimi janë dalluar *ngurosja morfologjike* e pjeshme a e plotë e gjymtyrëve të togfjalëshit të lirë; *ngurosja kuptimore, shkuptimësimi i gjymtyrëve dhe rikuptimësimi i gjithë togfjalëshit* (që tani shndërrohet e kundrohët si një njësi e mëvetësishme shënuese, ashtu si edhe fjala); *funksionet e ndryshme sintaksore; ngjyrimi emocionues i spikatur; zhvillimet semantike e fjalëformuese* etj.⁸¹

c. Nisur nga ky parashtrim, lënda e sjellë prej nesh në këtë kumtesë, përfshin përgjithësisht njësi frazeologjike në kuptimin e ngushtë a të mirëfilltë të fjalës, duke lënë mënjanë, fjalët e urta, proverbat, aforizmat, fjalët fluturake, edhe nëse ato janë të shndërruara figurativisht etj.⁸²

2. Si jemi shprehur, shqipja është një nga gjuhët me frazeologji shumë të pasur dhe në ditët e sotme procesi i krijimit të njësive është shumë aktiv dhe shumë produktiv. Jani Thomai, që është njihet si studiuesi kryesor dhe më i mirë i pasurisë frazeologjike të shqipes, duke hartuar edhe një fjalor me këtë pasuri është marrë edhe me burimin e kësaj pasurie. Duke u mbështetur në parashtrimet e tij, pranojmë se

Shprehje edhe *gjuh.* Grup fjalësh me një ndërtim të caktuar, zakonisht të qëndrueshëm, që ka disa veçori dalluese gramatikore, kuptimore e stilistike; njësi e frazeologjisë së gjuhës; mënyrë të foluri. *Shprehje e bukur (e goditur)*. *Shprehje e vjetër (e rrallë, e re)*. *Shprehje popullore*. *Shprehje e qëndrueshme (e ngurtësuar)*. *Shprehje proverbiale*. *Shprehje poetike (e figurshme, idiomatike, dialektore, familjare, përbuzëse, tallëse, fyese)*. *Shprehje e rëndë (e ashpër, e forte, diplomatike)*. *Shprehje e thjeshtligjërimit (e gjuhës së gazetave, e gjuhës së fëmijëve)*. *Shprehje rrugësh (rrugaçësh)*. *Shprehje pa kuptim frazë e zbrazët, boshe*. *Me falni për shprehjen!*

⁸⁰ Shih më gjerë fjalorë të tillë si Π. Βλαστού, *Συνώνυμα και συγγενικά*, Αθίνα, 1999

⁸¹ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999, f. 186

⁸² Shumë njësi që ne po shqyrtojmë, e kanë fillësën te këto **fjalë fluturake**, por që sot përdoren në ligjërim, jo si thënie, jo si sentenca të shkëputura, por si **të barasvlershme me një fjalë të vetme**.

Së pari nga *burimi*, “pjesa kryesore e njësive frazeologjike të shqipes është krijim brenda ligjëtimeve popullore, ka lindur dhe është përpunuar në gjuhën e folur”⁸³.

Së dyti, “shqipja ka edhe njësi frazeologjike të huazuara, por këto nuk zënë vend të rëndësishëm. Pak njësi frazeologjike të huazuara kanë mbetur krejt të paasimiluara, si rrjedhim edhe të pamotivuara. Ato kanë hyrë si formula të ngurosura me karakter ndërkombëtar, kryesisht nga latinishtja e gjuhët neolatine, nuk janë bërë elemente të vërteta të shqipes, përdoren vetëm në stile e në fusha të caktuara: *casus belli, honoris causa, modus vivendi, mot à mot, salto mortale ...*”⁸⁴

Së treti “në shqipe do të zinin vend më të madh njësitë frazeologjike kalke, d.m.th. ato që janë përkthyer fjalë për fjalë nga një gjuhë tjetër, si: *më bën përshtypje, hauret e Augjiasit, i hedh hije, ka vend, kullë e fildishtë, marr masa, marr pjesë, troket në derë të hapur, thyej akullin, vë pikën mbi i ...*”⁸⁵

Gjuha shqipe ka në përdorim njësi që lidhen me frazeologjinë e greqishtes dhe është e kuptueshme, që vëmendja jonë do të përqendrohet te grupi paradigmatic që është formuar me *kalkim* apo me *kuazikalkim* (*pothuajse kalkim*). Nëse në gjuhën shqipe kemi njësi kalke, atëherë në këtë gjuhë nuk ekziston procesi i shndërrimit të figurshëm, që ka ndodhur në greqishte dhe për të cilin pranohet se “nënkupton, së pari, krijimin (ngjizjen) e togfjalëshave të llojeve a të përmasave të ndryshme brenda gjirit të fjalive (të thënieve), nënkupton bashkëlidhje leksiko-sintagmatike të fjalëve të kushtëzuara nga faktorë brenda e jashtëgjuhësorë dhe nga këtu kapet fthillimi i shndërrimit të figurshëm. Ky është një proces treshkallësh: *togfjalësh i lirë - togfjalësh “i parapërgatitur” - togfjalësh (njësi) frazeologjike.*”⁸⁶

* * *

Përmes një konceptimi taksonimik këtë grup paradigmatic e ndajmë në dy nëngrupe, që në vetvete mund të ndahen më tej:

a. Nēngrupi që përfshin ***njësi frazeologjike kalke që janë përkthyer nga greqishtja fjalë për fjalë***. Në përbërje të këtyre njësive kemi dy a më shumë fjalë emërtuese që i përkasin leksikut të përgjithshëm të gjuhës, si: *mollë sherri* etj. Njësitë frazeologjike të huazuara e të kalkuara përdoren kryesisht pa ngjyrim emocionues dhe në një stil të ngritur, si në fushën e shkencës, në fushën politiko-shoqërore, në publicistikë etj.⁸⁷

Disa kalke kanë dalin me një përdorim dysh. P.sh. në shqipe kemi njësinë nga *alfa tek omega* që i ruan lidhjet drejtpërdrejt me njësinë e greqishtes duke pasur një kalkim të pjesshëm, por edhe njësinë nga *a-ja tek zh-ja* ku procesi i kalimit është i plotë.

b. Nēngrupi ***me njësi frazeologjike kalke, që nuk janë përkthyer fjalë për fjalë***. Në përbërje të këtyre njësive kemi dy a më shumë fjalë emërtuese, ku njëra fjalë i përket leksikut të përgjithshëm të gjuhës, ndërsa tjetra është një emër i përveçëm që

⁸³ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 255

⁸⁴ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 255

⁸⁵ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 255

⁸⁶ V. Memisha, *Rreth shndërrimit të togfjalëshit të lirë në njësi frazeologjike*, në SF, 3-4, 2006, f. 113

⁸⁷ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 255

lidhet zakonisht me botën mitologjike, historike, filozofike, politike, kulturore, letrare etj. të Greqisë, si *molla e Adamit, guri i Sizifit, vuajtjet e Tantalit* etj.

Disa njësi këtu, të tipit *molla e Adamit* (shqip *fikthi*), *kompleksi i Edipit* etj. dalin **si emërtime të pathjeshta** në fusha të ndryshme të shkencës e të dijes, të cilat J. Thomai, duke parë zhvillimet semantike brenda ndërtimeve të tilla, i merr **si njësi frazeologjike me vlerë emërore**, çka rinxjerr edhe një herë për diskutim vetë konceptin për njësinë e mirëfilltë frazeologjike⁸⁸.

Në gjuhën shqipe kanë hyrë nga greqishtja drejtpërdrejt apo tërthorazi nga gjuhët të tjera, sidomos nga ato me status ndërkombëtar, **shumë njësi frazeologjike, që lidhen me ligjërimin e shkruar**. Ato, sidomos nën ndikimin e publicistikës, po bëhen gjithnjë e më të pranishme dhe në ligjërimin e folur. Në frazeologjinë e këtij tipi është fiksuar së pari **mendësia mitologjike** dhe **përvoja e pasur historike e popullit grek**, por në të pasqyrohen thënie që me shndërrimet e figurshme lidhen me punën dhe veprimtarinë e përditshme, me mënyrën e jetesës dhe kulturën e njerëzve dhe që gjuha shqipe i ka marrë sepse vetë populli shqiptar si mbartës i kësaj gjuhe ka shumë gjëra të përbashkëta me atë grek.

Në greqishte këto njësi kanë përkatësi burimore të ndryshme⁸⁹, si:

a. Kanë prejardhje **nga mitologjia e pasur e grekëve të lashtë**: si *pastroj ahuret (stallat) e Augjias, filli i Arianës, flet nga maja e Olimp, si gosti në Olimp pëlhura e Penelopës, kutia e Pandorës, zjarri i Prometeut, bashka e artë, shpata e Damokleut, thembra e Akilit, kalë Troje, midis Skillës dhe Karibdës, dhurata e danajve, feneri i Diogjenit, fuçia e Diogjenit, feneri i Diogjenit, mundimet e Tantalit, frutat e Tantalit, guri i Sizifit, kompleksi i Edipit, fluturimi i Ikarit, nyja gordiane, kaloj Akerontin, ka veshët e Midasit, kthehem në Itakë, mollë sherri, kapërceu shtyllat e Herkulit* etj.

b. me burim biblik: *grykimi i Solomonit, si Shën Thomai mosbesues, gomari i Balamit, molla e Adamit, mollë e ndaluar, pesha e kryqit, udha kryqit, toka e premtuar, arka e Noes, ardhja e dytë, ka humbur biblën, gjethe fiku, si kopshti e Edenit, qengji i Perëndisë* etj.

c. me burim nga filozofia, letërsia etj: *nga alfa te omega, alfa dhe omega, fluturim pindarik, dashuri platonike, ironi sokratike, i thur ditirambe* etj.

d. Me burim nga gjeografia, historia: *si fitore e Pirros; këtu është Rodi, këtu kërce; si beteja e Termopileve; vrapim Maratone* etj.

3. Problemi i fundit që mendojmë të trajtojmë në këtë syth për njësitë frazeologjike, është prania në të dy gjuhët, por edhe në një hapësirë shumë më të gjerë ballkanike, e qindra e mijëra **njësive frazeologjike paralele, që kanë përmbajtje të**

⁸⁸ Shih më gjerë V. Memisha, *Termtat togjalësha në fjalorët shpjegues të shqipes* në Konferencën shkencore “Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe, probleme e detyra”, Tiranë, 2009, f. 106-122

⁸⁹ Shih më gjerë A. Jashari, *Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe*, Korçë, 2007, Parathënie.

njëjtë, por shpesh edhe strukturë ndërtimore e leksikore të njëjtë apo gati të njëjtë në të dy gjuhët.

Këtu ***nuk mund të flasim për karakterin dhënës apo marrës të shqipes a të greqishtes***, por mbështetim mendimin e shprehur në *Parathënien e Fjalorit frazeologjik ballkanik* (Tiranë, 1999) se në bashkësinë gjuhësore ballkanike, të krijuar në një trevë historikisht të lashtë të bashkekzistencës së popujve që i kanë shtuar afritë gjuhësore tipologjike edhe me ndikime të ndërsjella, nga Sanfeldi, Çabej etj., është llogaritur që të jenë krijuar 400-500 njësi frazeologjike paralele, por që sipas autorëve të fjalorit e vërteta është se pasuria që ekziston e kalon dhjetëfishin e këtij numri⁹⁰. Këto njësi janë me burim popullor dhe mund të lidhem me fusha nga më të larmishmet dhe me entitete të ndryshme, të botës materiale dhe shpirtërore dhe në ngjizjen e tyre kanë luajtur rol të veçantë faktorët jashtëgjuhësorë, si gjeo-historikë, psikologjikë, ekonomikë, etno-kulturorë, mitologjikë etj.

Këtu po përmendim disa nga këto njësi, si: *me dorë në zemër / με το χέρι στην καρδιά; fërkon duart / τρίβει τα χέρια του; i doli nga hundët (për hundësh) diçka / του βγαίνει από τη μύτη κάτι; iu lidh gjuha / του δέθηκε η γλώσσα; iu pre gjuha / του κόπηκε η γλώσσα; i dolën sytë (jashtë, nga vendi) / του βγήκαν τα μάτια(έξω); (rri) me duar lidhur / (κάθεται) με τα χέρια δεμένα(στη μέση), më kushtoi shtrenjtë / μου κόστισε ακριβά; ia ka shkundur era trutë / έχουν πάρει τα μυαλά του αέρα; e shtiu në dorë / τον/την έβαλε στο χέρι; i lë dorë të lirë / του άφησε το χέρι ελεύθερο; i iku truri / έχασε το μυαλό του(τρελάθηκε); nga koka deri tek këmbët / από το κεφάλι μέχρι τα νύχια; nuk ta mbush syrin / δεν σου γεμίζει το μάτι; më doli për hundësh / μου βγήκε από τη μύτη; i kthej shpinën / γυρίζω τα νότια, e ka gjuhën të gjatë / έχει μακριά γλώσσα etj.*

Dihet që greqishtja është gjuha e një kulture të lashtë dhe si e tillë ajo ka zhvilluar që herët prirjen për përdorimin e gjerë të shprehjeve frazeologjike. Ajo ka në përdorim një sistem të pasur e të zhvilluar të njësive frazeologjike që bën të mundur përdorimin e tyre me ngjyrimet e ndryshme stilistikore. Burimi i shndërrimit të sintagmave në njësi frazeologjike në gjuhën greke, ashtu si dhe në shqipe (dhe në gjuhë të tjera), ka ardhur nga gjuha e folur e popullit, i cili i ka krijuar dhe i ka përdorur ato fillimisht në gjuhën e folur dhe më pas përdorimi i tyre u përhap edhe në gjuhën e shkruar. Për këtë dëshmon ndër të tjera, përdorimi i mjaft shprehjeve frazeologjike në veprat e shkrimtarëve të lashtë grekë si nga Ezopi në fabulat e njohura, Sofokliu etj. Njësitë frazeologjike me përdorimin më të dendur dhe me një larmi të madhe variantesh, si sinonimike, ashtu edhe antonimike janë ato që i përkasin sferës së jetës së përditshme të njeriut.

Duke bërë përqasjen e tyre me frazeologjizmat analoge të gjuhës shqipe konstatojmë se midis tyre ka shumë ngjashmëri çka shpreh një mentalitet të përafërt të të dy popujve, ashtu sikurse ka edhe mjaft dallime.

a. Ne vërejmë se shumë njësi frazeologjike dalin me komponentë identikë, si në shqipe, ashtu edhe në greqishte: *nuk u zë besë veshëve të mi / δεν πιστεύω στα αυτιά μου; s'ka tru" δεν έχει μυαλό etj.*

⁹⁰ J. Thomai, Xh. Lloshi, R. Hristova, K. Qiriazati, A. Melonashi, *Fjalori frazeologjik ballkanik (shqip - bullgarisht - greqisht - rumanisht - serbokroatisht)*, Tiranë, 1999

b. Por kemi shumë njësi frazeologjike me komponentë pjesërisht identikë: *më mirë të të dalë syri se nami / καλύτερα να σου βγει το μάτι παρά το όνομα* (më mirë të të dalë syri se emri); në majë të lugës, një majë luge *στη μύτη του κουταλιού* (në hundë të lugës); i iku truri / *έχασε το μυαλό του* (humbi trurin) etj.

c. Kemi me qindra e qindra njësi frazeologjike me komponentë të ndryshëm: në majë të gishtave *στα νύχια* (mbi thonj); *varem tërësisht nga dikush / κρέμομαι από τα χείλη σου* (*varem nga buza e tij*) etj.

Από το ένα αφτί του μπαίνουν και από το άλλο του βγαίνουν / nga një vesh i hyjnë e nga tjetri i dalin (Τι άνθρωπος είσαι? Ποτέ δεν θα αλλάξεις, από το ένα αφτί σου μπαίνουν από το άλλο σου βγαίνουν αυτά που σου λένε. /Çfarë njeri je? Asnjëherë nuk do të ndryshosh, nga një vesh të hyjnë e nga tjetri të dalin ato që të thonë.)

Με τα αφτιά τεντωμένα / me veshë të ngritur (përprjetë) Έκανε την αδιάφορη, αλλά καθότανε με τα αφτιά τεντωμένα να ακούσει γι'αυτόν.- *Hiqej si indiferente, por rrinte me veshët përprjetë të dëgjonte për atë.*

Μου έπεσε στ'αυτί / më ra në vesh/ ma zuri veshi (Δεν ήξερα ότι η αδερφή του Γιάννη ζει στην Γαλλία, σήμερα μου έπεσε στ'αυτί τυχαία. -*Nuk e dija që motra e Janit jeton në Francë, ma zuri veshi rastësisht sot.*

Είμαι όλος αφτιά / jam tërë sy e vesh (Ο καθηγητής εξηγούσε το μάθημα και εμείς ήμασταν όλοι αυτιά. / *Profesori shpjegonte temën e leksionit dhe të gjithë ne e dëgjonim tërë sy e vesh.*

Έχει γλώσσα ψαλίδι / e ka gjuhën brisk (Μην τον βλέπεις έτσι ντροπαλό, έχει γλώσσα ψαλίδι. / *Mos e shiko ashtu të turpshëm, e ka gjuhën brisk.*)

Έχει μακριά γλώσσα / e ka gjuhën të gjatë/ka llapë të madhe.

Flas shumë me vend pa vend dhe shpeshherë ofendoj dikë, jam llafazan.

p.sh.Την απέλυσαν γιατί είχε μακριά γλώσσα και τους σχολίαζε όλους.- E hoqën nga puna se kishte llapën të madhe dhe i mbante nëpër gojë të gjithë.

Έλύσε τη γλώσσα του / Zgjidh gjuhën (Συνήθως δεν μιλάει καθόλου, αλλά όταν ακούει για ποδόσφαιρο, του λύνεται η γλώσσα. / *Zakonisht nuk flet fare, por kur dëgjon për futboll i zgjidhet gjuha.*

Μάλλιασε η γλώσσα του / i zuri gjuha lesh; i ra goja (Μου μάλλιασε η γλώσσα λέγοντας τους, πώς να συμπεριφερθούν. / *Më zuri gjuha lesh duke i porositur si të sillen.*)

Του έπεσε η γλώσσα (κάτω) / i ra gjuha (përtokë) (Μου έπεσε η γλώσσα να σας λέω μη και μη, αλλά εσείς συνεχίζεται τη δουλειά σας. / *Më ra gjuha përtokë duke ju thënë mosni e mosni, po ju vazhdoni avazin.*)

Του δέθηκε η γλώσσα / iu lidh gjuha (Βλέποντας όλους αυτούς τους ανθρώπους, δέθηκε η γλώσσα του και δεν μπόρεσε να μιλήσει. / *Duke parë gjithë ata njerëz, iu lidh gjuha dhe s'mund të fliste.*)

Έχει(κάτι) στην άκρη της γλώσσας του / e ka në majë të gjuhës (Περίμενε λίγο. Μην το πεις στην άκρη της γλώσσας το έχω.- *Prit pak. Mos e trego, në majë të gjuhës e kam.*)

Μετριοούνται στα δάχτυλα(του ενός χεριού) / numërohen me gishtat e dorës (Δεν έχει έρθει πολλές φορές στο σπίτι μου, μετριοούνται στα δάχτυλα οι επισκέψεις της. *Nuk më ka ardhur shumë herë në shtëpi, numërohen me gishta vizitat e saj.*)

Κρύβεται πίσω από το δάχτυλο του / fshihet pas gishtit

(Χρόνια τώρα η διοίκηση κρύβεται πίσω από το δάχτυλο της και αρνείται να αναγνωρίσει τα προβλήματα / *Kryesia ka shumë vite që fshihet pas gishtit dhe nuk pranon gabimet.*)

Να γλύφεις τα δάχτυλά σου / (është) për të lëpirë gishtat (Είναι εξαιρετική μαγείρισα. Κάνει κάτι φαγητά να γλείφεις τα δάχτυλά σου.- *Është guzhinjere e shkëlqyer. Bën disa lloje gjellësh për të lëpirë gishtat*)

Τον δείχνουν με το δάχτυλο / e tregojnë me gisht (Από τότε που βίασε τη δεκαεφτάχρονη τον δείχνουν όλοι με το δάχτυλο στο χωριό.- *Që kur përdhunoi vajzën shtatëmbëdhjetë vjeç, të gjithë e tregojnë me gisht në fshat.*)

(Κάτι) Γλιστράει μέσα από τα δάχτυλά μου/ χέρια μου / më iku (më rrëshqiti) nga duart (Στεναχωρήθηκα πάρα πολύ γιατί η μόνη ευκαιρία στη ζωή μου,

μου γλίστρησε μέσα από τα χέρια την τελευταία στιγμή. / *U mërzita shumë, sepse rasti i vetëm i jetës time, më iku nga duart momentin e fundit.*)

Ακονίζει τα δόντια του / mpreh dhëmbët (Μόλις είδε το ψητό ακόνισε τα δόντια του. / *Sapo pa mishin e pjekur, i mprehu dhëmbët; Μην ακονίζεις τα δόντια σου άδικα, δεν γίνεται αυτό. / Mos i mprih dhëmbët kot, nuk bëhet kjo gjë.*)

Δείχνει σε (κάποιον) τα δόντια του / i tregon dhëmbët (*Εγώ φταίω που δεν τους έδειξα τα δόντια από την αρχή που ήρθαν. - Unë e kam fajin që nuk i tregova dhëmbët që në fillim kur erdhën.*)

Μιλάει έξω από τα δόντια / flet me zemër në dorë (*Ο γιατρός μιλάει πάντα έξω απ'τα δόντια, όσο και να σε στεναχωρεί. /Doktori flet hapur, sado që të mërzitësh.*)

Πονάει το δοντάκι μου(είμαι ερωτευμένος) / më dhemb zemra për dikë (*Κάνει την αδιάφορη, αλλά πιστεύω πως έχει καταλάβει ότι πονάει το δοντάκι μου γι αυτή. - Qëndron indiferente, por jam i sigurt e ka kuptuar që më dhemb zemra për të.*)

Ήλιος με δόντια / diell me dhëmbë (*Δεν θα πάμε αύριο εκδρομή γιατί θα είναι ήλιος με δόντια και μπορεί να βρέξει. - Nuk do të shkojmë nesër ekskursion se do të ketë diell me dhëmbë dhe ka mundësi të bjerë shi.*)

Δεν έχει μυαλό / s'ka tru (*Δεν έχει μυαλό αυτός ο άνθρωπος, άρρωστος από τους πνεύμονες και καπνίζει. / S'ka tru ky njeri, i sëmurë nga mushkëritë edhe pi cigare.*)

Έχασε το μυαλό του (τρελάθηκε) / i iku truri (*Μόλις την είδε με άλλον έχασε το μυαλό του και την σκότωσε. / Kur e pa me një tjetër, i iku truri dhe e vrau.*)

Έχει τα μυαλά του πάνω απ' το κεφάλι / i ka hipur mendja në qiell (*Έχεις τα μυαλά σου πάνω από το κεφάλι και ζοδεύεις πολλά, μα μην ξεχνάς πως είμαστε φτωχοί άνθρωποι. / Të ka hipur mendja në qiell dhe shpenzon shumë, por mos harro se jemi njerëz të varfër.*)

Παίρνουν τα μυαλά του αέρα / ia ka shkundur era trutë (*Αυτό το παιδί δεν είναι καλά, πήραν τα μυαλά του αέρα από την επιτυχία και δεν ξέρει τι κάνει. / Ky djalë s'është mirë, ia ka shkundur era trutë nga sukcesi dhe bën si të dojë.*)

Δεν του κάνει η καρδιά / s'i bën zemra (*Δεν μου κάνει η καρδιά να τον αφήσω μόνο, όταν τον βλέπω τόσο θλιμένο. - S'më bën zemra ta lë vetëm, kur e shoh që është aq i pikëlluar.*)

Κλαίει η καρδιά του / i qan zemra (për dikë / diçka) (*Και εμένα κλαίει η καρδιά μου για αυτήν την θέση εργασίας, όμως ξέρω πολύ καλά ότι είναι πιασμένη. - Edhe mua më qan zemra për atë vend pune, por e di shumë mirë se është i zënë.*)

Κρύωσε η καρδιά του / iu ftoh zemra (*Τον είχα φανταστεί διαφορετικά, όταν όμως μου μίλησε κατά αυτόν τον τρόπο κρύωσε η καρδιά μου. - E kisha menduar ndryshe, por kur më foli në atë mënyrë, m'u ftoh zemra.*)

Με μισή καρδιά / me gjysmë zemre (*Του ζήτησα αυτό το ωραίο φόρεμα, αλλά με μισή καρδιά γιατί φοβόμουνα πως θα έφερνε αντίρηση. - I kërkova atë fustan të bukur, por me gjysmë zemre, se kisha frikë se mos më kundërshtonte.*)

Με όλη μου την καρδιά / me gjithë zemër (*Φαινόταν από τον τόνο της φωνής που μου είπε με όλη του την καρδιά «σου πάει πολύ». / Dukej nga toni i zërit që ma tha me gjithë zemër fjalën "të shkon shumë".*)

Μου άνοιξε την καρδιά του / më hapi zemrën (*Αφού πέρασαν λίγες ημέρες δεν άντεξε άλλο και μου άνοιξε την καρδιά του, λέγοντάς μου το μυστικό που τον βασάνιζε τόσο καιρό. - Pasi kaluan disa ditë, nuk duroi më dhe më hapi zemrën, duke më rrëfyer sekretin që e mundonte prej kohësh.*)

Του έκανε την καρδιά κομμάτια / ia copëtoi / thërrmoi zemrën (ma bëri zemrën copa) (*Μετά από ένα χρόνο θα έφευγε μακριά από τη μητέρα του, αυτή η ιδέα*

του έκανε την καρδιά κομμάτια. / Mbas një viti ai do të largohej përsëri nga nëna e vet, ky mendim ia copëtoi zemrën(ia bëri zemrën copa).

Μπήκε στην καρδιά του / i ka hyrë në zemër (Παρόλο που οι υπόλοιποι δεν αντέχουν εκείνο το φιλάσθενο παιδί, εμένα μου μπήκε στην καρδιά μου. / *Edhe pse të tjerët e kanë bezdi atë fëmijë shëndetlig, mua më ka hyrë në zemër.*)

Με το χέρι στην καρδιά / me dorën në zemër(me singëritet) (Τον πίστεψα σε ότι μου είπε γιατί μου μίλησε με το χέρι στην καρδιά. - *E besova në gjithçka që më tha se më foli me dorë në zemër.*)

Έκανε την καρδιά πέτρα / e bëri zemrën gur (Έκανε την καρδιά πέτρα και χώρισε φιλικά με τον υπεύθυνο αυτής της κακοτυχίας. / *E bëri zemrën gur dhe u nda miqësisht me shkaktarin e asaj fatkeqësie.*

Δεν έχει μυαλό στο κεφάλι / nuk i ka mentë në kokë (Το λυπάμαι αυτό το κορίτσι δεν έχει μυαλό στο κεφάλι, ανύπαντρο θα μείνει. / *Më vjen keq për këtë vajzë, nuk i ka mentë në kokë, pa martuar do të ngelet.*)

Δεν σηκώνει κεφάλι / S'e ngre kokën (Σύμφωνα τις συμβουλές του γιατρού δεν πρέπει να δουλεύει πολύ, αυτός δεν σηκώνει κεφάλι από τη δουλειά.-*Sipas doktorit nuk duhet të punojë shumë, kurse ai s'ngre kokën nga puna.*)

Είναι να του κόψεις το κεφάλι / (është) për t'i prerë kokën (Την έχεις δει την κόρη της Μαριώς είναι να της κόψεις το κεφάλι. *E ke parë vajzën e Marios, është për t'i prerë kokën.*)

Μ'έπιασε το κεφάλι μου / më zuri koka (Όταν άρχισαν να μιλάνε ξανά για το ατύχημα, συγκινήθηκα, μ'έπιασε το κεφάλι και βγήκα έξω. /*Kur filluan të flisnin prapë për aksidentin, m' u mblodh një lëmsh, më zuri koka dhe dola përjashta.*)

Το' φαγε το κεφάλι του / e hëngri kokën (Μετά από όλα όσα έκανε το 'φαγε το κεφάλι του.- *Mbasi bëri të gjitha këto, e hëngri kokën e vet.*)

Για τα μάτια του κόσμου / për sy të botës (Δεν παντρεύτηκε γιατί τον αγαπούσε, αλλά για τα μάτια του κόσμου. / *Nuk u martua se e dashuroi atë, por u martua për sytë e botës.*)

Δεν σου γεμίζει το μάτι / nuk ta mbush syrin (Όταν το βλέπεις απ'έξω δεν σου γεμίζει το μάτι, από μέσα όμως είναι πολυτελείας. / *Kur e shikon nga jashtë nuk ta mbush syrin, brënda është shumë i bukur.*)

Έκλεισε τα μάτια του(για πάντα) / i mbylli sytë (përgjithmonë) (Ο πατέρας μας έκλεισε τα μάτια του για πάντα, μα εμείς θα τον αγαπάμε και θα τον θυμόμαστε. / *Babai i mbylli sytë për gjithmonë, por ne do ta duam e do ta kujtojmë.*)

Έχει κακό μάτι / ka sy të lig (të keq) (Κάθε φορά που έρχεστε στο σπίτι μας κάτι θα συμβεί, έχει κακό μάτι. / *Sa herë vjen në shtëpinë tonë ndodh diçka, ka sy të keq.*)

Παίρνω από/ με καλό μάτι / e ka me sy të mirë (Ο δάσκαλος τον έχει πάρει με καλό μάτι από την αρχή, γι'αυτό του βάζει καλούς βαθμούς. / *Mësuesi e ka me sy të mirë, prandaj i vë nota të mira.*)

Χώνει τη μύτη του παντού (μην χώνεις τη μύτη σου παντού, γιατί δεν αρέσει σε κανέναν από εμάς) / fut hundët (Αυτή η υπόθεση ανήκει σε μένα, γι'αυτό μην χώνεις τη μύτη σου εκεί που δεν χρειάζεται. / *Kjo çështje më përket mua, ndaj mos i fut hundët atje ku nuk të takon.*)

Του βγαίνει από τη μύτη κάτι / i doli nga hundët (për hundësh) diçka (Ήταν τόσο δύσκολο βιβλίο, που μου βγήκε από τη μύτη η αμοιβή που πείρα. /*Ishte libër aq i vështirë, saqë më doli për hundësh shpërblimi që mora.*)

Του έπεσε η μύτη / E uli hundën/ i ra hunda (Είχε μάθει να μιλάει πάντα με ειρωνεία, όμως μετά την σκληρή κριτική του τύπου του έπεσε η μύτη. / *Ishte mësuar të fliste gjithmonë me ironi, por pas kritikës së ashpër që iu bë nga media, i ra hunda.*)

Δεν κατεβάζει τη μύτη του / s'e ul hundën *Γιατί δεν ήρθες στα γεννέθλια του Γιάννη. Θα σου κατέβαινε η μύτη να ζητούσες συγνώμη. / Përse nuk erdhe në ditëlindjen e Janit, apo s'e ul hundën t'i kërkosh falje.)*

Απ' την κορυφή ως τα νύχια(από πάνω μέχρι κάτω) / nga koka deri tek këmbët/ fund e krye(e majë) *(Έμεινε ικανοποιημένος από το γιατρό, τον εξέτασε από την κορυφή μέχρι τα νύχια. / Mbeti i kënaqur nga doktori, e vizitoi nga koka deri te këmbët.)*

Άνθρωπος με δύο πρόσωπα / njeri me dy faqe/ me dy fytyra *(Τι μπορεί να περιμένεις από το Θωμά, εκείνος είναι άνθρωπος με δύο πρόσωπα. / E çfarë mund të presësh nga Thomai, ai është njeri me dy faqe.)*

Έδειξε το πραγματικό του πρόσωπο / tregoi fytyrën e vërtetë *(Με τις πράξεις του έδειξε το πραγματικό πρόσωπο που έκρυβε τόσο καιρό. / Me veprimet që bëri, tregoi fytyrën e vërtetë që e fshihte kaq kohë.)*

Μας έβγαλε ασπροπρόσωπους / na zbardhi faqen *(Μας έβγαλε ασπροπρόσωπους μ' αυτή την συνέντευξη που έδωσε. / Na zbardhi faqen me atë intervistë që dha.)*

Με τον ιδρώτα του προσώπου του / me djersën e ballit *(Γιατί να τραπώ, αφού το έχω κερδίσει με τον ιδρώτα του προσώπου μου. / Përse të më vijë rëndë, kur e kam fituar me djersën e ballit.)*

Άπλωσε τα πόδια σου κατά το πάπλωμά σου / shtriji këmbët sa ke jorganin *(Έχουμε ξοδέψει πολλά αυτήν την περίοδο άσκοπα, μήπως είναι καλύτερα να απλώσουμε τα πόδια κατά το πάπλωμά μας. / Kemi harxhuar shumë këtë periudhë, edhe për gjëra të ranevojshme, a nuk do ishte më mirë t'i shtrijmë këmbët sa kemi jorganin.)*

Βάζει το ένα πόδι πάνω στ' άλλο / hedh këmbën mbi këmbë *(Με μικρά παιδιά και με οικονομικές δυσκολίες υπέφερε πολύ, ωστόσο τώρα που μεγαλώσανε και έχουν διμηνουργηθεί με όλα τα καλά, έχει βάλει το ένα πόδι πάνω στ' άλλο και κάνει ζωή χαρισάμενη. / Me fëmijë të vegjël e me ramundësi ekonomike vuajti shumë, mirëpo tani që iu rritën dhe janë me gjithë të mirat, ka hedhur këmbën mbi këmbë e bën jetë zotërie.)*

Γλιστράει το έδαφος κάτω από τα πόδια του / i dridhet (rrëshqet, shket, lëviz) toka (trualli) nën këmbë *(Γλίστρησε το έδαφος κάτω από τα πόδια του, όταν άκουσε την δυσάρεστη είδηση στην τηλεόραση. / I rrëshqiti toka nën këmbë, kur dëgjoi lajmin e kobshëm në televizor.)*

Είναι με το ένα πόδι στον τάφο / është me një këmbë në varr *(Τι άνθρωπος και αυτός με το ένα πόδι στον τάφο και το μυαλό του στα λεφτά! / Bobo çfarë njeriu, edhe pse me një këmbë në varr, nuk e heq mendjen nga lekët!)*

Μου έπεσαν τα πόδια / më ranë këmbët *(Του έπεσαν τα πόδια ψάχνοντας αυτό το γραφικό μέρος.- I ranë këmbët duke kërkuar atë vend piktoresk.)*

Πήρε τα πόδια του στις πλάτες / mori këmbët në krahë *(Πήρε τα πόδια του στις πλάτες και έφυγε από εκεί που ήρθε. / Mori këmbët në krahë dhe ia mbathi andej nga kishte ardhur.)*

Σηκώνονται τα πόδια και χτυπούν το κεφάλι / ngrihen këmbët e i bien kokës *(Και μη χειρότερα φίλε μου, μ' αυτά που μου λες είναι το ίδιο σαν να σηκώνονται τα πόδια και χτυπούν το κεφάλι. / Jemi katandisur si mos më keq, me këto që më the i dashur mik, është njësoj si të ngrihen këmbët e t'i bien kokës.)*

Τέντωσε τα πόδια του / i ndeu këmbët (me këmbët nga dielli) *(Μη μου μιλάς γι' αυτόν, τέντωσε τα πόδια του και ησυχάσαμε. / Mos më thuaj për atë, i ndeu këmbët dhe ramë në qetësi.)*

(Στο/ από) Το στόμα του λύκου / në gojë të ujkut (Χωρίς να το καταλάβει πήγε κατευθείαν και στο στόμα του λύκου. / *Si pa e kuptuar, shkoj drejt e në gojë të ujkut.*)

Από στόμα σε στόμα / gojë më gojë (Η είδηση ότι θα παντρευτούν σύντομα πέρασε από στόμα σε στόμα και το έμαθαν όλοι. / *Lajmi se do të martohet së shpejti kaloi gojë më gojë, e morën vesh të gjithë.*)

Με άφησε με το στόμα ανοιχτό / më la me gojë hapur (Ήταν σε μικρή ηλικία και όταν άρχισε να απαγγέλλει με άφησε με το στόμα ανοιχτό. / *Ishte në moshë të vogël dhe kur filloi të recitonte më la me gojë hapur.*)

Δεν παίρνεις κουβέντα από το στόμα του / s'e hap gojën (Πάντα έτσι απόμακρος και σιωπηλός ήταν στη ζωή του, δεν έπαιρνες κουβέντα από το στόμα του. / *Gjithmonë ashtu i mbyllur e pa fjalë ka qënë, s'e hapte gojën ndonjëherë.*)

Στάζει μέλι το στόμα του / e ka gojën mjaltë (ka gojë të ëmbël) (Το στόμα του στάζει μέλι, γιατί και όταν σε μαλώνει φαίνεται σαν να σε χαιδεύει. / *E ka gojën mjaltë, se edhe kur të qorton, duket sikur të lajkaton.*)

Δεν έχει στόμα να μιλήσει / s'ka gojë të flasë (dikush) (Με όλες αυτές τις χάρες που του έχω κάνει δεν έχει στόμα να μιλήσει. / *Me tërë ato ndere që i kam bërë, s'ka gojë të flasë.*)

Βρέχει το στόμα του / njom gojën (njom fytin) (Σε παρακαλώ δώσε μου μια γουλιά νερό να βρέξω το στόμα μου. / *Të lutem më jep një raki sa të lag fytin.*)

Έβαλε χαλινάρι στο στόμα του / i vuri fre gojës (i vuri kyçin gardh) (Έβαλε χαλινάρι στο στόμα του, από τον φόβο μην καταστραφεί από τις βλακείες που πετούσε. / *I vuri fre gojës, vetëm nga frika se mos digjej për vete nga broçkullat që këpuste.*)

Έμεινα με το στόμα ανοιχτό / mbeta me gojë hapur (Όταν σήκωσα τα μάτια μου ψηλά και είδα την γέφυρα του Μπρούκλιν, έμεινα με το στόμα ανοιχτό. / *Kur ngrita sytë lart dhe pashë urën e Bruklinit mbeta me gojë hapur nga bukuria e saj.*)

Έχει στόμα. / është i zoti i gojës (Ξέρει να υποστηρίξει τον εαυτό του στα εύκολα και στα δύσκολα, γιατί έχει στόμα. / *Di ta mbrojë veten në të mirë e në të keq, se është i zoti i gojës.*)

Το θέλει στο στόμα / e do në gojë (e do në pjtë) (Πιο τεμπέλικο παιδί δεν έχω δει, τα θέλει όλα στο στόμα. / *Fëmijë më përtac s'më kanë zënë sytë, e do gjithëka në pjtë.*)

(Γλίτωσε) Παρά τρίχα / shpëtoi për një qime (Ο δρόμος ήταν πολύ επικίνδυνος, γλιτώσαμε παρά τρίχα. *Rruga ishte shumë e rrezikshme, shpëtua për qime.*)

Μου σηκώνεται η τρίχα - μου σηκώνονται οι τρίχες της κεφαλής μου / iu ngritën (iu çuan) qimet/ flokët/ leshrat e kokës përjetë (Το σπίτι στο χωριό ήταν έτοιμο να πέσει. Όταν το είδε εκείνη σ'αυτή την κατάσταση της σηκώθηκαν οι τρίχες της κεφαλής της. / *Shtëpia e fshatit ishte gati për të rënë. Kur ajo e pa në atë gjendje iu ngritën qimet e kokës përjetë.*)

Κάνει την τρίχα τριχιά / e bën qimen tra (Δεν έχω και πολύ εμπιστοσύνη στον ανιψιό μου, γιατί αυτός κάνει την τρίχα τριχιά. / *Nuk i kam shumë besim nipit tim se ai e bën qimen tra.*)

Κρέμεται από μια τρίχα / varet (mbahet) në një qime (Η ζωή του κρέμεται από μια τρίχα τώρα πια. / *Jeta e tij varet nga një qime tashmë.*)

Από πρώτο χέρι / i dorës së parë (Η επιχείρηση του πάει πολύ καλά, γιατί όλα τα προϊόντα τα έχει από πρώτο χέρι. / *Biznesi i ecën shumë mirë, sepse mallin e ka të gjithë të dorës së parë.*)

Είναι το δεξί χέρι κάποιου / është dora e djathtë e dikujt (Λένε πως ο προιστάμενος του γραφείου είναι το δεξί χέρι του δημάρχου. / *Thonë se shefi i kabinetit është dora e djathtë e kryetarit të bashkisë.*)

Έχει χρυσά χέρια / i ka duart flori / të arta (Η κόρη της Άννας είναι χρυσοχέρα, έκανε άνα γλυκό που έλιωνε στο στόμα. / *Vajza e Anës i ka duart flori, kishte bërë një ëmbëlsirë që të tretej në gojë.*)

Με τα χέρια στις τσέπες / me duart në xhepa (Εάν κάθεις όλη την ημέρα με τα χέρια στις τσέπες σίγουρα και δεν έχεις μέλλον μπροστά σου. / *Po qëndrove gjithë ditën me duar në xhepa domosdo që nuk ke të ardhme përpara.*)

Με το χέρι στην καρδιά / me dorë në zemër (Κάτι μου λέει ότι είναι έντομος άνθρωπος, μου μίλησε με το χέρι στην καρδιά και μου είπε όλη την ιστορία. – *Besoj që është njeri i ndershëm, më foli me dorë në zemër dhe më tha gjithë historinë.*)

Μου έφυγε από το χέρι / më doli nga dora (Ήταν ένα πολύ ωραίο σπίτι δίπλα στην θάλασσα, Δεν πρόλαβα να το αγοράσω, μου έφυγε από το χέρι αυτή η ευκαιρία και κάθε φορά που το βλέπω το ζηλεύω. / *Ishte një shtëpi shumë e bukur afër detit, nuk arrita ta blej, më iku nga dora dhe e kam zili sa herë e shikoj.*)

Σου/ του φιλώ το χέρι / i puth dorën (i lutem, i bie në gjunj) (Για το προσωπικό του συμφέρον, φυλάει και το χέρι του εχθρού. - *Për interesin e tij vetjak, ai i puth dorën edhe armikut.*)

Τελευταίο χέρι / dorë e fundit (Θα περάσω το τελευταίο χέρι και θα σου το φέρω. / *Sa t'i jap edhe dorën e fundit dhe do të ta sjell.*)

Τον/την έβαλε στο χέρι / e futi / e shtiu/ e vuri në dorë (Πραγματικά κουράστηκε, αλλά τελικά τον έβαλε στο χέρι. - *Me të vërtetë u lodh ca, por së fundmi e shtiu në dorë.*)

Του άφησε το χέρι ελεύθερο / i lë dorë të lirë (Αφού πείστηκε για την τιμιότητα του, του άφησε το χέρι ελεύθερο να διηγήσει εκείνος την επιχείρηση. / *Si u bind për ndershmërinë e tij i la dorë të lirë të vazhdonte ai biznesin*)

Του δέθηκαν τα χέρια / iu lidhën duart (Ήταν τόσο συγκινημένος, που του δέθηκαν τα χέρια και έμεινε ακίνητος. - *Ishte aq i emocionuar, sa që iu lidhën duart e ngeli në vend.*)

Του δίνω το χέρι / i jap dorën (ndihmoj) (Οι δουλειές του δεν πήγαιναν και πολύ καλά, του έδωσα το χέρι γιατί τον λυπήθηκα. – *Biznesi i tij po falimentonte dhe unë i dhashë dorën, se më vinte keq për të*)

Του έσφιξε το χέρι / i shtrëngoј dorën (përgëzoј) (Του έσφιξε το χέρι για το σχέδιο και την τέλεια δουλειά που είχε κάνει. / *I shtrëngoј dorën për projektin dhe punën e përkryer që kishte bërë.*)

Του δίνει το χέρι και σου παίρνει τον ώμο / i jap gishtin e të merr dorën (Μην ξεγυιέσε από τέτοιους ανθρώπους, τους δίνεις το χέρι και σου παίρνουν τον ώμο. / *Mos u gënjë nga njerëz të tillë, se u jep gishtin e të marrin dorën.*)

Του πιάνει το χέρι / I vjen doresh (Είναι πολύ καλός τεχνίτης, του πιάνει το χέρι, και τι δεν έχει φτιάξει στο σπίτι του. / *Është usta i mirë, i vjen për dore, çfarë nuk ka bërë në shtëpinë e ve.*)

Τρίβει τα χέρια του / fërkoј duart (gëzohem për fatëkeqësinë e tjetrit) (Είναι τόσο κακός, που τρίβει τα χέρια με τις κακοτυχίες των άλλων. / *Është aq dashakeq, sa fërkon duart me fatkeqësitë e fqinjëve.*)

Ψήνω ψάρι στα χείλη (κάποιου) / i pjek peshkun në buzë (Του έχει ψήσει ψάρι στα χείλη, δεν άντεξε άλλο και την παράτησε. / *I ka pjekur peshkun në buzë, nuk e duronte më e la dhe iku.*)

Κρέμομαι από τα χεῖλη σου / varem kokë e këmbë nga dikush (Θα μου πεις τι έγινε τελικά, δεν με βλέπεις που κρέμομαι από τα χεῖλη σου; – Do të më tregosh se çfarë ndodhi, nuk e shikon jam varur kokë e këmbë nga ty?)

* * *

Duke u ndalur shumë shkurt në një vështrim strukturor të frazeologjisë së interpretuar vërejmë se në gjuhën greke si dhe në shqipe njësitë frazeologjike mund të kenë strukturën e një togfjalëshi ose strukturën e një fjale.

Kur janë **me strukturë togfjalëshi** dalin:

a. në sintagma dygjymtyrëshe:

Njësi frazeologjike greke:

Folje	+	Emër	<i>Αλλαξε χέρι</i>
Folje	+	Folje	<i>Πες και γέλα.</i>
Numëror	+	Emër	<i>Από πρωτο χέρι.</i>
Folje	+	Ndajfolje	<i>Το πλήρωσα ακριβά.</i>
Emër	+	Ndajfolje	<i>Με τα χέρια γεμάτα.</i>
Ndajfolje	+	Emër	<i>Ψηλά τα χέρια!</i>
Emër	+	Emër	<i>Με νύχια και με δόντια.</i>

Njësi frazeologjike shqipe:

Emër	+	emër	<i>Kodra pas bregut.</i>
Emër	+	mbiemër	<i>Me zemër të hapur</i>
Folje	+	folje	<i>Qesh e ngjesh</i>
Folje	+	ndajfolje	<i>E pagoi shtrenjtë</i>

b. në sintagma trigjymtyrëshe:

Njësi frazeologjike greke:

Folje + Emër + Emër	<i>Πιάνω το κεφάλι με τα χέρια</i>
Folje + Mbiemër + Emër	<i>Πατά σε σάπιο ζύλο</i>
Përemër + Folje + Emër	<i>Να σου ξεραθεί το στόμα.!</i>
Folje + Emër + Ndajfolje	<i>Σηκώνω τα χέρια ψηλά.</i>
Përemër + Folje + Emër	<i>Του έκλεισε το στόμα.</i>

Njësi frazeologjike shqipe:

Folje + emër + emër	<i>Vë duart në kokë.</i>
Folje + emër + mbiemër	<i>E nxori në udhë të madhe.</i>
Përemër + folje + emër	<i>Tu thaftë goja!</i>
Folje + emër + ndajfolje	<i>Nre duart lartë.</i>

c. Njësi frazeologjike në sintagma me më shumë se tri gjymtyrë:

Njësi frazeologjike greke:

*Δεν παίρνεις κουβέντα από το στόμα του
Είναι το δεξί χέρι κάποιου
Μου σηκώνονται οι τρίχες της κεφαλής μου etj.*

Njësi frazeologjike shqipe:

*I jap gishtin e të merr dorën
Është dora e djathtë e dikujt
Iu ngritën leshrat e kokës përprjetë*

Njësi frazeologjike *me strukturë fjalie:*

Njësi frazeologjike greke:

*Το ένα χέρι νίβει το άλλο και τα δύο το πρόσωπο.
Ψήνω ψάρι στα χείλη (κάποιου)
Σηκώνονται τα πόδια και χτυπούν το κεφάλι*

Njësi frazeologjike të shqipes

*nga të fryjë era,
nuk ia ha qeni shkopin,
ku ha pula strall
I pjek peshkun në buzë
ngrihen këmbët e i bien kokës*

* * *

Njësitë frazeologjike e këtij grupi në të dyja gjuhët kanë **përkatësinë leksiko-gramatikore të emrit, mbiemrit, të foljes e të ndajfoljes** dhe shndërrimi figurativ është bërë pak a shumë me të njëjtat mjete e rrugë, ndër të cilat do të veçonim **shndërrimet me krahasim, me metaforë, me hiperbolë, me personifikim, me metonimi, me sinekdokë, me analogji** etj.

Meqenëse Greqia shtrihet në jug të Shqipërisë, kuptohet që ndikimet më të mëdha nga greqishtja në leksikon, në frazeologjinë, në semantikën etj. të shqipes do të gjendeshin në hapësirat kontaktuese dhe sidomos në toskërishte dhe në të folmet kufitare. Por është me vend të theksojmë se **izomorfia e emërtimeve (pavarësisht se sillen si terma) dhe e njësive frazeologjike që trajtuam (me vlerat e tyre shënuesë,**

shprehëse, emocionore dhe stilistikore që mbarin), tregon se janë kapërcyer jo vetëm kufijtë gjeografikë shtetërorë dhe krahinorë e dialektorë të njohjes e të përdorimit, por edhe kufijtë shoqërorë brenda shoqërisë shqipfolëse. Ato përdoren tashmë jo vetëm nga shtresat me arsim të lartë, por edhe nga një masë shumë e madhe njerëzish, e kushtëzuar kjo edhe nga lëvizjet emigruese dhe shtimi i jashtëzakonshëm i kontakteve gjuhësore e kulturore ndërmjet dy popujve.

Njohja e pasurisë frazeologjike të dy gjuhëve përbën jo vetëm një hallkë të domosdoshme në përvetësimin e gjuhës, por bëhet tregues edhe i shkallës së emancipimit dhe i kulturës botërore. Gjithashtu përdorimi i saktë, me masë dhe me vend i saj, ka rolin vetë në transmetimin e informacionit ndërmjet njerëzve dhe i jep ligjëritim një larmi të papërsëritshme, e bën atë më shprehës, më të figurshëm dhe më të bukur.

Dy dhjetëvjetëshat e fundit, kontaktet gjuhësore ndërmjet shqiptarëve dhe grekëve janë rritur ndjeshëm. Ato kushtëzohen nga faktorë ekonomikë, shoqërorë, politikë, kulturorë, shkencorë etj. Shpesh, gjatë komunikimeve gjuhësore dalin probleme që lidhen drejtpërdrejt me zotërimin e greqishtes nga shqipfolësit dhe të shqipes nga greqishtfolësit⁹¹. Ky zotërim nuk lidhet vetëm me profesionin ose me specialitetin e folësve, por lidhet edhe me faktorë të tjerë gjuhësore e jashtëgjuhësore: me shkallën e zhvillimit e të lëvrimin të gjuhës, me shkollimin e folësit ose me shkallën e njohjes së leksikut nga ana e tij. Përdorimi i frazeologjisë e bën gjuhën e folur ose të shkruar më tërheqëse dhe më të zhdërvjellët dhe lehtëson të nxënit në shkolla, komunikimet e përditshme gjuhësore, përkthimet e shumta në të gjitha fushat si dhe punën leksikografike.

⁹¹ V. Memisha, *Mbiemrat prejpesorë në shqipe dhe në greqishte*, në “Studime për fjalën shqipe”, Tiranë, 2011, f. 38

3. HUAZIMET NGA LEKSIKU TERMINOLOGJIK GREK

Huazimet leksikore në shqipe nga greqishtja mund t'i shohim edhe *sipas vlerës së përgjithshme*, duke i grupuar ***në fjalë të huaja*** dhe ***në fjalë ndërkombëtare***⁹². Fjalët ndërkombëtare, që i takojnë më shumë terminologjisë, janë përvetësuar më lehtë, kanë zënë vend më shpejt në gjuhë, janë më të qëndrueshme.

Fjalët e huaja, duke hyrë në gjuhën tonë, ***mund të kenë pësuar edhe ndryshime në formë e në përmbajtje***. Pra, gjuha jonë i ka marrë fjalët e huaja dhe i ka përpunuar këto fjalë sidomos në rrafshin fonetik dhe në atë morfologjik (eptimor, si lakim dhe si zgjedhim) ashtu si fjalët e veta.

Fjalët e huaja vijojnë të zhvillohen në truallin e gjuhës sonë, bëhen njësi të fjalorit të saj dhe u nënshtrohen kushteve konkrete historike, që përcaktojnë zhvillimin e leksikut të gjuhës shqipe në përgjithësi; ato bëhen edhe tema prodhuese: *gremis – gremisem – gremisje, (i, e gremisur)* etj. Fjalët e prejardhura në këtë mënyrë janë formime të shqipes dhe nuk mund të quhen huazime.

Kurse fjalët ndërkombëtare kanë karakter më ruajtës, më të qëndrueshëm. Ato zakonisht janë terma emra dhe u përkasin fushave të ndryshme të dijës, të shkencës, të teknikës dhe të artit.

Po japim një pasqyrë të përmbledhur të termave ndërkombëtarë me origjinë greke⁹³ që janë bërë pjesë e pandashme e leksikut terminologjik të shqipes, ashtu si edhe i gjuhëve të tjera me shkallë të ndryshme përpunimi a rëndësie komunikimi: *Abanoz (bot.); absidë (arkit), adenopati (mjek.), aerodinamik (fiz.), aerofobi (trans.), aeronaut (trans), aeronautikë (trans.), afazi (mjek.) aferezë (gjuh.), agami (zool.), agave (bot.), agnosticizëm (filoz.), agnosticist (filoz.), agnozi (mjek.), agronom (bujq.), agronomi, (bujq.), aguridhe (bujq.), akademi (ars.), akademik (ars.), akropol (urb.), akroni (gjuh.), akronim (gjuh.), akronimi (gjuh.), akustik (fiz.), akustikë (fiz.), alegori (let.), alegorik (let.), alergji (mjek.), alergjik (mjek.), anatomi (mjek.), anatomik (mjek.), androgjen (mjek.), anekdotë (folk.), antagonizëm (filoz.), antagonist (filoz.), antifrazë (let.), antroponim (gjuh.), antropolog (arkeol.), antropologji (arkeol.), antroponimi (gjuh.), apologji (jur.), apoteozë (fet.), arkitekt (ndërt.), arkeolog, arkeologji, asket (filoz.),*

⁹² Në vazhdim jemi marrë dhe me greqizmat në shqipe, si ***huazime gjuhësore*** dhe ***jo si huazime historiko-kulturore***. Këto ndeshen shpesh në ligjërimin e folur, dhe sidomos në të folmet dialektore të jugut, mbartësit e të cilave janë në kontakte të drejtpërdrejta popullsinë e Greqisë Veriore, por edhe me mediet greke, sidomos me ato televizive. Gjithashtu, këtu kanë ndikuar lëvizjet e lira të popullsisë në këto treva, përkëtej e përtej kufirit shtetëror.

⁹³ Gjatë trajtimit të huazimeve greke në shqipe (pavarësisht nga rruga e hyrjes) ne nuk jemi ndalur tek huazimet që janë terma të përbërë nga një element latin dhe një element grek ose anasjelltas: si *radioskopi, planimetri* etj. ose *hidrocentral, monovalent* etj.

asketizëm (filoz.) astrolog, astrologji, astrologjik, atlet (sport.), atom (fizik.), autoqefal (fet.), autoqefali (fet.), azot (kim.), bakterje (biol.), bakteriolog (mjek.), bakteriologji (mjek.), barbar (hist.), barometër (fizik.), barometri (fizik.), bibliograf, bibliografi, bibliografik, bibliotekë, biologji, biologjizëm, biosferë, botanikë, biotip (biol.), cedër (bot.), cefalopodë (biol.), ciklop (mit.), cilindër (mat.), cilindrik (mat.), cimbalo (muz.), cinizëm (psik.), cinik (psik.), (citoplazmë (biol.), citron (qitro) (bot.), dafinë (bot.), daktilografi (shtyp.), daktilografik (shtyp.), diplomë (ars.), diabet (mjek.), diafoni (gjuh.), diafragmë (mjek.), diagonale (mat.), diagram (viz.), diakritik (gjuh.), diakronik (gjuh.), dialekt (gjuh.), dialektikë (filoz.), dialektologji (gjuh.), diametër (mat.), dietë (mejk), diasporë (hist.), diftong (gjuh.), dinamikë (fiz.), distrofi (mjek.), distrofik (mjek.), dhiatë (fet.), ekinokok (mjek.), ekzazë (psikol.), ekzemë (mjek.), ekzogjen (mjek.), ekzotik (gjeog.), elektrodë (fiz.), elektroenergji (fiz.), elektrokimi (kim.), enciklik (fet.), endemi (mjek.), endodermë (mjek.), endokrin (mjek.), endoskopi (mjek.), energji (fiz.), epentezë (gjuh.), epentetik (gjuh.), epidermë (anat.), epigrafi (arkeol.), epiglotë (anat.), epikrizë (mjek.), epilepsi (mjek.), episod (let.), epistemologji (foil.), erotikë (psik.), etikë (filoz.), etimolog (gjuh.), etimologji (gjuh.), etnos (hist.), etos (hist.), ezofag (anat.), fagocitozë (biol.), fantazmagori (psik.), faring (gjuh.), laringal (gjuh.), farmaci (mjek.), farmakologji (mjek.), fitoekologji (biol.), fizik (fiz.), fizikë (fiz.), fiziolog (mjek.), fiziologji (mjek.), fizionomi (anat.), flegmatik (psik.), fonetikë (gjuh.), fonofobi (fiz.), fonograf (fiz.), fonografi (fiz.), fonolog (gjuh.), fonologji (gjuh.), fotografi (fiz.), fotografik (fiz.), gaalaktikë (astr.), gametë (biol.), gastronomi (gjell.), gastroskopi (mjek.), glosë (gjuh.), glosemë (gjuh.), glosografi (gjuh.), glotë (gjuh.), glotogoni (gjuh.), gnoseologji (foloz.), grafemë (gjuh.), grafologji (gjuh.), gramatikë (gjuh.), gramatologji (gjuh.), gramafon (muz.), gjenealogji (biol.), gjeodezi, gjeografi, gjeometri (mat.), gjeomorfologji (gjeol.), gjeopolitikë (pol.), gjini (gjuh.), gjiroskop (astr.), hagiografi (fet.), halisterezë (mjek.), haptometër (okul.), harmoni, (muz.), hedizmë (mjek.), hegjemoni (pol.), hegzametër, (let.), heliofobi (mjek.), heliocentrik (astr.), helioplastikë (fotogr.), helioterapi (mjek.), hematomë (mjek.), hemisferë (gjeog.), hematozë (mjek.), hemolizë (mjek.), hepatit (mjek.), hermafrodit (mit.), hermeneutikë (fil.), heterofoni (mjek.), heteroorganik (gjuh.), hidremi (mjek.), hidrodinamikë (fiz.), hidrogjen (kim.), hidroardi (mjek.), hidrolizë (kim.), hidrometeorologji (gjeogr.), hidroplan (trans.), hidroterapi (mjek.), hierarki (soc.), hidrografi (gjuh.), hieroglif (gjuh.), himn (let.), homograf (let.), hiperbolë (let.), hiperdialekt (gjuh.), hipermetropi (mjek.), hipertrofi (mjek.), hipologji (mjek.), hipoktri (soc.), hipodrom (hipiz.), hipofizë (anat.), hipopotam (zool.), hipotekë (adm.), histologji (anat.), histori (hist.), histogram (hist.), homoetni (soc.), homofoni (muz.), homonimi (gjuh.), ideofon (gjuh.), idioglosë (gjuh.), idiolekt (gjuh.), idiomë (gjuh.), ikonë (fet.), ikonostas (fet.), izometrik (mat.), izomorf (gjuh.), izomorfemë (gjuh.), izosillabik (gjuh.), izotermik (fiz.), jod (kim), kandërr (zool.), karafil (bot.), karamanjollë (hist.), kardiografi (mjek.), kardiologji (mjek.), katastrofë (soc.), kategori (sist.), katekumen (ars.), katodë (fiz.), keraunofobi (gjeg.), kinema (kinem.), kinematografi (kinem.), kinokomedi (let.), kinolog (veter.), kitarë (muz.), kitarist (muz.), klorofil (bot.), kloroform (kim.), kor (muz.), koreografi (muz.), kozmogoni (filoz.), kozmologji (filoz.), kozmopolit (filoz.), kozmonaut (astr.), krimoterapi (mjek.), kriptomani (jur.), kriptomani (gjuh.), kriptonim (gjuh.), kromozom (biol.), kronografi (hist.), kronologji (hist.), ksilogji (biol.), ksilofon (muz.), ksilografi (gjuh.), ksenomani (soc.), labirint (anat.), laik (fet.), lagofalmi (mjek.), galofobi (mjek.), laring (anat.), leukoplast (mjek.), letargji (biol.), litani (fet.), lisofobi (psik.), logomani (psik.), logopati (mjek.), logopedi (mjeke.), logotipi (shtyp.), logjikë (filoz.), llogari (mat.), llukanik (gjell.), magmasferë (gjeol.),

magnetoskop (fiz.), makinë, makroklimë (gjeog.), mani (mjek.), megafon (fiz.), megalomani (psik.), menostazë (mjek.), metatezë (gjuh.), metamorfozë (biol.), metastazë (mjek.), metatoni (gjuh.), metataksë (ling.), meteor (astr.), meteorografi (gjeog.), metonimi (gjuh.), metonomazi (gjuh.), metrologji (mat.), mikrobiolog (biol.), mikrobiologji (biol.), mimeografi (tek.), miotomi (mjek.), mitër (anat.), mnemofili (post.), monofobi (mjek.), monogami (soc.), monoteist (filoz.), morfologji (gjuh.), morfofonemë (gjuh.), morfosintaksë (gjuh.), morfonologjik (gju.), muzikologji (muz.), nautofobi (lundr.), nekrobiozë (mjek.), hekrofili (mjek.), nekrofobi (mjek.), nekrologji (mjek.), nefit (fet.), neologjizëm (gjuh.), neuromë (mjek.), neuron (anat.), meuropatolog (mjek.), nomografi (jur.), obelisk (arkit.), odontologji (mjek.), oftalmologji (mjek.), oksifobi (mjek.), oksimoron (let.), oksiton (let.), oktapod (zool.), oligofreni (mjek.), oniomani (treg.), onomasiologji (gjuh.), onomastikë (gjuh.), onomatologji (gjuh.), onomatope (gjuh.), ontologji (filoz.), ontogjenezë (biol.), oqeanografi (gjeog.), ornitofili (biol.), ortodoks (fet.), ortofoni (gjuh.), ortoepi (gjuh.), ortogon (mat.), ortogram (gjuh.), ortogjenezë (biol.), otologji (mjek.), otoskopi (mjek.), paleogjen (gjeol.), paleolog (gjeol.), paleontografi (gjeol.), paleontologji (gjeol.), pandemi (mjek.), pankreas (anat.), panoramë (pikt.), paradoks (filoz.), paralizë (mjek.), patologji (mjek.), pederasti (patol.), periferi (gjeog.), periodë (hist.), petrografi (gjeol.), petrokimi (kim.), psikologji (psik.), psikoneurozë (mjek.), qiparis (biol.), rapsod (folk.), rinolog (mjek.), rinologji (mjek.), rtimikë (muz.), romb (mat.), semantemë (gjuh.), semafor (fiz.), semantikë (gjuh.), semasiologji (gjuh.), semiologji (gjuh.), siderigrifi, silepsë (soc.), silogjizëm (logj.), sinkopë (let.), sindromë (mjek.), sinharmoni (gjuh.), sinonim (gjuh.) sinonimi (gjuh.), stenografi (gjuh.), takikardi (mjek.), talantropi (mjek.), taksimetër (trans.), termometër (fiz.), termograf (fiz.), termograf (mjek.), tragjedi (let.), trikofagi (mjek.), thesar (fin.), uranometri (astr.), urologji (mjek.), zoofagji (fiziol.), zoofili (mjek.), zeugmë (gjuh.), zoologji, zoonim (gjuh.), zootekni (zool.) etj.

Një pjesë e këtyre termave (që u përkasin fushave të ndryshme) kanë përdorim shumë të gjerë në komunikimin e përditshëm dhe janë bërë pjesë e leksikut të përgjithshëm; ata i gjejmë edhe në fjalorët filologjikë ose shpjegues të shqipes (*kimi, fizikë, gramatikë, fonetikë, semantikë, leksikologji, leksikografi, gjeografi, gjeodezi, gjeometri* etj.).⁹⁴ Kurse termat e tjerë i gjejmë nëpër fjalorët terminologjikë, sepse u përkasin fushave të ngushta të përdorimit.

Në qoftë se do të ndaleshim *në një klasifikim të mbështetur në mënyrën e huazimit*, huazimet leksikore nga greqishtja mund të jenë *të drejtpërdrejta* ose *të tërthorta*, d.m.th. të marra drejtpërdrejt nga gjuha e huaj ose nëpërmjet një gjuhë tjetër të tretë. Fjalët nga greqishtja e vjetër shqipja i ka trashëguar nga nëna e vetë, ilirishtja jugore. Kurse huazimet nga greqishtja bizantine dhe nga greqishtja e re ajo i ka huazuar drejtpërdrejt.

Një problem interesant është se *terminologjia*, për të cilën u ndalëm gjerësisht në këtë syth, *nuk është huazuar nga greqishtja drejtpërdrejt, por tërthorazi*. Shkencat shqiptare përgjithësisht janë shkencë të reja dhe terminologjinë shkencore e kanë marrë

⁹⁴ Th. Feka, *Vëzhgime mbi leksikun terminologjik, në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"* (1980), SF, 2, 1986

nga shkencat e vendeve perëndimore. Këto në vetvete i kanë ndërtuar termat mbi bazën e greqishtes së vjetër dhe të latinishtes, një proces që vazhdon sot e kësaj dite. Kështu pjesa dërrmuese a termave kanë hyrë në shekullin XX në shqipe nga italishtja, anglishtja, frëngjishtja, rusishtja dhe nga gjermanishtja.

Prof. Sh. Demiraj pohon për këtë se “*në gjuhën shqipe, sidomos në shekullin tonë (është fjala për shekullin XX, shënimi ynë – SD), kanë hyrë edhe një numër i konsiderueshëm fjalësh që kanë një përdorim të gjerë edhe në gjuhët e tjera. Këto janë kryesisht fjalë terma, që njihen me emrin ndërkombëtarizma. Këto huazime, pavarësisht nga burimi i tyre, kanë depërtuar në shqipe kryesisht nëpërmjet gjuhëve romane (sidomos nga italishtja) dhe gjermanike (sidomos nga anglishtja). Ato u përkasin sferave të ndryshme të shkencës, teknikës, kulturës, arteve, sporteve etj.*”⁹⁵

Gjuha shqipe shumicën e këtyre termave në përdorim e ka kodifikuar, e ka standardizuar dhe e ka pasqyruar në fjalorë terminologjikë (madje edhe në fjalorë filologjikë). Është për t’u habitur që në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, që ka qenë në vartësi të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, asnjë fjalor terminologjik (kur janë hartuar rreth 60 të tillë), nuk e ka fjalësin në greqisht ose nuk mbështetet në terminologjinë e përpunuar nga shkenca gjuhësore greke⁹⁶.

⁹⁵ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 129

⁹⁶ Shih për këtë të gjitha botimet terminografike, të bëra në vite nga sektori i terminologjisë pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë.

KREU III

FUSHAT KONCEPTORE DHE GJUHËSORE TË HUAZIMEVE GREKE NË SHQIPE

1. FUSHAT KRYESORE KONCEPTORE LEKSIKORE TË HUAZIMEVE GREKE NË GJUHËN SHQIPE

Shpesh, në ditët tona, pohohet se studimet që referohen leksikut, shtresave, klasave a grupeve të tij paradigmatiske nuk mund të analizohen dhe nuk mund të interpretohen pa vështuar përmes *teorisë së fushave gjuhësore*. Konceptimi i fushave në gjuhësi është tepër i gjerë. Studiuesi J. Thomai pranon se “fushë quhet ajo tërësi lidhjesh të njëjësive gjuhësore (semantike, leksikore-sintaksore) që mbulohej nga një fjalë ose nga një grup fjalësh”⁹⁷.

Teoria e fushave e ka zanafillën e vet të paktën në mesin e shekullit XIX dhe në mënyrë më të përgjithshme te idetë e Humboldt (1836), i cili mbahet si stërgjyshi shpirtëror i kësaj teorie, dhe Herderit (1772). Ndërsa F. de Sosyri është përshëndetur në shumë mënyra si prekursor (pararendës) i saj.

Por me të drejtë J. Triri (Trier) është vlerësuar gjerësisht, pavarësisht nga kritikantët që i janë bërë, si linguisti që “hapi një fazë të re në historinë e semantikës”. Ky *e sheh fjalorin e një gjuhe si një sistem të integruar leksemash* të lidhura nga ana kuptimore. Sipas këtij dijetari, fjalori i një gjuhe është një grup i mbyllur leksemash, të cilat mund të jenë anëtare të një grupi fushash leksikore, d.m.th. të ndara brenda nëngrupeve të tilla që *ndërprerja e dy fushave çfarëdo, të dallueshme, është e pazënë, është e lirë* (d.m.th. asnjë leksemë nuk është pjesëmarrëse e më shumë se një fushe) dhe bashkimi i të gjitha fushave në fjalor është i barabartë me vetë *fjalorin*.⁹⁸

⁹⁷ Konceptin dhe termin *fushë* në krye të herës e përdorën një numër dijetarësh gjermanë dhe zviceranë [përkatësisht Ibsen (1924), Jolles (1934), Porzig (1934), Trier (1934)]. Vitet e fundit kjo teori ka pasur një trajtim të gjërë nga autorë të ndryshëm [Ohman (1951), Ullman (1957), Oksaar (1958), Kühlëein (1967), Seiffert (1968), Geckeler (1971), Palmer (1977), Lyons (1977) etj.]. J. Triri (Trier) hapi një fazë të re në historinë e semantikës. Ai është kritikuar se mbivlerësoi lidhjet paradigmatiske, Porzigu sepse mbivlerësoi lidhjet sintagmatike në analizën kuptimore, ndërsa Lyons-i, sepse tërësinë e fushave semantike e sheh të lidhur me raportet e kuptimit dhe me kundërvëniet paradigmatiske. *Shih më gjerë* V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999, f. 25 – 46; G. Mpampiniotis, *Eisagogi stin simasiologia*, Athina, 1985 etj.

⁹⁸ Sipas Tririt nuk kemi fusha të interseksionuara, nuk kemi kurrfarë lekseme që t’u përkasë dy fushave, ashtu si nuk kemi leksemë që në ndërgjegjen e folësit të gjendet e veçuar, e mënjeluar. Ai më shumë u mbështet në fushat konceptuale, të cilat ndërtohen në përgjithësi në lidhjet nocionore, sendore, duke i barazuar ato me fushat leksikore. Por fjalorët dhe secila fushë në fjalor nuk janë grupe të mbyllura leksemash, ato janë ose të hapura, ose të paracaktuara. Fjalori, në marrëdhëniet me fushat, mund të konceptohet si tërësi fushash ose si një makrofushë e strukturuar, në kushtet e lidhjeve të mbartura midis fushave të cilat ai i përmban, në të njëjtën mënyrë si janë strukturuar vetë fushat leksikore. Kufiri midis fushave konceptuale, leksikore e semantike është shpesh i errët, por gjuhëtarë të ndryshëm, duke u nisur nga pika të ndryshme startimi e studimi, hedhin dritë për klasa të tëra fjalësh apo kategorish semantiko-

Xhon Lljajens (J. Lyons) pranon se fushat janë realitete të gjalla, të ndërmjetme midis fjalëve të veçanta dhe tërësisë së leksikut. Si pjesë të së tërës, ato ndajnë me fjalën cilësinë e të qenit të integruara brenda një strukture më të madhe dhe me fjalorin cilësinë e të qenit të strukturuar në kushtet e njësisive më të vogla .

Triri dhe shumë dijetarë të tjerë u morën me leksema që shënojnë sende konkrete, e për pasojë në punimet e tyre mbizotëroi fusha konceptuale. Kjo teori e zbatueshme për leksema me referentë të identifikueshëm është shumë e vështirë për leksikun abstrakt. Por fusha semantike kanë edhe leksemat abstrakte. Prandaj për të përcaktuar një fushë, duhen pasur parasysh dhe lidhjet konceptuale, dhe leksikore, dhe semantike. J. Thomai vëren se “tërësia e leksemave që mbulon një fushë konceptuale dhe strukturën e lidhjeve kuptimore, formon një fushë leksikore”⁹⁹. Kufiri midis fushave konceptuale, leksikore e semantike është shpesh i errët, por gjuhëtarë të ndryshëm, duke u nisur nga pika të ndryshme startimi e studimi, hedhin dritë për klasa të tëra fjalësh apo kategorish semantiko-leksikore. Me të drejtë janë kritikuar Triri, që mbivlerësoi lidhjet paradigmatisht, Porzigu, që mbivlerësoi lidhjet sintagmatike në analizën kuptimore, apo Lyons-i, i cili tërësinë e fushave semantike e sheh të lidhur me raportet e kuptimit dhe me kundërvëniet paradigmatisht.

Kufiri midis fushave konceptuale, leksikore e semantike është shpesh i errët, por gjuhëtarët, duke u nisur nga këndvështrime të ndryshme, vënë në dukje klasa të shumta fjalësh apo kategorish semantiko-leksikore. Fushat, si tërësi njësisish, formojnë nëngrupe apo dhe mikrosisteme.

Tërësia e fjalëve që mbulojnë një fushë konceptore formon një fushë leksikore. Secila nga fjalët e një fushe leksikore mbulon një koncept të caktuar të një fushe konceptore, duke hyrë në lidhje me fjalët që emërtojnë konceptet e tjera të asaj fushe. ***Fushat leksikore përbëjnë sisteme apo nënsisteme të leksikut.*** Sipas Sosyrit vlera e një fjale përcaktohet duke e parë atë në lidhje me vlerën e fjalëve të tjera të së njëjtës fushe. Fushat leksikore të një gjuhe ndryshojnë, gjatë zhvillimit të gjuhës. Për kuptimin e fjalës nuk janë të rëndësishme vetëm raportet paradigmatisht midis fjalëve të një fushe leksikore. Faktor tjetër që ndikon në kuptimin e fjalës, janë dhe lidhjet sintagmatike të fjalës. ***Për të gjitha kuptimet e një fjale që dalin nga lidhjet e saj në sintagma thuhet zakonisht se përbëjnë fushën semantike të saj.***

Megjithëse gjuhëtarët nuk e shikojnë të gjithë njësoj konceptin e fushës semantike, mendimi i përgjithshëm është ***se teoria e fushës leksikore dhe teoria e fushave semantike duhen parë si dy teori që plotësojnë njëra - tjetrën.*** Studiues të ndryshëm dhe hartues të veprave të mirëfillta leksikografike, pranojnë me dhjetëra fusha leksiko - semantike të cilat mund t'i gjejmë në një fjalor shpjegues apo që duhet të kihen parasysh kur hartohet një fjalor i tillë.

Semantologu bashkëkohor, Haida pohon se, përgjithësisht në të gjitha gjuhët e i.e, ka rreth 100 fusha leksiko – semantike që mund t'i zbulojmë lehtësisht.¹⁰⁰

leksikore. *Shih më gjerë V. Memisha, Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999, f. 25 – 46.

⁹⁹ J. Thomai, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989, f. 70-71

¹⁰⁰ *Veprime (veprime që ndryshojnë trajtën e një objekti; veprimet themelore: përdorim dhe tjetërsim (manipulim); veprime pak a shumë violente); kafshë (zogjtë; kafshët shtëpiake; insektet; kafshët tokësore; krijesat e detit; terma të tjerë); trupit (pjesët e trupit; krahët dhe këmbët; funksionet trupore dhe prodhimet*

Në mendimin leksikografik shqiptar ekziston një taksonimi e mirëpërcaktuar. Gjithë leksiku i shqipes ndahet në dy fusha kryesore¹⁰¹:

- a. Fusha e fjalëve dhe e frazeologjisë që lidhet **me botën materiale**
- b. Fusha e fjalëve dhe e frazeologjisë që lidhet **me botën shpirtërore**.

Fusha e botës materiale përbëhet nga tetë grupe paradigmatiche emërtime.

A. Grupi që përfshin emërtimet që lidhen me ndërtimtarinë, më banesat, minierat, prodhimet dhe nënprodhimet e industrisë, me artikujt e përdorimit të gjerë, me veglat dhe mjetet e punës, me institucionet e ndryshme etj.

B. Grupi që përmbledh emërtimet për punishtet e artizanatit, për punëtoritë e ta gjitha profileve, për veglarinë dhe për sendet e prodhuara prej tyre, si dhe për gjithë mjeshhtëritë.

C. Grupi që përmbledh të gjitha emërtimet për bimësinë, për botën bimore, që mund të jenë emërtime të thjeshta dhe emërtime të pathjeshta:

D. Grupi që përfshin emërtimet për botën e kafshëve, që mund të jenë edhe këto emërtime të thjeshta dhe emërtime të pathjeshta:

E. Grupi që përfshin emërtimet që lidhen me relievin e një vendi dhe me dukuritë natyrore.

F. Grupi që përfshin emërtimet që lidhen me emërtimet për njësitë e matjes (të kohës, të peshës, të gjatësisë, të sipërfaqes, të vëllimit etj.).

G. Grupi që përfshin emërtimet që lidhen me lojërat dhe lodrat.

H. Grupi që përfshin leksikun me emërtimet e njerëzve sipas tipareve fizike.

e trupit; kockat, mishi dhe lëkura; koka dhe qafa; organet e brendshme; terma të tjerë; pjesët private); ndërtimet (materialet dhe veprimtaritë ndërtuese; pjesët e shtëpisë; tipet e ndërtesave); ceremonitë dhe besimi (fetar); vetitë e karakterit; pastrimi (si term përfshirës); veshja (veshja dhe zërat (artikujt) e veshjeve; bizhuteritë dhe zbukurimet; lëndët (materialet), pajisjet dhe veprimtaritë); termat për ngjyrat; tregtia; mbajtëset (koshat; mbajtëse të tjera); përmasat; drejtimit; bërjet dhe punët; ngrënia dhe pirja; emocionet dhe ndjenjat; pasthirrat (thirrat); veprimet e gojës dhe të syve; peshkimi; ushqim dhe gatim (pijet; përgatitja e ushqimit; frutat dhe perimet; termat të përgjithshëm; ushqime të tjera; ushqimet tradicionale); termat gramatikore; rritje dhe pjekuri; shëndeti dhe sëmundjet: kushtet e lindura; terma të përgjithshëm; sëmundjet, dëmtimet (lëndimet) dhe cenet; nxehtësi dhe ftohtësi; artikujt shtëpiakë: mobilet dhe dhoma e gjumit; pajisjet dhe enët; gjueti (veprimtaritë gjuajtëse (për gjah); armët dhe artikujt shoqëruar; insektet; farefisnia; jeta dhe vdekja; vendndodhjet (lokalizimet); proceset mendore; lëvizjet; muzika; objektet natyrore (tiparet gjeografike; trupat qiellore; terma të tjerë; numërorët (numërorët themelorë; terma të tjerë); pushtimet dhe pozicionet në shoqëri; populli; cilësitë fizike; toponimet; bimët dhe pemët (pemët; bimët e egra); pozita dhe konfigurimi (relievi); argëtimi; shkolla; shikimi dhe dëgjimi; format (trupat); masat dhe njehsimet; gjumi dhe pushimi; sjellja shoqërore (sjellja autoritare dhe nënshtruese; sjellja antagoniste dhe negative; sjellja sportive (mbështetëse, përkrahëse); tingujt: të folurit; terma të tjerë; shpejtësia; shije dhe erërim; kushtet kalimtare (te përkohshme); kohë (muajt; koha relative; stinët; periudhat dhe gjatimet kohor; kohët e ditës); transportim (udhëtimi ajror; udhëtimi tokësor; udhëtimi detar; termat e udhëtimeve të tjera); gjykimet e vlefshme; moti.”

¹⁰¹ Paraqitjen skematike po e mbështetim në botimin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, *Udhëzues për mbledhjen e fjalëve dhe të sprehjeve të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989.

Fusha e botës shpirtërore që përshin leksikon që lidhet me botën e brendshme të njeriut dhe me veprimtarinë e tij mendore. Kjo është një fushë shumë e gjerë dhe fjalët mund të shënojnë tipare të veçanta, veti a cilësi të përgjithshme, ndjenja, gjendje, veprime, marrëdhënie etj.

Kontaktet mijërvjeçare ndërmjet dy popujve, atij shqiptar dhe më atë grek, kanë bërë që huazimet të gjenden në të gjitha fushat, pavarësisht se në një fushë më shumë e në një tjetër më pak. Kështu, ato i gjejmë gati në të gjitha fushat leksiko-semantike të mundshme.

Huazimet greke në shqipe **mund të grupohen në fusha të ndryshme**, në bazë të kriterëve të ndryshme klasifikuese.

1. Në një prerje të madhe, duke u mbështetur në vlerën e tyre shënuese por edhe strukturore, këto huazime do të krijonin dy fusha të mëdha: **huazime fjalësh** dhe **huazime njësisish frazeologjike**.

2. Por **fushat leksikore** dhe semantike të huazimeve greke mund të krijohen edhe sipas fushave konceptore, që përfshijnë fjalë që tregojnë se **cilës fushë të botës materiale a shpirtërore të shqiptarit** u përkasin. Prof. E. Çabej edhe studiues të tjerë kur kanë parë kronologjinë e huazimeve greke, **kanë bërë edhe klasifikime ose grupime të njësisive të huazuara edhe sipas fushave të ndryshme**. Duke u mbështetur në parashtrimet e mëparshme në faqet e këtij punimi po përmendim shumë shkurt:

- Fusha leksikore e huazimeve që i përkasin **sferës kishtare**, si: *manastir* (munështir); *kallogjër* (kllogjën, kllogjër), *ikonë*, *korë*; *potir*; *Ujët e Bekuar*, *Java e Madhe* etj.

- Fusha leksikore e huazimeve që u përkasin **dokeve e zakoneve**, si: *poganik*, *poganiqe*, *prikë*, *përqi*, *vë kurorë*, *fron*, *thron* etj.

- Fusha leksikore e huazimeve që i përkasin **jetës shoqërore**: *gjini*, *gjiri*, *gjeni*, *gjëri*; *frati*, *qefili*, *permyqyr*, *pronë*, *flamur*, *aspër* etj.

- Fusha leksikore e huazimeve që u përkasin **zeje të ndryshmeartizanateve**: *enemi*; *pezovol* etj.

- Fusha leksikore e huazimeve që i përkasin **jetës shtëpiake**: *avlli*, *tagar* (mangall), *gaforre*, *llukanik* (suxhuk), *magjir* (kuzhinë) .

- Fusha leksikore e huazimeve që u përkasin **kopshtarisë, bimëve**: *perivol*, *trëndafil*, *dhjozmë*, (mendër), *dafinë*.

- Fusha leksikore e huazimeve që i përkasin **kafshëve a shpendëve që lidhen me gjuetinë**: *skile* (dhelpër), *skifter*, *gjeraginë*.

- Fusha leksikore e huazimeve që i përkasin **trupit të njeriut, petkave, stolive**: *kurm*, *tipar*, *i pastër*, *stoli*, *stolis*, *benevrekë*.

3. Huazimet e shekujve të fundit nga greqishtja, **mund të krijojnë me dhjetëra e dhjetëra fusha leksikore**, që mund të organizohen nga përbërës semantikë të ndryshëm, sidomos fushat që përfshijnë me dhjetëra folje.

4. Fushat leksikore, më shumë sesa në leksikon e përgjithshëm, krijohen në terminologji. Ndaj edhe nga termat e huazuara nga greqishtja në mund të diferencojmë shumë fusha terminologjike:

- Fusha leksikore që përfshin terma nga **biologjia (botanika)**: *cefalopodë* (biol.), *biologji*, *biologjizëm*, *biosferë*, *botanikë*, *biotip* (biol.), *cedër* (bot.), *citoplazmë* (biol.),

citron (qitro) (bot.), dafinë (bot.), fagocitozë (biol.), kromozom (biol.), ksilogji (biol.), mikrobiolog (biol.), mikrobiologji (biol.), metamorfozë (biol.), ontogenezë (biol.), ornitofili (biol.), ortogjenzë (biol.) etj.

- Fusha leksikore që përfshin terma nga **zoologjia**: *zoologji, zootekni (zool.) oktapod (zool.), hipopotam (zool.)* etj.

- Fusha leksikore që përfshin terma nga **mjekësia**: *afazi (mjek.), alergji (mjek.), alergjik (mjek.), bakteriolog (mjek.), bakteriologji (mjek.), endemi (mjek.), endodermë (mjek.), endokrin (mjek.), endoskopi (mjek.), distrofi (mjek.), distrofik (mjek.), ekinokok (mjek.), ekzemë (mjek.), ekzogjen (mjek.), epikrizë (mjek.), epilepsi (mjek.), lagoftalmi (mjek.), galofobi (mjek.), leukoplast (mjek.), odontologji (mjek.), oftalmologji (mjek.), oksifobi (mjek.), metastazë (mjek.), nekrobiozë (mjek.), hekrofil (mjek.), nekrologji (mjek.)* etj.

Fusha leksikore që përfshin terma nga **gjuhësia**: *aferezë (gjuh.), akronim (gjuh.), akronimi (gjuh.), antroponim (gjuh.), antroponimi (gjuh.), diakritik (gjuh.), diakronik (gjuh.), dialekt (gjuh.), dialektikë (filoz.), dialektologji (gjuh.), fonolog (gjuh.), fonologji (gjuh.), glosë (gjuh.), glosemë (gjuh.), glosografi (gjuh.), glotë (gjuh.), glotogoni (gjuh.), gnoseologji (filoz.), grafemë (gjuh.), grafologji (gjuh.), gramatikë (gjuh.), gramatologji (gjuh.), diafoni (gjuh.), epentezë (gjuh.), epentetik (gjuh.), etimolog (gjuh.), etimologji (gjuh.), metatoni (gjuh.), metataksë (ling.), izomorfmë (gjuh.), izosilabik (gjuh.), homonimi (gjuh.), ideofon (gjuh.), idioqlosë (gjuh.), idiolekt (gjuh.), idiomë (gjuh.), metonimi (gjuh.), metonomazi (gjuh.), monogami (soc.), morfologji (gjuh.), morfofonemë (gjuh.), morfosintaksë (gjuh.), morfonologjik (gjuh.), semantemë (gjuh.), semantikë (gjuh.), semasiologji (gjuh.), semiologji (gjuh.), zeugmë (gjuh.)* etj.

Fusha leksikore që përfshin terma nga **letërsia**: *alegori (let.), alegorik (let.), antifrazë (let.), episod (let.), hezametër (let.), himn (let.), homograf (let.), hiperbolë (let.), kinokomedi (let.), tragjedi (let.), sinkopë (let.)* etj.

- Fusha leksikore që përfshin terma nga **filozofia**: *asket (filoz.), asketizëm (filoz.), antagonist (filoz.), epistemologji (filoz.), etikë (filoz.), kozmogoni (filoz.), kozmologji (filoz.), kozmopolit (filoz.), laik (filoz.), monoteist (filoz.), logjikë (filoz.), paradoks (filoz.), ontologji (filoz.)* etj.

- Fusha leksikore që përfshin terma nga **fizika**: *aerodinamik (fiz.), barometër (fizik.), barometri (fizik.), dinamikë (fiz.), elektrodë (fiz.), elektroenergji (fiz.), energji (fiz.), fonograf (fiz.), fonografi (fiz.), fotografi (fiz.), fizik (fiz.), fizikë (fiz.), izometrik (fiz.), magnetoskop (fiz.), makinë, megafon (fiz.), termometër (fiz.), termograf (fiz.)* etj.

- Fusha leksikore që përfshin terma nga **arkeologjia**: *arkeolog, arkeologji, antropolog (arkeol.), antropologji (arkeol.), epigrafi (arkeol.)* etj.

- Fusha leksikore që përfshin terma nga **besimi fetar**: *autoqefal (fet.), autoqefali (fet.), apoteozë (fet.), dhiatë (fet.), enciklik (fet.), haxjiografi (fet.), ikonë (fet.), ikonostas (fet.), ortodoks (fet.), litani (fet.), nefit (fet.)* etj.

- Fusha leksikore që përfshin terma nga **astronomia**: *galaktikë (astr.), astrolog, astrologji, astrologjik, gjroskop (astr.), heliocentrik (astr.), kozmonaut (astr.), meteor (astr.), meteorografi (astr.), uranometri (astr.)* etj.

- Fusha leksikore që përfshin terma nga **matematika**: *diagonale (mat.), cilindër (mat.), cilindrik (mat.), diametër (mat.), gjeometri (mat.), ortogon (mat.)* etj.

- Fusha leksikore që përfshin terma nga **gjeografia**: *gjeografi, ekzotik (gjeog.), hemisferë (gjeog.), hidrometeorologji (gjeogr.), makroklimë (gjeog.), hidrografi (gjeog.), oqeanografi (gjeog.), periferi (gjeog.), petrografi (gjeol.)* etj.

- Fusha leksikore që përfshin terma nga **psikologjia**: *ekstazë (psikol.), fonofobi (psik.), flegmatik (psik.), fantazmagori (psik.), erotikë (psik.), lisofobi (psik.), logomani (psik.), megalomani (psik.), psikologji (psik.)* etj.

- Fusha leksikore që përfshin terma nga **muzika**: *gramafon (muz.), kitarë (muz.), kitarist (muz.), kor (muz.), koreografi (muz.), homofoni (muz.), muzikologji (muz.), ksilofon (muz.)* etj.

- Fusha leksikore që përfshin terma nga **kimia**: *epidermë (anat.), hidrolizë (kim.), hidrogjen (kim.), jod (kim.), kloroform (kim.)* etj.

- Fusha leksikore që përfshin terma nga **anatomi**: *epiglotë (anat.), ezofag (anat.), faring (anat.), hipofizë (anat.), histologji (anat.), laring (anat.), pankreas (anat.), mitër (anat.), neuron (anat.)* etj.

Fusha leksikore që përfshin terma nga **gjeologjia**: *gjeodezi, gjeomorfologji (gjeol.), magmasferë (gjeol.), paleogjen (gjeol.), paleolog (gjeol.), paleontografi (gjeol.), paleontologji (gjeol.)* etj.

Fusha leksikore që përfshin terma nga **historia**: *etnos (hist.), etos (hist.), histori (hist.), histografi (hist.), karamanjollë (hist.), kronografi (hist.), kronologji (hist.), periodë (hist.)* etj.¹⁰²

* * *

5. Fushat leksikore në shqipe mund të organizohen edhe **sipas marrëdhënie paradigmatike fjalëformuese**, që do të thotë se fushat leksikore e huazimeve nga greqishtja mund të organizohen edhe në bazë të semave të përbashkëta të mbartura nga një temë fjalëformuese të një temë a fjalë tjetër, kur ndodh procesi i fjalëformimit, P.sh. me fjalën **frikë** dhe nga derivatet e saj në Fjalorin e gjuhës shqipe (2006) kemi një fushë leksikore me 21 leksema:¹⁰³

frik kal., **-a, -ur** bised. frikësoj.

frikem vetv. frikësohem.

frikur (i, e) mb. i frikësuar.

frikác,-e mb., edhe si *em.*, frikacak.

frikacák,-e mb., edhe si *em.*, *mospërf.* që ka shumë frikë.

frikakéq,-e mb., edhe si *em.*, *mospërf.* frikacak.

frikamán,-e mb., edhe si *em.*, *mospërf.* frikacak.

frikanjós,-e mb., edhe si *em.*, *mospërf.* frikacak.

frikásh,-e mb., edhe si *em.*, *mospërf.* frikacak.

frik/ë,-a f. 1. ndjenjë shqetësimi të thellë para një rreziku, para një fatkeqësie etj.: *ka frikë; i hyri (e zuri) frika; i doli (i iku) frika; ia ka frikën (dikujt a diçkaje) i trembet; i druhet; ka frikë nga hija e vet (keq.)* është frikacak i madh. 2. pasiguri, dyshim: *kam frikë se mos nuk e bëj dot; pa frikë pa ngurrim.*

frikës,-e mb., edhe si *em.*, *mospërf.* frikacak.

frikës/ój kal., **-óva, -úar** i fut frikën dikujt; tremb.

frikësóhem vetv. më zë frika; trembem.

¹⁰² Termat që janë përfshirë në këto fusha terminologjike janë vjelë nga *Fjalor fjalësh dhe shprehjesh të huaja*, të M. Ndrecës, Prishtinë, 2000

¹⁰³ Shih më gjerë *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006

frikësim, -i *m. sh. -e(t)* 1. veprimi sipas **frikësoj, frikësohem**. 2. mjet a mënyrë për të frikësuar dikë; kërcënim: *nuk u mposht nga frikësimet*.

frikësuar (i, e) *mb.* që ka frikë; i trembur.

frikësues, -e *mb.* që të frikëson; kërcënues: *metoda frikësuese*.

frik/ój kal., -óva, -úar frikësoj.

frikóhem *vetv.* frikësohem.

frikúar (i, e) *mb.* i frikësuar.

friksh/ëm (i), -me (e) *mb.* 1. që të frikëson, që të tremb: *pamje e frikshme; zë i frikshëm*. 2. frikacak: *njeri i frikshëm*.

frikshëm *ndajf.* me frikë: *i pa frikshëm*.

Le të krahasohet kjo fushë me atë të krujuar nga fjala **frikë (tmerr)** dhe derivatet e saj në greqishte: **φρίκη** (η) {χωρ. πληθ.}

1. ο τρόμος που καταλαμβάνει κάποιον, όταν βλέπει ή ακούει κάτι αποτρόπαιο: *μου προκαλεί - η θέα τού αίματος || η ~ τού πολέμου* · ΦΡ. **ταινία φρίκης** η ταινία που με την υπόθεση της ή/και με αποτρόπαιες σκηνές αποσκοπεί στο να προκαλέσει τρόμο στον θεατή ΣΥΝ. ταινία τρόμου, γκραν-γκινιόλ.

2. (συνεκδ.) οτιδήποτε αποτρόπαιο προκαλεί το παραπάνω συναίσθημα: *ήταν ~ να το ακούς*.

3. (ως χαρακτηρισμός) για κάτι/κάποιον πολύ άσχημο, απωθητικό: *ΤΟ παίξιμο της στη χθεσινή παράσταση ήταν ~ || -Πώς σου φάνηκε ο άντρας της;*

[ETYM αρχ., παράλλ. τ. τού θηλ. **φρίξ, -ικός** “ελαφρός κυματισμός, ρίγος, ανατρίχιασμα”, αβεβ. ετύμου, ίσως συνδ. με μέσ. ιρλ. **bri** “λόφος” (αιτ. **brig**), ουαλ. -**briga** “ψηλός, ορθός” κ.ά., που ανάγονται στη μηδενισμ. βαθμ. τού Ι.Ε. ***bher-gh-** “ψηλός, ύψος”, με την έννοια “στέκομαι όρθιος – ανατριχιάζω”. Οι σημασιολογικά συγγενείς τ. **ρίγος**, λατ. **frigus** ανάγονται σε Ι.Ε. ***srig-** και δεν συνδέονται με τη λ. **φρίξ**].

φρικιάζω ρ. αμετβ. {φρικιάσα} 1. αισθάνομαι φρίκη 2. ριγώ, ανατριχιάζω. Επίσης (λόγ.) φρικιώ [μτγν.] {-άς...}. — φρικιάσμα (το).

φρικίαση (η) [μτγν.] {-ης κ. -άσεως | -άσεις, -άσεων} (λόγ.) 1. το ρίγος, το τρεμούλιασμα 2. (μτφ. για υδάτινη επιφάνεια) ο ελαφρός κυματισμός.

φρικιαστικός, -ή, -ό αυτός που προξενεί φρίκη: ~ θέαμα ΣΥΝ. φρικαλέος, φρικτός. — φρικιαστικά επίρρ.

* * *

6. Fushat leksikore dhe semantike mund të shihen edhe **si fusha frazeologjike**. a. Kështu një kriter për grupimin e organizmin e njësive mund të jetë gjymtyra kryesore që mbart vatrën leksikore e semantike, si **dorë, sy, këmbë, zemër** etj. pavarësisht nga burimi apo nga semantika e tyre. P.sh., më poshtë jepet fusha e njësive frazeologjike të organizuara me gjymtyrën **Gojë**:

(**Στο/ από**) **Το στόμα του λύκου / në gojë të ujkut** (*Χωρίς να το καταλάβει πήγε κατευθείαν και στο στόμα του λύκου. / Si pa e kuptuar, shkoi drejt e në gojë të ujkut.*); **Από στόμα σε στόμα / gojë më gojë** (*Η είδηση ότι θα παντρεφτούν σύντομα πέρασε από στόμα σε στόμα και το έμαθαν όλοι. / Lajmi se do të martohet së shpejti kaloi gojë më gojë, e morën vesh të gjithë.*); **Με άφησε με το στόμα ανοιχτό / më la me gojë hapur** (*Ήταν σε μικρή ηλικία και όταν άρχισε να απαγγέλλει με άφησε με το στόμα ανοιχτό. /*

Ishte në moshë të vogël dhe kur filloi të recitonte më la me gojë hapur.); Δεν παίρνεις κουβέντα από το στόμα του / s'e hap gojën (Πάντα έτσι απόμακρος και σιωπηλός ήταν στη ζωή του, δεν έπαιρνες κουβέντα από το στόμα του. / Gjithmonë ashtu i mbyllur e pa fjalë ka qënë në jetën e vet, s'e hapte gojën ndonjëherë.); Στάζει μέλι το στόμα του / e ka gojën mjaltë (ka gojë të ëmbël) (Το στόμα του στάζει μέλι, γιατί και όταν σε μαλώνει φαίνεται σαν να σε χαιδεύει. / E ka gojën mjaltë, se edhe kur të qorton, duket sikur të lajkaton.); Δεν έχει στόμα να μιλήσει / s'ka gojë të flasë (dikush) (Με όλες αυτές τις χάρες που του έχω κάνει δεν έχει στόμα να μιλήσει. / Me tërë ato ndere që i kam bërë, s'ka gojë të flasë.).

b. Një kriter tjetër mund të jetë për të krijuar një fushë frazeologjike mund të jetë burimi i tyre apo motivimi etimologjik. Kështu fushë më vete formojnë gjithashtu edhe frazeologjizmat që vijnë nga bota mitologjike greke, si: *pastroj ahuret (stallat) e Augjias), filli i Arianës, flet nga maja e Olimp, si gosti në Olimp pëlhura e Penelopës, kutia e Pandorës, zjarri i Prometeut, bashka e artë, shpata e Damokleut, thembra e Akilit, kalë Troje, midis Skillës dhe Karibdës, dhurata e danajve, feneri i Diogjenit, fuçia e Diogjenit, feneri i Diogjenit, mundimet e Tantalit, frutat e Tantalit, guri i Sizifit, kompleksi i Edipit, fluturimi i Ikarit, nyja gordiane, kaloj Akerontin, ka veshët e Midasit, kthehem në Itakë, mollë sherri, kapërceu shtyllat e Herkulit etj.*

Kriter tjetër mund të jetë ana semantike, ideografike (fushat konceptore kryesore). Edhe këtu mund të kemi me dhjetëra e dhjetëra fusha me disa apo me shumë njësi përbërëse.

2. FUSHAT KRYESORE SEMANTIKE TË HUAZIMEVE GREKE NË GJUHËN SHQIPE

Fushat semantike mund të organizohen sipas lidhjeve semantike të kushtëzuara e të pakushtëzuara (organizimi polisemik, organizimi sinonimik, organizimi antonimik, organizimi hiponimik, organizimi metonimik, organizimi fjalëformues etj.). Ne po japim në vijim disa fusha semantike (nga një fushë për disa njësi që janë elemente të një çerdheje paradigmatiche fjalëformuese), që organizohen nga marrëdhëniet semantike të afërisë a të barazisë (ose të sinonimisë):

PÁSTËR (i) mb. 1. Që nuk ka pluhur, plehra, lyrë, bojë etj.; që nuk është i ndotur a nuk është bërë pis. **Paqmë (i)** bised. - Mos ki gajle, është e paqme. Gavetën e ruaj për të mjelë. (Let. art.). **Papërlyer (i)**. **Panjollë (i)**. **Dëllirë (i)**. Takijen e dliër, takijen e nxirë, / Buzën më të qeshur, më të psherëtirë. (Let. art.). **Panjollosur (i)**. **Pandotur (i)**. **Steril** mjek. pa mikrobe (për pambuk, shishe etj.). **Higjienik**. **Akull** si mb. shumë i pastër. **Dritë** si mb. shumë i pastër. **Pasqyrë** si mb. shumë i pastër. Iu përvesh punës bashkë me ne dhe brenda orës kapanonin e bëmë pasqyrë. (Let. art.). **Xham** si mb. bised. fig. shumë i pastër. **Xixë** si mb. fig. shumë i pastër. **Tullupan** si mb. 2. Që nuk ndot e nuk ndotet. **Pastërtor** (për njeriun). Thosh me vete se, afërmendsh, doktorit do t'i pëlqente një vajzë e re, pastërtore, që ta bënte zonjë të madhe. (Let. art. përkth.). **Paqmë (i)** bised. 3. Që nuk ka puçrra, dregëza ose shenja të ndonjë sëmundjeje. **Paqmë (i)** bised. **Qëruar (i)**. Zhurinskaja ishte një grua trupgjatë, me një fytyrë të qëruar, me ca sy të ëmbël e plot jetë. (Let. art. përkth.). **Qelibar** si mb. **Dëllirë (i)**. 4. Që është pa re. **Kthjellët (i)**. **Paqmë (i)** bised. **Qëruar (i)**. Horizonti u zbardh që në mbrëmje dhe në mëngjes qielli ishte i qëruar. (Let. art.). **Kulluar (i)**. **Hapët (i)**. **Hapur (i)**. **Larë (i)**. Retë u çanë dhe një erë e mbarë i shtyu drejt majëmave ku shkarkuan shiun. Doli një qiell i thellë, i kaltër e i larë që të ngopte syrin (Let. art.). **Kristaltë (i)**. **Qelibar** si mb. **Pasqyrë** si mb. fig. **Qelq** si mb. fig. **Kristal** si mb. fig. **Xixë** si mb. fig. **Xham** si mb. bised. Koha ishte e kthjellët, qielli xham, sapo kishte nisur të dukej zhegu në ajër. (Let. art.). 5. Që nuk ka lëndë të huaja, pluhur etj. të tretura a të përziera me të; i përbërë thjesht prej një lënde. **Paqmë (i)** bised. **Papërzier (i)**. **Dëllirë (i)**. - Shihe një herë, pastaj ik! E ke grurë të dëllirë. (Ligj. fol.). **Paprishur (i)** (për ajrin). **Pandotur (i)** (për ajrin). **Qëruar (i)** (për orizin). **Kulluar (i)**. **Kthjellët (i)** (për ujin e lëngje të tjera). **Kristaltë (i)** (për ujin e lëngje të tjera). **Kristal** si mb. (për ujin e lëngje të tjera). **Qelibar** si mb. (për ujin e lëngje të tjera). **Thjeshtë (i)**. **Vërtetë (i)**. **Safi** bised. - Merre pa merak! E ke mjaltë safi. (Ligj. fol.). **Shqeto** bised. - Unë nxjerr raki pa hile, raki shqeto, që kur e pi, s'të jep ujë, as dhimbje koke. (Ligj. fol.). 6. fig. Që nuk ka djallëzi e prapamendime; që nuk ka asnjë njollë në jetë, në sjellje, në punë etj.; që nuk e errëson asgjë e keqe a e shtrembër. **Paqmë (i)**. - Më keni bërë një të mirë të madhe, ju falënderoj me zemër. Do t'jua shpërblejmë me punë të paqme. (Let. art.). **Çiltër (i)**. Flet për të me krenari e në mënyrë të çiltër. (Let. art.). **Ndershëm (i)**. **Larë (i)**. **Qëruar (i)**. Zemra q'është e qëruar / Kurdoher' është e gëzuar. (Let. art.). **Dëllirë (i)**. Po tani ajo mbeti vetëm, ishte e shkretë dhe duhej ta mbyllte dashurinë e saj pa ndihmën e tij, të zhdukte ndjenjën më të dëllirë, më të ndritur në shpirtin e saj. (Let. art. përkth.). **Kulluar (i)**. Po sikur ajo vërtet të kishte dashur një djalë kur ne nuk ishim njohur ende, a do ta doja vallë? Pse ne djemtë kërkojmë gjithmonë që vajza të jetë e

kulluar? (Let. art.). **Shpirtkulluar. Virgjër (i).** Zonja Z. kishte mbetur deri atëherë shumë e ndershme, me zemër të virgjër, e paprekur nga ndonjë ndjenjë dhe e paditur në punë epshi. (Let. art. përkth.). **Padjallëzuar (i). Papërlyer (i).** Sa herë e takonte, ai stepej dhe turbullohej, kurse gruas i pëlqente kjo gjendje e tij shpirtërore prej djaloshi të papërlyer. (Let. art.). **Panjollë (i).** - Erdhëm të gëzohemi e të qafohemi bashkë për fitoret e para e t'ia shtrëngojmë duart Dedë Gjo Lulit, që është burri më i pafrikë e më i panjollë i maleve tona. (Let. art.). **Panjollosur (i).** Lumtua hyri në bisedë me atë zërin e brendshëm të ndërjegjes së panjollosur, që është një nga shoqëronjësit më të pamëshirshëm të njerëzve në minutat e fundit të jetës së tyre. (Let. art.). **Pacën (i)** fig. - Është vajzë e mirë dhe e pacën. (Ligj. fol.). **Pacenuar (i)** fig. E ndiente veten të kredhur në prehrin e një lumturie të madhe, të asaj lumturie, që mund t'ia falë njeriut vetëm ndjenja e pastër, sedra e pacenuar dhe dëlirësia e natyrës. (Let. art.). **Qelibar (i)** si mb. fig. Ajo edhe sot e kësaj dite bën be e rrufe se revizori ka parë ëndërr e se ajo e ndiente veten qelibar e s'ka bërë kurrë inventar me iniciativën e saj. (Let. art.). **Faqelarë** fig. "Më në fund, - tha me vete, - sikur të vinte edhe një herë në fuqi qeveria e rreptë e perandorit Napoleon, unë do të isha faqelarë, se s'kam vjedhur asnjë grosh. (Let. art. përkth.). **Shëndoshë (i)** (dashuri, lidhje a marrëdhënie). 7. Që është bërë siç duhet. **Qëruar (i). Paqmë (i).** 8. Që nuk është i mbushur me fjalë, me shprehje e me ndërtime të huaja. **Qëruar (i).** Fytyra e tij e bukur, me ca sy të zinj e të hijeshuar, kthehej nga unë me njerëzillëk e me kujdes dhe më thoshte me një gjuhë të qëruar: -Ja, e shikoni, udhët tona ndahen. (Let. art.). **Paqmë (i)** bised. 9. Që tingëllon rrjedhshëm e qartë. **Qartë (i). Qëruar (i)** (për zërin).

PASTËR ndajf. 1. Në gjendje të pastër, me pastërti. **Paq bised. Akull** si ndajf. **Acar.** 2. Me cilësi të lartë, pa të meta. **Paq bised.** 3. → **Qartë**_{1,2} ndajf.

PASTËRTÍ,-A f. Të qenët i pastër. 1. **Higjienë. Dëlirësi.** *Dëlirësia dukej kudo, dora e zonjës nikoqire s'kish lënë vend pa pastruar.* (Let. art.). 2. **Dëlirësi.** *Dëlirësia e fytyrës ia shtonte bukurinë njomëzakes sykaltër, që hidhej përtpjetë nga gëzimi.* (Let. art.). 3. fig. **Dëlirësi.** *Ata s'e din' aspak se unë vetë / I ndolla gjer aty langojt' e Ferrit / Për të lëpirë ndyrësin' e fajit, / Që derdhën njerëzit mbi dëlirësinë.* (Let. art. përkth.). **Çiltëri.** *Ajo qeshi dhe Arsenit i vajtën sytë tek ato gropëzat e faqeve, që i jepnin fytyrës së saj një çiltëri foshnjore.* (Let. art.). **Padjallëzi. Ndershmëri.**

PASTËRTÓR,-E mb., edhe si *em.* Që mban pastër veten, shtëpinë etj., që i pëlqen pastërtia. **Pastër (i). Paqmë (i)** bised. **Vezullore.**

PASTRÍM,-I m. Veprimi sipas **Pastroj, Pastrohëm.** 1. **Spastrim. Paqësim** bised. **Fshirje. Larje. Shpëlarje. Dëlirje. Heqje. Marrje** (e pluhurave). **Shkrimbje.** 2. **Spastrim. Qërim. Kullim. Filtrim. Rafinim. Dëlirje.** 3. → **Distilim,-i m. spec.** 4. → **Qërim,-i**_{1,2} m. 5. **Spastrim. Dëlirje. Qërim.** 6. **Spastrim. Kthjellim. Hapje. Qërim.** 7. → **Hapje,-a**₂ f. 8. fig. **Spastrim. Larje.**

PASTRÓHEM Vetv. e Pastroj. 1. **Lahem. Paqohem** bised. **Paqësohem** bised. **Dëlirem. Spastrohem. Shpëlahem. Shkrimbem.** 2. v. III. **Spastrohet. Rafinohet. Kullohet. Dëliret.** 3. → **Qërohem**₂ vetv. 4. v. III. **Spastrohet. Dëliret. Qërohet.** 5. v. III. **Spastrohet. Kthjellohet. Hapet. Qërohet. Lahet.** 6. v. III. Largohet a zhduket diçka (që zinte shikimin, pengonte dëgjimin, zërin etj.). **Qërohet. Kthjellohet. Spastrohet. Hapet** (koha, qielli). 7. fig. Largoje nga vetja çdo gjë të keqe. **Spastrohem. Dëlirem.**

PASTRÓJ kal. 1. I heq diçkaje pluhurin, plehrat, baltën, lyrën, bojën etj. (me fshesë, me furçë, me ujë etj.); laj me ujë e me sapun; e bëj të pastër. **Paqoj** bised. **Paqësoj** bised. **Fshij. Laj. Spastroj.** *Nisi të spastronjë ca armë të stërgjyshërve të tij, të cilat ishin mykur e zgjyrosur dhe ishin hedhur e harruar në një çip qindra vjete me*

radhë. (Let. art. përkth.). Shpëlaj. Dëllir. Njeriu ma rrëmbeu dorën, thirri mandej një tjetër dhe bashkë me të filluen me dëllirë dhomën. (Let. art.). Heq. Marr (pluhurat). Shkrimb. Shkërmoj. Çndot. 2. I heq diçkaje lëndët e huaja a papastërtitë. Qëroj (orizin, ferrat). Kulloj (ujin, vajin etj.). Filtroj. Rafinoj (naftën, bakrin etj.). Spastroj. Dëllir. Brizoj (lirin). 3. → Distiloj kal. spec. 4. → Qëroj_{1,2} kal. 5. v. III. I heq puçrrat, dregëzat ose njollat (në fytyrë e në lëkurë). Dëllir. Qëron. Spastron. 6. v. III. I largon retë, mjegullën etj. Kthjellon. Hap. Spastron. Qëron. 7. → Hap₂ kal. 8. fig. Ia largoj të këqijat (për ndërgjegjen, shpirtin etj.). Laj bised. - E lave mëkatin, kuqalash. Hë, hë... këtë do ta zë në hesap. (Let. art. përkth.). Spastroj.

PASTRÚAR (i) mb. Që është pastruar. 1. **Fshirë (i). Larë (i). Shpëlarë (i).** 2. **Qëruar (i). Kulluar (i). Filtruar (i). Rafinuar (i).** 3. → **Distiluar (i) mb. spec. 4.** → **Qëruar (i)_{1,2} mb. 5. Qëruar (i) mb. 6. Kthjelluar (i). Hapur (i). Qëruar (i).**

PASTRÚES,-I m. Ai që pastron. **Spastrues. Fshirës.**

PASTRÚES,-E mb. Që pastron. **Spastrues. Dëllirës.**

PASTRÚES/E,-JA f. → **Gom/ë,-a₂ f.**

Këtu duhet të themi se kemi 11 fusha semantike sinonimike, nga një për çdo fjalë titull, e cila është dominant i një fushe. Por kuptimet e të gjitha fjalëve me lidhje dhe pa lidhje derivacioni me mbiemrin *i pastër* të huazuar nga greqishtja, formojnë *një makrofushë semantike*.

3. FUSHAT KRYESORE NDAJSHTESORE

Ne mund të flasim edhe për *fusha ndajshtesore*. Prof. J. Thomai thekson se “në rrafshin sinkronik të gjitha fjalët e formuara me një ndajshtesë formojnë *fushën ndajshtesore*, në të cilën ka një përbërës të përbashkët kuptimor që e sjell ndajshtesa, por që ka edhe nuancime (variacione) të tjera kuptimore¹⁰⁴.

Këto lloj fushash kanë një specifikë, sepse në to përrshihen *fjalët e shqipes jo të parme (të prejardhura) të krijuara nga ndajshtesa të burimit grek*:

Fusha ndajshtesore e njësive me *-omë*: *balt-omë, bur-omë, kredh-omë, zez-omë, valomë, mballomë* etj.

Fusha ndajshtesore e njësive me *-is*: *kallaj-is, paj-is, përrall-is, rast-is, tigan-is, vaj-is, përsëri-is, uj(ë)-is* etj.

Fusha ndajshtesore e njësive me *-os*: *ajr-os, barr-os, breng-os, brum-os, çeltnik-os, damk-os, fund-os, gjak-os, hekur-os, plag-os, tym-os, vend-os, vul-os* etj.

¹⁰⁴ Shih më gjerë për këtë J. Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 268

KREU IV

ZHVILLIMET LEKSIKORE TË HUAZIMEVE GREKE NË SHQIPE

1. ZHVILLIME LEKSIKORE NGA HUAZIMET GREKE NË SHQIPE (GRUPET FJALËFORMUESE KRYESORE)

Leksiku i një gjuhe zhvillohet e ndryshon paprerë. Kështu ndodh dhe me leksikun e shqipes. Ai është përpunuar dhe përpunohet, është pasuruar dhe pasurohet vazhdimisht dhe duke iu përgjigjur më mirë kërkesave të zhvillimit ekonomik, shoqëror e kulturor vendit. Ai është plotësuar dhe është i hapur për plotësime me fjalë e shprehje e kuptime të krijuara rishtas apo dhe me huazime sapo këtë e kërkon vetë marrëveshja gjuhësore në shoqëri.

Sh. Rrokaj, duke pasur në qendër të trajtimit shqipen e ditëve të sotme, thekson se “një gjuhë standarde **zhvillohet dhe larmohet** ajo merr prurje vazhdimisht nga rrethina dialektore, por ka edhe rrugën e saj të zhvillimit. Prurjet gjuhësore lidhen me nevojat që i lindin bashkësisë gjuhësore në faza të ndryshme të zhvillimit të saj. Në një shoqëri të hapur politikisht dhe ekonomikisht, siç është shoqëria shqiptare sot, ndihet edhe trysnia e gjuhëve të vendeve të fuqishme politikisht dhe ekonomikisht, me të cilat jemi në kontakt. Kjo trysni është e pashmangshme në fazat e para të hapjes ndaj botës.”¹⁰⁵

Kjo nënkupton se **pasurimi nga dialektet, nga fjalëformimi dhe nga huazimi** janë tri rrugët kryesore të pasurimit leksikor të shqipes sot (si dhe të greqishtes apo të gjuhëve të tjera).

Punimi ynë, që lidhet drejtpërdrejt me interferencat leksiko-semantike të greqishtes në shqipe (përgjithësisht me huazimet në shqipe), ndalet edhe në një dukuri të rëndësishme dhe interesante njëkohësisht, **me zhvillimet leksikore nga huazimet greke në shqipe dhe grupet paradigmatiche fjalëformuese kryesore që lidhen me to.**

Duke u nisur nga formimi dhe nga motivimi semantik, fjalët nuk janë të një rrafshi. J. Thomai, thekson se:

a. **Fjalët e thjeshta, të paanalizueshme (të pazbërthyeshme) nga ana ndërtimore e semantike (derë, shpejt, shoh etj.) janë “njëbërthamëshe”;** po ashtu, fjalët e prejardhura me konversion (si më sipër: *kyç - kyç, ndryshk - ndryshk, buzë - buzë* etj.) duhen parë si “njëbërthamëshe”, sepse edhe ato janë të pazbërthyeshme nga ana ndërtimore e semantike, ose janë të zbërthyeshme në një rrafsh, por jo në tjetrin. Në

¹⁰⁵ Sh. Rrokaj, *Shqipja standarde në pragun e shekullit të ri*, në “Çështje të gjuhës shqipe”, Tiranë, 2007, f. 220

gjuhën shqipe ka mundësi për zbërthimin semantik, por jo ndërtimor (p.sh. *kyç* “mbyll me kyç”, *krip* “bëj me kripë” etj.).

b. ***Fjalët e formuara me ndajshtesa a me përbërje e përngjijtje dalin si “dybërthamëshe”, temë - ndajshtesë ose temë - temë.*** Kjo analizë, padyshim, i takon më shumë diakronisë sesa sinkronisë, sidomos për njësi ku struktura fjalëformuese me kohë është errësuar dhe “bërthamat” nuk dalin të pastra (p.sh. *ashtu, sot, gëzoj* etj.). “Kur analizojmë formimet me prapashtesa, - shkruhet në *“Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe”, - duhet të kemi parasysht edhe lidhjen kuptimore midis temës fjalëformuese dhe emrit të prejardhur të formuar prej saj. Në qoftë se lidhja kuptimore tashmë është këputur dhe nuk ndihet më në vetëdijen e folësve, një emër i tillë nuk duhet trajtuar më si fjalë e prejardhur, p.sh. *frymë* nuk ndihet më si një fjalë e prejardhur nga folja *fryj*, po ashtu emri *qëllim* nga folja *qëlloj* dhe *bimë* nga folja (mbin)”. Dy bërthamat e fjalës, njëkohësisht, lidhen, ndërthuren, ndikojnë mbi njëra-tjetrën, plotësojnë njëra-tjetrën, kundërvihen në funksione dhe shkrihen në një njësi të vetme leksiko-semantike.”¹⁰⁶*

Kjo ka vlerë edhe për huazimet greke, ***të cilat dalin brenda shqipes si fjalë të parme në procesin fjalëformues dhe pasurues.*** Ndaj kur shohim lëvizjen kuptimore të fjala në dalim nga kuadri i leksikologjisë (që merret me klasat leksikore të fjalëve, me shtresimet e tyre sipas kritereve të ndryshme, njëri prej tyre është kriteri i burimit të fjalës në kundërvënien *fjala vendëse / fjalë e huazuar*) dhe gjendemi në atë të semantikës leksikore.

Nga kjo që parashtruar, del se prejardhja semantike ka lidhje të drejtpërdrejte me formimin e fjalëve në dy drejtime:

a. Së pari, ***fjalët e reja*** që formohen, ***zhvillojnë kuptime që mbështeten në temën semantike***, d.m.th. në kuptimin e fjalëve prodhuese;

b. Së dyti, prejardhja semantike brenda fjalëve (zgjerimi i strukturës kuptimore të fjalëve me kuptime të reja), “ngushton” krijimin e fjalëve të reja, pra, krijimi i njërive të reja semantike dhe krijimi i njërive të reja leksikore janë në përpjesëtim të zhdrejtë. Veçse edhe ky pasurim nuk duhet kuptuar në mënyrë mekanike, përndryshe s’do të kishim sinonime të plota e të pjesshme dhe gjuha do të humbiste një nga tiparet e saj, larminë. Prandaj pasurimi i gjuhës bëhet me të dyja rrugët, madje edhe “duke e përsëritur” njëra-tjetrën, pa krijuar kurrë ngarkesë të tepërt a të panevojshme për gjuhën. Me një përmbajtje të gjerë “kuptime të prejardhura” kemi quajtur jo vetëm kuptimet e dyta, të treta etj. të fjalëve polisemike, që vijnë nga kuptimi i parë ose njëri nga tjetri, por edhe gjithë kuptimet e fjalëve të prejardhura e të përbëra.

* * *

Modelet konkrete fjalëformuese që kanë në themel huazimet greke shqipes, janë të shumta e të larmishme. Kjo duket kur shikon me imtësi gjithë madhësitë që veprojnë me vlerat e tyre në prejardhjen fjalëformuese e në prejardhjen semantike, si temën prodhuese konkrete, ndajshtesën konkrete, ndërrimet leksiko-gramatikore, valencat e brendshme, rikuptimësimet etj.

Gati të gjitha huazimet greke në shqipe (të leksikut të përgjithshëm a të atij terminologjik, huazimet greke të hershme a të reja, huazimet që i përkasin gjithë shqipes a huazimet dialektore, huazimet e ligjërimeve të shkruara a tyre bisedore etj.)

¹⁰⁶ Gramatika e gjuhës shqipe, 1, Tiranë, 2002, f. 56

kanë krijuar grupe paradigmatiche fjalëformuese, duke përfshirë brenda tyre fjalë me prejardhje, me përbërje, me nyjëzim, me konversion etj.

Prof. J. Thomai, thekson se “Një gjë është për t’u theksuar veçanërisht: me gjithë praninë e disa modeleve në lidhjet e zhvillimet semantike, në përkimin e strukturave semantike etj., çdo fjalë e prejardhur dallohet nga përmbajtja, nga veçoritë e formimit e të zhvillimit semantik, në ruajtjen a trashëgimin e përbërësve kuptimorë të fjalës burimore, në zhvillimet e jashtme e të brendshme semantike (nga kuptimet, nuancat, ngjyrimet etj.), në tipat e prejardhjes semantike dhe në drejtimet e lëvizjeve semantike.”¹⁰⁷

Le të marrim mbiemrin **i pastër**, nga i cili janë formuar fjalë me prejardhje:

- me parashtesim: **papástër (i, e)**;
- me prapashtesim: **pastri, pastërri, pastërtor, pastroj**;
- me përbërje: **zemërpástër, shpirtpástër, gjakpástër**.

Nga folja jo e parme (e pathjeshtë) **pastroj** janë krijuar **pastrohem, pastrim, pastrues, pastruese, i pastruar** etj.

Këto fjalë jo vetëm ruajnë në strukturën e vet, temën fjalëformuese minimale (rrënjën) **i pastër**, por krijojnë secila strukturën përgjegjëse kuptimore, që mbart sema (përbërës kuptimorë) që lidhen drejtpërdrejt me një kuptim, me disa kuptime ose me të gjithë strukturën kuptimore të mbiemrit:

PASTËRTËR, ~E mb. 1. Që e mban pastër veten, rrobat, shtëpinë, vendin e punës etj., që është shumë i rregullt në veshje dhe i pëlqen pastërtia. *Grua (vajzë) pastërtore.*

2. *Përd. em.* sipas kuptimit të mbiemrit. *Është pastërtore e madhe.*

PASTRI, ~A f. Pastërri.

PASTRÍM, ~I m. sh. ~E, ~ET. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve PASTROJ, PASTROHEM. *Pastrimi i shtëpisë. Pastrimi i trupit. Pastrimi i kanaleve. Pastrimi i kullotave. Pastrimi i radhëve.*

PASTROHEM vetv. 1. Pastroj veten duke u larë me ujë e me sapun dhe duke u fërkuar; heq nga vetja baltën, njollat ose papastërtitë e ndryshme me ujë a me ndonjë lëndë tjetër pastruese. *Pastrohet përditë. U la e u pastrua.*

2. *vet. veta III.* I largohet diçka e huaj a që e zinte, qërohet. *Qielli u pastrua.*

3. *fig.* Zhduk nga ndërgjegjja mbeturinat a ndikimet e ideologjisë së huaj. *Të pastrohemi plotësisht nga mbeturinat dhe shfaqjet e huaja.*

4. *Pës. e PASTROJ.*

PASTRUES, ~I m. sh. ~, ~IT. 1. Punëtor që bën pastrimin e diçkaje; ai që punon me makinë pastruese. *Pastruesi i rrugëve. Pastruesi i oxhaqeve.*

2. Lëng a lëndë tjetër që përdoret për të hequr njolla boje, lyre, ndryshku etj.; send a mjet për të pastruar; makinë pastrimi. *Pastrues kimik. Pastruesi i gazit.*

PASTRUES, ~E mb. Që përdoret për të pastruar diçka. *Lëndë pastruese. Makinë pastruese.*

PASTRÚES/E, ~JA f. sh. ~E, ~ET. 1. *Fem. e PASTRUES, ~I₁.*

2. Punëtore që merret me pastrimin në një institucion a ndërmarrje dhe që bën disa shërbime të tjera të vogla. *Pastruesja e institutit (e shkollës).*

3. Gome për të fshirë diçka të shkruar.

4. Makinë për pastrimin e diçkaje. *Pastruese automatike.*

¹⁰⁷ J. Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 292

PAPÁSTËR (i, e) *mb.* 1. Që ka papastërti, që nuk është i pastër; që nuk është pastruar, i ndyrë, i fëlliqur. *Dhomë (klasë) e papastër. Rroba të papastra. Lesh i papastër. Me fytyrë (qafë) të papastër. Me dhëmbë të papastër. Me duar të papastra.*

2. Që nuk e mban veten pastër; që nuk mban pastërti aty ku jeton a punon. *Shitës i papastër.*

3. Që ka mbeturina e gjëra të tjera, të cilat e zënë, e prishin etj. *Pus i papastër. Vijë uji e papastër.*

4. Që ka grimca pluhuri, erë të keqe etj., i ndotur, i qelbur (për ajrin). *Ajër i papastër.*

5. Që të ndot, që të fëlliq. *Punë e papastër.*

6. Që ka lëndë të huaja të tretura a të përziera në të; jo i kulluar; i përzier. *Ujë i papastër. Fare e papastër. Mineral i papastër.*

7. *fig.* Që ka ndonjë njollë morale, që nuk është i pastër. *E ka ndërgjegjen të papastër.*

8. Që është bërë pa kujdes dhe me cilësi të dobët; që është me ndreqje e gabime. *Punë e papastër. Kopje e papastër.*

9. *si em.* PAST/ËR,~RA (e) *f.* Fletë në të cilën është shkruar diçka në dorë të pare dhe me gabime e ndreqje. *E dorëzoi në të papastër. E kishte në të pa pastër.*

PAPASTËRTI,~A *f. sh. ~, ~TË.* 1. *vet. nj.* Të qenët i papastër, gjendja e dikujt a e diçkaje të papastër; mungesë pastërtie. *Papastërti e madhe. Papastërtia e trupit. Papastërtia është burim sëmundjesh. Në dhomë kishte papastërti.*

2. *kryes. sh.* Pluhura, baltë, lyre ose mbeturina sendesh të ndryshme e të pavlefshme që mblidhen diku a mbi diçka; plehëra. *Fshiu (hodhi) papastërtitë.*

3. *kryes. sh.* Lëndë e huaj dhe e panevojshme e përzier në një tjetër. *Papastërtitë e ujit (e mineralit). Pastrojnë grurin nga papastërtitë.*

ZEMËRPÁSTËR *mb.* Që nuk ka asgjë të keqe në zemër, që e ka zemrën të paster, zemërdëlirë. *Vajzë zemërpastër.*

SHPIRTPÁSTËR *mb.* Që nuk ka asgjë të keqe në shpirt, që e ka shpirtin të paster, zemërpastër; *kund.* shpirtfëlliqur.

GJAKPÁSTËR *mb.* Që është i një race të mirë e të papërzier me të tjera (per kuajt e qentë). *Kale gjak-pastër.*

Formimet më të shumta janë me prejardhje, sidomos foljet e huazuara nga greqishtja **kanë krijuar vargje dhe grupe paradigmatiche fjalëformuese me ndajshesa të ndryshme.** Vetë ndajshesat, duke qenë mbartëse të disa nuancave kuptimore suplementare, janë gjithashtu mbartëse edhe të dy përbërësve semantikë themelorë të tipit leksiko-gramatikor:

Së pari, **të përbërësit themelor për kuptimin leksikor kategorial**, që përcaktohet nga përkatësia në një pjesë të ligjëratës, bën pjesë në kuptimin leksikor të fjalës së derivuar dhe mbartet kryesisht nga prapashtesa (nëse është emër, mbiemër, folje etj.);

Së dyti, **të përbërësit për kuptimin leksikor të klasës së fjalëve ose të grupit paradigmatic të dhënë**, p.sh. *veprimi* tek emrat e veprimit, *vepruesi* tek emrat e vepruesit etj. Këto kuptime janë më të përgjithshme se kuptimet e fjalëve të veçanta që bëjnë pjesë qoftë në të njëjtën kategori leksiko-gramatikore, qoftë në të njëjtën klasë fjalësh, d.m.th. në të njëjtin grup paradigmatic.

Grupi paradigmatic i formimeve leksikore nga fjala **vidhë** i tregon më së miri këtë proces dhe këto dukuri:

VIDH/Ë,~A *f. sh. ~A, ~AT.* Copë e vogël prej shufre të metaltë, që ka një kokë e një pjesë të zgjatur me vjaska dhe që përdoret për të mbërthyer a për të shtrënguar mirë

diçka; burmë. *Vidhë femër. Vidhë hekuri. Vidha e siguresës. Vidha e rrotës. Koka e vidhës. Mbërthej vidhat. Shtrëngoj (lirroj) vidhën.*

Ia gjeti vidhat (burmat, burgjitë) dikujt ia gjeti pikën ku mund të kapet; ia gjeti anën dikujt për ta bindur për diçka, për ta bërë për vete etj. **Ia di (ia njoh) vidhat (burmat) dikujt shih te BURM/Ë, ~Ai. Ia liroi vidhat (burgjitë) dikujt shih te LIROJ. I janë liruar (i kanë luajtur) vidhat (burmat, burgjitë) dikujt** nuk është në rregull nga mendja; ka shkalluar. **Ka luajtur nga vidhat (nga burgjitë)** nuk është në rregull nga mendja; ka shkalluar. **I shkanë vidhat (burgjitë) dikujt shih te SHKAS. I shtrëngoi vidhat (burgjitë, çivitë) dikujt shih te SHTRËNGOJ. Ka një vidhë (burgji) mangët mospërf.** është i metë nga mendtë, ka një dërrasë mangët.

VIDHÓS kal., ~A, ~UR. Fut a shtrëngoj diku një vidhë; mbërthej a shtrëngoj diçka me vidhë; kund. zhvidhos. *Vidhos dadot. E vidhosi me kaçavidë. Vidhose mirë!*

VIDHÓSET. Pës. e VIDHÓS.

VIDHÓSJ/E,~A f. Veprimi sipas kuptimeve VIDHOSUR (i,e) mb. Që është mbërthyer a shtrënguar me vidhë; që nuk i janë hequr a nuk i janë liruar vidhat; kund. i zhvidhosur

ZHVIDHÓS kal., ~A, ~UR. Zbërthej diçka të mbërthyer me vidhë; lirroj një vidhë. *Zhvidhosi ka-pakun. I zhvidhosi të gjitha vidhat.*

ZHVIDHÓSET. Pës. e ZHVIDHÓS.

ZHVIDHÓSJ/E,~A /. sh. ~E, ~ET. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve ZHVIDHÓS, ZHVIDHÓSET.

ZHVIDHÓSUR (i, e) mb. 1. Që i janë hequr vidhat, që i janë liruar vidhat, që është zhvidhosur; kund. i vidhosur. *Pjesë të zhvidhosura.*

2. *fig. tall.* I luajtur nga mendtë, i çmendur. *Njeri i zhvidhosur.*

* * *

Formimi i fjalëve në shqipe si dhe në greqishte lidhet pazgjydhshëmrisht **me mjetet fjalëformuese** si dhe **me marrëdhëniet semantike** që krijohen ndërmjet **njesisë derivuese dhe njesisë së derivuar**. Në pamje të parë këtu duket sikur kemi një ndarje të fushave studimore, sepse mjetet fjalëformuese (temat fjalëformuese dhe ndajshesat) së shumti janë objekt studimi për gramatikën, kurse leksikologjisë dhe semantikës në fushën e fjalëformimit u intereson njësia e re leksikore që krijohet, kryesisht me përmbajtjen e re që sjell në gjuhë.

Kur merremi me prejardhjen semantike gjatë formimit të fjalëve te reja nga huazimet greke në shqipe (ashtu si në gjithë procesin fjalëformues të shqipes, por edhe të greqishtes) dallojmë dy vija kryesore që përshkojnë sistemin e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe janë të përcaktuara qartë:

a. Vija e parë ndërtohet **nga madhësitë themelore që përbëjnë vargun e hallkave themelore të formimit të fjalëve**, pra edhe të kalimeve nga një njësi në tjetrën. Të tilla madhësi janë **derivuesi - tema - formanti - derivati**.

Kjo vijë jep mundësinë të ndiqet rruga e formimit të njesisë së re leksikore, të zbulohen mënyrat (prodhimtare a joprodhimtare) të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe (që për prejardhjen semantike kanë pak rëndësi), të shihen lidhjet ndërmjet kategorive leksiko-gramatikore etj., pra, të ndërtohet sistemi fjalëformues i gjuhës shqipe.

Llogarí - fjalë e parme (huazim)

Llogaridhënës - fjalë e joparime (fjalë e përbërë llogari + dhënës);

Llogaridhënie - fjalë e joparme (fjalë e përbërë **llogari** + **dhënie**);

Llogarit (llogaris) - **llogaritje** - fjalë e joparme (formim prapashtesor)

Llogarit (llogaris) - **llogaritur (i,e)** - fjalë e joparme (paranyjëzimi pjesores)

llogarit (llogaris) – **llogaritës** - fjalë e joparme (formim prapashtesor)

Llogari - **llogaritár / llogaritáre** - fjalë e joparme (formim prapashtesor)

Llogarít - **llogarítshëm (i)** - fjalë e joparme (formim i përzier)

Krijohen kështu vargje dhe grupe fjalëformuese. Vargu paradigmatic fjalëformues nënkupton një grup njësisht leksikore a njësi leksemore të një fushe tematike që kanë të përbashkët rrënjën si temë fjalëformuese¹⁰⁸. Njësitë që bëjnë pjesë në këtë varg kanë lidhje fjalëformimi drejtpërdrejt a tërthorazi me këtë rrënjë. Ne menduam të bëjmë objekt te punimit për mikrotezë vargjet që motivohen semantikisht a morfematikisht nga foljet. **Foljet në vete, si tema fjalëformuese mund të jenë të parme dhe jo të parme (te formuara me prejardhje, me konversion, me përbërje etj.).**

Shqipja është një gjuhë me zhvillim shumë të shpejtë. Ajo shpesh ndërton vargje fjalëformuese simetrike, sepse ka një leksik relativisht të ri. Kjo duket edhe vargu **folje – emër veprimi – emër vepruesi – mbiemër prejpjesor** që po bëhet shumë i shpeshtë dhjetëvjetëshat e fundit¹⁰⁹. Një nga arsyet e formimit është se është shtuar në skajshmëri bota nocionore e shqiptarëve dhe pa tjetër kërkohet dhe krijimi i njërive emërtuese. Gjithashtu dhe përballja me gjuhët e tjera, si anglishtja, e kërkon këtë si domosdoshmëri për të realizuar këtë përballje në të gjitha nënsistemet, por sidomos në atë leksikor. Dukuria e krijimit të vargjeve paradigmaticke fjalëformuese nuk ndodh vetëm në leksikon e përgjithshëm, por edhe në atë dialektor :

P.sh. në leksikon e përgjithshëm, në huazimin e vjetër nga greqishtja **drapër** :

dráp/ër,-ri m. sh. **-ínj(të)** dhe **-ërínj(të)** 1. vegël dore bujqësore për të korrur, me një presë si hark e të dhëmbëzuar dhe me një dorezë: **drapër lejlek** drapër dorezë të gjatë; **koha e draprit** koha e të korrave; **i vunë draprin grurit** e korrën; **është bërë për drapër** është bërë për t'u korrur; **bie (nis) drapri** fillon korrja e të lashtave; **i drejtë si drapri** i shtrembër, në trajtë harku; **jo i drejtë; / (iron)** që nuk vepron drejt; që të mashtron; **nuk futet drapri në thes (fj. u.)**.

2. **fig.** diçka e harkuar si presa e draprit: **drapri i vetullave; drapri i hënës** hëna kur ka nisur të përtërihet ose kur soset dhe ka trajtën e një vetulle. **★drapri në thes (brenda) e maja jashtë** është njeri i djallëzuar, që kërkon të bëjë një të keqe fshehurazi, por nuk fshihet dot.

drapër/ój kal., **-óva, -úar** korr a pres diçka me drapër. / **pës. drapëróhet** v. III.

drapërim,-i m. veprimi sipas foljes.

drapëruar (i, e) mb. që është korrur me drapër; që është me dredha: **rrugë e drapëruar**.

Kjo linjë mund të njohë pasurim gjatë zhvillimeve në rrjedhat e kohës në gjuhë. Kështu, për foljen **pandeh** në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*, 1980 kemi këtë çerdhe fjalëformuese:

PANDÉH kal., **~A, ~UR**. 1. E quaj për dikë a për diçka, e marr për..., e kujtoj. *E pandehu për të vëllanë. E pandehte për njeri të mirë. Ç'më pandeh ti mua? E pandehën për të vdekur.*

¹⁰⁸ Para lindjes së teorisë së fushave konceptore, leksikore dhe semantike, përdorej termi **çerdhe fjalëformuese**.

¹⁰⁹ V. Memisha, *Rreth vargut fjalëformues folje – emër veprimi – mbiemër prejpjesor në fjalorët shpjegues të shqipes*, në “Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005

2. (*zakon. me mohim*). Nuk e pres diçka prej dikujt, me vjen e papritur. *Nuk e pandehja prej tij. E gjesh nga mos e pandefsh! mallk.*

3. *jokal*. Mendoj, kujtoj; me duket, kam përshtypjen. *Pandeh se kishte të drejtë. Pandeh se do t'i lutem?! Mos pandeh se do të kthehet!*

PANDÉHUR,~I (i) *m. sh.* ~, ~**IT** (të) *drejt*. Ai që nxirret përpara gjyqit për fajë e veprime të kundërligjshme. *Në bankën e të pandehurve. Pyetja e të pandehurit.*

PAPANDÉHUR *ndajf.* Papritur, befas. *Hyri (doli, u ngrit) papandehur. U kthye papandehur. U ndal papandehur. Pyeti papandehur.*

PAPANDÉHURAZI *ndajf.* Papandehur. *Erdhi papandehurazi.*

Kurse në *Fjalorin e gjuhës shqipe*, 2006 kemi si më poshtë:

pandéh kal., -a, -ur 1. e quaj ose e marr për dikë a për diçka tjetër; *jokal*. mendoj, më duket; kujtoj: *e pandehu për të vëllanë; pandehu se kishte të drejtë*. 2. (*zakon. me moh.*) nuk e pres diçka prej dikujt: *nuk e pandehja prej tij.*

pandéhet *pavet.* besohet: *as mund të pandehet një gjë e tillë.*

pandéhj/e, -a f. 1. veprimi sipas foljeve. 2. pandehmë.

pandéhur, -i (i) *m. sh.* **-i(t)** (të) *drejt*. ai që nxirret para gjyqit: *pyetja e të pandehurit.*

pandéhm/ë, -a f. sh. **-a(t)** ajo që pandehim se është: *ka shumë pandehma për këtë ngjarje.*

papandéhur *ndajf.* papritur, befas: *hyri papandehur.*

papandéhurazi *ndajf.* papritur, befas.

Kurse nga leksiku dialektor do të përmendim: *mbodhis – mbodhisem- mbodhisje- mbodhisur; kumbis - kumbisem – kumbisje, i kumbisur; mballos – mballoset – mballosje - i mballosur; farmakos – farmakosem – farmakosje – i farmakosur; gremis – gremisem – gremisje – i gremisur; kopanis – kopanisem – kopanisje – i kopanisur; lajthis – lajthitem – lajthitje – i lajthitur* etj.

b. Vija e dytë ndërtohet nga lidhjet kuptimore që përshkojnë vargun e hallkave **derivuesi - tema - formanti – derivati** dhe që shpjegojnë lëvizjet e kuptimit nga një hallkë në tjetrën. Kjo vijë, që përbën sistemin semantik brenda sistemit fjalëformues, kërkon një ndriçim të veçantë.

Për njësinë leksikore më të lartë hedh dritë njësia leksikore më e ulët dhe formanti, gjithnjë në rrafshin e kuptimit. Prandaj *sistemi i prejardhjes fjalëformuese është shprehja më e dukshme e prejardhjes semantike.*¹¹⁰

LLOGARÍ,~A f. sh. ~, ~**TË**. 1. Veprime të ndryshme ekonomike e financiare, që bëhen për të njohur vlerat, për të ditur të ardhurat e shpenzimet në një degë të ekonomisë, në një ndërmarrje ose në gjithë ekonominë e vendit; dokument që pasqyron gjendjen pas këtyre veprimeve; zyra e nëpunësit që merret me këtë detyrë. *Llogari vjetore (mujore). Libri i llogarisë. Dëftesë llogarie. Zyra e llogarisë. Përmbledhësja e llogarisë. ek., vjet. bilanci. Nxjerr (përfundoj, mbyll) llogarinë. Punon në llogari.*

2. Veprime me numra, që bëhen për të nxjerrë sa kushton diçka ose sa kemi për të marrë a sa kemi për të dhënë, për të gjetur sasinë e diçkaje etj.; llogaritje. *Llogari e*

¹¹⁰ Shih më gjerë për këtë dukuri edhe J. Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 252-266

përpiktë. E bëri llogari e llogariti. Me bëj llogarinë! E bën mirë llogarinë. Si dilte mirë llogaria.

3. *ek.* Mjete financiare, të ruajtura ose të vena në bankë, të cilat përdoren për qëllime të ndryshme. *Llogari aktive (pasive). Llogari shlyese. Llogari rrjedhëse. fin.*

4. Shpjegime që jepen para dikujt për punën e kryer, për veprimet që janë bërë, për përgjegjësinë e një institucioni a të një punonjësi në veprimtarinë që kryen etj. *Llogari e hollësishme. Kërkesa e llogarisë. I kërkoi llogari. I jepte llogari. Mbledhje për të dhënë llogari e për zgjedhje.*

5. *fig. bised.* Veprime me mend, që i bëjmë për të parashikuar si do ta zgjidhim një çështje, kur dhe si do ta kryejmë diçka, si do të sillemi a si do të vep-rojmë në disa rrethana etj. *Kemi bërë llogari të ni-semi në fund të muajit. S'i doli llogaria si e kishte menduar.*

* **Për llogari të dikujt a të diçkaje** në dobi të dikujt a të diçkaje; për hesap të dikujt a të diçkaje. **I ndau (i qëroi) llogaritë (hesapet, lakrat) me dike shih te NDAJ. Rregulloi llogarinë (borxhet) me dike shih te RREGULLOJ. S'e vë në llogari (fare) dike a diçka** nuk e përfill fare, nule e marr parasys, s'e llogarit; s'e vë në hesap. **I bën llogaritë gabim shih te GABIM,~I. I ka bërë llogaritë (hesapet) pa hanxhinë shih te HANXHI,~U.**

LLOGARIDHËNËS,~E *mb. libr.* Që bëhet për të dhënë llogari; që karakterizohet nga dhënia e llogarisë. *Mbledhje llogaridhënëse. Raport llogaridhënës. Frymë llogaridhënëse.*

LLOGARIDHËNI/E,~A *f. sh. ~E, ~ET libr.* Veprimi i atij që jep llogari zakonisht përpara ko-lektivit për punën e kryer e për veprimet që janë bërë, për përgjegjësinë që mban etj, ose për ecurinë e punëve; njoftimet, shpjegimet e sqarimet që jepen me këtë rast. *Llogaridhënie e plotë. Llogaridhënia e kuadrove (e drejtuesve).*

LLOGARIT (LLOGARIS) *kal, ~A, ~UR. 1.* Numëroj a njehsoj diçka, bëj veprime me numra për të nxjerrë sa kushton diçka ose sa kam për të marrë a për të dhënë, për të gjetur sasinë e diçkaje etj.; bëj llogari. *Llogarit me gishta (me numëratore, me shkopinj). E llogariti me laps në dorë. Llogarit me përpikëri (me hollësi). Llogaritën të ardhurat (shpenzimet).*

2. E kam parasys, e përfill; e çmoj, e vlerësoj; e vë në hesap. *Me llogaritni edhe mua! Duhet llogaritur të gjithë pjesëtarët e families. S'e llogarit fare atë. E llogaritim mirë djersën e punëtorit (e fshatarit).*

3. *fig.* Zbërthej e peshoj me mend diçka, mendoj të bëj diçka; bëj veprime me mend për të parashikuar si do ta zgjidh një çështje, kur dhe si do ta kryej diçka, si do të sillem a si do të veproj në disa rrethana etj.; bëj llogari. *E kam llogaritur të kthehem brenda javës. Si llogariti mirë rrethanat. E llogaritën mirë punën.*

LLOGARITÁR,~I *m. sh. ~Ë, ~ËT.* Nëpunës që merret me veprimet financiare, me punët e llogarisë. *Llogaritar i pare.*

LLOGARITÁR/E,~JA *f. sh. ~E, ~ET.* Fem e LLOGARITAR,~I.

LLOGARITET. *Pës. e LLOGARIT.*

LLOGARITËS,~I *m. sh. ~, ~IT.* I. *spec.* Mjet që shërben për të bërë llogaritje. *Llogaritësi i topit. Llogaritësi i rrotullimeve. Përdorin llogaritësin.*

2. *usht.* ushtar i përgatitur, që llogarit me mjete të posaçme të dhënat për drejtimin e zjarrit të artilerisë. *Llogaritësi i pikes së vrojtimit. Llogaritësi i togës së drejtimit të zjarrit.*

3. *vjet.* Llogaritar.

LLOGARITËS,~E *mb.* Që shërben për llogaritje, që bën veprime llogarie. *Makinë (vegël) llogaritëse. Qendër llogaritëse. Vizore (tabelë) llogaritëse.*

LLOGARITJ/E,~A *f. sh. ~E, ~ET*. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve LLOGARIT, LLOGARITET. *Llogaritje aritmetike. Llogaritjet astronomike. Llogaritja e një këndi. Sistemi i llogaritjeve. Bëj llogaritje llogarit.*

LLOGARÍTSH/ËM (i), ~ME (e) *mb.* Që mund të llogaritet.

LLOGARÍTUR (i,e) *mb.* Që është llogaritur; që është menduar e peshuar mirë.
Punë e llogaritur.

* * *

Zakonisht, duke u mbështetur në veçantitë e prejardhjes semantike në gjuhën shqipe, grupin e madh paradigmatic të çerdhes fjalëformuese të një fjale që është huazim nga greqishtja, mund ta ndajmë në dy nëngrupe:

a. Nëngrupi i derivateve leksikore, që përfshin formimet me ndajshitesa e pa ndajshitesa *pa ndryshuar kategoria leksiko-gramatikore*, si:

PLEKS *kal., ~A, ~UR*. 1. Thur; gërshtoj; *kund.* shpleks. *Pleks gërshetin. Pleks gardkin. Pleks një cigare.*

2. *fig. keq.* Thur; ngatërroj. *Pleksin plane djallëzore.*

PLÉKSEM *Vetv.* 1. *vet. veto III.* Lidhet keq diçka me një tjetër sa nuk zgjidhet dot, ngatërrohet; *kund.* shplekset. *U pleksën fjetet.*

2. *vet. veta III fig.* Gërshetohet; ndërthuret. *Lufta per çlirim u pleks me luftën për drejtësi shoqërore.*

3. Lidhem ngushtë e shoqërohem me dike dhe nuk mund të shkëputem me prej tij; hyj në një çështje që nuk me takon a në një punë jo të mirë; ngatërrohem. *U pleks me një rrugaç. Mos u pleks me të!*

4. *Pës. e* PLEKS.

Kurse nëngrupi i dytë është ai i derivateve leksiko-gramatikore, që përfshin formimet me ndajshitesa a pa ndajshitesa dhe *me ndryshim të kategorisë leksiko-gramatikore*:

Kështu nga folja **pleks** formohet emri i veprimit (me prapashtesën *-je*) **PLÉKSJ/E,~A** *f. sh. ~E, ~ET*. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve PLEKS, PLEKSEM. *Pleksje rrethanash (kushtesh).*

Gjithashtu nga folja **pleks** formohet mbiemri prejpjesor **PLÉKSUR (i,e)** *mb.* Që është i lidhur me diçka tjetër sa nuk zgjidhet dot, i ngatërruar; i thurur; *Ë. i shpleksur. *Fije e pleksur. Me gërsheta të pleksura*

* * *

Ndodh ndonjëherë që një fjalë huazim që ekziston në ligjërimet e folura, nuk është pasqyruar në fjalorët shpjegues të shqipes, edhe pse ai ka formuar një fjalë, madje edhe polisemike, që gjendet në këta fjalor. Kështu nga greqishtja ka hyrë në shqipe, fjala **dhjak**, por edhe sinonimi **dhjakon**. Ky i fundit, që nuk është në fjalor, me prapashtesën *-ar* ka formuar fjalën **dhjakonar**.

DHJAK,~U *m. sh. ~Ë, ~ËT*. Titull fetar në kishën ortodokse, grada me e ulët fetare në këtë kishë; ai që mbante këtë grade a këtë titull, ndihmës i priftit në kryerjen e shërbesave fetare (në vendet ku vepron feja ortodokse; në të kaluarën edhe në Shqipëri).

DHJAKONÁR,~I *m. sh.* ~Ë, ~ËT *përb.* 1. Njeri që kërkon ta kalojë jetën pa punuar duke mbledhur lëmosha nga të tjerët, ai që jeton në kurriz të të tjerëve pa punuar.

2. Njeri dinak, i pabesë e shpirtkeq.

3. *Përd. mb.* sipas kuptimeve të emrit.

* * *

Kemi huazime që kanë mbetur në leksikon pasiv apo në leksikon dialektor të shqipes, kurse formimet e reja leksikore dhe zhvillimet semantike që kanë ndodhur në këto formime, kanë hyrë në leksikon normativ. P.sh. **llahtar** / **llahtarë** në shqipëri që i përgjigjet emrit **λαχτάρα (η)** në greqishte, i përket shtresës së fjalëve që bëjnë pjesë në leksikon bisedor, kurse **llahtari** është trajta e pranuar si standard.

λαχτάρα (η) {χωρ. γεν. πληθ.}

1. έντονη επιθυμία: είχα ~ να ζανανταμώσει τους δικούς του || είχα ~ να γευτεί τους τοπικούς μεζέδες ΣΥΝ. πόθος

2. (συνεκδ.) πρόσωπο ή πράγμα που αποτελεί αντικείμενο έντονης επιθυμίας: είναι η ~ μου

3. η συναισθηματικά φορτισμένη αναμονή (για κάτι): περίμενε με - να βγουν τα αποτελέσματα των εξετάσεων || κοίταζε με ~ τη φωτογραφία τού ξενιτεμένου γιου της ΣΥΝ. ανυπομονησία, αδημονία ANT. καρτερικότητα •

4. ο μεγάλος φόβος, η ταραχή από ένα συνήθ. ξαφνικό και δυσάρεστο γεγονός: περάσαμε μεγάλη ~, μέχρι να βγει από το νοσοκομείο || μόλις το ακούσαμε, πήραμε μια ~, που μας κόπηκαν τα ήπατα! || περάσαμε πολλές ~ μ ' αυτό το παιδί. [ETYM. μεσν. < λαχταρίζω (υποχωρητ.), βλ. Λ λαχταρώ].

λαχταρίζω ρ. μετβ. κ. αμετβ. [μεσν.] {λαχτάρισ-α, -μένος} λαχταρώ (βλ.λ.). — λαχτάρισμα (το).

λαχταριστός, -ή, -ό [μεσν.] αυτός που είναι αντικείμενο ζοηρής επιθυμίας ή έλξης: ~ φαγητό | παγωτό | κοπέλα ΣΥΝ. επιθυμητός, ποθητός, ελκυστικός. - λαχταριστά επίρρ.

λαχταρώ (κ. -άω) ρ. μετβ. κ. αμετβ. {λαχταράς... | λαχτάρησα} . (μετβ.)

1. επιθυμώ έντονα: ~ να σε δω ευτυχισμένο || λαχτάρησα μια μακαρονάδα | ένα πικάντικο φαγητό ΣΥΝ. ποθώ • 2. προκαλώ (σε κάποιον) μεγάλο φόβο (συνήθ. ξαφνικό): με λαχταράει κάθε φορά που οδηγεί, γιατί κάνει επικίνδυνες προσπεράσεις || με λαχτάρησε όταν μου είπε πως θα έμπαινε στο νοσοκομείο, αλλά ευτυχώς δεν ήταν κάτι σοβαρό ΣΥΝ. λαχταρίζω, τρομάζω ♦ (αμετβ.)

3. αισθάνομαι μεγάλο φόβο, τρομάζω: πώς λαχτάρησα, όταν έμαθα ότι τράκαρες! ΣΥΝ. παίρνω (μια) λαχτάρα | τρομάρα •

4. (σπάν.-για ψάρια) σπαρταρώ, τινάζομαι με σπασμούς: μόλις είχαν βγάλει τα ψάρια απ'το νερό και λαχταρούσαν στον πάτο τής ψαρόβαρκας.

LLAHTÁR,~I *m.* dhe **LLAHTÁR/Ë,~A** *f. bised.* Llahtari. / shtiu (i futi) llahtarin.

LLAHTARI, ~A *f. bised.* Frikë e madhe, tmerr; ankth i madh. *Llahtari e madhe. Mori llahtari u tremb shumë, u tmerrua. / zuri llahtaria. Shikonte me llahtari. Thirri me llahtari.*

LLAHTARÍS *kal., ~A, ~UR bised.* 1. E frikësoj shumë dike, e tmerroj. / *llahtarisi fëmijët.* 2. *jokal.* Llahtarisem.

LLAHTARISEM *vetv. bised.* Frikësohem shumë, tmerrohem. *U llahtarisën nga tërmeti.*

LLAHTARISUR (i,e) *mb. bised.* I frikësuar shumë, i tmerruar; që shpreh frikë të madhe ose tmerr; që është plot ankth. *Me fytyrë të llahtarisur. Zë i llahtarisur. Ikën të llahtarisura.*

LLAHTÁRSH/ËM (i), ~ME (e) *mb. bised.* Që të shtie frikën, që të kail tmerrin, i tmerrshëm. *Ulërimë e llahtarshme. Pamje (zhurmë) e llahtarshme. Tortura të llahtarshme.*

LLAHTÁRTË (i,e) *mb. bised.* I llahtarshëm.

* * *

Edhe termat nga greqishtja (të marrë drejtpërdrejt prej saj apo jo) mund të shërbejnë si tema fjalëformuese dhe krijojnë çerdhe apo vargje fjalëformuese. Këto fjalë të krijuara nga këto terma nuk quhen më huazime, por fjalë të shqipes. P.sh., *diplomë – diplomoj – diplomohet – diplomim - (i, e) diplomuar, diplomant; daktilografi – daktilografoj – daktilografim - (i, e) daktilografuar.*

Po kështu po përmendim: *oqean, oqeaniku, oqeanik, oqeanograf, oqeanografi, oqeanografik, oqeanolog, oqeanologji, oqeanor* etj.

* * *

Interesante është dukuria kur një fjalë greke mund të ketë hyrë nga latinishtja në shqipe (madje edhe burimi mund të jetë i diskutueshëm), që ka pësuar zhvillime të mëdha kuptimore fjalëformuese e semantike. Kështu kemi në shqip fjalën **murg** e cila ka hyrë nga latinishtja **mōnāchus** dhe jo nga greqishtja **μοναχός** (me strukturën e mëposhtme kuptimore), sepse fjala greke ka theks fundor dhe nuk do të jepte fjalën **murg** në shqipe.

μοναχός, -ή, -ό 1. (για πρόσ.) αυτός που δεν είναι μαζί με άλλους (συχνά + κτητική αντων.): *ταξιδεύει πάντα ~ || ζει ~ της || θα το φτει-άξω ~ μου, όταν φύγετε όλον ΦΡ. (παροιμ.)*

Në gjuhën shqipe kjo fjalë paraqitet me këtë strukturë kuptimore dhe me këtë grup fjalësh që lidhen drejtpërdrejt me të si fjalëformim.

MUR/G, ~GU *m. sh. ~GJ, ~GJIT.* 1. *fet.* Anëtar i një urdhri fetar, që rri në një manastir e bën një jetë prej asketi (në vendet ku vepron feja). *Murg katolik (budist). Urdhër murgjish. Jetonte si murg.*

2. *fig. keq.* Njeri i vetmuar, që bën një jetë të mbyllur; njeri i shkëputur nga jeta e gjallë.

3. *përd. mb. fig. (zakon. përpara emrit) bised.* I mjerë, i shkretë, i zi. *Murgu babal Murgu plak! Murgu ai! Epësoi murgu djalë!*

* **Murgu i natës** *mit.* plak shpirtkeq që besohej se jetonte duke bredhur natën për të dënuar njerëzit, për të bërë dëme etj. (sipas besëtytnive).

Kjo fjalë është dhe në greqishte, por nuk e ka fare kuptimin e parë të fjalës së shqipes, por e lidh me një qen të murrmë. Madje J. Babinjoti te fjalori i vet *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας, με σχόλια για τη σωστή χρήση των λέξεων ερμηνευτικό, ετυμολογικό, ορθογραφικό, συνωνυμών – αντιθέτων, κύριων ονομάτων, επιστημονικών ορών, ακρωνυμίων*; με αξιοποίηση τού γλωσσικού αρχείου¹¹¹ e lidh burimin fjalës me një emër të përvecëm ishulli, kur kuptohet që vetë emri i ishullit ka qenë fillimisht emër i përgjithshëm:

μούργος (ο) (οικ.) 1. ο μεγαλόσωμος ποιμενικός σκύλος, κυρ. σκούρου χρώματος ΣΥΝ. Μαντρόσκυλο.

2. (για πρόσ., συνήθ. σε προσφωνήσεις) αυτός που δεν διαθέτει αγωγή και ανατροφή, που φέρεται άξεστα ΣΥΝ. αγροίκος

3. (γενικότ. ως μειωτ. προσφώνηση ή χαρακτηρισμός): *ρε μούργο!*

[ETYM < μεσν. μούργος < μούργα (βλ.λ.). Κατ' άλλη άποψη, < *μοργός < αρχ. άμολγός “σκοτεινός” (αβεβ. σημ.) < άμέλγω “αρμέγω” (ο Ησύχιος ερμηνεύει τη σημασιολ. μεταβολή ως εξής: άμολγφ- τω μεσονυκτίω, ήτοι εν εκείνη τη ώρα εν η άμέλγουσιν). Σύμφωνα με τρίτη, τέλος, εκδοχή, πρόκειται για αντιδάνειο, < ρουμ. murg < λατ. amurca < αρρτ-. άμόργη (βλ. λ. μούργα)].

Αμοργός (η) 1. νησί των Α. Κυκλάδων ΝΑ. τής Νάξου.

2. η πρωτεύουσα τού ομώνυμου νησιού' αλλιώς *Χώρα*. — Αμοργιανός (ο), Αμοργιανή (η), αμοργιανός, -ή, -ό.

[ETYM. Το όνομα τού νησιού 'Αμοργός (αρχ.) συνδέεται μετωνυμικά με το ύφασμα άμοργός (ό) και άμοργίς (ή), που κατασκεύαζαν στο ομώνυμο νησί (βλ. κ. ζέρσει). Η Αμοργός ήταν περιώνυμη για τους χιτώνες της, που ονομάζονταν άμόργεια, άμόργινα ή άμοργίδες και παρασκευάζονταν από την άμόργη (< άμέργω “δρέπω, κόβω καρπούς, φυτά κ.τ.ό.”), είδος λιναριού εξαιρετικής ποιότητας, το οποίο φύτρωνε σε όλο το νησί. Το αρχ. άμέργω συνδέεται πιθ. με το αρχ. όμόργνυμι “στεγνώνω, σκουπίζω” και με λατ. mergae “θεριστικό δίκρανο”].

MURGÁR,~I *m. sh.* ~Ë, ~ËT. Murg.

MURGASH,~E *mb.* 1. Që është në ngjyrë hiri të errët, i murrmë; i zeshkët. *Pelë murgashe. Me qime murgashe. Me fytyrë murgashe. Vjen si mur gash.*

2. *Përd. em.* sipas kuptimit të mbiemrit (per emër-time kafshësh). *Po leh murgashi.*

MURGATÓR,~E *mb. bised.* 1. I shkretë, i ngratë, qyqar.

2. *Përd. em.* sipas kuptimit të mbiemrit. *Mbeti pa njeri, murgatori! I vdiq burri, murgatores!*

MURGÉSH/Ë,~A *f. sh.* ~A, ~AT. *Fem. e* MURG,~U. *Murgeshë e re (plakë). Kuvend (shkollë) murgeshash. E zbehtë si murgeshë.*

* Ka zemër murgeshë ka mëshirë e keqardhje kris-tiane për këdo pa përjashtim, nuk e ndan të mirin nga i ligu.

¹¹¹ Γ. Μπαμπινιώτη; *λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας, με σχόλια για τη σωστή χρήση των λέξεων ερμηνευτικό, ετυμολογικό, ορθογραφικό, συνωνυμών – αντιθέτων, κύριων ονομάτων, επιστημονικών ορών, ακρωνυμίων*; με αξιοποίηση τού γλωσσικού αρχείου; Αθηνών, 2002

MURGËSH/Ë, ~A_{II} *f. sh.* ~A, ~AT *zool* 1. Flutur e madhe me shirita të zinj e njolla të zeza në krahë dhe në bark, vemja e së cilës njihet si dëmtues i drurëve e sidomos i pishave.

2. Kandërr fluturuese që e ndryshon ngjyrën sipas mjedisit, me trup shumë të gjatë, me kokën trekëndëshe e shumë të lëvizshme, me sy të dale, me dy pale krahë të hollë, me të cilët, duke i fërkuar bën një zhurmë.

MÚRG/Ë, ~A *f. sh.* ~A, ~AT. 1. *fet.* Murgeshë. *U bë murgë.*

2. *bised.* Vajzë a grua që ka mbetur e shkretë, e vetme, pa njeri; vajzë a grua e mjerë, që bën një jetë të rëndë. *Murga e shkretë (e mjerë). 'Ç'e gjeti, murgën! Hoqi të zitë e ullirit, murga!*

* Rrinte si murga në linjë rrinte pa folur asnjë fjalë, rrinte e heshtur dhe e shushatur.

MURGËRÍ, ~A *f.* Të qenët murg; koha kur di-kush jeton si murg a si murgeshë në një manastir; jetesë prej murgu. *Në kohën e murgërisë.*

MÚRGËT (i, e) *mb.* 1. Që ka ngjyrë të errët, i murrmë. *Mëshqerra të murgëta. Arushë e murgët.*

2. I errët; i vrenjtur. *Nate (kohë) e murgët.*

3. *fig.* I vrenjtur, i ngrysur në fytyrë (per njerëzit). *Ishte i heshtur e i murgët.*

MÚRGËZ, ~A *f. sh.* ~A, ~AT. Zog dimëror i ngjashëm me trumcakun.

MURGJËRI, ~A *f. përmb.* Tërësia e murgjve, murgjit. *U ntblodh murgjëria.*

Nga greqishtja ka hyrë në shqipe fjala **murgë**, duke mbartur gati të gjithë strukturën kuptimore.

MÚRG/Ë, ~A *f.* Llumi i vajit që bie në fund të enës, fundërri vaji; lëngu i errët që del kur shtypin ullinjtë. / *heqin murgën (vajit). Murgën e përdorin për sapun.*

μούργα (η) (χωρ. πληθ.) (λαϊκ.) το κατακάθι τού λαδιού ή τού κρασιού, που μένει στον πυθμένα τού δοχείου ΣΥΝ. (λόγ.) ίζημα. [ETYM. Αντιδάν., μεσν. < λατ. amurca < αρχ. άμόργη “κατακάθι λαδιού” < άμέργω “κόβω, τρυγώ”. Βλ. κ. Αμοργός].

2. ZHVILLIME LEKSIKORE TEK HUAZIMET SHQIPE NË GREQISHTE

Edhe pse punimi ynë ka në qendër të trajtimit *interferencat leksiko-semantike të greqishtes në shqipe*, ne jemi ndalur në një numër të vogël fjalësh shqipe në greqishte dhe në strukturat e tyre kuptimore. Ne kemi pohuar disa herë se ndryshe nga *studimet për huazimet greke në shqipe*, që janë të shumta dhe shteruese, *studimet për huazimet shqipe në greqishte janë në një numër të vogël*. Albanologë shqiptarë dhe të huaj janë shprehur për këtë proces dhe *për karakterin dhënës të shqipes*, ndërkohë që gjuhëtarët grekë e pranojnë me rezerva karakterin *marrës të greqishtes nga gjuha shqipe*. Kjo shpjegohet edhe nga arsye jashtëgjuhësore, duke mos besuar në karakterin dhënës të shqipes si një gjuhë me dokumentim të vonë dhe një gjuhë e papërpunuar sa e si duhet.

Ne kemi folur në një syth të veçantë për huazimet shqipe në greqisht, që pranohen në një numër të vogël. Por studiuesi Dhori Qiriazhi, që është marrë për një kohë të gjatë me huazimet shqipe në greqishte, thekson se në të folmet e greqishtes ka ende lëndë të pazbuluar të shqipes, kryesisht të sferës materiale, gjë që do të tregohet më poshtë në mënyrë bindëse... *Me shoshitjen më të mirë të lëndës dialektore të greqishtes së re është e sigurt se do të rritet edhe numri i fjalëve me etimon shqip*. Gjatë viteve të fundit janë botuar në Greqi me dhjetëra fjalorë të folmesh lokale, vlera e të cilëve përmbledhet në shprehjen ‘nga ferra e vogël del lepuri i madh’. Por edhe fjalorët dialektorë më të hershëm, është e nevojshme, të kalohen në sitën e gjuhëtarit, pa lënë mënjanë tekste të ndryshme dialektore prej nga mund të vilet material i çmuar. Si të jetë grumbulluar gjithë këtë material, lind nevoja e rishqyrtimit dhe fthillimit të etimologjive që nuk të bindin apo që kanë mbetur deri më sot të errëta. Kështu, fjalët *βάργα* dhe *βάρκα* ‘varg fiqsh të thatë’ që hasen në zonën e Korinthisë (Peloponez) e që në Fjalorin Historik të Greqishtes së Re konsiderohen me etimologji të panjohur (3 : 425), lidhen sigurisht me fjalën *varg* të shqipes. Po ashtu, fjala *βάρτζα* (*βάρτζα*) lidhet direkt me shqipen *vajza* dhe nuk u formua nga gr. *βάρια* + *prap. zvog. -iza* të shqipes (FHGR 3 : 424).¹¹²

¹¹² Dh. Qiriazhi mendon se “ka ardhur koha të hidhen hapa për ndërmarrjen e një punimi të ri sintetizues, i cili, në njërin anë, të pasqyrojë lëndën e re dhe, në anën tjetër, të marrë parasysh edhe interpretimet e reja, që, sipas rastit, u shtojnë apo u heqin diçka listave të propozuara nga Meyer-i dhe Oikonomou (d.m.th., për fjalët shqipe në greqishte, shënimi është yni, S.P). Krahasuar me kohën kur Meyer-i hartonte Fjalorin etimologjik të shqipes, e më pas monografinë kushtuar huazimeve sllave, shqipe dhe rumune të greqishtes së re, sot ndodhemi në një pozicion mjaft më të favorshëm si për nga lënda e nxjerrë sërish në dritë, ashtu edhe për nga përfaqset e reja etimologjike, shpeshherë të suksesshme. Megjithatë, nuk kemi në duar ende atlasin dialektologjik të greqishtes, kurse fjalori historik i greqishtes së re dhe i dialekteve të saj, vepër e nisur qysh në vitet 20-të të shekullit të kaluar, po ecën me ritme shumë të ngadalta. Nga ana tjetër, njohja më e mirë e dialekteve jugore të shqipes, me të cilat kontaktojnë direkt dialektet veriore e veriperëndimore të greqishtes së re, njohja më e plotë gjithashtu e shqipes mesjetare, të shekujve kur arbërit zbresin në viset e Greqisë së sotme, janë disa nga premisat bazë për rrokjen e plotë të kësaj teme. Në harkun kohor që ka ndërmjetësuar është zgjeruar dhe është pasuruar ndjeshëm kuadri teorik i trajtimit të këtyre çështjeve; teoria e gjuhëve në kontakt, gjuhësia ballkanike, gjeografia gjuhësore etj. na kanë ndihmuar ta shohim punën e huazimeve “në një pamje më të gjerë, në dritën e marrëdhënieve të shoqishoqme të gjuhëve, të dukurisë së gjuhëve në kontakt” duke u larguar nga “ideja e qelizës gjuhësore” dhe duke i mëshuar “asaj të ndërvartësisë së gjuhëve”. E rëndësishme është të theksohet se këto arritje teorike kanë çuar në përpunimin

Megjithatë është interesante ndjekja e zhvillimeve semantike dhe leksikore (dukuria e polisemisë dhe e formimit të fjalëve të reja) te fjalët që kanë hyrë nga shqipja në greqishte.

Po ndalemi te fjala **κοπέλα (η) / kopile**, e cila është shqipe, edhe pse në fjalorët e greqishtes e trajtojnë si të huazuar nga latinishtja dhe jo nga shqipja.

κοπέλα (η) {χωρ. γεν. πληθ.}

1. veaρή (συνήθ. άγαμη) γυναίκα: όμορφη | άσχημη | ντροπαλή | απλοϊκή | καλοφτιαγμένη ~ || ~ τής πα-ντρειάς (σεηλικία γάμου) || ~ για σπίτι (κατάλληλη για να την παντρευτεί κάποιος και να κάνει οικογένεια μαζί της) ΣΥΝ. κόρη, κορίτσι, νέα.

2. (γενικόν.) κάθε γυναίκα (ανεξάρτητα από ηλικία): μια χαρά ~ είσαν τι σε νοιάζει η ηλικία;

3. (ειδικόν.) η γυναίκα με την οποία διατηρεί κάποιος αισθηματικό, ερωτικό δεσμό: μάλωσαν, γιατί του πείραξε την ~ ΣΥΝ. ερωμένη, (λαϊκ.) γκόμενα. Επίσης (μόνο για veaρές) κοπελιά [μεσν.]: (συχνό σε προσφωνήσεις): Κοπελιά! Να σε ρωτήσω κάτι; (μεγεθ.) κοπελάρα (η), (υποκ.) κοπελίτσα [μεσν.] κ. (σπανιόν.) κοπελούδα (η) [μεσν.].

[ETYM. μεσν., αρχική σημ. “υπηρέτρια, ψυχοκόρη”, < κόπελος- βλ. λ. κοπέλι].

κοπέλι (το) {κοπελιού | -ιών} (διαλεκτ.) 1. το αρσενικό παιδί ΣΥΝ. αγόρι, τέκνο ANT. κορίτσι, κοπελιά 2. (συχνόν.) ο veaρός στην ηλικία (και συνήθ. άγαμος) άνδρας ΣΥΝ. νέος, veaρός, παιδί, αγόρι ANT. γέρος- ΦΡ. (παροιμ.) λέγε-λέγε το κοπέλι, κάνει τη γριά (την κυρά) να ι και θέλει με την επιμονή μπορούν να πραγματοποιηθούν και τα πιο δύσκολα ή απίθανα πράγματα.

[ETYM < μεσν. κοπέλιον/ κόπελος “παιδί (σε ταβέρνα), υπηρέτης, ψυχογιός” < ιταλ. corpella “μικρή κούπα - υπηρέτρια, ερωμένη” < λατ. copo “κάπελας”· πβ. αλβ. copile, βουλγ. kopelak, ρουμ. copil].

Në shqipe, edhe pse kjo fjalë i takon përgjithësisht leksikut pasiv, ka një paradigmë më të gjerë¹¹³:

KOPÍL, ~I m. sh. ~Ë, ~ËT. 1. vjet. Fëmijë mashkull i lindur jashtë martese. *Bëri (lindi) kopil*.

2. vjet. Shërbyes për punë të rënda, të shtëpisë në familjet e të pasurve, shërbëtor. *Punonte si kopil*.

3. thjeshtligj. Njeri i zgjuar e dinak, njeri finok, shejtan. *Kopil i madh. S'ia hodhi dot atij kopilit. Çfarë kopili!*

4. Filiz i ri që nxjerr bima në rrënjë, në trung a në degë, i cili nuk prodhon dhe e pengon zhvillimin e bimës. *Kopilë ntisri (duhani). Pres (krasit) kopilët e rrushit*.

* **Çelës kopil** çelës që mund të hapë shumë dyer. **Ia la kopilin (doçin, dobiçin) në derë (në prehër) thjeshtligj.** ia veshi, ia ngarkoi fajin a gabimin dikujt tjetër, e bëri turpin vetë e ia la një tjetri. **Ta vë (ta hedh) kopilin (dobiçin) në prehër thjeshtligj.** është i tillë që fajin e vet ia hedh tjetrit.

KOPÍL, ~E mb. 1. vjet. Që ka lindur jashtë martese {per fëmijët}. *Fëmijë (djalë) kopil. Vajzë kopile*.

2. bised. 1 zgjuar e dinak, finok, shejtan. *Djalë kopil*.

e një metodologjie më të rreptë shkencore, zbatimi i së cilës solli rivlerësimin e një sërë fjalësh deri atëherë të konsideruara si huazime shqipe në greqishten e re.” Shih më gjerë punimin e daktologruar (të pabotuar ende) të Dh. Qiriazit, që gjendet në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike, Tiranë.

¹¹³ Shembujt janë marrë nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980

3. Që ka dale në rrënjët, në trung a në degë të një bime, nuk prodhon dhe pengon zhvillimin e bimës. *Filiz kopil. Degë kopile.*

KOPÍL/E,~JA f. sh. ~E, ~ET. 1. *Fem. e KOPIL, ~I₁₋₃. Punonte si kopile.*

2. *tek.* Kunj a pajisje e metaltë, që shërben për të shtrënguar një rrotë ose diçka tjetër të lëvizshme në një mekanizëm.

KOPILI,~Af. bised. Dinakëri, djallëzi; dredhi. *E bëri me kopili. I doli kopilia.*

KOPIL/ÓJ jokal., ~ÓVA, ~ÚAR. 1. bised. Dredhoj, bëj hile; shpëtoj me dinakëri. *Kopiloi bukur.*

2. *vjet.* Punoja si shërbyes për punë të rëndë në një familje të pasur, punoja si shërbëtor. *Kopilonte tek tregtarët.*

Po kështu edhe për fjalën **λέρα (η) / Ierë:**

λέρα (η) {λερών} (καθημ.) 1. η βρομιά, η ακαθαρσία: *κάποιοι αλητοτουρίστες φορούσαν παντελόνια γεμάτα* ~ ΣΥΝ. ρύπος ANT. καθαριότητα, πάστρα

2. (συνεκδ.) η βρόμικη κηλίδα, ο λεκές

3. (μτφ.-κακόσ.) πρόσωπο με κακή διαγωγή, πονηρός, απατεώνας: *μπλέχτηκε με μια ~ από τον Πειραιά* || *Πρόσεχε τον αυτόν! Είναι* ~ ΣΥΝ. παλιάνθρωπος, κακοήθης, χυδαίος. [ETYM μεσν. < λερώνω (υποχωρητ.)].

Λερναία Ύδρα (η) 1. ΜΥΘΟΛ. νερόφιδο με εννιά κεφάλια, που ζούσε στη λίμνη Λέρνη και το οποίο σκότωσε ο Ηρακλής, πραγματοποιώντας τον δεύτερο άθλο του 2. (μετωνυμ.) για να δηλωθεί ότι ένα κακό έχει πάρει τόσο μεγάλες διαστάσεις, ώστε όσα πλήγματα και αντου καταφέρει κανείς, αυτό επανεμφανίζεται ισχυρό: *η διαφθορά αποτελεί τη ~ τού =ημοσίου · είναι ένα πολυκέφαλο τέρας που δύσκολα καταπολεμείται.*

[ETYM. < αρχ. λερναίος < Λέρνα, αρχ. οικισμός τής NE. Αργολίδας, αγν. ετύμου. Η λ. ύδρα (αρχ.) είχε τη σημ. “νερόφιδο” και προέρχεται από το αρχ. ύδωρ].

λερός, -ή, -ό αυτός που είναι λερωμένος: ~ *πουκάμισο* | *σεντόνια* ΣΥΝ. ακάθαρτος, ρυπαρός, κηλιδωμένος ΣΥΝ. καθαρός, αρρύπαντος, παστρικός. [ETYM. < μτγν. *όλερός* “ακάθαρτος, νοθευμένος” (με αποβολή τού άτονου αρχικού φωνήεντος) < αρχ. *όλος* “μελάني τής σουπιάς”, από συμφυρμό των λ. *θολός* και *ορός* “υπόλειμμα γάλακτος”. Κατ' άλλη άποψη, προέρχεται από *salos (I.E. *sal-), πβ. λατ. saliva “σάλιο”, αρχ. γερμ. salo κ.ά.].

λερώνω ρ. μετβ. κ. αμετβ. (λέρω-σα, -θηκα, -μένος) ♦ (μετβ.)

1. *κάνω* (κάποιον/κάτι) ακάθαρτο, βρόμικο: *λέρωσε τη μπλούζα του με σάλτσα* || ~ *το πάτωμα* | *τους τοίχους* | *τα χέρια μου* | *τα ρούχα μου* ΣΥΝ. βρομίζω, ρυπαίνω, λεκιάζω ANT. Καθαρίζω. ΦΡ. *λερώνω τα χέρια μου* διαπράττω (κάτι) κακό, παράνομο, ανήθικο κ.λπ.: *δεν θα λερώσω εγώ τα χέρια μου κάνοντας παρανομίες* || *λέρωσε τα χέρια του με το αίμα τού αδελφού του* (βλ. λ. αίμα)

2. (μτφ.) σπιλώνω την τιμή, την υπόληψη (κάποιου), τον προσβάλλω ηθικά: *με το βαρύ παράπτωμα του λέρωσε το όνομα τής οικογένειας του* || *μακριά απ'αυτό το πρόσωπόπου αγγίζει, λερώνει!* ΣΥΝ. ντροπιάζω, στιγματίζω ♦

3. (αμετβ.) λερώνομαι, βρομίζω: *τα ανοιχτόχρωμα ρούχα λερώνουν εύκολα*

4. *λερώνει!* σε επιγραφές, για να προειδοποιείται το κοινό να μην αγγίζει μια βρόμικη ή φρεσκοβαμμένη επιφάνεια 5. (μεσοπαθ. *λερώνομαι*) (για μωρό ή ηλικιωμένο) *κάνω επάνω μου την ανάγκη μου, τα κάνω πάνω μου.* - **λέρωμα** (το). [ETYM. μεσν. < λερός (βλ.λ.)].

LERÁSH,~E mb. 1. Që është i fëlliqur me lerë, i palarë, i ndyrë.

2. *fig.* Që thotë fjalë të ndyra, gojëndyrë; që ka qëndrim të keq moral. *Djalë lerash. Grua lerash.*

3. *Përd. em.* sipas kuptimeve të mbiemrit (për njerëzit).

LÉR/Ë,~A f. 1. Baltë e hollë, llucë; vend a grope e gjerë me baltë të hollë e me ujë të ndenjtur; tokë e squllët që të thith brenda, moçalishtë. *Grope me lerë. U be lerë. Ngeci në lerë. I futi buajt në lerë.*

2. Zhul në trup a në rroba, që bëhet nga të palarët për një kohë të gjatë; llum, zdralë. *Lera e kokës (e flokëve, e trupit). Lera e rrobave (e jakës). Ka zënë lerë.*

3. Llum vaji; papastërti të ndryshme që zë një send. *Lera e pushkës. Pastroi lerën e tytës.*

4. edhe *sh.* ~A, ~AT. Pellg me ujë në kullotat malore, që bëhet gjatë verës kur shkrin bora; gropë e madhe që mbushet me ujë për të pirë bagëtitë në kohën e thatësirës. *Lerat e kullotave. I çoi bagëtitë në lerë.*

5. *fig.* Diçka e turpshme dhe e fëlliqur; njollë turpi; turp. *I vuri lerë dikujt e njolloosi, e turpëroi. Ia la lerën në derë. E bëri lerë dike e turpëroi, i vuri njollë.*

6. *fig.* Fjalë të ndyra e të turpshme. *Nxori lerë nga goja.*

7. *përd. ndajf.* Tërë, krejt (kur dikush a diçka fëlliqet shumë). *V be lerë me gjak.*

* **E bëri barkun lerë** piu shumë ujë, piu sa u fry.

LERÓS kal., ~A, ~UR. 1. E bëj me baltë dike a diçka, e ndot me lerë, e përbalt, e ndyj a e fëlliq me diçka, e zhyej. *I lerosi këpucët (pantallonat). I lerosi duart (këmbët). Po leroste buajt. E lerosi me domate.*

2. E bëj të zërë lerë, e bëj të palarë, e bëj me zhul, e fëlliq. *E lerosi këmishën (jakën). Lerosi jastëkun (çarçafët).*

3. *fig. bised.* E prish keq një punë, e fëlliq fare, e nxiros, e katranos. *E lerosi punën.*

4. *fig.* I vë njollë të keqe dikujt, e njolloso keqas, e fëlliq, e turpëroj. *Ia lerosi emrin.*

LERÓSEM vetv. 1. Bëhem me baltë, ndotem me lerë, përbaltem; ndyhem a fëlliqem me diçka, zhyhem. *U lerosën derrat (buallicat) në llucë. U leros me baltë. U leros me gjellë (me domate, me vaj). Leroset si fëmijët.*

2. Zë lerë, bëhem me zhul, fëlliqem (nga të palarët etj.). *U leros jaka. U lerosën çorapet. I është lerosur koka.*

3. *fig.* Bëhem me një njollë të keqe, njollosem keqas, fëlliqem, turpërohem. *U leros keq.*

4. *vet. veta HI.* Rrëshqet, shembet, fundoset (për tokën). *V leros toka.*

5. *Pës. e LEROS.*

LERÓSUR (i,e) mb. 1. I fëlliqur me baltë, i ndotur me lerë, i përbaltur; i ndyrë me diçka, i zhyer. *Me duar (me këmbë, me këpucë) të lerosura. Me fytyrë të lerosur.*

2. Që ka zënë]erë; që është bërë me zhul, i fëlliqur nga të palarët. *Me këmishë (me jakë) të lerosur. Çarçafë të lerosur.*

3. *fig. bised.* Që është prishur keq, i fëlliqur fare, i katranosur (per një punë). *Punë e lerosur.*

4. *fig.* I njolloso keqas, i fëlliqur, i turpëruar. *Njeri i lerosur.*

5. Që ka rrëshqitur poshtë, i shembur, i fundosur. *Vend i lerosur.*

Duhet të theksojmë se ne të gjithë lëndën që kemi interpretuar dhe që do të interpretojmë në vazhdim e kemi marrë nga fjalorët shpjegues apo dygjuhësh, të botuar

në Shqipëri a në Greqi (apo jashtë tyre). Kjo do të thotë se jo të gjitha lëvizjet semantike, apo formimet e fjalëve nga huazimet përkatëse dhe që gjallojnë në gjuhën e folur greke a në atë shqipe gjenden të pasqyruara në këto vepra. Ato kanë të regjistruar vetëm një pjesë të kësaj pasurie.

3. KRIJIMI I EMËRTIMEVE TË PATHJESHTA NGA HUAZIMET GREKE

Huazimet greke në shqipe, jo vetëm kanë pësuar zhvillime të brendshme kuptimore, nga më të larmishmet e nga më interesante, dhe kënë krijuar me qindra njësi frazeologjike, por ato kanë zënë vend në sitagma të ngurtësuara që sot dalin si emërtime të pathjeshta¹¹⁴.

P.sh., si: *Bisht gomari* bot. shih te BISHT,~I. *Çuç gomari* zool. shih te ÇUÇ,~I. *Ferrë (gjemb) gomari* bot. shih te FERR/Ë,~A. *Lule gomari* bot. shih te LUL/E,~JA. *Vesh gomari* bot. veshgomar.

Me fjalën e huazuar *oqean* kemi disa emërtime të pathjeshta, prej të cilave po veçojmë: *Oqeani ajror* libr. atmosfera. *Oqeani botëror* (i përbotshëm) gjeogr. Hidrosfera.

Disa emërtime të pathjeshta në shqipe mund të jenë kalke nga greqishtja, brenda strukturës së të cilave mund të gjejmë fjalë ose morfema rrënjore etj. të huazuara nga kjo gjuhë.

P.sh. *Guri filozofik lëndë fantastike, të cilën kërkonin ta zbulonin alkimistët në mesjetë, duke besuar se ajo kishte gjoja veti të bënte çudira, t'i kthente të gjitha metalet në ar, të shëronte çdo sëmundje, të zgjaste jetën e njeriut e t'i bënte pleqtë përsëri të rinj.*

Nyja gordiane një çështje shumë e ndërlikuar e shumë e vështirë për t'u zgjidhur. *Pres (zgjidh) nyjën gordiane* zgjidh menjëherë me guxim e vendosmëri një çështje shumë të ngatërruar e të vështirë. *Trëndafil breshke* bot. balkrocë; lloj trëndafili, me gjethe gjithmonë të blerta, me lule të bardha, me erë të mirë e të grumbulluara në tufa.

¹¹⁴ Për këto tipe emërtime V. Memisha, *Termtat togfjalësha në fjalorët shpjegues të shqipes*, në Konferenca "Terminologjia e shqipes: dukuri dhe probleme", Tiranë, 2009

4. KRIJIMI I NJËSIVE FRAZELOGJIKE SI ZHVILLIME SEMANTIKE NË SINTAGMA

Zhvillimet semantike ndodhin gjatë përdorimeve të fjalëve për një kohë të gjatë dhe në lidhje të shumta e të larmishme sintagmatike. Shumë shpesh këto lidhje mund të ngurtësohen dhe në këtë mënyrë krijohen njësi frazeologjike.¹¹⁵

Pranohet se përgjithësisht njësitë frazeologjike janë formuar nga shndërrimi i figurshëm i shkallëshkallshëm i togfjalëshave të lirë, proces ky shumë i gjatë. Ato janë parë si njësi që hyjnë të gatshme në ligjërim, që kanë si veçori parësore kuptimin e figurshëm të leksikalizuar etj. Si veçori të këtij shndërrimi janë dalluar *ngurosjat morfologjike* e pjeshme a e plotë e gjymtyrëve të togfjalëshit të lirë; *ngurosjat kuptimore, shkuptimësimi i gjymtyrëve* dhe *rikuptimësimi i gjithë togfjalëshit* (që tani shndërrohet e kundrohet si një njësi e mëvetësishme shënuese, ashtu si edhe fjala); *funksionet e ndryshme sintaksore; ngjyrimi emocionor i spikatur; zhvillimet semantike e fjalëformuese* etj. Shumë nga fjalët që kanë hyrë në shqipe nga greqishtja kanë formuar dhe motivuar njësi të tilla. P.sh., me fjalën *gomar* kemi me dhjetëra njësi frazeologjike (reth 30 që janë në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*, por edhe po kaq që janë në ligjërimin e shkujdesur dhe që nuk janë pasqyruar në këtë fjalor) që janë zhvillime semantike të gjuhës shqipe:

* **(Punonte) për shpirt të gomarit** punonte kot, i shkonte munda humbur. **Sa gomarë buzëbardhë (ka)!** *iron, shih te BUZËBARDHË.* **S'çalon gomari nga veshët** *fj.u. shih te ÇALLOJ.* **S'di si (nga) lidhet gomari mospërf.** *shih te LIDHEM.* **Ia ha bukën gomari mospërf.** është shumë i ngathët dhe i mefshtë. **Kur të hipë gomari (derri) në fik (në majë të fikut)** *thjeshtligj.* kurrë, asnjëherë. **I kanë hedhur (i kanë**

¹¹⁵ Formimi i njësive frazeologjike nënkupton, së pari, krijimin (ngjizjen) e togfjalëshave të llojeve a të përmasave të ndryshme brenda gjirit të fjalive (të thënieve), nënkupton bashkëlidhje leksiko-sintagmatike të fjalëve të kushtëzuara nga faktorë brenda- e jashtëgjuhësorë. Dhe nga këtu kapet fyllimi i shndërrimit të figurshëm. Mendojmë se kemi një proces trishkallësh: *togfjalësh i lirë - togfjalësh "i parapërgatitur" - togfjalësh (njësi) frazeologjike*. *Shih më gjerë, V. Memisha, Rreth shndërrimit të togfjalëshit të lirë në njësi frazeologjike, në SF, 3-4, 2006*

sh tënë) trutë e gomarit nuk vepron sipas mendjes së tij, por bën si i thonë të tjerët, ia kanë marrë mendjen të tjerët. **I lan kokën (kryet) gomarit** *shih te LAJ*. **Nuk i shkoj gomari (kali) në udhë (në urë)** *edhe poh. shih tek UDH/Ë,~A*. **I shkon (i ka hije) si shala gomarit** *iron, shih te SHAL/Ë,~A. II*. **I vuri lëkurën e gomarit** *dikujt shih te LËKUR/Ë,~A*. **S'di gomari ç'është bari** *mospërf.* nuk është i zoti të vlerësojë atë që është me të vërtetë e mirë e me vlerë, nuk di dhia ç'është tagjia. **E di gomari ku e vret samari** *fj.u.* secili i di vetë punët e hallet e tij, e di i zoti ku i pikon çatia. **S'di t'i japë ujë (as) gomarit** *dikush mospërf.* është i trashë nga mendja ose fare i pazoti. **Kali humbi, gomari s'duket** *fj. u.* është rrëmujë e madhe, nuk e merr vesh i pari të dytin. **Prit gomar të mbijë bar!** mos prit kot!; s'dihet kur do të bëhet një punë a kur do të vijë dikush, mund të mos bëhet a të mos vijë kurrë; është fare e pasigurt diçka. **Punon kali, ha gomari** *fj. u. shih te KAL/Ë,~I*. **Sikur i ka ngrënë gomari bukën (macja brumin)** *shih te HA*. **I zoti e nxjerr (e qit) gomarin nga balta** *fj.u. shih te BALT/Ë,~A*. **Le gomari që na ngordhi**, po s'na lënë rehat as mizat le fatkeqësia, le halli i madh që kemi, por na shqetësojnë e na ngacmojnë edhe për gjëra të vogla. **S'ka ç'i bën gomarit, i ble samarit** *fj.u.* ia nxjerr inatin jo atij që duhet, por dikujt tjetër që nuk ka faj, gjetkë e ka inatin e gjetkë e nxjerr. **Kali ha tagjinë, gomari mbart bucelat** *fj. u. shih tek TAGJI,~A*. **Presin të ngordhë gomari (kali) që t'i marrin potkonjtë** *përb.* presin të përfitojnë ndonjë gjë nga ajo që mbetet, presin të përfitojnë nga diçka pa bërë asgjë vetë. **Ti zot, unë zot, po gomarin kush e kullot?** secili duhet të bëjë atë që i takon dhe të mos ia hedhim punën njëri-tjetrit; po të mos bëjë secili punën e vet, nuk i dilet mbanë; po të japin të gjithë urdhra nuk bëhet asnjë punë.

Gjithashtu në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980) mund të gjejmë shumë njësi frazeologjike që lidhen me emrin *shkop* dhe që janë zhvillime të brendshme të shqipes: **U bë për shkop** u plak sa nuk mund të ecë dot pa u mbështetur në shkop. **Me një të rënë të shkopit** si me magji, menjëherë e me lehtësi, pa u munduar e pa u përpjekur. **Me shkopin magjik** menjëherë e pa mundim, me një të thënë; si çudibërës. **I bindet shkopit të dirigjentit** (të dirigjuesit) *libr. shih te DIRIGJENT, ~I* **Ka gjetur shkopi doçen** *keq.* ka gjetur tënxher ja kapakun. **E ha barin pa shkop** *keq.* vepron lirisht, nuk e pengon asgjë, livadhisi. **S'ia ha qeni shkopin** *shih te QEN,~I*. **E heq shkopin zvarrë** është njeri i urtë, nuk trazon njeri, s'i bie njeriu në qafë. **Ishte me plaçka në shkop** *shih te PLAÇK/Ë,~A*. **Vetë zot, vetë shkop** *shih te ZOT,~I n.* **I vë (i fut) shkopinj në rrota** i nxjerr pengesa e ngatërresa, e pengoj në punën e tij, i nxjerr telashe. **Kujto (zër në gojë) qenin, rrëmbe (bëj gati) shkopin** *fj. u. shih te QEN,~I*. **Shkopin, po e ndyve të tërë, s'ke ku e kap** *fj. u. shih te NDYJ*.

Ne mund të paraqesim këtu me dhjetëra e dhjetëra njësi frazeologjike, që motivohen nga huazime të tjera greke në shqipe¹¹⁶, si:

(E kam) presh në kopsht (dikë) *iron. sh. (e kam) lakra në kopsht* (dikë) *iron.* *Kur kryetari i gjyqit e pyeti Gjergjin "a e ke gjë ti të pandehurin, farefis ose ilaka?", ai iu përgjigj me tallje: "Presh në kopsht e kam!" (Let. art.).*

(E la) presh në diell (dikë) e la pa gjë fare, ia mori të gjitha, i zhvati gjithçka; e **la lakuriq; e la gisht.** *Nga kumari nisën të prisheshin me njëri-tjetrin, i merrte kushëriri kushëririt paret e xhepit, i zhvaste djersën e ballit me një të hequr të letrës dhe e linte atë presh në diell. (Pub.)*

¹¹⁶ Frazologjia në vazhdim është nxjerrë nga *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999, i hartuar nga J. Thomai.

(E kapi, e zuri) **me presh në dorë** (dikë) e kapi në çastin kur po vidhte ose po bënte diçka të keqe, e zuri në faj; (e kapi, e zuri) **me duar në presh**; (e kapi, e zuri) **me pelë për dore**; (e zuri, e kapi) **ndër lakra**; e zuri në cak. - *Po të zunë me presh në dorë, ta bënë të zezën. Nuk pyesin fare se kush je. (Let. art.). - Këtë radhë e kam kapur me presh në dorë, - tha postkomandanti duke parë nga mysafirët. (Let. art.).*

Fle mbi dafina (dikush) ka rënë në qetësi e është shkujdesur pas arritjes së një suksesi, të një fitoreje etj., është vetëkënaqur, ia ka marrë mendtë lavdia dhe nuk punon e nuk përpiqet më tej. - *Nuk kemi të drejtë të dehemi nga sukseset dhe të flemë mbi dafina. (Pub.).*

E bën hapin kilometër (dikush) *libr.* përparon shumë, shkon shpejt përpara; ecën me ritme të shpejta. *"E bën natën ditë filani", "e bën dimrin verë tjetri", "e bën hapin kilometër ky", "e bën orën minutë ai", atëherë ku është puna e tyre, se s'po e shohim. (Let. art.).*

(Erdhi) **si kofini pas së vjeli (pas të vjelave)** (dikush a diçka) erdhi tepër vonë, pasi ka mbaruar puna, kur s'duhet më, kur s'hyn më në punë; (erdhi) **si koshi pas së vjeli (pas të vjelave)**; (erdhi) **si shirku pas së vjeli** (pas të vjelave) *krahin.*; (erdhi) **si shiu pas së vjeli**; (erdhi) **pas pilafit**. *Nxitohesha për të mos u dhënë shkas atyre që të më thonë: "Ja, dhe ky, një herë që e ftuam, na vjen si kofini pas së vjeli". (Let. art.).*

I hoqi (i preu) koromanen (dikujt) *thjeshtligj. sh. i hoqi (i preu) kafshatën e gojës* (dikujt).- *Do të na merrni në qafë me këto.. Ti s'ke gajle, se çekanin s'ta prek njeri, kurse mua më presin koromanen. (Let. art.).*

Ia di (ia njoh) vidhat (dikujt) *sh. ia di (ia njoh) burmat* (dikujt). *Mësuam se ai dhe një grup nxënësish të tjerë ishin miq të drejtorit, i cili ua dinte vidhat. (Let. art.). - Sa për Llazin, që thua ti Xhoxhi, ja tek është edhe Agimi, që ia njeh mirë vidhat. (Let. art.).*

Ia gjeti vidhat (dikujt) ia zbuloi dëshirat a mënyrën se si ta bindë e ta bëjë për vete; ia gjeti pikën a anën ku mund të kapet; **ia gjeti burgjitë; ia gjeti burmat**. *Pas këtij vinte Koço Pirrua, djalë i zgjuar, që ia kish gjetur vidhat Hilmiut dhe dinte ta kurdiste si të donte. (Let. art.).*

Ka një vidhë mangët (dikush) mospërf. është i metë nga mendtë; **ka një dërrasë mangët; ka një burgji mangët; ka luajtur nga vidhat**. *Dikush tha se kot e zgjasnin. Fjala që ai kishte një vidhë mangët doli e vërtetë. (Let. art.).*

I janë liruar vidhat (dikujt) nuk është në rregull nga mendja; ka shkalluar; **ka luajtur nga vidhat; i janë liruar burgjitë; i janë liruar burmat; i janë zbërthyer dërrasat**. *Neve sikur na erdhi zyra rrotull. Ish në vete ky shefi, apo mos i qenë liruar vidhat nga të nxehtit? (Let. art.).*

Ia liroi vidhat (dikujt) i bëri shumë lëshime, nuk e shtrëngoi më si më parë; **ia liroi burgjitë; kund. ia shtrëngoi vidhat**.

Lufta s'mënoi. Korierit i duheshin liruar ca vidhat se, fundja, pse të rrezikohej kot së koti! (Let. art.).

Ka luajtur nga vidhat (**dikush**) **nuk është në rregull nga mendja; ka shkalluar**; i janë liruar vidhat; ka një vidhë mangët; i shkanë vidhat; ka luajtur nga burgjitë. - *Ku ishe? Qen i tërbuar! - Ç'pate? Luajte nga vidhat? Të thashë, isha te Fazuliu. (Let. art.). Ferti e pa Majklin dhe ndjeu një peshë në zemër. E qysh mund të këshillohej me një njeri të tillë, i cili kishte luajtur nga vidhat? (Let. art. p.).*

I shkanë vidhat (dikujt) ka luajtur nga mendtë, s'është më në vete, s'është më në terezi, lajthiti; **ka luajtur nga vidhat; i shkanë burgjitë**. *Që atëherë i shkanë vidhat, siç thoshin në facende. Ditën rrinte fare pa punë.. e kur niste të ngrysej fillonte nga profecitë. (Let. art. p.).*

Ia shtrëngoi vidhat (dikujt) e detyroi të sillet a të veprojë në një mënyrë të caktuar; **ia shtrëngoi burgjitë; ia mblodhi rripat; ia shtrëngoi çivitë** thjeshtligj.; kund. **ia liroi vidhat.** - *Sa herë të kam paralajmëruar, Shatillov, - i tha Lluçenkua i vrejtur, - që t'ia shtrëngosh mirë vidhat Lutovit, kur i merr vendin në ndërrimin e turnit!* (Let. art. p.).

(E kam) **presh në kopsht** (dikë) iron. sh. (e kam) **lakra në kopsht** (dikë) iron. Kur kryetari i gjyqit e pyeti Gjergjin "a e ke gjë ti të pandehurin, farefis ose ilaka?", ai iu përgjigj me tallje: "Presh në kopsht e kam!" (Let. art.).

(E la) **presh në diell** (dikë) e la pa gjë fare, ia mori të gjitha, i zhvati gjithçka; e **la lakuriq; e la gisht.** Nga kumari nisën të prisheshin me njëri-tjetrin, i merrte kushëriri kushëririn paret e xhepit, i zhvaste djersën e ballit me një të hequr të letrës dhe e linte atë presh në diell. (Pub.)

(E kapi, e zuri) **me presh në dorë** (dikë) e kapi në çastin kur po vidhte ose po bënte diçka të keqe, e zuri në faj; (e kapi, e zuri) **me duar në presh;** (e kapi, e zuri) **me pelë për dore; (e zuri, e kapi) ndër lakra; e zuri në cak.** - *Po të zunë me presh në dorë, ta bënë të zezën. Nuk pyesin fare se kush je.* (Let. art.). - *Unë gjithmonë kam dyshuar për mësuesin, por këtë radhë e kam kapur me presh në dorë, - tha postkomandanti duke parë nga mysafirët.* (Let. art.).

Fle mbi dafina (dikush) ka rënë në qetësi e është shkujdesur pas arritjes së një suksesi, të një fitoreje etj., është vetëkënaqur, ia ka marrë mendtë lavdia dhe nuk punon e nuk përpiket më tej. - *Nuk kemi të drejtë të dehemi nga sukseset dhe të flemë mbi dafina.* (Pub.).

E bën hapin kilometër (dikush) libr. përparon shumë, shkon shpejt përpara; ecën me ritme të shpejta. "E bën natën ditë filani", "e bën dimrin verë tjetri", "e bën hapin kilometër ky", "e bën orën minutë ai", atëherë ku është puna e tyre, se s'po e shohim. (Let. art.).

(Erdhi) **si kofini pas së vjeli (pas të vjelave)** (dikush a diçka) erdhi tepër vonë, pasi ka mbaruar puna, kur s'duhet më, kur s'hyn më në punë; (erdhi) **si koshi pas së vjeli (pas të vjelave);** (erdhi) **si shirku pas së vjeli** (pas të vjelave) *krahin.*; (erdhi) **si shiu pas së vjeli; (erdhi) pas pilafit.** *Nxitohesha për të mos u dhënë shkas atyre që të më thonë: "Ja, dhe ky, një herë që e ftuam, na vjen si kofini pas së vjeli".* (Let. art.).

I hoqi (i preu) koromanen (dikujt) thjeshtligj. sh. **i hoqi (i preu) kafshatën e gojës** (dikujt).- *Do të na merrni në qafë me këto.. Ti s'ke gajle, se çekanin s'ta prek njeri, kurse mua më presin koromanen.* (Let. art.).

Formimi i njësive frazeologjike është një nga tiparet kryesore të shqipes, që njihet si gjuhë polisemike, d.m.th., si gjuhë që e ka si tipar kryesor lëvizjen e brendshme kuptimore. Kjo nënkupton që shndërrimet e figurshme jo vetëm në një fjalë por edhe në sintagma, ndodhin shumë shpesh, duke prekur pa tjetër edhe ndërtime me huazime nga greqishtja.

KREU V

ZHVILLIMET SEMANTIKE TË HUAZIMEVE GREKE NË SHQIPE

1. ZHVILLIME SEMANTIKE NË HUAZIMET NGA GREQISHTJA

(Dukuria e polisemisë si zhvillime të brendshme kuptimore)

Huazimet, e greqishtes në shqipe apo të shqipes në greqishte, ashtu si gjithë huazimet në gjuhët e tjera, që në çastin kur hyjnë në gjuhën marrëse, *u nënshtrohen ndryshimeve morfologjike të kësaj gjuhe dhe më vonë*, me kalimin e kohës ato pësojnë edhe ndryshime e zhvillime që u përkasin të gjitha nësistemeve gjuhësore (fonetike, fjalëformuese, semantike), duke fituar dhe vlera të tjera shumë të rëndësishme, si *vlera semantike, vlera emocionuese, vlera stilistike, vlera sintagmatike, vlera paradigmatiche vlerë a aftësi zëvendësuese (substitutive)*.

Fjalët e huaja, duke hyrë në gjuhën tonë, mund të kenë pësuar edhe ndryshime në formë e në përmbajtje. *Shqipja i ka marrë fjalët e huaja dhe i ka përpunuar ashtu si fjalët e veta*. Fjalët e huaja vijojnë të zhvillohen, bëhen njësi të fjalorit të saj dhe u nënshtrohen kushteve konkrete historike, që përcaktojnë zhvillimin e leksikut të gjuhës shqipe në përgjithësi; ato bëhen edhe tema prodhuese, por “*fjalët e prejardhura në këtë mënyrë janë formime të shqipes dhe nuk mund të quhen huazime.*”¹¹⁷

Huazimet nga greqishtja kanë hyrë në shtresa të ndryshme të leksikut të shqipes. *Shumë fjalë, që kanë zënë vend në leksikun e përgjithshëm të saj, kanë pësuar zhvillime semantike, fjalëformuese, stilistike etj. të shumta, që bien në sy në qoftë se i përqasim me huazimet terma*. Një krahasim i thjeshtë i strukturave kuptimore të disa fjalëve huazime në rrafshin e sotëm sinkronik në shqipe dhe greqishte e tregon këtë.

Siç kemi përmendur më parë, shqipja (por edhe greqishtja) ka marrë fjalë të huaja, (ka huazuar nga gjuha greke në rastin tonë), nëse ato fjalë shënonin një nocion të ri (kanë hyrë nga greqishtja së bashku me nocionin), nëse shënonin një nuancë a ngjyrim të ri kuptimor që nuk e shënonin barsvlerësit e shqipes ose nëse e kërkonte një stil i caktuar (sidomos termat ndërkombëtarë). Kjo do të thotë që *fjala në shqipe nuk ka hyrë qysh në krye me të gjithë strukturën kuptimore, por vetëm me një kuptim dhe zakonisht me atë kryesorin*. Ne do të ndalemi gjerësisht në fjalorët shpjegues të shqipes dhe të greqishtes (por edhe në fjalorët filologjikë dy- e shume gjuhësh) për t'i

¹¹⁷ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2009

parë këto procese e dukuri¹¹⁸, që prekin edhe rrafshin leksikor dhe atë semantik të huazimeve greke në shqipe, por edhe të huazimeve shqipe në greqishte.

Duke u mbështetur në këtë proces, ne do ta shohim procesin e zhvillimeve semantike në dy drejtime: si proces vertikal (si lëvizje brenda strukturës kuptimore të një fjale të huazuar) dhe si proces horizontal (si lëvizje gjatë fjalëformimit kur si temë prodhuese e motivuese shërben një fjalë e huazuar).

Studiuesi V. Memisha thekson shqipja ka qenë dhe është në proces të vazhdueshëm pasurimi e zhvillimi. Sipas tij “*ky zhvillim duket së pari, në pasurimin e leksikut dhe është një proces ky dydrejtimësh: pasurim horizontal, si pasurim i strukturës leksikore me fjalë dhe njësi frazeologjike të reja; pasurim vertikal (semantik), si pasurim i strukturës semantike me kuptime, me ngjyrimë a me nuanca kuptimore të reja*”¹¹⁹.

Pasurimi horizontal, në leksikologji shihet si *pasurim i strukturës leksikore të gjuhës, si shtim numerik me fjalë*. Veçoria kryesore e këtij zhvillimi të leksikut në ditët e sotme është prirja për *simetri* dhe për *sistematikë*, kjo në të gjitha shtresat a grupet paradigmatiche. Në ligjërimin e shkruar sidomos, por dhe në atë të folur, po futen me shpejtësi në përdorim me mijëra njësi të reja të krijuara sipas mënyrave e tipave të prejardhjes fjalëformuese e semantike. Dhe duhet të pranojmë se fjalët e reja, ato që i përkasin leksikut abstrakt ose që lidhen me botën intelektuale, janë në numër shumë më të madh se ato që i përkasin leksikut konkret a që lidhen me botën materialo-sendore¹²⁰.

Një drejtim i pasurimit të leksikut të shqipes është edhe futja në përdorim të gjerë e *frazeologjisë* që lidhet me botën materiale e shpirtërore të popullit tonë, por edhe me botën kulturore e shkencore të fushave të zhvilluara në arenën ndërkombëtare. Studiuesi A. Jashari me të drejtë shprehet se në rrjedhën e furishme të viteve shqipja nuk ka mënuar të huajë kalke, huazime frazeologjike, fjalë të urta dhe proverba, pra ne gjejmë në ligjërimet e ndryshme “shprehje të huazuara që nuk duhet të vështrohen si mish i huaj në trupin e shqipes, por pjesë e saj si gjuhë kulturore, si shenjë e marrëdhënieve të ndërsjella në kulturat e popujve të ndryshëm dhe si shenjë e *përngritjes* kulturore te popullit shqiptar”¹²¹. Po përmendim këtu disa nga këto njësi që tashmë i ndeshim shpesh: *alfa dhe omega, punë Sizifi, si shpata e Damokleut, me vdekjen te thembra, zjarri i Prometeut* etj.

¹¹⁸ J. Thomai, thekson se “*Dihet që një fjalor është në radhë të parë pasqyrë e fjalëve, e frazeologjisë dhe e kuptimeve të tyre leksikore. Por çdo fjalor, për më tepër çdo fjalor shpjegues kombëtar, është në shumë elemente të tij edhe pasqyrë fonetike e gjuhës (që nga tingujt, drejtshkrimi, drejtshqiptimi e deri te theksi i fjalëve); është pasqyrë (e pjesshme) gramatikore (sepse jep edhe kuptimet gramatikore themelore e mjetet e shprehjes së tyre, temat bazë të fjalëve të eptueshme, kuptimet leksiko-gramatikore, si dhe sintagmatikën a leksematikën më të përgjithshme etj.); është pasqyrë semantike në vështrim më të gjerë se leksiku; po ashtu është pasqyrë stilistike e përgjithësisht e kulturës së gjuhës, lidhur edhe me ruajtjen e pastërtisë së leksikut e të normës leksikore në përgjithësi, sikundër, në disa elemente e sipas rastit, mund të jetë edhe pasqyrë etimologjike, historiko-gjuhësore, etnokulturore etj. Kjo ndodh sepse vetë njësia themelore e leksikut, fjala, është njësi gjuhësore shumëvlerëshe*”. Shih për këtë J. Thomai, *Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë* në *Leksikografia shqipe - trashëgim dhe perspektivë*, Tiranë, 2006, f. 12

¹¹⁹ V. Memisha, *Rreth intelektualizimit të leksikut të shqipes*, në *Seminari II Ndërkombëtar i Albanologjisë*, Tetovë, 2008, f. 194

¹²⁰ V. Memisha, *Rreth intelektualizimit të leksikut të shqipes*, në *Seminari II Ndërkombëtar i Albanologjisë*, Tetovë, 2008, f. 195

¹²¹ A. Jashari, *Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe*, Korçë, 2007, f. VI

Përveç rrugës së formimit të fjalëve të reja dhe të njërive frazeologjike pasurimi i leksikut të gjuhës shqipe, bëhet edhe *përmes huazimit të fjalëve*.¹²² Këtu kemi parasysh si *huazimin* e drejtpërdrejtë nga gjuha dhënëse a huazimin e tërthortë, ashtu edhe *kalkimin e fjalëve të huaja* duke përdorur mjete fjalëformuese të shqipes, kur mënyrat dhe tipat e fjalëformimit të gjuhës nga është kalkuar fjala përputhen me mënyrat dhe tipat e fjalëformimit të shqipes. Në këto raste nuk kemi thyerje të strukturës së shqipes, meqë modeli është karakteristik edhe për shqipen¹²³.

Kurse një rrugë a drejtim tjetër i pasurimi të leksikut të shqipes është ai në *rrafshin vertikal, në zgjerimin e strukturave kuptimore*, proces shumë i rëndësishëm dhe që nënkupton se në ligjërim janë rritur vlerat shënuese, shprehëse – emocionore, stilistike, paradigmatiske, sintagmatike të fjalëve etj.

Ky proces njihet edhe me termin *ndryshime semantike të njërive leksikore*. R. Memushaj, pranon se “Ndryshimet semantike luajnë një rol shumë të rëndësishëm në gjuhë, duke shërbyer si një nga rrugët kryesore të pasurimi të leksikut, që njihet me emrin *prejardhje semantike*. Nëse për çdo objekt të botës reale do të kishim një njësi të veçantë, do të duhej një numër i pafund fjalësh, gjë që do ta bënte shumë të vështirë, në mos të pamundur, komunikimin. Ky problem është kapërcyer duke u dhënë koncepteve të reja emra të vjetër, d.m.th., duke i bërë fjalët ekzistuese të shumëkuptimshme, pra me anë të prejardhjes kuptimore.”¹²⁴

Tregues të ndryshimeve dhe të zhvillimeve semantike të fjalës në gjuhën shqipe janë fjalorët shpjegues. Kështu në Fjalorin shpjegues të 1980-ës mbi 80% e fjalëve në leksikon e gjuhës shqipe dalin me më shumë se një kuptim.

Këto shndërrime semantike mund të jenë të drejtuara ose lëvizje të pavetëdijshme. Shndërrime të drejtuara kemi kur me vetëdije fjalëve ua zgjerojmë strukturën kuptimore duke krijuar kuptime të figurshme, terminologjike, eufemistike, ekspresive, të tipit tabu etj. Ndryshimet e pavetëdijshme janë më “objektive”, ato nisin me ndryshime në vetë realien ose në konceptin për të dhe zakonisht shoqërohen me errësimin e motivimit etimologjik, me specializimin stilistik e shtresimin social etj. Këto janë më të shumtat ndryshime dhe studiues të semantikës këtu e kanë përqendruar vëmendjen për të gjetur rregullsitë e kategoritë semantike.

* * *

Sot *procesi vertikal i pasurimit të leksikut*, sidomos në shqipe, ose i ashtuquajtur *procesi i prejardhjes së brendshme semantike* është tepër veprues. Kjo duket edhe tek grupi paradigmatiske i fjalëve të huazuara nga greqishtja, të cilat janë pjesë organike leksikut të shqipes. Hovi sasior që ka njohur letërsia, publicistike, përkthimtaria etj., ka mundësuar përdorime të shumëllojshme dhe të pafundme të *sintagmave minimale* ose *të strukturave bërthamë*, ku ngjizen dhe ku sendërtohen

¹²² H. Shehu pyet se “A ka arsye për ardhjen e fjalëve të huaja? Sigurisht, ka; më së shumti, subjektive. Ndër arsyet subjektive mund të përveçoheshin: formimi i pamjaftueshëm gjuhësor i aksh gazetari, redaktori, politikani etj. si dhe njohja e pamjaftueshme e kulturës së gjuhës. Të njohësh kulturën e gjuhës, nuk do të thotë të njohësh vetëm normat gramatikore, drejtshqiptimore e drejtshkrimore, por edhe normën fjalësore (leksikore) e stilistikore, pra ta zgjedhësh e ta përzgjedhësh fjalën, shprehjen etj. për thënie të tilla. Ndoshta (besojmë të jenë arsye shoqërore të përkohshme), edhe njëfarë qëndrimi kozmopolit a prirja intelektualiste për t’u dukur i ditur e i mësuar para të tjerëve dhe edhe kryemëvetja e ndonjë shkruesi, folësi etj. Ndoshta, edhe njëfarë shkujdesjeje a pakujdesie.”

¹²³ E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe*, 2005, f. 56

¹²⁴ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2008, f. 175

kuptimet e figurshme edhe tek këto huazime, një tipar thelbësor ky i shqipes si gjuhë me polisemi të zhvilluar. Ky proces veprues tashmë ka një intensitet të fuqishëm. Botimet në Shqipëri dhe në Greqi janë tregues për këtë dukuri. Edhe nëse thuhet se kemi shumë prurje sasiore botimesh, por jo cilësore, ne mbrojmë pikëpamjen tonë me një fakt: sot kemi me qindra e qindra libra me poezi të botuar nga autorë të rinj. Është e rëndësishme të pohojmë se edhe te vëllimi poetik më i dobët gjen patjetër fjalë me kuptime të figurshme, si lidhje fjalësh ku shfaqen shumë shpesh jo vetëm tropet letrare, por edhe ato gjuhësore, si metaforat, metonimitë etj., duke sythuar kështu lëvizjen kuptimore.

Pasurimi i leksikut të shqipes standarde nuk do të thotë vetëm ardhje në leksik e “fjalëve të mëdha”, që u përkasin fushave të mirëfillta shkencore e me kuptim të kapshëm vetëm nga shtresat e arsimuara, por dhe *futje në përdorim* të fjalëve a të njëjësive frazeologjike me qartësi kuptimore, *mënjanim i ambiguitetit semantik*. Kjo ka çuar në një prirje të rëndësishme të shqipes së ditëve të sotme: kemi një pasurim gjithnjë e më të madh *të relacioneve leksikore e semantike*, si edhe diferencim të tyre. Huazimet sidomos ato me vjetërsi të madhe përdorimi, shfaqen si kategori semantike dhe si grupe paradigmatiche të pasura, që jo vetëm ngërthejnë lëndë leksikore e frazeologjike, por edhe e orientojnë përdoruesin te përzgjedhja, te zhdërvjelltësia, te lakonizmi a te sinonimia e të shprehurit. Nga studimet e bëra dhe nga botimet cilësore leksikografike, mund të pohojmë se sinonimia, antonimia, hiponimia, taksonomia, meronimia etj. te këto njësi mund të zbulohen lehtësisht ashtu si te grupe të tjera fjalësh a te shtresa leksikore të ndryshme¹²⁵.

Shqipja (por edhe greqishtja) ka marrë fjalë të huaja si huazime historiko-kulturore dhe jo si huazime gjuhësore, nëse ato fjalë kanë shënuar një nocion të ri (kanë hyrë nga greqishtja së bashku me nocionin), nëse kanë shënuar një nuancë a ngjyrim të ri kuptimor që nuk e shënonin barsvlerësit e shqipes ose nëse e kërkonte një stil i caktuar (sidomos termat ndërkombëtarë). Kjo do të thotë që fjala në shqipe nuk ka hyrë qysh në krye me të gjithë strukturën kuptimore, por vetëm me një kuptim dhe zakonisht me atë kryesorin. Nëse ne ndeshemi me një fjalë të huazuar që ka më shumë se një kuptim, zakonisht, pranohet se kuptimet e prejardhura (kuptimet dytësore, kuptimet e figurshme etj.), të jenë zhvillime te brendshme të shqipes. Kjo dukuri shumë e rëndësishme mund të ndiqet te të gjitha fjalët që nuk janë terma.¹²⁶

Ne kemi analizuar strukturat kuptimore të shumë fjalëve të huazuara në shqipe nga greqishtja, por i mëshojmë edhe një herë faktit, se në qoftë se në shqipe ndeshim çerdhe paradigmatiche fjalësh, kjo nuk do të thotë se fjalët në përbërje të njërës apo tjetrës çerdhe janë huazuar. Fjala që është huazuar, është zakonisht fjala bazë e çerdhes, e vargut apo e grupit paradigmatic. Mund të ndodh që në shqipe të kemi formim me regresion. P.sh., emri **πάστρα (η) (pastërta)**, në shqipe ka hyrë si mbiemër (*i pastër*) apo si ndajfolje (*pastër*), kurse emri abstrakt *pastërta* është formim i brendshëm i shqipes nga mbiemri. Në greqishte ka ndodhur procesi i kundërt: është formuar mbiemri nga emri.

¹²⁵ Shih më gjerë V. Memisha, *Rreth intelektualizimit të leksikut të shqipes*, në Seminari II Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2008, f. 195

¹²⁶ Dihet, tashmë, se karakteristika kryesore e fjalëve-termave janë *përpikëria* dhe *njëkuptimshmëria*, ndaj edhe nuk mund të kërkojmë zhvillime semantike të brendshme tek ata. Nëse ky proces haset edhe te ky grup paradigmatic, atëherë te termat fillon procesi i *shterminologjizimit* ose kalimi nga leksiku terminologjik në leksikun e përgjithshëm.

Nëse ne ndalemi te fjalët e mëposhtme vërejmë këto raporte kuptimore fjalë në greqishten e sotme / fjalë në shqipen e sotme¹²⁷: **πάστρα (η) / pastërti,-a** 1:3; **παστρέω / pastrój** 1:10; **παστρικός / pastrικός** 4:16. Vetëm me vështrimin e parë zbulojmë se shqipja shfaqet menjëherë si gjuhë polisemike (për të tria fjalët që formojnë një fushë semantike fjalëformuese, kemi 6 kuptime në greqishte dhe 29 kuptime në shqipe, pra në shqipe kemi 23 kuptime më shumë, ose gati pesëfishin e kuptimeve të fjalëve në greqishte).

Në qoftë se ne strukturën kuptimore të fjalëve ndeshim kuptime të njëjta a të afërta, kjo ka të bëjë me zhvillime paralele, të veçanta në secilën gjuhë, duke u bërë tregues i të përbashkëtave që kanë dy popujt fqinj në botën materiale dhe shpirtërore.

πάστρα (η) (χωρ. πληθ.) η καθαριότητα: το σπίτι έλαμπε από ~ ANT. βρόμα.

[ETYM. μεσν. < σπάστρα (me proληπτική ανομοίωση τού σ-) < σπα-στρέω (υποχωρητ.), βλ. λ. παστρεύω].

PASTËRTÍ,~A f. 1. Të qenët i pastër, vetia e dikujt a e diçkaje të pastër (në kuptimet 1-9, 11-14). *Pastërti e madhe (shembullore). Pastërti morale (shpirtërore). Pastërtia e ajrit (e mjedisit). Pastërtia e farës. Pastërtia e ndjenjave (e shpirtit). Pastërtia e gjuhës. Shkalla e pastërtisë së një lënde. Mban pastërti. Këtu ka pastërti. I prish pastërtinë.*

2. Mungesë e ndikimeve të huaja, e shtrembërimeve ose e përzierjeve ideologjike; gjendje në të cilën nuk ka pikëpamje të shtrembra ose elementë me qëndrime politikisht të huaja. *Pastërtia ideologjike. Pastërtia e teorisë revolucionare. Pastërtia e radhëve.*

3. *bised.* Punishte me pajisjet e nevojshme ku lahen dhe pastrohen ndërresat e rroba të ndryshme. *I çoi ndërresat në pastërti. Mori pallton nga pastërtia.*

παστρέω ρ. μετβ. (πάστρ-εψα,-εύτηκα,-εμένος) καθαρίζω, αφαιρώ τη βρομιά από κάτι: ~ το σπίτι | το τζάκι. — πάατρεμα (το). ➤ ΣΧΟΛΙΟ λ. ξε-.

[ETYM. μεσν. < σπαρτεύω “καθαρίζω με σκούπα από σάρτο” (me μετάθεση τού σ- και αντιμετάθεση συμφώνων στο σύμπλεγμα -ρτ-) < αρχ. Σπάρτον (βλ.λ.). Από συμφυρμό των τ. παστρεύω και σπαρτεύω προήλθε το μεσν. σπαστρέύω (> σπάστρα > πάστρα, βλ.λ.)].

PASTR/ÓJ kal., ~ÓVA, ~ÚAR. 1. I heq diçkaje pluhurin, plehërat, baltën, lyrën, bojën etj. me fshesë, me furçë, duke e fërkuar me leckë të lagur, me ujë etj., i heq papastërtitë e ndryshme, e bëj të pastër; laj me ujë e me sapun. *Pastroi shtëpinë (dhomën, oborrin). Pastroi rrobat (këpucët). Pastroj xhamat. Pastroj biçikletën. Pastroj dhëmbët. Pastroj me fshesë (me furçë, me leckë). Pastroj me ujë.*

2. *tek.* I heq ndryshkun diçkaje duke e fërkuar; e fshij dhe e bëj të shkëlqejë, i jap shkëlqim. *Pastroj armët (shpatën). Pastroj enët.*

3. I heq mbeturinat a çdo gjë tjetër që e zë, e ndalon, e prish etj.; largoj gjërat që e kanë zënë dhe që të pengojnë për të kaluar, për të punuar etj. *Pastroi kanalën (pusin,*

¹²⁷ Fjalët e gjuhës greke që kanë hyrë në shqipe në periudha kohore të ndryshme, janë marrë së bashku me strukturën e tyre kuptimore nga Γ. Μπαμπινιώτη; *Λεξικό της νεας ελληνικής γλώσσας, με σχόλια για τη σωστή χρήση των λέξεων ερμηνευτικό, ετυμολογικό, ορθογραφικό, συνώνυμων – αντιθέτων, κύριων ονομάτων, επιστημονικών ορών, ακρωνυμίων*; me αξιοποίηση τού γλωσσικού αρχείου; Αθηνών, 2002, si *një fjalor i tipit të madh* dhe nga më cilësorët të botuar deri tani në Greqi. Kurse fjalët gjegjëse shqipe me zhvillimet dhe me strukturat e plota kuptimore janë marrë nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1980, si fjalori me strukturat kuptimore më të plota, deri më sot në shqipen standarde.

vijën e ujit). Pastroj oxhakun. Pastroj çatinë nga dëbora. I pastroi rrugën. Ia pastroi tryezën. E pastroi vendin për arkat.

4. *vet. veta III.* I heq puçrrat, dregëzat ose njollat në fytyrë e në lëkurë, e qëron; ia lan organizmin nga diçka e keqe, e dëlir. *Ia pastroi fytyrën. Ia pastroi zorrët.*

5. *vet. veta III.* E kthjellon, i largon retë. *Era e pastroi qiellin (motin).*

6. E qëroj nga lëndët e huaja, nga pluhuri etj., c bëj të kulluar a të pastër. *Pastroj ujin (ajrin). Pastroj grurin. Pastroj arën nga gurët (nga ferrat).*

7. heq cipën, lëkurën ose pjesë të tjera të panevojshme një sendi ushqimor përpara se ta gatuj ose përpara se ta ha, qëroj. *Pastroj peshkun. Pastroj perimet. Pastroje mollën (dardhën)!*

8. *fig.* Zhduk mbeturinat e ndikimet e ideologjisë së huaj; dëboj elementët me qëndrime politikisht të huaja e të dëmshme. *Pastroj ndërgjegjen (vetëdijen). Pastroj botëkuptimin. I pastruan radhët e Partisë.*

9. E çliroj a e shpëtoj një vend duke dëbuar ose duke asgjësuar armiqtë c tradhtarët. *Ushtria Nacionalçlirimtare e pastroi vendin nga pushtuesit e tradhtarët. E pastruan nga bandat e kriminelëve.*

10. Heq atë që është e huaj, e tepërt, e panevojshme ose e dëmshme; e bëj me të qartë dhe me të kuptueshme diçka. *Pastroj gjuhën nga fjalët e huaja. Pastroj programet (tekstet) nga lënda e tepërt.*

***Pastro (laj) gojën!** *mospërf. shih te LAJ. Pastroj (kruaj) zërin (gurmazin) shih te KRUAJ. Pastroj ahuret ë Augjiasit libr. shih tek AHUR,~I.*

παστρικός, -ή (λαϊκότ. -ιά), -ό [μεσν.] (λαϊκ.) 1. καθαρός: ~ σπίτι | νοικοκυριό χωριό 2. (μτφ.) ξεκάθαρος, τίμιος: αυτός κάνει μόνο ~ δουλειές || *Μίλα ντόμπρα! Θέλω ~ κουβέντες!* || ~ απάντηση | θέση 3. (μτφ.-ειρων. για πρόσ.) αυτός που είναι αμφίβολης ηθικής ή ύποπτος για παράνομες δόσοληψίες: ~ κουμάσι! 4. (στον τ. παστρικά - παλαιότ.) η πόρνη.

PASTËR (i,e) mb. 1. Që nuk ka pluhur, plehëra, baltë, lyre, bojë etj., që nuk është i fëlliqur, që i janë hequr, i janë fshirë a i janë larë pluhuri, balta, lyra etj. *kund. i ndyrë; i fëlliqur. Shtëpi (dhomë) e pastër. Oborr i pastër. Rroba të pastra. Shami e pastër. Lesh i pastër. Me duar të pastra. Me fytyrë (qafë) të pastër. Me dhëmbë të pastër. Enë (lugë) të pastra. Xhama të pastër.*

2. Që lahet mirë e rregullisht, që mban përherë veshje të lara; që e mban mirë, të larë e të fshirë vendin ku jeton e punon, pastërtor. *Njeri i pastër. Grua e pastër.*

3. Që nuk ka mbeturina, pengesa e gjëra të tjera, të cilat ta zënë, ta ndalojnë, ta prishin etj. *Gyp i pastër. Pus i pastër. Kanal i pastër. Rast i pastër. sport. mundësi për të gjuajtur e për të shënuar pa e penguar asgjë (në futboll).*

4. Që nuk ka puçrra, dregëza ose shenja të ndonjë sëmundjeje, i qëruar. *E ka fytyrën të pastër. I ka mushkëritë të pastra.*

5. Që është pa re, i kthjellët. *Qiell i pastër.*

6. Që nuk të ndot. *Punë e pastër.*

7. Që nuk ka lëndë të huaja, pluhur etj. të tretura a të përziëra me të, i kulluar; i përbërë thjesht prej një lëndë. *Ujë i pastër. Lesh i pastër. Grurë i pastër. Ar i pastër. Mineral i pastër. Dal në ajër të pastër dal jashtë një dhome të mbyllur.*

8. *fig.* I ndershëm e i çiltër në jetë, i sjellshëm në punë e i panjollë; që nuk e errëson asgjë e pandershme a e shtrembër. *Njeri i pastër. Vajzë e pastër. Me biografi të pastër. E ka ndërgjegjen të pastër.*

9. *fig.* Që nuk ka djallëzi e prapamendime dhe nuk udhëhiqet nga interesa të ngushta e të rastit; i dëlirë, i kulluar, i çiltër. *Ndjenjë (dashuri) e pastër. Miqësi e pastër. Me zemër (me shpirt) të pastër.*

10. *fig.* Që nuk ka ndikime të huaja, shtrembërime ose përzierje ideologjike; që nuk ka elementë me qëndrime politikisht të huaja. *Vija e Partisë sonë është e pastër. T'i mbajmë të pastra radhët tona.*

11. Që është bërë me kujdes, me cilësi të lartë dhe pa të meta; që është pa ndreqje e gabime. *Punë e pastër. Kopje e pastër. Në faqe të pastër.*

12. Që i përket një lloji të mirë dhe nuk është përzier me lloje të tjera (kryesisht për racat e kafshëve). *Racë e pastër.*

13. Që nuk është e mbushur me fjalë, me shprehje e me ndërtime të huaja dhe është tërësisht në përputhje me normën letrare (për gjuhën). *Gjuhë e pastër. Fliste një shqipe të pastër.*

14. Që tingëllon rrjedhshëm, pa u shoqëruar me zhurma e gërvishtje, i qëruar (për zërin). *Tingull i pastër. Ka një zë të pastër.*

15. *sport.* Që zhvillohet në përputhje të plotë me rregullat, jo i rëndë, pa të shtyra, pa grindje e goditje. *Lojë e pastër. Futboll i pastër.*

16. *si em.* PAST/ËR, ~RA (e) *f.* Fletë e bardhë, në të cilën është shkruar përfundimisht diçka pa gabime e pa ndreqje. *E hedh në të pastër.*

PASTËR *ndajf.* 1. Në gjendje të pastër, me pastërti. *E mban pastër shtëpinë. I mban pastër rrobat. Mbahet pastër e mban veten dhe veshjen gjithnjë të pastër*

2. Me cilësi të lartë, pa të meta, pa ndreqje e gabime. *Punon pastër. E ka shkruar pastër.*

3. Në mënyrë që dëgjohet mirë e kuptohet pa vështirësi, qartë. *Flet (i shqipton fjalët) pastër.*

4. Pa fjalë, shprehje e ndërtime të huaja dhe në përputhje me rregullat e me normat letrare, në një gjuhë të pastër. *Shkruan (shprehet) pastër.*

Zhvillimet e brendshme kuptimore, si zgjerim i aftësisë shënuese të fjalëve të huazuara nga greqishtja **shikohen edhe në fjalë të tjera**, si:

MÓK/ËR,~RA *f. sh.* ~RA, ~RAT. 1. Gur i sheshtë e i rumbullakët si rrotë, mjaft i rëndë e me një vrimë në mes, i cili rrotullohet mbi një gur tjetër të tillë, që është me i madh e i palëvizshëm, për të bluar drithë; gur mulliri. *Mokrat e mullirit. Bluanin me (në) mokër.*

2. Mulli dore me dy gurë të vegjël e jo shumë të rëndë, që shërben për të bluar trashë drithë a oriz e për ta bërë bollgur, për të thërrmuar grurë të zier etj.; secili nga dy gurët e këtij mulliri. *Goja pa dhëtnbë është mulli pa mokra. fj.u. E kam si mokër në qafë e kam barrë të rëndë dike a diçka.*

3. Gur i madh. *Mokra të forta.*

* **Kërkon për mokra** *keq.* flet kot, bluan, grin. **I vuri mokrat në këmbë** e pengoi, nuk e la të bëjë diçka.

Si jemi shprehur shpesh, **herë është krejtësisht e natyrshme që struktura kuptimore e fjalës që ka hyrë si huazim në shqipe prej greqishtes, të mos jetë e njëjtë apo e barasvlershme me atë të fjalës në greqishte**. P. sh te fjala *greminë* në shqipe kemi tri kuptime, kurse te ajo në greqishte kemi një kuptim.

GREMÍN/Ë, ~A *f. sh.* ~A, ~AT. 1. Vend (grope, përrua etj.) i thellë me anë të thepisura, zakonisht në mal, në mes shkëmbinjve etj.; humnerë, hon. *Greminë e thellë. Greminat e maleve. Në fund të gre-mines. Ra në greminë.*

2. *fig.* Shkatërrim i plotë, humbje, zhdukje. *Shkoi në greminë. Ecën drejt greminës.*

3. *fig.* Hendek i thellë që ndan forcat a grupet e ndryshme shoqërore, dallim i madh. *Greminë klasore. I ndan një greminë.*

* **Ra në greminë** pësoi një humbje a fatkeqësi të madhe. **E hodhi në greminë dikë** i shkatërroi jetën, e çoi në një gjendje shumë të keqe. **Është në buzë të greminës (të humnerës)** është në prag të shkatërrimit të plotë ose të një humbjeje a fatkeqësie të madhe.

γκρεμός κ. **γκρεμνος** κ. (λόγ.) κρημνός (ο) το επικίνδυνα απότομο και βαθύ χάσμα, το βάραθρο: ο ~ έχασκε κάτω από τα πόδια τους || το αμάξι έπεσε στον - ΣΥΝ. βάραθρο, άβυσσος· ΦΡ. (α) στο **χείλος τού γκρεμού** (i) (κυριολ.) στην άκρη μιας απότομης, βραχώδους επι- φάνειας (ii) (μτφ.) στα πρόθυρα τής καταστροφής, λίγο πριν από την ολοκληρωτική συντριβή: όταν ανέλαβε την εξουσία η οικονομία βρι- σκόταν ~ (β) (μτφ.) **μπρος γκρεμός | βαθύ και πίσω ρέμα** για οριακές καταστάσεις αδιεξόδου, όταν έχει κανείς να επιλέξει μεταξύ δύο εξί- σου δυσάρεστων εναλλακτικών λύσεων | δεδομένων κ.λπ.: *Και τώρα τι να κάνω; ~! Η πληρώνω και μένω αδέκαρος ή δεν πληρώνω και πάω φυλακή!*

[ETYM μεσν. < γκρεμνός (το γκ- αντί κ- από τη συνεκφορά τής λ. με την αιτ. τού άρθρου: τόν κρημνό) < αρχ. κρημ-νός < θ. krem-, εκτετα- μένη βαθμ. πρώτης συλλαβής τής δισύλλαβης ρίζας krema-, η οποία απαντά στο ρ. κρέμαμαν βλ. κ. κρεμώ].

Interesante është ndjekja e polisemisë te folja **gremis** në shqipe që ka vetëm 3 kuptime +1 përdorim në pësore dhe **γκρεμίζω** në greqishte që ka një strukturë kuptimore trefish më të madhe, me 9 kuptime:

GREMÍS *kal.*, ~A, ~UR. 1. E rrëzoj dike për-dhe, duke e penguar gjatë ecjes; rrëzoj dike nga një vend i lartë; shtyj dike me force dhe e rrëzoj në një përrua, në një grope etj.; e hedh a e lëshoj poshtë. *E gremisi nga shkallët (nga shkëmbi). E gremisi në përrua.*

2. *bised.* Shemb diçka, shkatërroj plotësisht. *E gremisi shtëpinë tërmeti.*

3. *fig. bised.* Përzë, dëboj. *E gremisi nga shtëpia.*

4. *Pës. e GREMIS.*

γκρεμίζω ρ. μετβ. {γκρέμισ-α, -τηκα, -μένος}

1. προκαλώ την καταστροφή (τοιχού ή γεν. οικοδομικής κατασκευής): *οι αρχαίες ελληνικές πόλεις γκρέμιζαν μέρος των τειχών τους για να τιμήσουν τους νικητές των Ολυμπιακών Αγώνων || γκρέμισαν το σπίτι, για να χτίσουν πολυκατοικία ΣΥΝ. Κατεδαφίζω.*

2. ρίχνω (κάποιον) από μεγάλο ύψος, πετάω σε γκρεμό: *τον έσπρωξε από πίσω και τον γκρέμισε στο φαράγγι ΣΥΝ. (κατα)κρημνίζω.*

3. (εκφραστ.) ρίχνω στο έδαφος ΣΥΝ. ρίχνω κάτω.

4. (μτφ.) ανατρέπω: *οι επαναστάτες γκρέμισαν τον δικτάτορα από την εξουσία.*

5. (ειδικότ.) (για κάτι σημαντικό, υψηλό) παύω να εκτιμώ, να σέβομαι και να υπολογίζω: *το κοινό αναδεικνύει αλλά και γκρεμίζει τα είδωλα του-* (μεσοπαθ. **γκρεμίζομαι**)

6. πέφτω στον γκρεμό: *δεν μπόρεσε να ελέγξει το αυτοκίνητο και γκρεμίστηκε στη χαράδρα.*

7. πέφτω κάτω (από ύψος και με κίνδυνο τραυματισμούς ο αναβάτης γκρεμίστηκε από το άλογο.

8. (μτφ.) καταρρέω, καταστρέφομαι: - η αυτοκρατορία που με τόσο κόπο έχτισε κινδυνεύει να γκρεμιστεί- (εφημ.)- ΦΡ. *γκρεμίζεται ο κόσμος | γκρεμίζονται τα πάντα γύρω μου* αισθάνομαι να καταρρέουν τα πάντα γύρω μου (ό,τι πίστευα, ό,τι υπολόγιζα κ.λπ.)• για πολύ μεγάλη απογοήτευση και διάψευση: *όταν έμαθε το παρελθόν του πατέρα της, ένωσε να γκρεμίζεται ο κόσμος γύρω της.*

9. (στην προστ. *γκρεμίσου* με επιθετική διάθεση) (μεσν.) απομακρύνσου, φύγε αμέσως• κυρ. σε προστ.:*γκρεμίσου από 'δώ αμέσως- και να μη σε ξαναδώ στα μάτια μου!* ΣΥΝ. γκρεμοτσακίσου, τσακίσου, ξεκουμπίσου. [ETYM. μεσν. < γκρεμνίζω < μτγν. κρημνίζω < αρχ. κρημνός, βλ. κ. γκρεμός].

γκρέμισμα (το) {γκρεμίσμ-ατος | -ατα, -άτων}

1. το να γκρεμίζει κανείς (κάτι): το - *τού εργοστασίου κράτησε μήνες.*

2. *γκρεμίσματα* (τα) τα απομεινάρια, τα ερείπια που αφήνει μια κατεδάφιση, μια καταστροφή: *περπατούσε μέσα στα - τού πατρικού του με δάκρυα* ΣΥΝ. ερείπια, χαλάσματα, συντρίμια, ρημάδια.

3. (μτφ.) πτώση, διάλυση: το ~ *τού κομμουνισμού στην πρώην Ε.Σ.Σ.= προκάλεσε ανακατατάξεις στον ευρωπαϊκό χάρτη.*

4. (εκφραστ.) η πτώση από μεγάλο ύψος.

Në fjalorin *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας, με σχόλια για τη σωστή χρήση των λέξεων ερμηνευτικό, ετυμολογικό, ορθογραφικό, συνώνυμων – αντιθέτων, κύριων ονομάτων, επιστημονικών όρων, ακρωνυμίων;* με αξιοποίηση του γλωσσικού αρχείου, të J. Babinjotit, nuk kemi zë të veçantë leksikografik të vetvetores. Kurse në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (Tiranë, 1980), kemi edhe vetvetoren *gremisem* që është një zhvillim jo vetëm leksikor por edhe semantik, një dukuri shumë karakteristike për shqipen.¹²⁸

GREMÍSEM *vetv.* 1. Rrëzohem përdhe nga një vend i lartë; bie përdhe gjatë ecjes, pasi pengohem në diçka; bie poshtë në një përrua, në një grope etj. *U gremis në rrugë. U gremis në përrua. U gremis nga shkallët. U gremis nga shkëmbi. Mbaje fëmijën, se mos gremiset*

2. *fig. bised.* Iki a largohem pa dëshirën time nga një vend a nga një punë, shporrem. *Gremisu që këtej!*

Shqipja mund të ketë huazuar nga greqishtja edhe fjalë shërbyese, me kuptim leksikor të errësuar. P.sh. parafjala **me** mendojmë se është huazim nga greqishtja, mendim që e ka edhe G. Majeri.¹²⁹ Po të krahasohen strukturat kuptimore të kësaj parafjale në fjalorët gati të një tipi në greqishte dhe në shqipe, duket sikur kemi një mbartje mekanike të kuptimeve, sepse ajo ka 13 kuptime në greqishte¹³⁰ dhe 15 në gjuhën shqipe¹³¹.

¹²⁸ Shih më gjerë J. Thomai, *Rreth semantikës së foljeve veprorë, pësore e vetvetore në gjuhën shqipe*, GjJ, 1984, 3

¹²⁹ G. Meyer, *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, Tiranë, 2007

¹³⁰ Ne jemi mbështetur në fjalorin e J. Babinjotit: Γ. Μπαμπινιώτη; *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας, με σχόλια για τη σωστή χρήση των λέξεων ερμηνευτικό, ετυμολογικό, ορθογραφικό, συνώνυμων – αντίθετων*,

με κ. μ' (μπροστά από φωνήεν) πρόθ. (+αιτ.) δηλώνει:

1. (α) συνοδία ή συντροφιά, παρέα (με κάποιον) (συχνά προηγείται το επίρρ. μαζί): *πήγα στο θέατρο ~ τον πατέρα μου (ή μαζί ~ τον πατέρα μου) || θα έρθω - τον Πέτρο* (β) συνύπαρξη: *ζει ~ μια φίλη της.*

2. τρόπο: *τα πορτοκάλια πωλούνται ~ το κιλό κι όχι ~ το κομμάτι || με βοήθησε ~ προθυμία || πίνω τον καφέ ~ ζάχαρη και γάλα || βγαίνοντας από το διαμέρισμα του ήρθε πρόσωπο ~ πρόσωπο με τη Μαρία || γίνεται μάχη σώμα - σώμα | στήθος - στήθος || περπατούσαν χέρι (~) χέρι! || θα έρθει - χαρά στη συγκέντρωση || ~ λίγα λόγια (σύντομα), πες μου ποιο είναι το πρόβλημα σου || μιλάει πάντα ~ τουπέ (αλαζονικά) || βλέπω ή παίρνω κάποιον ~ καλό ή κακό μάτι (διατίθεμαι ευνοϊκά ή δυσμενώς απέναντι του) || ~ χίλια βάσανα (πολύ δύσκολα) κατάφερε να μεγαλώσει τα παιδιά της || βγάζω το ψωμί μου ~ τον ιδρώτα τού προσώπου μου (δουλεύοντας πολύ σκληρά, κοπιάζοντας πολύ) || τίποτα δε γίνεται ~ το ζόρι (με πίεση), πρέπει να τον πάρεις ~ το καλό (να τον καλοπιάσεις, να του μιλήσεις γλυκά) για να γίνει η δουλειά σου || σήκωσε το ~ το μαλακό (προσεκτικά, χωρίς βίαιες κινήσεις) || δέχτηκε ~ ΤΟ στασιό (πιεζόμενος, χωρίς να θέλει) || ~ τα πολλά (με πολλές προσπάθειες, ύστερα από πολύ κόπο) κατάφερα να την πείσω να δώσει εξετάσεις.*

3. μέσο μεταφοράς ή όργανο: *πήγα - τρένο | τα πόδια || έκοψα το καρπούζι ~ το μαχαίρι || διαβάζει ~ το φως τής λάμπας || (ευχετ.) ~ τη βοήθεια τού Θεού, θα τα καταφέρουμε!*

4. σχέση | αναφορά: *έχει μανία ~ το ψάρεμα || μ' εκείνο το πρόβλημα που είχαμε χτες, δεν μπόρεσα να βρω λύση.*

5. ισότητα, ομοιότητα, συμφωνία, επικοινωνία φιλική ή εχθρική: *το αυτοκίνητο σου είναι ίδια μάρκα -το δικό μου. || η =ανάη μοιάζει ~ τον πατέρα της || έχει τσακωθεί ~ τους δικούς της || οι Ισραηλινοί άρchiσαν διαπραγματεύσεις - τους Παλαιστίνιους || είναι σύμφωνος -τις απόψεις μας.*

6. (α) συνθήκες: *δεν ταξιδεύω ~ τέτοια βροχή || ~ τόσο θόρυβο μου είναι αδύνατον να κοιμηθώ* (β) ψυχική κατάσταση: *γέλασα ~ την καρδιά μου (πολύ) || έφαγα - την ψυχή μου (όσο ήθελα, πολύ) || δούλεψε ~ πυλλή όρεξη.*

7. αιτία: *συγκινήθηκα ~ τη συμπεριφορά του.*

8. κυριότητα, κτήση, κατοχή (ακόμα και για είδη ένδυσης): *νύφη ~ προίκα*

9. ιδιαίτερο χαρακτηριστικό ή ιδιότητα, περιεχόμενο: *σπίτι - ωραία επίπλωση || μπουτίλια ~ λάδι || η δασκάλα ~ τα γαλάζια μάτια || το κορίτσι ~ τα μαύρα (ενν. ρούχα). ΦΡ. **χρήμα με ουρά** πολύ χρήμα: η νύφη μπορεί να μην είναι όμορφη, όμως έχει.*

10. χρόνο: (α) χρονικό προσδιορισμό: *θα ξεκινήσουμε το πρωί ~ την ανατολή τού ήλιου || πρωί-πρωί ~ τηδρο-σούλα- ΦΡ. **κοιμάμαι | πάω για ύπνο με τις κότες** κοιμάμαι πολύ νωρίς* (β) όριο | τέλος χρονικού διαστήματος: *δέκα ~ έντεκα έχουμα μάθημα.*

11. ποσό ή αντάλλαγμα | αντιστάθμισμα: *άλλαξα τα ρούβλια ~ δολάρια || τον βοήθησε - το αζημίωτο || δεν πουλώ ~ κέρδος, αλλά ~ ζημία*

12. αντίθεση, εναντίωση (παρά): *~ τόσες υποχρεώσεις, τα κατάφερε μια χαρά || ~ όλο το σεβασμό που σου 'χω, θα διαφωνήσω μαζί σου || μ' όλες της τις παραξενιές, είναι χαριτωμένη*

13. ως περι-φραστ. πρόθεση (+αιτ.) ή περιφραστ. σύνδ. (+να...): (α) **με βάση:** *~ τα διεθνή πρότυπα, το νέο αεροδρόμιο είναι από τα καλύτερα στον κόσμο* (β) **με**

κύριων ονομάτων, επιστημονικών ορων, ακρωνυμιών; με αξιοποίηση τού γλωσσικού αρχείου; Αθηνών, 2002, që është një nga fjalorët më të plotë dhe më të mirë të hartuara vitet e fundit në leksikografi në greke.

¹³¹ Ne jemi mbështetur te Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1980, i cili është i tipit të mesëm për numrin e fjalëve, por i tipit të madh për ndërtimin e shpjegimet e strukturave kuptimore.

αποτέλεσμα (+να...): άργησε να ξεκινήσει, ~ να φτάσει καθυστερημένος || δεν διάβασε στις εξετάσεις ~ την αποτυχία (γ) **με σκοπό** | **στόχο** (+να...): έκανε τα πάντα ~ να ανέβει στην ιεραρχία τής επιχείρησης- ΦΡ. **με τίποτα στον κόσμο** | **ούτε με σφαίρες** για να δηλωθεί κατηγορηματική άρνηση για κάτι: Εγώ, να φάω κρέας, ενώ είμαι χορτοφάγος; ~! (Βλ. λ. πρόθεση, ΠΙΝ.).

[ETYM, μεσν. < αρχ. μετά (βλ.λ.), με ανομοιοτική αποβολή τής β' συλλαβής, κυρ. όταν ακολουθούσε άρθρο (π.χ. μετά τα...)]. **με**² αντων. αιτιατική ενικού τού ά προσ. τής προσωπικής αντων. εγώ. - ΣΧΟΛΙΟ προσωπικές αντωνυμίες, λ. προσωπικός. [ETYM μεσν. < αρχ. έμέ (βλ. λ. εγώ)]. **μέα** → τα σέα και τα **μέα mea culpa** λατ. (προφέρεται *μέα κούλπα*) ελλην. *δικό μου λάθος*- δικό μου τ φταιξιμο, φράση με την οποία παραδέχεται κανείς το λάθος του δημόσια. [ETYM < λατ. mea culpa “λάθος μου” < mea (< αντων. meus “εμός, δικός μου”) + culpa “λάθος”].

ME. I. paraffj. Përdoret me një emër ose me një përemër në rasën kallëzore për të treguar: 1. Praninë e dy a me shumë vetave a sendeve së bashku në një vend, qenien e tyre së bashku në një gjendje të caktuar ose pjesëmarrjen e tyre të përbashkët në një veprim; shoqërimin e dikujt a të diçkaje nga dikush a diçka tjetër kur ndodhet në një gjendje të caktuar ose kur kryen një veprim. *Motra me vëllanë janë në një klasë. Rri gjithnjë me të. Jetonte me fëmijët. Është i një mendjeje me shokët. Luan me shokët e klasës. Shkon mirë me të gjithë. Foli (bisedoi) me miqtë. U takua me miqtë. U zu (u pajtua) me të tjerët. Marrin e japin me njëri-tjetrin. E mori me vete. Doli shëtitje me prindërit. Eja me mua! E shoqërojnë misrin me fa-sule. Ra me zhurmë të madhe.*

2. Afrinë a takimin në hapësirë ose lidhjen e di kujt a të diçkaje me dike a me diçka tjetër. *Kufizohet me det. Janë fqinjë me Agronin. Është i rrethuar me male të larta. Të gjitha fshatrat janë lidhur (me telefon) me qytetet. E shkrijnë bakrin me kallajin. Populli është i lidhur ngushtë me Partinë. U fejua (u martua) me një djalë (me një vajzë) të mirë. U përqaftua me të.*

3. Praninë e një pjese a të një shtese ose qenien e një tipari të jashtëm a të brendshëm, e një vetie a cilësie te dikush a te diçka. *Opinga me xhufka. Këpucë me qafa. Drapër me dhëmbëza. Shtëpi me oborr (me ballkon). Fletore me vija (me katrorë). Yll me bisht. Plak me flokë të thinjur. Vajzë me gërsheta. Lopë me bale në ballë. Djalë me vullnet (me talent). Burrë me mend. Punëtor me duar të arta. Njeri me zemër të gjerë. Kalë me huqë. Dokument me vlerë. Punë me rëndësi.*

4. Lëndën a diçka tjetër, me të cilën është bërë, është mbushur a është lyer diçka ose është mbështjellë, veshur a mbuluar dikush a diçka. *Mur me tulla. Tavan me dërrasa. Akulllore me qumësht (me lëng pemësh). Tufë me lule. Gjellë me mish. Byrek me djathë. Lakror me lëpjetë. Çaj me limon. Dyshek me pambuk (me lesh). Shportë me fiq. Qyp me mjaltë. Grope me ujë. Ara me misër (me grurë). Një koshere me bletë. Bukë me gjalpë. E mbështolli me letër. E mbuloi me tjegulla (me kashtë). E shtroi me dërrasa (me qilima). E leu me bojë (me baltë). U mbulua me bore. V zu qielli me re. U vesh mali me gjelbërim.*

5. Një dukuri, gjendje a tipar, që shoqëron një veprim dhe përcakton mënyrën si bëhet ose si shfaqet diçka, si vepron dikush etj. *E priti me kënaqësi (me gëzim, me padurim, me dyshim, me gjakftohtësi, me mirënjohje). E merrte me të mirë. E donte me gjithë shpirt. Bërtiti me sa kishte në kokë bërtiti me të gjitha forcat. / merr punët me gjithë mend (me të qeshur). Punon me kujdes (me mend në kokë). Lexon me vëmendje. Doli me kokë jashtë. Iku me të \katra (me zemër të thyer). Hyri me vrap (me të shpejtë). Vijnë me radhë. E gjetën me shumë vështirësi. E \arritën me përpjekje të mëdha. E*

ngriti me force. E pa me inat. Erdhi me kohë erdhi në kohën e duhur e shpejt. Shkruhet me shkronjë të madhe. Mbledhja u bë me dyer të mbyllura.

6. Mjetin me të cilin a nëpërmjet të cilit kryhet një veprim a një punë. *E preu me thikë. E çau me sëpatë. Korrin me drapër. E punoi me shut (me traktor). Ha me luge. E piu me gotë. Shkruan me laps. Iku me biçikletë. Udhëtuan me tren (me avion). E mbartën me kalë. E nisi letrën me postë (me një shok). Dërgoi lajm me djalin. E bleu me para. Rronte me punën (me djersën) e vet.*

7. Njeriun, sendin a dukurinë, që i nënshtrohet një veprimi a gjendjeje; qenien, gjënë a çështjen me të cilën kemi të bëjmë. *Ngjau një fatkeqësi (një e papritur) me të. Ç'ndodhi më tej me djalin? Si sillet me ju? Sillet shumë mirë me nxënësit. Ç'u bë me perimet? E ka keq me zemrën (me mëlçinë e zezë). S'i ka punët mirë me mësimet. Me planin jemi mirë. U vonuan pak me të mbjellat (me korrjet). Luftojmë me vështirësitë (me thatësirën, me ngricën, me shfaqjet e huaja). Do t'ia dalim mbanë edhe me zotimet e reja. U mësua me punën e re (me të ftohtët, me vapën).*

8. Kufizim për dike a për diçka, përcaktimin se nga ç'anë e shohim a e vlerësojmë atë etj. *I vogël me trup, por i madh me zemër. Sheh vetëm me njërin sy. Shitej me peshë (me cope). Me shtëpi (me banesë) është në Shkodër. Me sa thuhet (dihet)... Me sa me kujtohet...*

9. Gjendjen në të cilën ndodhet ose vihet dikush a diçka. *Është me leje (me pushime). Është me barrë. Ishte me ethe (me grip). U mbulua me lavdi. E bëri me turp. E vuri me shpatulla në mur. E la me gisht në gojë. Ishte me kokë në torbë. Qëndroi me shpirt ndër dhëmbë.*

10. Shkakun ose arsyen e një veprimi a të një gjendjeje ose llojin e veprimeve që kryejmë për t'ia arritur një qëllimi. *Me atë shi që ra s'ka se si të mos rritet bari. Me ato pengesa që u dolën s'kishin si të mos vonoheshin. Me atë mendje që ka do ta pësojë keq. Me shpenzimet që bënte do të shkatërrohej një ditë. Me atë sëmundje që kishte do të vdiste shpejt. Me atë vullnet që ka (me ato përpjekje që bën) do t'ia dale mbanë pa tjetër.*

11. Qëllimin a synimin e një veprimi. *Erdhi me qëllime të mira (të këqija). V paraqit me kërkesa të reja. E bëri (u nis) me shpresë se do të fitonte.*

12. Kohën a diçka tjetër, nga e cila nis një veprim ose së bashku me të cilën zhvillohet një veprim, shfaqet një dukuri etj. *Që me ditët e para (me fëmijërinë). Vajti e u kthye me diell. U zgjua me natë. Fjeti me pulat ra për të fjetur shumë herët. E zgjati (e shtyu) me sot me nesër. Me dimrin vjen të ftohtët. Me pranverën kthehen dallëndyshet. Me çlirimin e Shqipërisë filloi një epokë e re. Shkoi vapa me gushtin. fj. u. Me pleqërinë i erdhën edhe sëmundjet. Me kohë do të kalojë. Është me moshë çdo gjë. Puna është me ditë (me orë).*

13. (edhe me numërorë) Sasi ose masë të caktuar a të pacaktuar, të përafërt, të madhe etj. *Klasë me tridhjetë nxënës. Dhomë me dy dritare. Ndërtesë me shtatë kate. Shtëpi me tri ndarje. Familje me pesë veta. Punonin me qindra të rinj. Erdhën me dhjetëra punëtorë. Kafe me shumë sheqer. Ka atje me okë (me thasë, me kuintalë, me qerre) ka shumë.*

14. Krahasimin e një numërori themelor, që vihet në një marrëdhënie të caktuar me një tjetër. *Në përpjesëtimin dy me tre. E shumëzohmë (e pjesëtojmë) me shtatë.*

15. Kohë, mënyrë etj., në togje që formohen nga përsëritja e një fjale ose nga dy fjale të afërta. *E prisnin dita me ditë (me sot me nesër). V ndeshën trup me trup.*

II. pj. 1. Përdoret me një emër foljor asnjans për të formuar një trajtë të pashtjellë, me kuptimin kohor, «sapo, sa». *Me të dëgjuar thirrjen, u ngrit. Me t'u kthyer nga puna, u la. Me t'u gdhirë, nisën zhurmat.*

2. Përdoret zakonisht në të folmet e Veriut me pjesoren për të formuar një nga trajtat e paskajores. *Me qenë. Me marrë. Me dale.*

Me anën e... shih tek AN/Ë,~A. *Me kusht që...* shih te KUSHT,~I. *Me përjashtim të...* shih te PËRJASHTIM, ~I.

* * *

Kur duam të shqyrtojmë lëvizjen kuptimore të brendshme (si dukuri e polisemisë), por edhe atë të jashtme (si proces i fjalëformimit dhe i motivimit semantik), duhet të kemi parasysh se **zhvillimi semantik ka shumë shkallë, kurse formimi i kuptimit leksikor ka dy caqe**, - një cak të fillimit, kur ky nis “të buthtojë” dhe një cak të fundit, kur është kristalizuar plotësisht. Brenda këtyre caqeve, që përfshijnë lindjen e një numri të caktuar përbërësish semantikë të kuptimit, që nënkuptojnë edhe “një copë kohe” të përfshirë ndërmjet tyre, bëhet formimi i plotë i kuptimit leksikor, kristalizimi i tij si i tillë. Për ta marrë vesh kuptimin e ri, atëherë, nuk ka më nevojë t’i drejtohesh kuptimit prej nga ka ardhur. Para caktit të fillimit mund të kemi nuancë, një përdorim të figurshëm të fjalës ose vetëm një përbërës semantik shtesë, për të cilët duhet t’i drejtohem kuptimit të mëparshëm.

Lëvizja kuptimore del si dukuri që lidhet me emërtimin, *si lëvizje e realieve nën të njëjtën fjalë emërtuese dhe përgjithësisht lëvizjet kuptimore bëhen sipas disa figurave gjuhësore*, që në gjuhësi e në stilistikën letrare janë quajtur **trope**. Figurat gjuhësore në vetvete nuk janë të veçanta për çdo gjuhë, as për shqipen, porse shfaqja e tyre konkrete, në fjalë të ndryshme, ka veçanti për secilën gjuhë. Si trope më kryesore, më të zakonshme, do të përmendim *metaforën, metoniminë, sinekdokën*.

Metafora është mjeti më i shpeshtë dhe më kryesori në këtë proces. Metaforë kemi kur emërtimi i një realie, kalon si emërtim edhe në një realje tjetër në bazë të ngjashmërisë. V. Memisha vëren se nga lënda leksikore që kemi në dorë në këta dhjetëvjeçarët e fundit, vërejmë, gjithashtu, se shqipja është në një fazë **metaforizimi** shumë të fuqishëm, prirje kjo e gjuhëve me stile funksionale shumë të përpunuara. Strukturat minimale ku ndodh ky metaforizim (jo metaforizim në kuptimin e ngushtë, por si lëvizje kuptimore përfshirëse) sendërtojnë bashkëlidhje të shumta fjalësh dhe pasurojnë me valenca të reja semantike strukturat e tyre. Por ky proces metaforizimi ka karakterizuar gjithë zhvillimin semantik të fjalëve të shqipes, ashtu si edhe të greqishtes në rrjedhën e shekujve.

Por në një koncept më të gjerë metafora është nocion përfshirës, ajo nënkupton vetë lëvizjen kuptimore dhe të gjitha tropet e tjera gjuhësore interpretohen dhe ftillohen brenda saj. Kjo nënkupton që edhe vetë metafora, metonimia, sinekdoka, si dhe antonomazia të jenë bashkëhiponime të hiperonimit metaforë.

Siç kemi theksuar në vazhdimësi, ne për të gjitha analizat semantike jemi mbështetur në strukturat kuptimore të fjalëve të pasqyruara në fjalorë fjalorë shpjegues të shqipes dhe të greqishtes. P.sh., në realizimin e strukturën kuptimore të fjalës greminë (në shqipe) mund të zbulojmë dy procese kryesore: kuptimi 2 është krijuar me **metonimizim** (që është proces semantik i realizuar me tropin gjuhësor të *metonimisë*¹³²),

¹³² *Metonimia* është një figurë e rëndësishme e tipit semantik, e cila përdor një detaj ose një koncept për të dhënë një ide ose një objekt me të cilët ka lidhje kuptimore, logjike, dhe **kuptimi transferohet nga një fjalë tek një fjalë tjetër në bazë të një lidhjeje shkaku, hapësire ose kohe**. Kështu përdoret lënda për enën dhe anasjelltas; shkaku për pasojën dhe anasjelltas; abstraktja për konkretën dhe anasjelltas; autori për veprën; simboli për atë që simbolizohet (nderoj flamurin për nderoj atdheun) etj. Kemi lëvizje kuptimore

kurse kuptimi 3 është realizuar me metaforizim (që është proces semantik i realizuar me tropin gjuhësor të *metaforës*).

GREMÍN/Ë, ~A *f. sh.* ~A, ~AT. 1. Vend (grope, përrua etj.) i thellë me anë të thepissura, zakonisht në mal, në mes shkëmbinjve etj.; humnerë, hon. *Greminë e thellë. Greminat e maleve. Në fund të gre-mines. Ra në greminë.*

2. *fig.* Shkatërrim i plotë, humbje, zhdukje. *Shkoi në greminë. Ecën drejt greminës.*

3. *fig.* Hendek i thellë që ndan forcat a grupet e ndryshme shoqërore, dallim i madh. *Greminë klasore. I ndan një greminë.*

Kurse te struktura kuptimore e fjalës **Gomar** zbulojmë vetëm procesin e metonimizimit, qoftë në formimin e kuptimit të dytë, qoftë në atë të kuptimit të tretë:

GOMAR, ~I *m. sh.* ~Ë, ~ËT. 1. Kafshë një-thundrake, që mbahet në shtëpi për ngarkesë, me trup me të vogël se kali, me kokë të madhe, me veshë të gjatë dhe me qime zakonisht në ngjyrë të hirtë. *Veshët e gomarit. Kërriç gomari. Ngarkoj gomarin. Palli gomari. I bie gomarit. Punon si gomar punon shumë. Duron si gomar duron shumë. Këndon si gomar këndon keq.*

2. Sasia e barrës a ngarkesa që mban kjo kafshë. *Një gomar dru.* 3. *fig. thjeshtligj., shar.* Njeri i trashë nga mendja, budalla; hajvan. *Gomar i madh. Mori mendjen e atij gomari. Ç'gomar qenka! Gomar me veshë. thjeshtligj., keq.*

Po kështu tek fjala *shkop*, huazim nga greqishtja e vjetër, kemi procese të ndryshme të lëvizjes kuptimore që shfaqet si zgjerim i aftësisë shënuese të fjalës që ka hyrë me kuptimin e parë nga kjo gjuhë: Kuptimi 2, 3, 4, 7 dhe 9 kanë lindur përmes metaforizimit (me tropin *metaforë*, kemi ngjashmëri fizike), kurse kuptimi 5, 6 dhe 8 kanë lindur përmes metonimizimit (me tropin *metonimi*, kemi mjetin për pasojën).

SHKOP, ~I *m. sh.* ~INJ, ~INJTË. 1. Një cope dru i hollë e i gjatë, që shërben për t'u mbështetur kur ecim, për të goditur a për punë të tjera, *Shkop i gjatë. Shkop thane. Shkopi i bariut. Kërcim me shkop. sport. Shkop e cingël lojë fëmijësh, cingëlthi. I rrëfeu shkopin. E zuri (e rrahu, i ra) me shkop. Kullot dhentë me shkop e shfrytëzoj kullotën ngastra-ngastra, nuk i lëshoj dhentë të kullotin nga të duan. Kullot dhentë pa shkop i lëshoj dhentë të kullotin nga të duan. Kur s'ke shokun, pyet shkopin. fj. u.*

2. Mjet a send i hollë, i gjatë e i rrumbullakët prej druri, prej gome etj., që përdoret për qëllime të ndrysh-më. *Shkopi i stafetës. sport. Shkop gome mjet prejgome të forte, i gjatë e i rrumbullakët, që e përdorin policët në vendet kapitaliste për të shpërndarë demonstratat e masave punonjëse.*

3. Bastun. *Ecën me shkop.*

4. Kunj i drunjtë që bashkon shtizën e parmendës me veshët. *U thye shkopi.*

5. *fig. bised.* Një e qëlluar me dajak a me dru, goditje. *I tregoj (i rrëfej) shkopin. Ai do një shkop të mirë. I dhanë (hëngri) tridhjetë shkopinj.*

6. *fig. bised.* Qortim i rëndë; detyrim me force, dhunë; kërcënim. *Me shkop me detyrim, me dajak. Disiplina e shkopit. Bien shkopinj të mb i dike.*

me metonimi kur një fjalë përdoret për një fjalë tjetër me të cilën ajo është e lidhur, kur një person, një objekt ose një fakt nuk emërtohet drejtpërdrejt me emrin e vërtetë, por me anë të një emri tjetër me të cilin ka lidhje kuptimore të logjikshme varësie. Sipas J. Thomait, metonimia është në përgjithësi një rrugë e zgjerimit të kuptimit, si një lëvizje nga shkaku te pasoja dhe anasjelltas: për shkak të enës quhet ashtu edhe përmbajtja, për shkak të tiparit quhet ashtu edhe sendi që e ka atë tipar, për shkak të veprimit quhet ashtu edhe rezultati i tij etj. Shih më gjerë J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2009, f. 120

7. *vet. sh.* Dy thupra të vogla që përdoren zakonisht në vendet e Azisë Lindore e Juglindore për të ngrënë gjellë të ndryshme. *Hani oriz me shkopinj.*

8. *fig. keq.* Njeri i trashë nga mendja, hu. *Është shkop ai.*

9. *përd. mb.* Shumë i dobët (nga trupi). *Ishte bërë shkop!*

* * *


Një fjalor shpjegues ndërtohet duke u mbështetur në disa parime kryesore¹³³. Nisur nga synimi i punimit dhe nga problematika e tij ne po veçojmë disa nga këto parime, ndër të tjera: *mënjanimi i ambiguitetit* (këtu do të theksonim zbulimin dhe përcaktimin e saktë të kufirit të kuptimeve në një fjalë polisemike dhe të homonimisë me prejardhje etimologjike, si shpërbërje e polisemisë¹³⁴), *përcaktimi i saktë i sinonimisë* (në një fjalor shpjegues sinonimet dalin si mjet i mirëfilltë shpjegues, ose si mjet shpjegues plotësues), *vendosjen e saktë të lidhjeve kuptimore të fjalëve* (sidomos si lidhje të kushtëzuara, por edhe të pakushtëzuara, si ato të barazisë, të afrisë, të kundërvënies etj.), si dhe *nxjerrja e vlerave të fjalëve* duke dhënë brenda strukturës kuptimore të fjalës edhe një sintagmatikë të domosdoshme përmes ilustrimeve me thënie a me shembuj.

Vendosja e saktë e lidhjeve kuptimore të fjalëve shpërfaqet drejtpërdrejt në strukturën hierarkike të një fjalori shpjegues. Vetë kjo strukturë shihet si një nga relacionet leksiko-semantike më të njohura dhe më të rëndësishmet në gjuhë. Relacionet semantiko-leksikore janë elemente qendrore në organizimin e sistemit të njohurive leksikore e semantike dhe luajnë rol thelbësor në semantikën leksikore, duke pasur peshë përcaktuese në ndërtimin, në krijimin dhe në të kuptuarit e komunikimit gjuhësor.

Mbiemri *i pastër* në gjuhën shqipe ka këta skemë derivimi:


¹³³ Shih më gjerë: A. Kostallari, Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, II, Tiranë, 1972; J. Thomai, *Leksikologjia...* 2009 etj.

¹³⁴ J. Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009



Por zhvillime të brendshme semantike mund të ndodhin edhe te pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, si p.sh., te parafjalët. Edhe këtu duket sikur kemi huazim të strukturave kuptimore, por më shumë kemi zhvillime të pavaruara, të brendshme në secilën gjuhë. Afëritë semantike duhen kërkuar te afëritë në mendesinë dhe në veprimtarinë e dy popujve.

Parafjala *me*, grafikisht mund të paraqitet në skemën e një tufe kuptimore, sepse në fjalët shërbyese struktura kuptimore është e errësuar dhe nuk mund të ndiqet lëvizja kuptimore dhe të zbulohen semantemat apo llojet e ndryshimeve kuptimore:



Skemat e mësipërme të derivimit a të lidhjeve të kuptimeve me njëri tjetrin janë mbështetur dhe ndryshimet që ndodhin gjatë lëvizjes kuptimore, e cila lidhet me ndryshime në katër llojet e përbërësve të kuptimit: *të ruajtur*, *të zhdukur*, *të ndryshuar* e *të lindur*. Dihet që çdo fjalë e huazuar nga greqishtja në shqipe apo e kundërta, ka *një kuptim fillestar*, me të cilin ka hyrë në përdorim që me lindjen e saj. Prej këtij kuptimi, mund të ketë dalë një kuptim tjetër, i cili ndaj kuptimit fillestar është *i prejardhur*. Ky proces mund të vështrohet edhe si tipologji lëvizjeje, por duke parë edhe mjetet e realizimit të kësaj lëvizjeje semantike.

Nëse te parafjala *me* kemi në gjendje të sotme të fthillimit të lëvizjes kuptimore, vetëm një temë motivuese, kuptimin e parë (madje edhe ky nuk del si semantemë e mirëfilltë), mund të themi se te mbiemri *i pastër (në shqipe)* kemi një strukturë të ndërlikuar, me lëvizje horizontale, vertikale dhe të përziera. Te kjo strukturë dallojmë katër semantema që motivojnë ose një kuptim, ose tufa kuptimore: kuptimi 1 (motivon kuptimin 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8), kuptimi 3 (motivon kuptimin 11, 15) kuptimi 7 (motivon kuptimin 9, 10, 12, 13, 14), kuptimi 15 (motivon kuptimin 16).

Nëse do të mbështeteshim tek të tri rrugët e lëvizjes së brendshme kuptimore, që njohen edhe në shqipe e në greqishte (por edhe në gjuhë të tjera), ne i ndeshim ato që të gjitha në strukturat kuptimore të huazimeve nga greqishtja: **zgjerim kuptimi, ndërrim kuptim, ngushtim kuptimi**.

Po japim për ilustrim dy shembuj ku kemi ngushtim dhe zgjerim kuptimi, kur në të dy rastet kemi procesin e metaforizimit:

MURGËSH/Ë,~A f. sh. ~A, ~AT. Fem. e MURG,~U. Murgeshë e re (plakë). Kuvend (shkollë) murgeshash. E zbehtë si murgeshë.

* **Ka zemër murgeshë** ka mëshirë e keqardhje kristiane për këdo pa përjashtim, nuk e ndan të mirin nga i ligu.

MURGËSH/Ë,~A f. sh. ~A, ~AT zool 1. Flutur e madhe me shirita të zinj e njolla të zeza në krahë dhe në bark, vemja e së cilës njihet si dëmtues i drurëve e sidomos i pishave.

2. Kandërr fluturuese që e ndryshon ngjyrën sipas mjedisit, me trup shumë të gjatë, me kokën trekëndëshe e shumë të lëvizshme, me sy të dale, me dy pale krahë të hollë, me të cilët, duke i fërkuar bën një zhurmë.

MÚRG/Ë,~A I f. sh. ~A, ~AT. 1. fet. Murgeshë. *U bë murgë.*

2. *bised.* Vajzë a grua që ka mbetur e shkretë, e vetme, pa njeri; vajzë a grua e mjerë, që bën një jetë të rëndë. *Murga e shkretë (e mjerë)! Ç'e gjeti, murgën! Hoqi të zitë e ullirit, murga!*

* **Rrinte si murga** në linjë rrinte pa folur asnjë fjalë, rrinte e heshtur dhe e shushatur.

MÚRG/Ë,~A II f. Llumi i vajit që bie në fund të enës, fundërrri vaji; lëngu i errët që del kur shtypin ullinj të. *I heqin murgën (vajit). Murgën e përdorin për sapun.*

Në huazimet nga greqishtja, siç jemi shprehur nuk është i panjohur edhe dukuria e ndryshimit të kuptimit. Fjala **σκύλος (o) / qen,-i** në shqipe emërton *dhelprën* si gjitar i egër mishngrënës a njeriun dinak.

SKÍL/E,~JA /. sh. ~E, ~ET. 1. *zool.* Dhelprë. *Lëkurë skileje. Strofka e skiles. Këlyshët e skiles.*

2. *fig.* Njeri dinak, dhelprë. *Skile e vjetër.*

σκύλος (o) (πβ. λ. σκυλί") 1. κατοικίδιο σαρκοφάγο θηλαστικό ζώο, που εμφανίζεται σε διάφορους τύπους και έχει πολλαπλή χρησιμότητα (κυνήγι, φύλαξη ανθρώπων ή ποιμνίων, καταδίωξη κακοποιών, εντοπισμό βομβών ή ναρκωτικών, συνοδία τυφλών κ.ά.): - *κυνηγετικός | σαλονιού | συνοδίας*- ΦΡ. (α) *σαν τον σκύλο με τη γάτα* για τη σχέση ανθρώπων που καβγαδίζουν συνεχώς: *τρώγονται ~* (β) *σκύλος που γαβγίζει δεν δαγκώνει* βλ. λ. *γαβγίζω (γ) και την πίτα ολόκληρη και τον σκύλο χορτάτο* βλ. λ. *πίτα (δ) εγώ το λέω τού σκύλου μου και ο σκύλος στην ουρά του* για πράξεις ή καθήκοντα που μεταβιβάζονται από τον έναν στον άλλον, με αποτέλεσμα να μην εκτελούνται ποτέ (ε) *μπάτε, σκύλοι, αλέστε κι αλεστικά μη δώσετε* βλ. λ. *αλέθω (στ) το φτηνό το κρέας το τρων' οι σκύλοι* βλ. λ. *κρέας*

2. (ειδικότ.) το αρσενικό αυτού τού ζώου (θηλ. σκύλα)

3. (μτφ.) άνθρωπος σκληρός και άγριος που δεν συμβιβάζεται

4. (μτφ.) αυτός που είναι ακούραστος: *δουλεύει σαν ~*

5. το σκυλόψαρο, μικρός καρχαρίας.

[ETYM < μτγν. σκύλ(λ)ος (όπως παραδίδεται στη “γλώσσα” τού Ησυχίου σκύλλον την κόνα λέγουσιν) < αρχ. σκύλαξ, -ακος “μικρός σκύλος, κουτάβι” (με

μεταπλασμό κατά τα ουσ. σε -ός), εκφραστ. λ., με επίθημα -αζ (πβ. βεῖρ-αζ, δέλω-αζ), που πιθ. συνδ. με λιθ. skalikas “κυνηγόσκυλο”, kale “σκύλα”. Σύμφωνα με άλλη πρόταση, η λ. Ανάγεται σε θ. *skul-, μηδενισμ. βαθμ. τού I.E *(s)kyel-, αλλά τα παράγωγα αυτής τής ρίζας (λ.χ. αρχ. ισλ. skval “απεραντολογία”, skvala “φονάζω δυνατά”) απέχουν σημασιολογικώς. Κατ’ άλλη άποψη, η λ. θα μπορούσε να αναχθεί στο θ. σκυ- τού αρχ. σκούζω | -ομαι (βλ. λ. σκούζω) με εσφαλμ. μορφολ. χωρισμό τού ρ. (δηλ. σκού-ζω αντί *σκύδ^ω). Τέλος, έχει προταθεί η σύνδεση με αρμ-cul “μικρός τάυρος”, άποψη που παρουσιάζει σημασιολ. δυσχέρειες].

Nga sa pamë në këtë syth, lëvizja kuptimore del si *kondensim semantik dhe ai tregon se shqipja dhe greqishtja kanë prirje të forta sintetizimi si në strukturë, ashtu edhe në brendi*. Kondensim semantik kemi edhe çdoherë që kalohet nga kuptimi konkret (lëndor) në kuptim abstrakt (të figurshëm), pasi rritet shkalla e përgjithësimit, thellohet abstraktimi. Meqë prejardhja semantike shkon zakonisht nga kuptime konkrete në abstrakte, nga të drejtpërdrejta në të figurshme, atëherë mund të themi se *rruga e prejardhjes semantike është edhe rruga e kondensimit semantik*. Kjo nuk mohon plotësisht të kundërtën, pasi ka edhe raste kur prejardhja semantike kalon nga kuptime abstrakte në kuptime konkrete (fjala vjen, tek emrat e veprimit në kuptimin e parë, të veprimit sipas foljes, prej nga rrjedh kuptimi i dytë, i rezultatit të veprimit).

Kondensim të madh kuptimor fjalët arrijnë sa më shumë t’i zgjerojnë lidhjet sintagmatike, ato fitojnë kështu një kuptim shumë të përgjithshëm, me dendësi të madhe, por, si të thuash, “pa ngjyra të theksuara”, pra, shumë herë të papërcaktueshëm qartë. Kondensimi semantik shfaqet kështu edhe përmes një përgjithësimi e abstraktimi më të lartë; përmbajtja leksikore e fjalës në këtë rast zgjerohet: sasia e përbërësve semantikë vërtet ulet, kurse vëllimi i realieve që mbulon ky kuptim rritet.¹³⁵

¹³⁵ J. Thomai, *prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f.

2. RELACIONET SEMANTIKE TEK HUAZIMET GREKE NË SHQIPE

Në studimet për semantikën leksikore të shqipes, J. Thomai pranon dy ndarje të mëdha të lidhjeve semantike ndërmjet fjalëve: lidhje semantike *të kushtëzuara* dhe lidhje semantike *të pakushtëzuara*. Sipas këtij studiuesi, *të kushtëzuara* janë lidhjet semantike që zbulohen gjatë prejardhjes kuptimore në formimin i njësisve kuptimore, si dhe lidhjet kuptimore ndërmjet fjalëve të parme e fjalëve jo të parme brenda një çerdheje fjalëformuese etj. Kurse *si lidhje semantike të pakushtëzuara* njihet lidhjet semantike ndërmjet fjalëve që nuk vijnë nga njëra-tjetra, as si formim e as si kuptim, pra, ndërmjet fjalëve të ndryshme pa lidhje prejardhjeje, por që kanë një bosht kuptimor të përbashkët e mund të grupohen për këtë arsye në një klasë leksikore. Lidhjet semantike të pakushtëzuara janë dyfarëshe: lidhje barazie dhe lidhje ngjashmërie.

Tipat e ndryshme të marrëdhënieve semantike mund të identifikohen në më lehtë në leksemat e një fjalori shpjegues. Ato zbulojnë "*marrëdhënie barazie, marrëdhënie hierarkike dhe marrëdhënie shoqërimi*" Këtu menjëherë kuptohet se jemi në një hapësirë psikolinguistike: marrëdhënie shoqërimi njihen ato që vendosen ndërmjet marrëdhënieve të tilla si *shkak* dhe *pasojë (aksident / plagosje)*, *veprim* dhe *produkt (shkrim / botim)*, *lëndë e parë* dhe *produkt (rrush / verë)* etj.

Në një këndvështrim më të gjerë, relacionet leksiko-semantike kryesore mund të jenë:

A: *Relacionet paradigmatiche*, ku do të përfshiheshin

1. *Relacioni leksikor sinonimik* që është marrëdhënie (lidhje) horizontale ndërmjet dy a më shumë njësisve leksikore që i kanë *të njëjtë* përbërësit më të rëndësishëm (thelbësorë) dhe ndryshojnë vetëm në përbërësit plotësues apo dytësorë (anësorë). Relacione të tilla ndërmjet dy a më shumë njësisve leksikore shihen si lidhje semantike të pakushtëzuara të barazisë ose të afrisë. Ndaj, nëse do ta paraqitim në mënyrë algjebrike këtë relacion, do të kishim $X = / \sim Y$, ekuacion ku shenja e barazimit (=) na shpie te sinonimia e plotë (te sinonimia absolute), kurse tilda (~) na shpie te sinonimia e përafërt.

STOLÍS kal. 1. Zbukuroj me stoli (nusen etj.). **Nis**. E bëjnë nuse, e nisin me tel, i vënë xhevahiret dhe e shpien te burri. (Folk.). **Ndreç** bised. **Rregulloj** bised. **Teletis** stolis nuse me tela. **Telis** stolis nusen me tela. **Ujdis** bised. - Çupën e ujdin gratë. Mirë është t'i japësh diçka gruas që e bën nuse çupën. (Ligj. fol.). **Godit** krahin. **Stis** bised. **Ormis** krahin. 2. edhe fig. → **Zbukuroj**₁ jokal.

STOLÍSEM. Vetv. e **Stolis**. 1. **Nisem**. **Ndreçem** bised. **Rregullohem** bised. **Teletisem**. **Telisem**. **Ujdisem** bised. **Goditem** bised. **Stisem** bised. Ajo nuk e duron dot diellin dhe mban syze të mëdha, të errëta, stisur me brilante falso. (Let. art. përkth.). **Ormisem** krahin. 2. edhe fig. → **Zbukurohem**₁ vetv.

STOLÍSJ/E,-A f. Veprimi sipas **Stolis**, **Stolisem**. 1. **Ujdisje**. **Nisje**. **Ndreçje** bised. **Rregullim** bised. **Goditje** bised. **Stisje** bised. **Ormisje** krahin. 2. → **Zbukurim,-i**₁ m.

STOLÍSUR (i) mb. Që është stolisur. 1. **Nisur** (i). **Teletisur** (i). **Ujdisur** (i) bised. **Stisur** (i) bised. 2. → **Zbukuruar** (i)₁ mb.

SKELÉT,-I m. 1. anat., zool. Tërësia e eshtrave të trupit të njeriut dhe të kurrizorëve të tjerë; eshtrat e një pjese të trupit. **Eshtëri.** U zbulua në Kinë eshtëria e një dinozauri. (Pub.). **Ashtëri. Ashtërim. Ngrehë.** - Thonë se te ngreha e njeriut ka një pjesë, te shtylla e kurrizit që nuk kalbet asnjherë. (Ligj. fol.). **Zgorre.** - Mishi kalbet, zgorreja mbetet. (Ligj. fol.). **Skurrjalë** eshtrat që mbeten nga trupi pasi kalbet mishi. 2. Shtyllat, harqet dhe pjesët e tjera më të forta e më të qëndrueshme, në të cilat mbahen a mbështeten pjesët e tjera të një ndërtese, të një mjetei etj. **Ngrehë. Trup.** Predhat shkatërruan kompasin, rrëzuan antenën, prishën një varkë shpëtimi dhe dëmtuan tubacionet e trupit të anijes. (Pub.). **Pandë.** - Tani që e bëra pandën, kasollja quhet e mbaruar. (Let. art.). 3. → **Korniz/ë,-a** f. 4. si mb. fig. → **Dobët (i)**₁ mb.

σκελετός (ο) {κ. λαϊκ. πληθ. σκελετά (τα) (σημ. 4)}

1. το σύνολο των οστών που αποτελούν την εσωτερική στερεή δομή του σώματος των ανθρώπων και των σπονδυλωτών ζώων

2. το σύνολο των οστών ανθρώπων ή ζώων που έχουν πεθάνει και βρίσκονται σε κατάσταση προχωρημένης ή ολικής αποσύνθεσης: ~ *προϊστορικών ζώων και ανθρώπων*

3. (μτφ.) άνθρωπος παρά πολύ αδύνατος, ώστε να διαγράφονται τα κόκκαλά του: *γίνομαι | μένω ~ || καταντώ ~ από την αστία | το άγχος | τη στενοχώρια ΣΥΝ. κάτισχνος, πετσί και κόκκαλο ·*

4. το εξωτερικό περίβλημα ενός τεχνικού έργου, που στηρίζει και καθορίζει το σχήμα της κατασκευής: *ο ~ ενός κτηρίου | μιας γέφυρας || μόνο ο ~ του εργοστασίου έμεινε μετά την πυρκαγιά*

5. (ειδικότ.) το πλαίσιο από μέταλλο ή κόκκαλο των γυαλιών ηλίου ή οράσεως, στο οποίο προσαρμόζονται οι φακοί: *γυαλιά με μεταλλικό | χρυσό | κοκκάλινο ~*

6. (μτφ.) το βασικό σχέδιο, τα κύρια σημεία ενός θέματος, τα οποία αναπτύσσονται με λεπτομέρειες σε προφορικό ή γραπτό λόγο: *ο ~ ενός μυθιστορήματος | της ιστορίας | της ομιλίας ΣΥΝ. σχεδιάγραμμα, βάση. ΣΧΟΛΙΟ λ. εμετός.*

[ETYM < αρχ. επίθ. σκελετός “αποξηραμμένος, κατάξερος” (η σημερινή σημ. είναι μτγν.) < θ. σκελε- (τού ρ. σκέλλομαι “ξηραίνω - γίνομαι ισχνός”) + -τός (πβ. *συρφε-τός*). Το αρχ. σκέλλομαι < *σκέλ-ίομαι < θ. *skel-3-, δισύλλ. θ., που ανάγεται πβ. σε I.E. *(s)kel- “στεγνός, ξηρός”, πβ. σουηδ. skall “μπαγιάτικος, λεπτός”, αγγλ. shalloë “ρηχός”, μέσ. άνω γερμ. hei “ασθενής, αδύναμος”, γερμ. hellig “κουρασμένος, στεγνός από δίψα” κ.ά Ομόρρ. *σκλη-ρός* (βλ.λ.)].

Sinonimia mund të vendoset e dhe ndërmjet njësive frazeologjike që motivohen nga një huazim grek në shqipe, si

(Erdhi) **si kofini pas së vjeli (pas të vjelave)** (dikush a diçka) erdhi tepër vonë, pasi ka mbaruar puna, kur s'duhet më, kur s'hyn më në punë; (erdhi) **si koshi pas së vjeli (pas të vjelave)**; (erdhi) **si shirku pas së vjeli** (pas të vjelave) *krahin.*; (erdhi) **si shiu pas së vjeli**; (erdhi) **pas pilafit.** *Nxitohesha për të mos u dhënë shkas atyre që të më thonë: "Ja, dhe ky, një herë që e ftuam, na vjen si kofini pas së vjeli". (Let. art.).*

2. Relacioni leksikor antonimik, që është marrëdhënie (lidhje) horizontale zakonisht ndërmjet dy njësive leksikore që i kanë **të kundërt** përbërësit më të rëndësishëm (thelbësorë). Relacionet leksikoro-semantike antonimike shihen si lidhje semantike të pakushtëzuara. Nëse do ta paraqitim në mënyrë algjebrike këtë relacion, do të kishim **X ↔ Y**, ekuacion ku shigjeta dykahëshe na shpie tek antonimia e mirëfilltë.

PLEKS kal., ~A, ~UR. 1. Thur; gërshctoj; **kund. shpleks. Pleks gërshetin. Pleks gardkin. Pleks një cigare.**

2. *fig. keq.* Thur; ngatërroj. *Pleksin plane djallëzore.*

PLËKSEM *Vetv.* 1. *vet. veta III.* Lidhet keq diçka me një tjetër sa nuk zgjidhet dot, ngatërrohet; *kund. shplekset.* *U pleksën fjet.*

2. *vet. veto III fig.* Gërshetohet; ndërthuret. *Lufta per çlirim u pleks me luftën për drejtësi shoqërore.*

3. Lidhem ngushtë e shoqërohem me dike dhe nuk mund të shkëputem me prej tij; hyj në një çështje që nuk me takon a në një punë jo të mirë; ngatërrohem. *U pleks me një rrugaç. Mos u pleks me të!*

4. *Pës. e PLEKS.*

PLÉKSJ/E,~A *f. sh. ~E, ~ET.* Veprimi sipas kuptimeve të foljeve PLEKS, PLEKSEM. *Pleks]e rrethanash (kushtesh).*

PLÉKSUR (i,e) *mb.* Që është i lidhur me diçka tjetër sa nuk zgjidhet dot, i ngatërruar; i thurur; *kund. i shpleksur.* *Fije e pleksur. Me gërsheta të pleksura.*

3. *Relacioni leksikoro-semantik i shkallëzueshmërisë,* që nënkupton lidhjen (marrëdhënien) ndërmjet njësive leksikore, që, duke u mbështetur në disa tipare semantike të nënvendosjes / mbivendosjes, kanë vlera të ndryshme shënuese. Shembujt këtu mund të jenë të shumtë, sidomos kur jemi në hierarkinë e një institucioni. Psh., në hierarkinë e emërtimeve që lidhen me bësimin ortodoks kemi disa shkallë që lidhen, me emërtimet për institucionet, për klerikët që lidhen me altarin apo me ata që janë jashtë altarit:

PATRIÁRK,~U *m. sh. ~Ë, ~ËT. fet.* Titulli i kryetarit të kishës ortodokse të një vendi; ai që mban këtë titull, patrik (në disa vende ku vepron kisha e krishterë).

PATRÍK,~U *m. sh. ~Ë, ~ËT.* Titulli i kryetarit të kishës ortodokse të disa vendeve; ai që mban këtë titull (në disa vende ku vepron kisha ortodokse). *Patriku i Stambollit.*

ARKIMANDRÍT,~I *m. sh. ~Ë, ~ËT fet.* Titulli më i lartë për murgjit dhe kryetarët e manastireve; titull më i ulët se i dhespotit për priftin që nuk martohet e që është murg (në vendet ku vepron kisha ortodokse).

KRYEPESHKOP,~I *m. sh. ~Ë, ~ËT fet.* Titull me i lartë se ai i peshkopit në hierarkinë kishtarë; i pari i peshkopëve që mban këtë titull dhe që ka nën drejtimin e vet disa peshkopë (në vendet ku vepron kisha e krishterë); kryetari i kishës ortodokse.

PESHKÓP,~I *m.sh. ~Ë, ~ËT. 1. fet.* Kryetari i një dioqeze ortodokse, dhespot (në vendet ku vepron kisha ortodokse).

DHESPÓT,~I *m. sh. ~Ë, ~ËT.* Titull fetar në kishën ortodokse ndërmjet priftit dhe mitropolitit, peshkop; ai që mban këtë titull, kryetar i një dioqeze ortodokse (në vendet ku vepron feja ortodokse; në të kaluarën edhe në Shqipëri).

*E bën dhespotin (priftin, hoxhën) me barrë *tall, shih te BARR/Ë,~A.*

MITROPOLÍT,~I *m. sh. ~Ë, ~ËT.* Peshkop ortodoks, që ushtron pushtetin fetar në një mitropoli; titulli me i lartë i peshkopit në kishën ortodokse; titullari i mitropolisë (në vendet ku vepron kisha ortodokse).

IGUMÉN,~I *m. sh. ~Ë, ~ËT.* Kryetar i një ma-nastiri të murgjve ortodoksë (në vendet ku vepron kisha ortodokse). *Igumeni i manastirit.*

KALLOGJÉR,~I *m. sh. ~Ë, ~ËT. 1.* Murg ortodoks (në vendet ku vepron kisha ortodokse). *U bë kallogjer.*

OSHËNÁR,~I *m. sh. ~Ë, ~ËT. 1. fet.* Murg ose besimtar, që rron i vetmuar e me mundime trupore dhe përpiqet të jetë gjoja i papërlyer për të fituar, sipas paragjykimeve

fetare, hirin e zotit; murg ose besimtar i tillë që është shpallur nga kisha si shenjt (në vendet ku vepron kisha ortodokse). *Jetë oshënar*. *Rron si oshënar*.

DHJAK, ~U *m. sh.* ~Ë, ~ËT. Titull fetar në kishën ortodokse, gradë e ulët fetare në këtë kishë; ai që mbante këtë gradë a këtë titull, ndihmës i priftit në kryerjen e shërbesave fetare (në vendet ku vepron feja ortodokse

IKONÓM, ~I *m. sh.* ~Ë, ~ËT *fet., vjet.* Titulli me i ulët në hierarkinë fetare ortodokse, prift i thjeshtë.

PSALT, ~I *m. sh.* ~Ë, ~ËT *fet.* Ai që këndon psalme në kishë, ai që psal (në vendet ku vepron kisha e krishterë). *Zëri i psaltit. Ishte psalt.*

PSÁLTËS, ~I *m. sh.* ~, ~IT *fet.* Psalt.

πατριάρχης (ο) {πατριαρχών} **1.** αυτός στον οποίο ανάγεται η καταγωγή μιας πάτριας (βλ.λ.), ο αρχηγός γένους, φυλής

2. Π.Ε. καθένας από τους γενάρχες, τους αρχηγούς των φυλών τού ισραηλιτικού λαού, λ.χ. ο Αβραάμ

3. Πατριάρχης (ο) ο τίτλος τού ανώτατου επισκόπου και αρχηγού μιας Ορθόδοξης Χριστιανικής Εκκλησίας· (ειδικότ.) **Οικουμενικός Πατριάρχης** ο Πατριάρχης Κωνσταντινουπόλεως και προκαθήμενος τής Ανατολικής Ορθόδοξης Χριστιανικής Εκκλησίας **4.** (μτφ.) πρόσωπο στο οποίο αποδίδεται η πατρότητα ιδέας, πρακτικής, μεθόδου κ.λπ.: *ο Άνταμ Σμιο είναι ο – τού φιλελευθερισμού ΣΥΝ. πατέρας.* [ETYM. μτγν. < *πάτρια* + *-άρχης* < *άρχω*. Η χρήση τής λ. ως τίτλου στην Κων/πολη και στις υπόλοιπες αυτοκέφαλες Εκκλησίες είναι μεσν.]

αρχιμανδρίτης (ο) {αρχιμανδριτών} ΕΚΚΛΗΣ. **1.** ο ηγούμενος μονής (= μάνδρας) ή ο επόπτης ομάδας μοναστηριών μιας περιφέρειας **2.** άγαμος ή χήρος πρεσβύτερος. ➔ ΣΧΟΛΙΟ λ. *κληρικός*. [ETYM. μτγν. < *άρχι-* (< *άρχω*) + *μάνδρα* «μονή», ο όρος αυτός χρησιμοποιήθηκε αρχικά ως τίτλος τού επόπτη μοναστηριών. Η σημερινή σημ. Είναι μεσν.]

δεσπότης (ο) {-η κ. (λόγ.) -ου (κλητ. δέσποτα) | -ες (κ. λαϊκ. -άδες), -ών (λαϊκ. -άδων)}

1. (καθημ.) ο επίσκοπος: την *ευλογία σου, δέσποτα* ΣΥΝ. μητροπολίτης, αρχιερέας- ΦΡ. (α) (παροιμ.) *καλά είναι τα φαρδομάνικα, μα είν' για δεσποτάδες* για όσους έχουν φιλοδοξίες ανώτερες των δυνατοτήτων τους (β) *λέω τον δεσπότη Παναγιώτη* για περιπτώσεις στις οποίες κάποιος σαστίζει, τα χάνει ή παθαίνει κάτι και υποφέρει: *Το τι τράβηξα μ' αυτή την υπόθεση δεν λέγεται! Είπα τον δεσπότη Παναγιώτη!*

2. αυτός που έχει απόλυτη εξουσία, άρχοντας που κυβερνά αυθαίρετα και απολυταρχικά: *αμείλικτος | τυραννικός | στυγνός* ~ ΣΥΝ. δυνάστης, άρχοντας, αυθέντης, εξουσιαστής, ηγεμόνας, βασιλιάς, κυβερνήτης, κυρίαρχος.

3. (ως προσφώνηση) ο Θεός: *ευλόγησον, δέσποτα!* ΣΥΝ. Κύριος .

4. ΙΣΤ. (στο Βυζάντιο) (α) ο αυτοκράτορας (β) μέλος τής αυτοκρατορικής οικογένειας (πρώτος στην ιεραρχία τού παλατιού) (γ) (κατά τον 13ο αι.) καθένας από τους ανεξάρτητους ηγεμόνες τής Ηπείρου και τού Μυστρά (βλ. κ. λ. *δεσποτάτο*).

5. ο αρχηγός τής οικογένειας και κύριος τού οίκου και (κατ' επέκτ.) αυτός που κατέχει απόλυτα, που έχει την πλήρη κυριότητα πράγματος ΣΥΝ. οικοδεσπότης, νοικοκύρης, σπιτονοικοκύρης, αφεντικό. Επίσης (λαϊκ.) **δέσποτας** (σημ. 1). ΣΧΟΛΙΟ λ. *δούλος, κύριος*.

[ETYM. αρχ. < *δεμ-σ-πότης, συνθ. λ. που ταυτίζεται με το σανσκρ. dampati “οικοδεσπότης”. Είναι αβέβαιο αν το α' συνθ. (*δεμ-σ-) προέρχεται από Ι.Ε. *dem- (από όπου και *dema- “χτίζω - κατοικία”, βλ. λ. *δέμας, δόμος*) με ριζική παρέκταση -s- ή αν πρόκειται για γενική πτώση αρχ. λ. με τη σημ. “σπίτι”. Το β' συνθ. είναι η λ. *πόσις* “ο σύζυγος, ο κύριος (τού σπιτιού)”, που προέρχεται από Ι.Ε. *roti-s, πβ. σανσκρ. patii? “κύριος, ο σύζυγος”, λατ. rotis, γαλλ. rounoir “ισχύς”, αγγλ. roëer κ.ά. Από τη σημ. τού οικοδεσπότη η λ. χαρακτηρίσε αργότερα τον αυτοκράτορα τού Βυζαντίου και, επί Τουρκοκρατίας, τον χριστιανό διοικητή ενός δεσποτάτου. Η εκκλησ. χρήση τής λ. ως προσφωνήσεως τού επισκόπου είναι μεσν. Από την κλητ. *δέσποτα σχηματίστηκε* και τ. ονομαστικής *ό δέσποτας*, πβ. *πατήρ* - κλητ. *πάτερ*, ονομαστική *ό πάτερ*].

επίσκοπος (ο) {επισκόπ-ου | -ων, -ους} ΕΚΚΛΗΣ. Ο κληρικός που φέρει τον υψηλότερο βαθμό τής ιεροσύνης (οι άλλοι δύο: διάκονος, πρεσβύτερος) ΣΥΝ. δεσπότης, μητροπολίτης- ΦΡ. *σχολλάζων επίσκοπος* βλ. λ. *σχολλάζω* (βλ. λ. *κληρικός, ΣΧΟΛΙΟ*). [ETYM. αρχ., αρχική σημ. “φρουρός, επιβλέπων, επιτηρητής”, συνθ. εκ συναρπαγής από τη φρ. *επί σκοπόν*. Η σημερινή σημ. ανάγεται στην Κ.Ε., όπου το *επίθ. επίσκοπος* αποδίδεται στους πρεσβυτέρους κάθε τοπικής εκκλησίας, εναλλασσόμενο στη χρήση με τη λ. *πρεσβύτερος* (βλ.λ.)].

καλόγερος κ. (λόγ.) καλόγηρος (ο) {-ου κ. -έρου | -ων κ. -έρων κ. -ήρων, -ους κ. έρους κ. -ήρους} (καθμ.)

1. ο άνδρας που, επιθυμώντας να αφοσιωθεί στον Θεό, παραμένει άγαμος και διάγει ασκητικό βίο εκτός των πλαισίων τής κοινωνίας, σε ειδική χριστιανική κοινότητα (μοναστήρι) ή και εντελώς μόνος ΣΥΝ. μοναχός, ασκητής ANT. κοσμικός, λαϊκός .

2. (μτφ.-σκωπτ.) ο άνδρας που ζει μονήρη και ασκητική ζωή, που δεν έχει συνάψει γάμο. ΦΡ. (α) (παροιμ.) *το μοναστήρι να 'ν' καλά (κι από καλογήρους βρίσκεις)* βλ. λ. *μοναστήρι* (β) (λαϊκ.) *μπή- κε ο καλόγερος στο φαί* κάηκε το φαγητό, τσίκνισε .

3. μακρόστενο, φορητό έπιπλο με ειδικές εγκοπές ή υποδοχές για το κρέμασμα ενδυμάτων, καπέλων κ.λπ. ΣΥΝ. Κρεμάστρα.

4. απόστημα μέσα σε ιδρωτοποιού θυλάκιο, το οποίο καταλήγει σε εξογκωμένο, κοκκινωπό και οδυνηρό οίδημα στο δέρμα και εμφανίζεται στην περιοχή τού ιερού οστού.

5. NAYT. μικρός βράχος που προεξέχει από την επιφάνεια τής θάλασσας, είτε μεμονωμένος είτε με άλλους παρόμοιους βράχους

ΣΥΝ. σκόπελος • ΦΡ. (αινίγματα) (α) *χίλιοι-μύριοι καλόγεροι σ' ένα ράσο τυλιγμένοι* οι κόκκοι τού ροδιού (β) *μακρυσ-μακρύς | ψηλός - ψηλός καλόγερος και κόκκαλα δεν έχει* ο καπνός (γ) *μακρυσ-μακρυσ καλόγερος και πίτα η κεφαλή του* το φτυάρι τού φούρνου (δ) *ψηλός-ψηλός καλόγερος και πέρα η φωνή του* το καμπαναριό τής εκκλησίας. - (υποκ.) *καλογεράκι* (το) [μεσν.], *καλογερίστικος*, -η, -ο, *καλογερίστικα* επίρρ. [ETYM. μεσν. < μτγν. *καλόγηρος* < *κάλο-* + *-γηρος* < *γήρας*].

διάκος (ο) ο διάκονος (βλ.λ., σημ. 1). [ETYM. μεσν. < μτγν. *διάκων* (κατά το σχήμα *δράκων - δράκος, γέρων - γέρος* κ.τ.ό.), μεταπλασμ. τ. τού αρχ. διακυνος κατά τα τριτόκλιτα σε -ων].

διάκονος (ο) {διακόν-ου | -ων, -ους} 1. ΕΚΚΛΗΣ. ιερωμένος τής Ορθόδοξης Χριστιανικής Εκκλησίας που κατέχει τον κατώτερο από τους τρεις βαθμούς τής ιεροσύνης (οι άλλοι δύο είναι ο πρεσβύτερος και ο επίσκοπος) ΣΥΝ. (λαϊκ.) διάκος 2. (μτφ.) αυτός που έχει αφοσιωθεί σε ένα έργο, που υπηρετεί έναν σκοπό: ~ τής *ειρήνης και τής αγάπης*. ➔ ΣΧΟΛΙΟ λ. *κληρικός*.

[ETYM. αρχ., αβεβ. ετύμου, πιθ. < διακονώ (υποχωρητ.). Αν το δια- θεωρηθεί á συνθ., τότε ίσως η λ. συνδ. με το ρ. *εγκονώ* “υπηρετώ με προθυμία”, για το οποίο υποστηρίζεται ότι < εν + -κονώ < θ. κον-, που συνδ. με λατ. conor “επιχειρώ, προσπαθώ”. Οι παραδοσιακές απόψεις που συνδέουν ετυμολογικά τη λ. *διάκονος* με το ουσ. *κόνις* “σκόνη” ή με το ρ. *διήκω* “φθάνω” δεν στηρίζονται επαρκώς. Η λ. γνώρισε ιδιαίτερη διάδοση στους πρώτους χριστιανικούς αιώνες, αφού στην Κ.Ε. προσδιορίζει τόσο τον εκκλησιαστικό βαθμό υπηρεσίας (πβ. Α' *Τιμόθ.* 3, 8-10, όπου καθορίζονται σαφώς τα προσόντα τους) όσο και γενικότερα κάθε πιστό (π.χ. Μάρκ. 10, 43: *άλλός αν θέλη μέγας γενέσθαι εν ύμῖν εσται υμών διάκονος*). Η λ. πέρασε και σε ξέν. γλώσσες, π.χ. αγγλ. *deacon*, γαλλ. *diacre*, γερμ. *Diakonus* κ.ά.].

PATRIKAN/Ë,~A f. fet. 1. Selia e patrikut; sistem i drejtimit të kishës ortodokse me një patrik në krye.

2. Zona ku shtrihet pushteti i patrikut. *Patrikana e Stambollit*.

MITROPOLÍ,~A f. sh. ~, ~TË fet. Qendra kishtare e një zone ku shtrihet pushteti fetar i peshkopit ortodoks (në vendet ku vepron kisha ortodokse). *Kishat e mitropolisë*.

KRYEPESHKOPÁT/Ë,~A f. sh. ~A, ~AT fet. Dioqeza që drejtohet nga një kryepeshkop; selia e kryepeshkopit (në vendet ku vepron kisha e krishterë).

PESHKOPÁT/Ë,~A f. sh. ~A,~AT fet. Dioqeza ortodokse që ka në krye një peshkop; ndërtesa ku rri peshkopi (në vendet ku vepron kisha ortodokse). *Peshkopata e Ohrit. Peshkopatat e Shqipërisë së Jugut*.

MANASTÍR,~I m. sh. ~E, ~ET. Institution fetar, me prona e ndërtesa banimi rreth një kishe e zakonisht larg qytetit, ku jetojnë, sipas disa rregullash të caktuara, murgj a murgesha; kuvend (në vendet ku vepron kisha). *Pasuria (të ardhurat, tokat) e manastirit. U mbyll në manastir. Sa me afër fshatit të jetë manastiri, aq me të varfër jartë fshatarët. fj. u.*

PSALTÍR,~I m. sh. ~Ë, ~ËT fet. 1. Pjesë e «Dhiatës së vjetër» që përmban 150 psalme, libri i psalmeve.

2. Vend i caktuar në kishë, ka rri psalti kur psal. *U ngjit në psaltir*.

KREU VI

PASQYRIMI LEKSIKOGRAFIK I HUAZIMEVE GREKE NË FJALORËT E GJUHËS SHQIPE

Një nga rrugët e hyrjes së huazimeve greke në shqipe është *dhe ajo përmes gjuhës së shkruar*. Shumë fjalë kanë hyrë nëpërmejt përdorimit të gramatikave dhe të fjalorëve të greqishtes, si vepra themelore, nga qindra e mijëra shqiptarë nëpër shekuj, por veçanërisht 2-3 shekujt e fundit. Këto vepra kanë ndihmuar në zotërimin e greqishtes nga shqiptarët dhe të shqipes nga grekët. Veçanërisht fjalorët janë vepra që pasqyrojnë gjendjen e pasurisë leksikore, semantike, frazeologjike etj. të njërës apo tjetrës gjuhë, si edhe bëhen njëherazi dhe regjistruer historikë të huazimeve, duke u bërë kështu një burim i patjetërsueshëm për studime gjuhësore të shumta, të ndryshme, të pjesshme a të plota.

Greqishtja e shkruar ka një traditë leksikografike rreth 30-shekullore, që është e lidhur ngushtë me vetë historia e saj. Grekët u morën me hartimin e fjalorëve që në lashtësi. Sot në fondin e saj numërohen me mijëra e mijëra fjalorë njëgjuhësh dhe dy- a më shumëgjuhësh, që sjellin jo vetëm fjalë e shprehje, por edhe elemente të kulturës grake në mijëvjeçarë.

Për të parë *burimin dhe kohën e hyrjes së fjalës greke në shqipe* duhet të mbahen parasysh disa faktorë si kontaktet e drejtpërdrejta të shqiptarëve me grekët dhe anasjelltas, kontaktet me veprat historike, letrare kulturore etj. të shkruara në greqishte, por të paktën edhe dy lloj fjalorësh: *fjalorët shpjegues e fjalorët etimologjikë të greqishtes*. Vetëm duke u mbështetur në vepra të tilla ne mund të përcaktojmë se fjalët, për të cilat jemi ndalur disa herë në këtë punim janë apo nuk janë huazime.

Në shekullin XX e në fillim të këtij shekulli në leksikografinë greke janë hartuar vepra shumë të vëllimshme dhe shumë cilësore, nga të cilat mund të veçohen të tilla, si: *Ετυμολογικό Λεξικό της Κοινής Νεοελληνικής* (Fjalori Etimologjik i Gjuhës së Re Greke), i hartuar nga N. Andriotis¹³⁶; *Λεξικό της Κοινής Νεοελληνικής* (Fjalori i Greqishtes së Re)¹³⁷, botim i Institutit të Studimeve Helenistike të Universitetit të Selanikut dhe *Λεξικό της Νέας Ελληνικής* (Fjalori i Gjuhës së Re Greke), Athinë më 2001, i hartuar nga J.Babiniotis¹³⁸. Si vepra të arrira janë vlerësuar edhe fjalorët shpjegues: *Λεξικόν της ελληνικής γλώσσας* (Fjalori i gjuhës greke) i hartuar nga Akademia e Athinës; *Fjalori i madh i gjuhës greke* (me 9 vëllime) i hartuar nga Dh.

¹³⁶ N. Andriotis *Ετυμολογικό Λεξικό της Κοινής Νεοελληνικής*, Selanik, 1951

¹³⁷ *Λεξικό της Κοινής Νεοελληνικής*, Selanik 1998

¹³⁸ Γ. Μπαμπινιώτη, *Λεξικό της Νέας Ελληνικής*, Αθηνών, 2001

Dhimitrakos; *Λεξικόν της Νέας Ελληνικής Γλώσσας (Fjalor i gjuhës së Re Greke)*, 1971, i hartuar nga I. Stamatakos; *Λεξικόν της νέας ελληνικής γλώσσας, ορθογραφικόν και ερμηνευτικόν (Fjalor i gjuhës së re greke, ortogragik dhe etimologjik)*, i hartuar nga Πρωΐα; *Νέο Ελληνικό Λεξικό (Fjalor i greqishtes së re)*, i hartuar nga E. Kriara, në Athinë, 1995 etj.¹³⁹

Greqishtja, si një nga gjuhët me dokumentimin më të vjetër në botë, spikat edhe për një pasuri të madhe fjalorësh etimologjikë. Në punimin tonë, sidomos për të parë edhe huazimet shqipe në greqishte ne u jemi referuar veprave të tilla si: *Ετυμολογικόν Λεξικόν της ελληνικής γλώσσας (Fjalor etimologjik i gjuhës greke)*, i hartuar dhe i botuar nga P. K. Dhorbaraqis, Athinë 1963; *Ετυμολογικό λεξικό (Fjalor etimologjik)*, i hartuar dhe i botuar nga K. Dhangjitsis; *Νεοελληνικό ετυμολογικό και ερμηνευτικό λεξικό (Fjalor i gjuhës së re greke etimologjik dhe shpjegues)*, i hartuar dhe i botuar nga A. Fillos; *Το Μεγάλο Ετυμολογικό Λεξικό της Νεοελληνικής Γλώσσας (Fjalori i madh etimologjik i gjuhës së re greke)*, i hartuar dhe i botuar nga J. Kullaqis, në Athinë në vitin 1993 si dhe Γ. Μπαμπινιώτη¹⁴⁰. Ne jemi mbështetur te një nga veprat leksikografike më të mira të fondit leksikografik të greqishtes, në *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας, με σχόλια για τη σωστή χρήση των λέξεων ερμηνευτικό, ετυμολογικό, ορθογραφικό, συνώνυμων - αντιθέτων, κύριων ονομάτων, επιστημονικών ορων, ακρωνυμίων; με αξιοποίηση τού γλωσσικού αρχείου; Αθηνών, 2002*, të hartuar nga Γ. Μπαμπινιώτη etj.

Shumë fjalë e njësi frazeologjike që lidhen sidomos me botën shpirtërore, me kulturën dhe letërsinë e pasur greke, besojmë se kanë hyrë në gjuhën shqipe edhe nga puna me fjalorë greqishtes.

Njësitë leksikore, semantike dhe frazeologjia që kanë hyrë nga greqishtja në gjuhën shqipe, i gjen të pasqyruara dhe në fjalorët e ndryshëm të shqipes, qofshin në fjalorët dygjuhësh qofshin në ata njëgjuhësh (shpjegues). Leksikografia shqipe ka një histori 400-vjeçare dhe rreth 500 fjalorë dygjuhësh dhe njëgjuhësh.

Për të gjykuar rreth vlerave të një fjalori së pari duhet të kemi parasysh ndërtimin e tyre të brendshëm, *makrostrukturën* dhe te *mikrostrukturën*¹⁴¹, qoftë te një fjalor njëgjuhësh apo fjalor dygjuhësh, qoftë shpjegues apo terminologjik, qoftë i shtypur apo formës elektronike¹⁴².

Në fjalorët e shqipes të botuar këta 60-70 vjetët e fundit gjejmë huazime që janë zgjedhur sipas parimeve të hartimit të vetë veprës.

¹³⁹ Shih më gjerë për këtë syth Bibliografinë shkencore, në fund të punimit.

¹⁴⁰ Shih më gjerë për këtë syth Bibliografinë shkencore, në fund të punimit.

¹⁴¹ **Makrostruktura** në një fjalor dygjuhësh nënkupton ndërtimin i fjalorit në tërësi: fjalësin ose listën e fjalëve a të njësie frazeologjike gjuhës së parë, strukturën kuptimore të fjalëve a të njësie frazeologjike (të rrudhosura në krahasim me një fjalor shpjegues), trajtat plotësuese të fjalëve, shënimet gramatikore, stilistike e për fushën e përdorimit, thëniet e shembujt etj. si dhe fjalët e njësitë frazeologjike gjegjëse te gjuhës së dytë. Makrostruktura është “ndërtesa” në tërësi e fjalorit, kurse **mikrostruktura** e fjalorit është ndërtimi i çdo njësie leksikografike veças, ç’përmban ai që quhet “zë leksikografik”. Si makrostruktura, edhe mikrostruktura varen nga tipi e nga synimi kryesor i fjalorit. Shih më gjerë J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 308

¹⁴² Për tipet dhe llojet e fjalorëve, shih edhe V. Memisha, *Rreth një fjalori shkurtesash në gjuhën shqipe*, në “Seminari I Ndërkombëtar i Albanologjisë”, Ohër, 2007, f.

Së pari në një fjalor kombëtar do të gjejmë fjalë huazime nga greqishtja, që i tashmë takojnë *leksikut të përgjithshëm*, që kanë karakter mbarëkombëtar dhe që përfshihen në leksikon normativ të shqipes standarde. Ne kemi dhënë me dhjetëra e dhjetëra shembuj të marra nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, 1980. Fjalët mund të jenë të veçanta, por edhe si elemente përbërëse të fushave paradigmatiche fjalëformuese. Shembujt në vijim e tregojnë këtë.

AKÓMA ndajf. 1. Deri në kohën kur flasim, ende. *Punon (rron) aicoma. Akoma s'është gati (nuk ka ardhur). Është akoma fëmijë. Është akoma dimër. Akoma s'është gdhirë.*

2. Edhe më, edhe ca, më tepër. *Ha (merr) akoma. Ka akoma. Do akoma?*

3. Edhe më shumë, më tepër (me shkallën krahasore të mbiemrave e të ndajfoljeve). *Akoma më shumë (më tepër, më pak). Akoma më i madh (më i mirë, më i ftohet).*

4. *bised., iron.* Përdoret me një mohim për të treguar se nuk shqetësohemi për të keqen që mund të ndodhë ose për të dëshiruar një të keqe. *Akoma s'është thyer! Akoma s'ka thyer qafën!*

***Akoma ti?! a)** përdoret për të treguar se puna për të cilën na pyesin ka mbaruar prej kohësh; **b)** përdoret për të treguar se kërcënimi që na bëhet nuk na tremb. **Është akoma (ende, hala) tek ura iron. shih tek UR/Ë, ~A i.**

MOLÉPS kal., ~A, ~UR. 1. I ngjit dikujt një sëmundje; përhap mikrobe tek të tjerët a në një mjedis të caktuar; ndyj me fëlliqësira, me gjëra që kanë mikrobe etj.; infektoj. *Ia mplepsi plagën. Molepsi ajrin (token, mjedisin, ujin, lumin). E molepsi rëndë (keq).*

2. *fig.* Bëj që dikush të marrë vese, të ketë të meta e shfaqje të dëmshme etj.; infektoj. *Ua molepsi mendjen. Dhia e zgjebosur moleps gjithë kopenë. fj. u.*

MOLÉPSEM vetv. 1. Marr nga një tjetër një sëmundje ngjitëse; marr mikrobe, infektohem; *vet. veto III* ndyhet me fëlliqësira, me gjëra që kanë mikrobe etj. *I larguan fëmijët që të mos molepseshin. U moleps i gjithë vendi. U molepsën rëndë.*

2. *fig.* Marr nga një tjetër vese, të meta a diçka të dëmshme; ndikohem a prekem nga ideologjia e huaj; infektohem. *Iu moleps ndërgjegjja.*

3. *Pës. e MOLEPS.*

MOLÉPSËS, ~E mb. Që të moleps, ngjitës (per sëmundje etj.).

MOLÉPSJ/E, ~A f. sh. ~E, ~ET. Veprimi dhe gjendja sipas kuptimeve të foljeve MOLEPS, MOLEPSEM. *Molepsja e njerëzve (e bimëve, e kafshëve, e vendit, e mjedisit). Molepsje sojesh* përzierja e fares së një soji me fare të sojeve të tjera.

MOLÉPSUR (i,e) mb. I. Që ka marrë një sëmundje nga një tjetër, që ka marrë mikrobe, që është molepsur. *Kafshë e ntolepsur. Ujëra të molepsura. Ajër i molepsur.*

2. *fig.* Që ka marrë vese, të meta a diçka të dëmshme; që është ndikuar a është prekur nga ideologjia e huaj; i keq, i fëlliqur (në sjellje, në të folur etj.); i infektuar. *Shoqëri e molepsur. Njeri i molepsur.*

Ka fjalë të huazuara nga greqishtja që i përkasin leksikut të përgjithshëm, mbarëkombëtar dhe që përfshihen në leksikon normativ të shqipes standarde, por që në fjalorët shpjegues shenjohen me elemente plotësuese, të tilla si *bised.* (që i përkasin ligjërimin bisedor), *krahin.* (që i përkasin leksikut krahinor apo dialektor) etj. Këto fjalë në pamje të parë, përmes këtyre markimeve, i përkasin leksikut pasiv, por derisa janë futur në fjalorët kombëtarë normativë ato tregojnë edhe prirjen për të dalë nga ky leksik apo nga të folmet krahinore e dialektore dhe të kthehen në njësi që i përkasin leksikut të

përgjithshëm, leksikut aktiv. Poe ilustruam këtu me disa shembuj nga Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (FGjSSh), 1980:

PSONIS kal., ~A, ~UR bised. 1. edhe *jokal*. Blej diçka në treg; bëj pazarin. *Doli për të psonisur*.

2. Gjej diçka dhe e sjell me vete, gjej. *Se ku i kishte psonisur!*

PSONISJ/E,~A f. sh. ~E, ~ET bised. Veprimi sipas kuptimeve të foljes PSONIS.

Në ndonjë fjalor të fundit mund të kemi edhe një proces “prapavajtës”, kur elementet plotësuese janë vendosur për fjalë që kanë në ditët e sotme zënë vend gjerësiht në leksikon e përgjithshëm. P.sh., moleps (dhe çerdhja e fjalëve që lidhen me të), në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980), nuk ka asnjë elemente plotësues, kurse në Fjalorin e gjuhës shqipe, 2006, pra gati 30 vjet më prapa, kjo fjalë dhe ato që lidhen mormetaikisht me të, janë shenjuar me elementin plotësues bised., pra ka kaluar në leksikon pasiv.

moléps kal., -a, -ur bised. 1. i ngjith dikujt një sëmundje; fëlliq, ndyj. 2. *fig. keq.* bëj që dikush të marrë një ves të keq; e korruptoj; infektoj. • **molépsëm** vetv. e *moleps.* / pës. **molépsëm.** • **molépsj/e,-a** f. sh. -e(t) veprimi dhe gjendja sipas foljeve. • **molépsur** (i, e) mb. që është molepsur.

molépsës,-e mb. që të moleps; ngjitës.

Ndonjëherë *dy fjalë sinonime që kanë hyrë nga greqishtja* (si dhe fjalët e çerdheve paradigmatiske fjalëformuese që lidhen me to), *janë të dallueshme në fjalor*, njëra prej tyre shoqërohet me elementin plotësues bised. (p. sh., te folja *zileps*), kurse tjetra nuk shoqërohet me elementin e tillë (te folja *zilis*).

ZILÉPS kal., ~A, ~UR bised. I shtie zilinë; e kam zili, zilis.

ZILÉPSEM vetv. bised. Me hyn zilia, zilisem.

ZILÍ,~A f. Dëshirë e madhe për të pasur a për të arritur atë që ka a që ka arritur dikush tjetër; ndjenjë lakmie a keqdashjeje që na ngjallet kur shohim dike tjetër me mirë se veten; smirë, resë, ndezë. *E ka zili. I shtiu zilinë. E sheh me zili. E mposhti zilinë. Plasi nga zilia. Ia brente zemrën zilia. Është për ta pasur zili.*

ZILIQÁR,~E mb. 1. Që i ka zili të tjerët, që ndien zili për të tjerët; që shpreh zili; smirëzi. *Njeri ziliqar. Vështrim ziliqar. Mos u bëj ziliqar!*

2. *Përd. em.* sipas kuptimit të mbiemrit. *Është ziliqar i madh.*

ZILIS kal., ~A, ~UR. E kam zili, zileps. **ZILÍSEM** vetv. Më hyn zilia, zilepsëm.

APÓSTU/LL,~LLI m. sh. ~J, ~JT. 1. *fet.* Secili nga dymbëdhjetë nxënësit e Krishtit, që predikuan dogmat e tij sipas mitologjisë së krishterë; libër fetar, ku tregohet veprimtaria e tyre. *Veprat e apostujve.*

2. *fig. libr.* Mbrojtës dhe përhapës i zjarrtë i një ideje, i një doktrine etj. *Apostull i lirisë (i së vërtetës). Aposull i idesë kombëtare.*

Në fjalorët shpjegues të shqipes fjalët e huazuara nga greqishtja jepen jo vetëm sipas ligjërimeve, por edhe sipas stileve, duke na dhënë shumë fjalë terma, por edhe kuptime terminologjike me shpjegime të plota. Kur këto fjalë gjenden në të shumë

fjalorë, ato kthehen nga terma në fjalë që njihen nga një rreth i gjerë përdoruesish, ndodh i ashtuquajtur i *shterminologjizimit*.¹⁴³

ÁLFA *f. palak*. 1. *spec.* Emri i shfcronjës së parë jtë alfabetit grek; përdoret si simbol (a) në matematikëj jnë astronomi e në fizikë për të shënuar të parin kënd, !të parin yll a të parën pikë, r.jë lloj rrezesh e grim-icash etj. në vargun s emërtimit të tyre. *Rrezet alfa. fiz. Thërrmija (grimca.) alfaa. fiz. Këndi alfa. mat.*

2. *si em. f. ALF/Ë,~A fig. libr.* Fillimi i diçkaje, Igjēja e parë që duhet bërë. pika ngaduhet nisur; a-ja, jabëcēja.

***Alfa dhe omega** fillimi dhe fundi i diçkaje; gjēja kryesore, themelore. *Nga alfa tek omega* nga fillimi deri në fund, nga a-ja te zh-ja.

ETIMOLOGJI,~A *f.sh. ~, ~TË gjuh.* 1. Degë e gjuhësisë që studion prejardhjen e fjalëve të një gjuhe, duke u mbështetur në historinë e saj e në lidh-jet me gjuhët e tjera. *Etimologjia shkencore. Etimologji popullore* etimologji që e përcakton në mënyrë të gabuar prejardhjen e fjalëve, duke u mbështetur zakonisht te ngjashmëria e tyre e jashtme, tingullore me fjalë të tjera të njohura dhe pa marrë parasysh ligjet e zhvillimit historik të gjuhëve. *Etimologjia e gjuhës shqipe. Merrem me etimologji.*

2. Prejardhja e një fjale. *Etimologji e qartë (e panjohur). Etimologji e një fjale. Përcaktoj etimologjinë e fjalës.*

ETIMOLOGJIK,~E *mb. gjuh.* Që ka të bëjë me etimologjinë, që i përket etimologjisë, i etimologjisë; që mbështetet në etimologji, sipas etimologjisë. *Kërkime (studime) etimologjike. Fjalor etimologjik, Drejtshkrim etimologjik.*

BIOLOGJI,~A *f.* 1. Shkencë natyrore, që studion dukuritë e ligjet e përbashkëta të jetës e të zhvillimit të të gjitha qenieve të gjalla. *Biologjia e përgjithshme. Biologjia e bimëve (e kafshëve). Kabineti (këndi) i biologjisë. Instituti (fakulteti) i biologjisë.*

2. Veçoritë e ndërtimit dhe të zhvillimit të një qenieje të gjallë, që përcaktojnë natyrën e saj. *Biologjia e një kafshe (e një kandrre). Biologjia e një bime.*

3. Lëndë mësimore që jep njohuritë e kësaj shkencë në shkollë; *bised. teksti që përmban këto njohuri. Mësuesi i biologjisë. Ora e biologjisë. Mori dhjetë në biologji.*

BIOLOGJÍK,~E *mb.* 1. Që ka të bëjë me biologjinë, i biologjisë; që ka të bëjë me jetën e gjallë ose me qeniet e gjalla. *Proces biologjik. Ligj biologjik. Vetë (veçori) biologjike. Analizë biologjike. Stacion biologjik. Vdekje biologjike. Nevojë biologjike. Kusht biologjik. Teori biologjike. Kabineti biologjik.*

2. Që ka të bëjë me përdorimin e biologjisë ose me shfrytëzimin e mundësive dhe të mjeteve që jep ajo për qëllime praktike. *Pastrim biologjik. Metodat bio-logjike. Armë biologjike. Lufta biologjike.*

* * *

Gjuha standarde shqipe, e kodifikuar në nënsistemet e saj kryesore në Kongresin e Drejtshkrimit në vitin 1972 ka në përdormi disa fjalorë shpjegues, që të gjithë të tipit të mesëm: *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980; *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, 1984 / 2002; *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006. Megjithatë ata kanë dallime ndërmjet tyre, sepse janë hartuar sipas parimeve të dhe teknikave të ndryshme leksikografike. Këto dallime dhe ndryshime përfshinë edhe paraqitjen e strukturave

¹⁴³ H. Pasho, *Një vështrim mbi dukuritë kuptimore në terminologjinë e ekonomisë*, SF, 3, 1986

kuptimore të huazimeve greke. Po japim vetëm dy gjendje leksikografike, një të njërën nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, që është një fjalor me struktura të gjera kuptimore dhe kuptimet ilustrohen me shumë shembuj në formën e thënieve togfjalësha apo fjali të thjeshta. Kurse gjendja tjetër është marrë nga *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006. Ky fjalor ka rreth 8-10.000 fjalë më shumë se ai Fjalori i 1980-s, por strukturat kuptimore i ka më të ngjeshura, më sintetike dhe thëniet ilustruese më të reduktuara.

a. Fjala **lakër** dhe çerdhja me fjalët që krijon ajo te FGJSSH, 1980:

LÁK/ËR,~RA f. sh. ~**RA**, ~**RAT**. 1. bot. Një nga perimet kryesore të vjeshtës e të dimrit që mbillet në kopshte e rritet si kokërr e madhe me gjethe të gjera, të mbledhura e të ngjeshura rtjëra mbi tjetrën. *Laker e bardhë (e kuqe)*. *Lakër turshi*. *Një kokë lakër*. *Koçani (kërçelli) i lakrës*. *Fletët (gjetet) e lakrës*. *Supë (sallatë) me lakër*. *Japarak me lakër*. *Mish me lakër*.

2. Përdoret si pjesë e dytë e disa emërtimeve të pathjeshta që shënojnë dëmtues ose sëmundje të kësaj bime. *Çimka (tartabiqja) e lakrës*. zool. *Flutura e lakrës*. zool. *Miza e lakrës*. zool. *Morri i lakrës*. zool. *Pleshti i lakrës*. zool. *Tenja e lakrës*. zool. *Turigjati i lakrës*. zool. *Vemja e lakrës*. zool. *Vruga i lakrës*.

3. bot. zakon. sh. Barishte të ndryshme të egra e të buta (si lëpjetët, laboti, nenët, hithra, spinaqi etj.) që përdoren si ushqim për njerëzit e për kafshët. *Lakra të egra (të buta)*. *Lakra dimri (behari)*. *Lakra mali*. *Byrek (lakror) me lakra*. *Gjellë me lakra*. *Mbledh lakra*. *Grij lakrat*.

4. vet. sh. fig. bised. Mendime të gabuara të turbullta e prapanike ose mendime të kundërta me botëkuptimin tonë socialist, që ka dikush në kokë e që duhet t'i heqë. *Njeri me lakra*. *Ka lakra në kokë*. *La hoqën (ia shkullën) lakrat nga koka*.

E bëri lakër a) *diçka* e bëri copë-copë, e co-pëtoi, e griu; b) *dike* e rrahu fort, e bëri fërtele, e lakanisi. **U bë lakër** u këput e u zdërtaq nga lodhja, nga vapa e madhe ose nga një sëmundje. **Grin lakër** (sallatë) *shih te* GRIJ. **Hyri nëpër lakra** u përzie kot në një punë të ngatërruar a në *diçka* që nuk i takon. **Lëng ndër lakra** *shih te* LËNG,~U. **I ndau (i qëroi) lakrat (llogaritë, hesapet) me dikë** *shih te* NDAJ. **E zuri (e kapi, e gjeti) ndër lakra** e zuri dikë duke- bërë një punë të keqe, e zuri me presh në duar. **U be si lakër e bujtur** nuk ka me lezet, u be i mërztishëm; i ra rëndësia, s'ia var me njeri. I ka rënë shiu në lakra i shkon puna shumë mirë. **I dolën (iu zbuluan) lakrat lakrorit** iu zbuluan dikujt të fshehtat që kërkonte të mbante (per *diçka* të keqe); i dolën në shesh të pa-larat. **Është hapur si vaji në lakra (në ujë)** *shih te* VAJ, ~I i. **E kam (jemi) lakra (presh) në kopsht dikë (me dikë)** iron, s'e kam gjë fare dike, nuk kam ndonjë lidhje farefisnie me të; jemi shumë të largët njeri me tjetrin. **Ia nxori (ia qiti) lakrat në shesh** ia zbuloi punët e këqija që kishte bërë; ia nxori fajet a gabimet në shesh. **Rronte me një shoshë lakra** ishte i varfër e i këputur. **Vaji në lakra bie** *shih te* BIE i. **U derdh lëngu e ra në lakra** *shih te* LËNG,~U. L u l e l a k r e bot. lulëlakër;

LAKËR DETI bot. Lloj alge e ujërave të kripura që bëhet e rrumbullakët si kokë lakre.

LAKËR PATE bot. Bimë barishtore e egër, me gjethe si të dejzës, por me të vogla, me lule të verdha e me fara të grumbulluara në vile, që rritet në toka me lagështi dhe e hanë shumë patat e rosat.

LAKËR QENI bot. Bimë barishtore e egër, që rritet në kullota e në vende me shkurre dhe që ka lëng të hidhur e mund të helmojë kafshët që e hanë.

LAKËR E VERDHË bot. Bimë barishtore e egër, me lule të verdha e të rrumbullakëta, me gjethe të vogla e me push në anën e poshtme, që rritet në vende pa ujë ose pa lagështirë të tepërt.

LAKËR ZOGU bot. Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe të holla, me lule të grumbulluara dhe me fara të mbledhura si xhufkë, të cilat i hanë shumë zogj-të dhe që rritet në lëndina e fusha.

LAKËRARMË,~JA f. Lakër e vënë turshi, lakër turshi, turshi lakre, arme.

LAKËRÍSHT/Ë,~A_I f. sh. ~A, ~AT. i. Kopsht a are që është mbjellë me lakra. 2. vet. sh. Lakrat, lakrurinat.

LAKËRÍSHT/Ë,~A_{II} f. sh. ~A, ~AT bot. bimë barishtore ujëse, me kërcell të gjatë, me lule të bardha dhe me gjethe të gjera gjithë push, të cilat rrinë të zhytura në ujë.

LAKËRÓHEM vetv. 1. Bëhem copë-copë nga q-obat; pritem shumë vende-vende, lakanisem, grihem, bghem fërtele. *M'u lakëruan rrobat. Iu lakëruan duart.*

2. Pës. e LAKËROJ.

LAKËR/ÓJ kal, ~ÓVA, ~ÚAR. E bëj diçka copë-copë, e gris shumë; e pres diçka copa-copa a thela-thela të vogla, e grij; e lakanis, e bëj fërtele. / *lakëroi rrobat (petkat) në ferra. Ia lakëruan trupin me shpatë.*

b. Fjala *lakër* dhe çerdhja me fjalët që krijon ajo te FGJSH, 2002:

lák/ër,-ra f. sh. **-ra(t)** 1. bot. perime me gjethe të gjera, të mbledhura e të ngjeshura në një kokë të madhe; kryes. sh. barishte të ndryshme të egra e të buta, si lëpjeta, laboti, spinaqi etj., që përdoren si perime: *lakra të egra (të buta); supë (mish) me lakër.* 2. bot. gjymtyrë e parë e emërtimeve të pathjeshta për disa bimë: *lakër deti* algë e ujërave të kripura, sallatë deti; *lakër pate* bimë me gjethe si të dejëzës, me lule të verdha e me fara në vile, që e hanë shumë patat e rosat; *lakër qeni* bimë me lëng të hidhur e helmues, që rritet në kullota e në vende me shkurre; *lakër e verdhë* bimë e vendeve të thata, me lule të verdha e të rrumbullakëta, me gjethe të vogla e me push në anën e poshtme; *lakër zogu* bimë e livadheve, me gjethe të holla, me lule dhe me fara të mbledhura si xhufkë, të cilat i hanë shumë zogjtë. 3. zool. gjymtyrë e dytë e disa emërtimeve të pathjeshta që shënojnë dëmtues ose sëmundje të kësaj bime: *çimka (tartabiqja) e lakrës; flutura e lakrës; miza e lakrës; morri i lakrës; pleshti i lakrës; tenja e lakrës; turigjati i lakrës; vemja e lakrës; vrugu i lakrës (bot.).* 4. sh. fig. bised. mendime të gabuara që ka dikush: *ka lakra në kokë.* ★(u bë) si *lakër e bujtur* nuk ka më lezet, u bë i mërzitshëm; i ra rëndësia, s'ia var më njeri; (u bë) si *lakër e mërdhirë* (dikush) është zbehur e dobësuar shumë; *e bëri lakër* (diçka) e bëri copë-copë, e griu; / (dikë) e rrahu fort, e bëri fërtele, e lakanisi; *i dolën (iu zbuluan) lakrat lakrorit* iu zbuluan dikujt të fshehtat që kërkonte të mbante (për diçka të keqe); i dolën në shesh të palarat; *hyri nëpër lakra* u përzie kot në një punë të ngatërruar a në diçka që nuk i takon; *e kam lakra (presh) në kopsht* (dikë) iron. s'e kam gjë fare, nuk kam ndonjë lidhje fafëfisnie me të; jemi shumë të largët njëri me tjetrin; *i ndau (i qëroi) lakrat (llogaritë)* (me dikë) përcaktoi qartë qëndrimin e vet ndaj dikujt; u shkëput përfundimisht prej tij; *ia nxori (ia qiti) lakrat në shesh* ia zbuloi punët e këqija që kishte bërë, ia nxori fajet a gabimet në shesh; *e zuri (e kapi, e gjeti) ndër lakra* e zuri dikë duke bërë një punë të keqe, e zuri me presh në duar.

lakërarmë,-ja f. lakër e vënë turshi; arme.

lakërísht/ë,-a_I f. sh. **-a(t)** 1. kopsht a arë e mbjellë me lakra. 2. sh. lakra, lakrurina.

lakërísht/ë,-a_{II} f. sh. **-a(t)** bot. barishte ujëse, me kërcell të gjatë, me lule të bardha dhe me gjethe të gjera.

lakër/ój kal., **-óva, -úar** e bëj diçka copë-copë, e gris shumë; e pres në pjesë të vogla, e grij; *i lakëroi rrobat në ferra.* • **lakëróhem** vetv. e **lakëroj**: *m'u lakëruan*

pantallonat; iu lakëruan duart. / pës. lakëróhem. • lakërim,-i m. veprimi dhe gjendja sipas foljeve. • lakëruar (i, e) mb. që është lakëruar: me petka të lakëruara.

Siç shihet dallimet bien në sy. Megjithatë në të dy fjalorët fjala *lakër*, jepet akoma si term që lidhet me fushën e biologjisë, kur nuk ka shqiptar që të mos e përdor këtë fjalë. Ndaj jem e mendimit që kjo duhej të mos shoqërohej me shkurtime terminologjike (*bot. etj.*).

* * *

Një hapësirë e rëndësishme leksikografike, *për të parë kohën e hyrjes së huazimeve greke në shqipe si dhe shtrirjen e tyre në shtresa të ndryshme të leksikut, është dhe leksikografia që lidhet me botën e arbëreshëve të Italisë*. Procesi i emigrimit të shqiptarëve drejt Italisë shpaloet në disa valë. Pas vdekjes së Gjergj Kastrioti - Skënderbeut numri i banorëve shkoi në 250. 000 vetë.

Profesor E. Çabej shkruan se shqiptarët janë shpërndarë gjithandej Italisë, por vendosja kryesore dhe më e përqendruar është në jug të saj. Sipas këtij studiuesi, valët e lëvizjeve të shqiptarëve drejt Italisë kanë ndodhur: në vitin 1437, kohë gjatë së cilës shqiptarët u vendosën në Ankona; në vitin 1448, kohë gjatë së cilës shqiptarët u vendosën në Kalabri e Sicili; në vitin 1484, kohë gjatë së cilës shqiptarët u vendosën në Abrucatë; në vitin 1774, e cila e konsiderohet edhe vala e fundit, gjatë së cilës shqiptarët u vendosën në Brindizi dhe Apulja. Edhe pse me shumë vështirësi, për arsye se kanë qenë gjithmonë nën ndikimin e një gjuhe e kulture të huaj “... arbëreshët kanë ruajtur gjuhën traditat, folklorin, doket, zakonet, flamurin e kohës së Skënderbeut, i cili përfaqëson simbolin e heroizmit shqiptar ndër shekuj me fushën e kuqe, shqiponjën e zezë dhe yllin prej gjashtë cepash”¹⁴⁴.

Për mbijetesë arbëreshëve u është dashur të bëjnë të tyren edhe italishten, apo sikundër thonë ata *gjuhën e bukës*, e cila më pas ka ndikuar në mënyrë të dukshme në të gjitha sistemet e këtyre të folmeve. Por, për të shprehur ndjenjat e tyre *me fanatizëm* ruajnë dhe përdorin *gjuhën e zemrës*. Komunitetit i arbëreshëve në Itali i ka ruajtur të paprekura format kulturore dhe karakteri arkaik i arbërishtes vihet re në krijimtarinë popullore apo ndryshe në folklorin e tij. E ndeshim atë në përralla, rrëfime e legjenda, në proverba e frazeologji, në këngë e melodi, në enigma e gjëgjëza, rite e ceremoni, besime, supersticione etj., “...e gjitha kjo është një botë e dukshme dhe e padukshme e realitetit dhe e imagjinatës, e cila lëviz dhe zemërohet, buzëqesh e rënkon për atë që di t'i afrohet dhe ta kuptojë” .

Për vetë karakterin konservues të arbërishtes si gjuhë e zemrës, në fjalorët që lidhen me këtë të folme (apo me të folmet e arbëreshëve) mund të shohësh se shumë huazime leksikore kanë hyrë në mbarë shqipen dhe një pjesë nga shqiptarët që u larguan nga Moreja (Peleponez, Greqi).

Vepra më e plotë që lidhet me leksikonin e të folmeve arbëreshe është *Fjalor i arbëreshëve të Italisë*, të hartuar prej Emanuele Giordanos.¹⁴⁵ Më poshtë po renditim disa fjalë nga greqishtja që gjenden në këtë fjalor. Ato i takojnë jo vetëm leksikut dialektor, por edhe atij të përgjithshëm. Një pjesë e tyre janë edhe terma ndërkombëtarë, ashtu si një pjesë e madhe i përkasin leksikut aktiv dhe janë pjesë e pandshme e të

¹⁴⁴ Shkurtaç, Gj., *Studime filologjike*, 4, Tiranë, 1979

¹⁴⁵ E. Giordano, *Fjalor i arbëreshëve të Italisë*, Bari, 1963/2000

folurit të përditshëm në mjediset arbëreshe. Duhet të theksojmë se shumë huazime kanë hyrë si emra dhe në procesin e zhvillimit historike ato kanë krijuar çerdhe paradigmatiche fjalëformuese sipas ligjeve të shqipes dhe me mjetet fjalëformuese (ndajshitesat e shqipes): *adham, adhazmu, adhjasënj, adhjasia, i adhjustë, i adhjasur, aguridhe, agutiksënj, agutiksje, ahjimia, ajazëm, alisidhe, anagllusia, anahoria, anahorisënj, anakatosënj, anangasia, anangasënj, andirisënj, angosënj, angosia, apathia, argalia, argomë, arhjimandrit, arisënj, armuridhe, askondrepës, avlaq, cimbaria, cmbarisënj, cimbidhe, cimbjasënj, cimbjosënj, dharakopsënj, dramidhe, dhafën, dhakonj, dhaskal, dhaskalia, dheksëm, dhespotia, dhiks, dhiksënj, dhilpë, dhokondrea, dhokar, dhokasënj, dhrimon, dhomatiqia, dhrom, dhrosia, egoizëm, epakurisënj, evangjelizonj, fanadksëm, falloppjasënj, faneksënj, faraksem, firasëm, psonisënj, farmak, farmakosëm, fasodhe, feksënj, gremia, greminë, gremisënj, harepsor, horë, horjotë, idhca, idheall, igumen, jatrua, jatrepesënj, kakamaqia, kakamaqasënj, kalimera, kallogre, kallogjer, kallojer, karamele, katalimoth, katallivënj, katamilosënj, katamiqosënj, katamitosënj, kondrepesia, ksenëtuar, kses, ksevalënj, ksomollia, lefteria, lefteronj, lefterosënj, lipidhjasënj, lloizmoja, qerjorinë, votariqe, zilepsënj, zilisënj etj.*¹⁴⁶

* * *

Siç jemi shprehur, huazimet greke kanë hyrë në gjuhën shqipe në kohë të ndryshme. Kjo mund të vërehet edhe në një fjalor etimologjik. Shqipja nuk ka akoma një vepër të tillë. Ne shpesh i jemi referuar *Fjalorit etimologjik të gjuhës shqipe*” të Gustav Majerit (*Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, 1891)¹⁴⁷. Ky fjalor u hartua kur “nuk kishin dalë ende fjalorët më të mirë të shqipes, si fjalori i Kostandin Kristoforidhit, i Shoqërisë “Bashkimi” etj., kështu që autori nuk pati mundësi të njihnte leksikon e mbarë gjuhës shqipe. Kjo do ta ndihmonte për të shpëtuar nga përfundimi i gabuar dhe nga pasqyra etimologjike jo e drejtë që dha. Siç dihet, nga 5140 fjalë që shqyrtoi Gustav Majeri në fjalor, 400 i cilësoi si të shtresës indoevropiane, 730 i la pa etimologji, 1420 i nxori të burimit latino-roman, 1180 të burimit turk, 840 të burimit grek dhe 540 të burimit sllav. Tashti fjalori i Gustav Majerit është tejkaluar dhe pasqyra etimologjike e shqipes ka ndryshuar në dobi të shqipes. Megjithatë, fjalori etimologjik i Gustav Majerit ka vlera të mëdha, si vepra e parë e këtij lloji, e botuar kur edhe gjuhë më të studiuara se shqipja nuk e kishin atëherë fjalorin e tyre etimologjik.”¹⁴⁸

¹⁴⁶ E. Giordano, *Fjalor i arbëreshëve të Italisë*, Bari, 1963/2000

¹⁴⁷ G. Meyer, *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, 1891

¹⁴⁸ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f. 321

2. HUAZIMET GREKE NË FJALORËT DYGJUHËSH (ME SHQIPEN GJUHË TË PARË)

Gjeografia e leksikografisë dygjuhëshe e shqipe është shumë e gjerë. J. Thomai thekson se “Fjalorët dygjuhësh të shqipes rrokin thuajse të gjitha gjuhët indoevropiane: anglisht, bullgarisht, çekisht, danisht, frëngjisht, greqisht, gjermanisht, holandisht, italisht, kroatisht, maqedonisht, norvegjisht, polonisht, rumanisht, rusisht, serbisht, sllovenisht, spanjisht, suedisht dhe gjuhë joindoevropiane: arabisht, estonisht, hungarisht, kinezisht, romisht, turqisht etj.”¹⁴⁹

Në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XX dhe në këto vite të shekullit XXI, ka leksikografia shqipe njohur një hop sasior të jashtëzakonshëm. Me qindra janë fjalorët dygjuhësh që janë hartuar, nga leksikografë e jo leksikografë, nga grup hartuesish dhe nga individë, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Kërkesat e praktikës leksikografike, d.m.th. kërkesat për fjalorë dygjuhësh për të mësuar një gjuhë të huaj (anglisht, greqisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht etj.), si edhe mundësitë që u krijuan me përvojën e fituar, me zhvillimin e teorisë leksikografike e të teknikave të përparuara kompjuterike, nxitën shumë hartues fjalorësh dygjuhësh për nisma vetjake, që sollën edhe një numër të madh fjalorësh dygjuhësh në qarkullim.

Huazimet greke, siç e kemi parë në kapitujt e mëparshëm, kanë hyrë në shqipe, në periudha kohore të ndryshme. Shqipja është gjuhë e shkruar relativisht vonë, megjithatë që në fjalorët e parë dygjuhësh i gjen huazimet greke. *Kurse në fjalorët që janë hartuar 100 vjetët e fundit janë pasqyruar në mënyrë shkencore, sistematike dhe në përputhje vlerat gjuhësore që ato mbartin, me kriteret shkencore dhe teknikat leksikografike bashkëkohore.*

A. HUAZIMET GREKE NË FJALORËT SHQIP – GREQISHT

Kontaktet e shumta dhe interesat e dyanshëm ndërmjet shqiptarëve kanë çuar, ndër të tjera, në zotërimin e gjuhëve respektive, çka nënkupton minimalisht zotërim të leksikut dhe të gramatikës së tyre. Veç kësaj në Shqipëri ka një minoritet që arsimohet në të gjitha nivelet dhe në Greqi ka me qindra mijë shqiptarë, shumica e të cilëve janë emigrantë ekonomikë. Ky proces ka kërkuar detyrimisht *hartimin e fjalorëve dygjuhësh*. Ne vërejmë se për një periudhë disashekullore kemi disa fjalorë,

¹⁴⁹ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f.

Në ditët e sotme gjenden në dorën e përdoruesve fjalorë greqisht – shqip dhe shqip - greqisht të hartuar nga profesionistë, por edhe shumë fjalorë të tjerë të botuar nga dashamirë të njërës apo të tjetrës gjuhë, sidomos fjalorë me një numër të vogël fjalësh, fjalorë shprehjesh të etnokulturës (përshëndetje, formula komunikimi në mjedise të ndryshme bilingue etj). Shumë prej tyre kanë mangësi të theksuara leksikografike dhe përdorimi i tyre sjell më shumë pasoja negative sesa ndihmojnë në zotërimin e gjuhës së huaj (sidomos të greqishtes).

Është fakt i padiskutueshëm se sot gjendemi përballë një kontradikte: *nevojat e shoqërisë, të shkollës, të jetës shkencore, kulturore etj. për këtë lloj fjalorësh kanë qenë dhe mbeten shumë të mprehta e imperative. Fakt është se fjalorët greqisht-shqip dhe shqip – greqisht numërohen me gishta*. Gjendja e sotme e marrëdhënieve ndërmjet popullit grek dhe atij shqiptar si dhe ndërmjet dy kulturave respektive, bën të domosdoshme që hartimi i fjalorëve, qofshin të vegjël dhe praktikë në përdorim, qofshin fjalorë shkollorë apo fjalorë të tipit të mesëm (me 50.000 fjalë) të organizohet dhe të institucionalizohet. Përvoja është, qarqet akademike dhe universitare duhet ta kenë përparësi edhe këtë objektiv¹⁵⁰.

Më poshtë po japim shumë shkurt një skicim të pasqyrimin të huazimeve greke shqipe në disa fjalorë dygjuhësh shqip-greqisht:

Fjalori i parë ku shqipja shfaqet si gjuhë e dytë, përballë greqishtes si gjuhë e parë, i takon viteve 1762-1764. Ai është hartuar nga *P. Haxhi Daniili* dhe titullohet *Lexikon tetraglosson, çetiri jaziçen reçnik (greqisht - shqip - maqedonisht - turqisht)*¹⁵¹. Botimi është bërë në shtypshkronjën e Akademisë së Voskopojës.

Në vitin 1770 *Teodor Kavalioti* boton *Protopeirian*¹⁵² dhe përfshin në të edhe një *Fjalor greqisht – arumanisht – shqip*, me 1.070 fjalë. Vepra është një libër fillestar për ata që, midis shqiptarëve dhe vllahëve, do të duan të mësojnë gjuhën greke.”¹⁵³

Në shekullin XVIII gjejmë dhe *botimin e fjalorthëve të vegjël dygjuhësh, që zakonisht shoqërojnë pjesë ungjijsh e gjithë veprën* (të cilët shpesh mbeteshin edhe në dorëshkrim). Kështu në Bibliotekën Kombëtare të Tiranës gjendet një kodik beratas, me përkthime të ndryshme kishtarë dhe me fjalorë greqisht - shqip, dhe mendohet se autori është Kostandin Berati ose Ikonom Kostandini dhe i përkasin vitit 1764¹⁵⁴. Vepra ka rreth 44 faqe me lutje të ndryshme fetare me një radhë shqip dhe tjetra shqip të shkruara me alfabet grek. Brenda kodikut kemi dy *Fjalorthë greqisht – shqip*, njëri me 110 fjalë dhe tjetri me rreth 1.600 fjalë.

Fjalësi i fjalorëve të kësaj periudhe përgjithësisht i përket pak a shumë botës kishtarë, ndaj kemi shumë huazime greke që lidhen me këtë fushë. Kjo dukuri është e pranueshme, sepse literatura kishtarë ndihmonte në ruajtjen e besimit ortodoks në kohën kur kemi ndeshje kulturash, qytetërimesh, gjuhësh, besimesh me pushtuesit turq. Gjithashtu shkrimet e kodikëve dhe fjalorët që ata përmbanin, shërbenin edhe për

¹⁵⁰ Shih më gjerë V. Memisha *Rreth fjalorëve shqip – greqisht dhe greqisht – shqip*, në “Studime për fjalën shqipe” Tiranë, 2011, f. 163-174; S. Delojorgji, *Niko H. Gjini dhe leksikografia shqiptaro-greke*, në *Albanohellenica*, 4, 2011 etj.

¹⁵¹ *Leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë*, Tiranë, 2005, f. 330

¹⁵² Dh. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë, 1976, f. 29

¹⁵³ Dh. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë, 1976, f. 127

¹⁵⁴ Dh. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë, 1976, f. 121

përhapjen e arsimimit dhe ndihmonin në shkollimin e popullsisë. Ndaj ata kanë qenë një nga mjetet edhe të përhapjes së huazimeve greke në shqipe.¹⁵⁵

Në shekulli XIX u botua vepra *Λεξικόν τῆς Ρωμαϊκῆς καὶ Ἀρβανήτικῆς Ἀπλῆς* (i njohur si *Fjalor greqisht - arvanitshe e thjeshtë*)¹⁵⁶, i hartuar nga Marko Boçari. Vepra ka rreth 1.800 fjalë dhe u botua në Tiranë më 1926 nga Lumo Skëndoja, duke ruajtur alfabetiin grek dhe ortografinë e origjinalit, kurse në vitin 2008, ribotohet nga Shtëpia botuese “Arbëria”. Fjalori i M. Boçarit, edhe pse nuk është vepër e një gjuhëtari e leksikografi dygjuhësh, ka meritën se me lëndën që pasqyron, shënon për herë të parë shkëputjen nga fjalorët dygjuhësh dhe shumëgjuhësh me lëndë leksikore vetëm nga bota kishtare dhe e besimit. Aty ndër të tjera gjejmë shumë fjalë të huazuara nga greqishtja (*anakatosurë, allimonon, aguridhë, cukunidhë, kerdhes, hinopor, hinotoni, vromë, liturgji, dhidhaskali, dhipllo, dhiavas* etj.). Fjalësi jep lëndë të drejtpërdrejtë nga e folmja e krahinës së Sulit dhe jep mundësi për të parë edhe veçoritë dialektore të folmes dhe ka rëndësi për studimet historike, sepse pasqyron një gjendje gjuhësore, gati të papërpunuar, të fillimit të shekullit XIX.

Më 1904 botohet *Leksikon tis alvaniqis glossis “Fjalori i gjuhës shqipe”* i K. Kristoforidhit¹⁵⁷, i cili u ripunua dhe transkriptua në alfabet shqip nga A. Xhuvani më 1961 dhe botohet me titullin “*Fjalor shqip-greqisht*”.¹⁵⁸ Është pranuar se *Fjalori* i K. Kristoforidhit është në përgjithësi dygjuhësh, *shqip-greqisht*, ku greqishten e përdori si mjet shpjegues. K. Kristoforidhi përfshiu në fjalorin e tij fjalë e frazeologji nga goja e popullit, *si pasuri të përbashkët e shqipes*. Gjithashtu, ai përfshiu edhe disa neologjizma të formuara prej atij vetë. Vepra zakonisht ka fjalën shqipe dhe përkrah saj fjalën gjegjëse të greqishtes. Në të gjejmë shumë fjalë nga greqishtja, që i përkasin leksikut të përgjithshëm si *apostull, dafinë, delfin, buzuk, kanistër* etj., por edhe shumë fjalë që i futen në leksikon pasiv, që kanë mbetur në leksikon dialektor ose si barabrizma, si *avysë, dhipllar, dhiafor, dhiqel, dhromë, pras, cinxur, varielë, vigël, cimbis, dhimisqi, haliç* etj.

K. Papafili shkrimtar, por jo leksikograf, boton në vitin 1997 në Athinë fjalorin *Λεξικό Έλληνο - Αλβανικό (Fjalor greqisht - shqip)*.¹⁵⁹ Kjo ndodhi bëhet tregues kuptimplotë, sepse dëshmon që në leksikogafinë e re greke hartimi i fjalorëve dygjuhësh greqisht-shqip dhe shqip-greqisht **fillon të bëhet dhe nga autorë grekë**. Po në vitin 1997, K. Papafili boton *Fjalorin Shqip- Greqisht* [K. Παπαφίλη, *Λεξικό Άλβανο - Ελληνικό (Fjalor shqip – greqisht)*]¹⁶⁰, me 30.000 fjalë në shqipe dhe me barasvlerësit e tyre në greqishte. **Por vepra si në rrafshin makrostrukturor ashtu dhe në atë mikrostrukturor ka mangësi**. Edhe ky fjalori ka karakter të theksuar pragmatist, duke synuar ta çojë përdoruesin e tij lehtësisht te fjala shqipe dhe te gjegjësjja në greqishte. Megjithatë ai ka meritën e padiskutueshme se pasqyron në një vëllim të vogël, shumë të përdorshëm, një numër relativisht të madh fjalësh.

Edhe në këtë fjalor huazimet greke në fjalësin e shqipes, mbështeten sidomos në ato të pasqyruara dhe që kanë zënë vend në Fjalorin e shqipes së sotme, 1984.

¹⁵⁵ V. Memisha, *Rreth fjalorëve shqip-greqisht dhe greqisht - shqip*, në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, për letërsinë dhe për kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2009, 27/1

¹⁵⁶ Dh. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë, 1976, f. 165

¹⁵⁷ K. Kristoforidhi, *Leksikon tis alvaniqis glossis*, Athina, 1904

¹⁵⁸ K. Kristoforidhi, *Λεξικόν Άλβανο - Ελληνικόν (Fjalor shqip – greqisht)*, Tiranë, 1961

¹⁵⁹ K. Παπαφίλη, *Λεξικό Έλληνο - Αλβανικό (Fjalor greqisht - shqip)*, Αθήνα, 1997

¹⁶⁰ K. Παπαφίλη, *Λεξικό Άλβανο - Ελληνικό (Fjalor shqip – greqisht)*, Αθήνα, 1997

Në vitin 1998, Niko Gjini boton në Universitetin e Janinës, *Αλβανο-Ελληνικό Λεξικό (Fjalor shqip – greqisht)*¹⁶¹, nën kujdesin e drejtpërdrejtë të filologut J. Kapsalis. Fjalori jep lëndë të bollshme për të ndërmarrë studime shkencore në fusha të ndryshme, në ato gjuhësore a jashtëgjuhësore. Autori, në hartimin e Fjalorit, është mbështetur në një literaturë shkencore teorike dhe në botimet më të mira leksikografike njëgjuhëshe e dygjuhëshe në greqishte dhe në shqipe. Fjalori i N. Gjinit shkon në duart e përdoruesit me një fjalës me 50. 000 njësi. Ky korpus kaq i madh fjalësh vetvetiu nënkupton që aty përfaqësohet denjësisht dhe gati e tëra bota materiale, shpirtërore e intelektuale e popullsisë shqiptare, sepse fjalët na çojnë te historia dhe tek e sotmja e popullit tonë, te kultura dhe psikologjia e tij, që shpesh vërtiten në një nënshtrat të përbashkët. Në këtë mënyrë, përdoruesi i fjalorit jo vetëm rrit kompetencën gjuhësore me fjalë, me kuptime, me frazeologji shqipe, por ai përfshihet dhe bëhet padashur pjesë e botës shqiptare. Ndaj vepra *Αλβανο – Ελληνικό Λεξικό (Fjalor shqip – greqisht)*, ka lëndë të bollshme për studiuesit grekë të fushave të ndryshme. Fjalori ka meritën tjetër të padiskutueshme, sepse e gjithë lënda leksikore, semantike, thëniet ilustruese etj. i përkasin shqipes standarde, dhe jep në mënyrë të zgjeruar strukturat kuptimore të fjalëve, duke e bërë fjalorin gati - gati shpjegues, ashtu si kishte bërë më Fjalorin greqisht - shqip, të botuar në vitin 1993.

Dihet që shqipja është gjuhë polisemike (përkundrejt greqishtes që është një gjuhë sinonimike), dhe N. Gjini ka ditur me mjeshtëri jo vetëm të japë pasurinë e saj leksikore në përballje me atë të greqishtes, por të japë edhe pasurinë semantike, një çështje kjo e vështirë për leksikografinë dygjuhëshe. janë me mijëra fjalët që janë dhënë me struktura kuptimore me më shumë se një kuptim, madje kemi shumë fjalë me mbi 5 kuptime që janë në përgjithësi fjalë emërtuese (kuptimplota).

Huazimet nga greqishtja e të pasqyruara në Fjalor, tregojnë edhe zhvillimet semantike që kanë pësuar në shqipe. Mjafton të krahasojmë fjalën *fis* të shqipes, me burim nga greqishtja e vjetër, me fjalën *fis* të greqishtes së sotme në fjalorët e këtij autori, për të parë ndryshimet e zhvillimet e brendshme në secilën gjuhë.

fis, -i, m., sh. -e, -et, ουσ. Αρσ. 1. η φυλή, το φύλο, “për fiset ilire” για τα Ιλλυρικά φύλα, 2. το γένος, η καταγωγή, η συγγένια εξ αίματος, “jemi fis me ata” είμαστε συγγενείς με αυτούς, “fisi i gruas” το γένος της συζύγου, “është një fisi im” είναι ένας συγγενής μου, 3. εθνικότητα, έθνος, “fisi shqiptar” η αλβανική φυλή, το αλβανικό έθνος, φρ. “e ka për fis” το έχει κληρονομικό, “do të vejë në fis” θα το δείξει τι είναι και πόσο αξίζει.

φύση, η Δ., φύσις, (-εως), η Α. Κ., f. 1. natyr/ë, -a f. nga natyra, η ανθρωπίνη φύση natyrë njerëzore, 2. temperament, -i m., sh. -e, -et, natyra e vet, karakter, -i m., αγαθή φύση natyrë e mirë, natyrë e patëkeq, e padjallëzuar, 3. natyr/ë, -a f., bota organike dhe joorganike, η ομορφιά της φύσης bukuria e natyrës, 4. η φύση και τέχνη natyra dhe arti, 5. organet gjinore mashkullore.

Fjalori ka meritë tjetër, të padiskutueshme, se pasqyron me mijëra njësi frazeologjike, në të cilat jo vetëm duken veçoritë dalluese të secilës gjuhë, por për së shumti bëhen treguese edhe të pasurisë etno-linguistike të greqishtes dhe të shqipes etj. Do të mjaftonin vetëm këto njësi për të argumentuar e për të treguar përbashkësitë, por edhe dallimet ndërmjet gjuhëve.

¹⁶¹ N. Γκινη, *Αλβανο - Ελληνικό Λεξικό (Fjalor shqip – greqisht)*, Ιωαννίνων, 1998

Një vepër pak e veçantë është dhe *Fjalori frazeologjik ballkanik*¹⁶² i hartuar nga J. Thomai, Xh. Lloshi, R. Hristova, K. Qiriazati e A. Melonashi, dhe i botuar më 1999. Vepra ka rreth 5.000 njësi frazeologjike në pesë gjuhë: *shqip – bullgarisht – greqisht – rumanisht – serbokroatisht*. Ky fjalor është i pari në llojin e vet jo vetëm në gjuhësinë ballkanike, por edhe në atë evropiane, vlerat e tij janë të rrafshit shkencor-teorik dhe të rrafshit praktik. Fjalori nuk ka fjalës me leksema, megjithatë ai ka rëndësi të madhe, sepse së pari u shërben drejtpërdrejt studiuesve në fushën e gjuhësisë ballkanike, por edhe gjithë atyre që duan të mësojnë në rastin tonë shqipen (kur janë grekë) dhe greqishten (kur janë shqiptarë). Por me lëndën e veçantë që ai përmban, u shërben edhe përkthyesve, edhe shkrimtarëve, edhe publicistëve etj. si dhe të tjerëve që ndiejnë nevojën e studimeve krahasuese ndër-gjuhësore në frazeologji.

Ne kemi folur jo pak për vlerat e veprës, kur kemi huazime të frazeologjisë greke në shqipe apo paralele frazeologjike në të dy gjuhët.

B. HUAZIMET NË FJALORË TË TJERË DYGJUHËSH (SHQIPJA GJUHË E PARË)

Pas viteve ‘40 të shekullit XX në përputhje me rrethanat dhe me kërkesat e praktikës, leksikografia shqipe pati si një drejtim kryesor hartimin e fjalorëve dygjuhësh. Ndër fjalorët ku gjuha shqipe është gjuhë e parë po përmendim: “*Fjalor shqip-frëngjisht*” (1977, me rreth 25000 fjalë) dhe “*Fjalor shqip-frëngjisht*” (1998, me rreth 35.000 fjalë), të hartuar nga Vedat Kokona; “*Fjalor shqip-anglisht i Oksfordit*” (*Oxford Albanian-English Dictionary*, 2000, rreth 70.000 njësi), i hartuar nga Leonard Niumarku; “*Fjalor shqip-anglisht*” (1999, me rreth 45.500 fjalë), i hartuar nga Pavli Qesku; “*Fjalor shqip-gjermanisht*” (*Wörterbuch Albanisch-Deutsch*, 1992, 739 faqe), i hartuar nga Oda Buchhölz, Wilfried Fiedler, Gerda Uhlisch dhe “*Fjalor shqip – gjermanisht*” (2005, me 1765 faqe dhe me rreth 50.000 fjalë i hartuar nga Ali Dhrimo; “*Fjalor shqip-italisht*” (2003, me rreth 40.000 fjalë), i hartuar nga Ferdinand Leka e Zef Simoni; “*Fjalor shqip-italisht*” (1999, me rreth 40.000 fjalë), i hartuar nga Abedin Preza; “*Fjalor shqip-serbokroatisht*” (1976, me rreth 30.000 fjalë e fraza), i hartuar nga Mikel Ndreca; “*Fjalor shqip-serbokroatisht*” (1982), i hartuar nga Abdulla Zajmi, Mehdi Bardhi, Sulejman Drini, Latif Mulaku, Gani Luboteni e Sitki Imami; “*Fjalor historik shqip-anglisht*” (*An historical Albanian-English Dictionary*, 1948, 600 faqe) dhe “*Fjalor anglisht-shqip*” (*An English-Albanian Dictionary*, 1957, 434 faqe), të hartuar nga Stjuart Mani; “*Fjalor shqip-maqedonisht*” (1996, me rreth 40.000 fjalë), i hartuar nga Adnan Agai e Kimete Agai; “*Fjalor shqip-maqedonisht*” (1997, 782 faqe), i

¹⁶² J. Thomai..., *Fjalori frazeologjik ballkanik*, Tiranë, 1999

hartuar nga Haki Ymeri, Petar Atanasov, Zihni Osmani; “*Fjalor maqedonisht-shqip*” (2000, me rreth 42000 fjalë), i hartuar nga Haki Ymeri e Zihni Osmani etj.

Përgjithësisht këta fjalorë janë hartuar pas vitit 1972 dhe veçanërisht, pas vitit 1980, vit kur u hartua *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe. Makrostrukturat e tyre, por edhe mikrostrukturat për fjalësin në shqip, janë mbështetur te ky fjalor*. Kjo do të thotë se *edhe huazimet greke që janë bërë pjesë e leksikut të shqipes së ditëve tona të pasqyruara në këtë fjalor, janë pasqyruar patjetër edhe në fjalorët dygjuhësh ku shqipja është gjuhë e parë*. Këtë e tregojnë në mënyrë të tërthortë *parathëniet* e secilës vepër, në të cilat pohohet janë mbështetur së pari në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, i hartuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Në vitin 1908 u botua në Shkodër “*Fjalori i ri i shqipes*” i Shoqërisë “Bashkimi” (*Fjaluer i Rii i Shcypes*). Është një fjalor *dygjuhësh, shqip-italisht*. Ka rreth 11000 fjalë. Fjalori është mbështetur në dialektin e Veriut. Ky fjalor përfshin një lëndë deri diku të zgjedhur. Në fjalor fjalët jepen në çerdhen e tyre, domethënë emri, mbiemri, folja, ndajfolja, emrat foljorë etj. nga e njëjta rrënjë; p.sh., *ashpër (i, e, t’)*, *ashprim-i*, *ashproj*, *ashpruem (i, e, t’)*, *ashpruemit (t’)*, *ashprueshim (i)*, *ashprueshim ...* Edhe në pjesën shqipe jepen nën një fjalë sinonime shqipe e të huajtura: *mersele-ia*, *prallë-a*; *meidan-i*, *shesh-i*, *patalog-u ...* Fjalori i Shoqërisë “Bashkimi” ka shërbyer gjithashtu si mbështetje për fjalorë të mëvonshëm.¹⁶³

Ne jemi ndalur vetëm tek ky Fjalor për të dhënë disa shembuj nga huazimet greke, meqenëse fjalori është mbështetur në dialektin verior të shqipes dhe ky është një tregues i shtrirjes dhe i ngulitjes së këtyre huazimeve në mbarë shqipen: *akllagii* (toskërisht *oklagi*, sot *okllai / petës*, *mjet për të holluar petët*); *angarii*, *angllatisi*, *apostolik*, *bitis*, *dheksi*, *harakopisem*, *kallakatrum*, *kallam*, *kallamboq*, *llamburis*, *pocaqi*, *pocaqisem* etj.¹⁶⁴

¹⁶³ Shih më gjerë, J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008, f.

¹⁶⁴ Shih më gjerë *Fjaluer i Rii i Shcypes*, Shkoder, 1908

KREU VII

KONTAKTET BASHKËKOHORE TË SHQIPES ME GREQISHTEN

A. GJENDJE BILINGUE NË GREQI DHE HAPËSIRAT E INTERESIMIT LEKSIKO-SEMANTIK

Populli shqiptar dhe populli grek janë dy dhjetëvjeçarët e fundit i kanë rritur kontaktet ndërmjet tyre në mënyrë të jashtëzakonshme. Si ura lidhëse kanë shërbyer ndër të tjera dhe popullsia minoritare greke në Shqipëri dhe popullsia shqipfolëse në Greqi. Pas vitit 1990 drejt Greqisë u nisën valë të tëra emigrantësh shqiptarë, duke kapur një shifër që shpesh i kalon të 600.000 vetët. Ata jetojnë dhe punojnë në një mjedis greqishtfolës, por në shtëpi komunikojnë shqip. Situata bilingue, *me greqishten si gjuhë të bukës dhe me shqipen si gjuhë të zemrës* kërkon patjetër zotërimin e greqishtes.

Kjo patjetër shton mundësitë për futjen në leksik të shumë fjalëve, të njësive frazeologjike dhe të shumë kuptimeve në ligjërimin e tyre shqip në shtëpi apo në kontaktet ndërmjet tyre në mjedise të ndryshme. Kjo dukuri interferuese, që del si dukuri komplementuese (plotësuese, dytësore, sepse ata i kanë fjalë në shqipe) mbartet dhe në mjediset ligjërimore kur vijnë në Shqipëri. Dhe mundësia dhe hapësira e interferimit kështu rritet.

R. Hudson shprehet se “Gjuhë të ndryshme, nuk parashikojnë thjesht mënyra të ndryshme për të shprehur të njëjtat ide, por ato dallohen për një kuptim më të përgjithshëm (dhe interesant): idetë që mund të shprehen mund të ndryshojnë nga gjuha në gjuhë. Ne mund ta quajmë këtë lloj ndryshueshmërie *relativitet semantik...* Relativiteti semantik është se ai zbatohet vetëm te leksiku... Sidoqoftë është e sigurt që variacioni semantik midis gjuhëve është shumë më i madh sesa shumë prej nesh janë të ndërgjegjshëm.”¹⁶⁵

Ky variacion semantik, por edhe leksikor sepse greqishtja është gjuhë sinonimike, ushtron trysni të jashtëzakonshme, siç ndodh në të gjitha popullsitë apo komunitetet gjuhësore të huaja në një vend çfarëdo (në Amerikë, në Gjermani, në Francë, në Greqi, në Spanjë etj.)

Kjo gjendje dygjuhësie te këta shqiptarë greqisht folës duhet të merret në konsideratë dhe duhet të bëhen përpjekje për arsimin në shqip të fëmijëve apo të

¹⁶⁵ R. Hudson, *Sociolinguistika*, Tiranë, 2002, f. 95, 97

moshave të reja, që ata jo vetëm të shkruajnë në shqip, por edhe ta ruajnë shqipen, si gjuhë amtare, nga huazimet e panevojshme nga greqishtja.

B. GJENDJA BILINGUE NË ZONAT MINORITARE NË SHQIPËRI

Situata bilingue (dygjuhësie) i quajtur ndryshe *Gjeobilinguizmi shqiptaro-grek*¹⁶⁶, ka ekzistuar dhe ekziston edhe në zonat në jug të Shqipërisë, por në 20 vitet e fundit dhe më gjerë. Është i njohur ndikimi i shqipes në të folmet greke në këto zona. Ne jemi ndalur për këtë dukuri disa herë gjatë punimit.

Studiuesi Shkurtaj, Gj. shkruan se “Gjeobilinguizmi shqiptaro-grek rezulton të jetë nga më të hershmet takime të shqipes me një gjuhë të huaj, përderisa, siç dihet, iliro-shqiptarët dhe grekët janë dy popujt më të lashtë të Gadishullit të Ballkanit...” Dhe më poshtë vazhdon “Në mënyrë të veçantë do të ishte me interes një studim i thelluar i leksikut të të folmeve të tilla si ajo e Bregdetit të Poshtëm, e Sarandës, e përgjithësisht e të folmet e skajit jugor të Shqipërisë, ku takimi i shqipes me greqishten ka qenë dhe është pasojë, jo vetëm e afërsisë gjeografike të dy popujve, por edhe e fqinjësisë së një pjese të caktuar të toskërishtes jugore me greqishten e enklavave të diasporës greke në Dropull dhe gjetkë. Kjo fushë mjerisht, deri më sot ka mbetur pothuaj djerr.”¹⁶⁷

Në shekullin e njëzet, pas përcaktimit të kufijve shtetërorë të Shqipërisë kuptohet që gjendja dygjuhësore në këto hapësira gjeografikë do të çonte në të folmet greke në hyrjen e shumë fjalëve nga të gjitha shtresat e leksikut të shqipes, sidomos nga ai i jetës së përditshme.

Pasojat e gjendjes politike në gjysmën e dytë të shek. XX për minoritetin grek në Shqipëri, sidomos në vitet 60-80 të këtij shekulli u shfaqën edhe në gjuhën e tyre amtare në greqishtes. P. Barka shkruan se “gjuha amtare, edhe në zonat me popullsi kompakte të etnisë greke *tkurrej në fjalorin e gjuhës së rëndomtë*. Ajo pësoi deformime në përdorim dhe filloi të ndiqte një proces të vetin *idiomatik zhvillimi*, nën ndikimin e imponuar të gjuhës shqipe. Këtë ndikim e hasim në leksikologji, por edhe në fonetikë, morfologji dhe sintaksë. Me qindra fjalë që lidheshin me strukturat e reja të organizimit të jetesës dhe të punës socialiste hynin në arsenalin e gjuhës së përditshme të minoritetit etnik grek, herë të plota, herë duke shtuar prapashtesa apo mbaresa të greqishtes. Kjo ndodhte se kanalet analoge të përdorimit të të njëjtave terma në Greqi ishin të bllokuara. Madje edhe fjalë që shqipja i huazonte nga greqishtja, si hibrid, futeshin në fjalorin e ditës nga shqipja.”¹⁶⁸

¹⁶⁶ Shkurtaj, Gj., *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë, 2009, f. 309

¹⁶⁷ Shkurtaj, Gj., *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë, 2009, f. 309

¹⁶⁸ P. Barka, *Zhvillimet ekonomike-shoqërore e kulturore në Shqipëri dhe mjedisi dygjuhësor*, në Kërkime universitare, 5, Gjirokastrë, 2001

Pas viti 1991, për këtë autor, në Minoritetin Etnik Grek në Shqipëri, kemi një ekuilibër të ri gjuhësor. Po sipas këtij autori te ky minoritet *“ekziston një brez i ri* tek i cili përdorimi i gjuhës amtare është perfekt dhe shumë autoritar ndaj gjuhës zyrtare. Kemi **një brez të mesëm** i cili në rast se nuk ka zhvilluar kontakte të ngushta me shtetin amë dhe ka ruajtur kontaktet tradicionale me shoqërinë shqiptare, gjuha amtare është inferiore ose në pozita të barabarta ndaj gjuhës zyrtare dhe *një brez i tretë* që i përket moshës së tretë ku gjuha amtare është zotëruese.

Do të ishte me interes të ndërmerreshin studime për interesimet leksiko-semantike dhe sociolinguistike tek përfaqësues të këtyre brezave, jo vetëm për të parë gjendjen, numrin e njësisve shqipe, por edhe për të parë rrugët dhe mundësitë e hyrjes në ligjërimin e tyre të përditshëm.

Ndryshim të raportit të elementeve të dygjuhësisë, në favor të gjuhës kemi edhe në familje me martesë të kryqëzuara.

Gjithashtu raportet e reja ekonomike dhe lidhjet e shumëfishta shoqërore e kulturore me Greqinë, risollën si *domosdoshmëri dygjuhësinë* në ambient më të gjerë në formën e dygjuhësisë tekniko-ekonomike, me një shtrirje më të gjerë si *dygjuhësi emigrantësh* përtej kufirit nga njëra anë dhe *dygjuhësi e pastër tekniko-ekonomike* këtë kufirit dhe shtrirje deri në veriun e Jugut të Shqipërisë.¹⁶⁹

Në shtojcën e punimit¹⁷⁰ për doktoraturë ne kemi dhënë qindra njësi leksikore që kanë hyrë në të folmet greke dhe si kemi pohuar shpesh herë, pavarësisht shtresës mbizotëruese të interferimeve leksikore, semantike a frazeologjike etj., jo të gjitha njësitë janë të brumit të shqipes. Ato mund të jenë huazime brenda leksikut të shqipes. Ndaj nuk është aspak e rasti që në këto interferime gjejmë edhe sllavizma, turqizma, italianizma etj.

¹⁶⁹ P. Barka, *Zhvillimet ekonomike-shoqërore e kulturore në Shqipëri dhe mjedisi dygjuhësor*, në Kërkime universitare, 5, Gjirokastrë, 2001

¹⁷⁰ Shih Kreun IX të punimit, por edhe lëndën e dhënë në kapituj dhe në sytha të mëparshëm.

KREU VIII

QËNDRIMI NDAJ HUAZIMEVE NË DITËT E SOTME

Fjalët e huaja hyjnë në një gjuhë në kushte të caktuara gjuhësore e jashtëgjuhësore. Në gjuhën shqipe situata është krejt ndryshe nga ajo në gjuhën greke, për statusin e të cilave ne tashmë jemi ndalur shpesh herë në faqet e këtij punimi. Shqipja ka qenë e hapur ndaj greqishtes, dukuri që ajo e tregon edhe sot kur fjalët e huaja shumë shpesh futen në leksikon e saj pa asnjë kontroll. Sa për ilustrim po i përmendim disa fjalë që na bie shpesh t'i ndeshim në mediat tona: *involvoj (involvim), prononcoj (pronocim), trajnoj (trajnim), relaksoj (relaksim), negocioj (negocim), menaxhoj (menaxhim), fashionoj (fashionim), suprimoj (suprimim), implementoj (implimentim), konspiroj (konspirim) konspiracion; pastaj logjistikë, kasko, balotazh, akses, ruletë, trojkë, konvejoj, staf, bodigard, fleksibil, okular* etj. Qëndrimi ndaj këtyre fjalëve duhet të jetë shkencor, nuk duhet të pranohen ose duhet të zëvendësohen me shpejtësi, sepse shqipja ka fjalën e vet për secilën.

Huazimet greke që i përkasin sidomos historisë dhe jo ato të ditëve të sotme, kanë zënë vend në fjalorin e shqipes së sotme, sepse kanë hyrë në përdorim në bazë të vlerave që kanë sjellë vlera shënuese, semantike, fjalëformuese, shprehëse, stilistikore etj. Ato në ndërgjegjen e përdoruesit të ri, bashkëkohor, nuk trajtohen si huazime, prandaj ato duhet të trajtohen si pasuri e shqipes. Zhvillimet e shumanshme fjalëformuese, semantike, sintagmatike, paradigmatiske, stilistikore etj.) që kanë ndodhur tek ato e tregojnë vlefshmërinë e tyre.

Sot kemi shumë huazimet leksikore, veçanërisht nga anglishtja, kryesisht në terminologji, por edhe në leksikon e përgjithshëm, huazime që e pasurojnë shqipen. Por nga huazimet e shqipes standarde po i vjen sot një valë e madhe fjalësh, forca e së cilës shumëfishohet nëpërmjet ndërthurjes së huazimit me neologjinë. Mund të thuhet gjithashtu se fjalët huazuara shpesh janë edhe më të paqëndrueshmet, për shkak të mënjanimin të vetvetishëm a të vetëdijshtëm të fjalës shqipe.

Sipas disa studiuesve fjalët e huaja e pasurojnë gjuhën, sipas të tjerëve ato e prishin dhe prandaj duhen nxjerrë të gjitha nga përdorimi. Në këtë çështje duhet mbajtur një qëndrim i drejtë dhe i mbështetur shkencërisht. Por siç u shprehëm, shumë fjalë nga greqishtja **janë bërë pronë e leksikut të shqipes**, si *lakër, mokër, i pastër, murg* etj. dhe zëvendësimi i tyre me fjalë të tjera nuk mund të bëhet më.

Po kështu kanë zënë vend në leksikon e gjuhës sonë edhe fjalët ndërkombëtare (ndërkombëtarizmat / internacionalizmat) dhe termat e fushave të ndryshme me burim grek që kanë hyrë në këta 100 vjetët e fundit, edhe pse mund të kenë hyrë në mënyrë të tërthortë në përdorim (nga anglishtja sidomos).

Huazimi ka vlerën e vet pasuruese, por huazimi pa kufi, pa kontroll e pengese, kthehet në një dukuri të dëmshme për gjuhën tonë, sidomos kur mbushet me fjalë të huaja ligjërimi i folur ose shtresa leksikore e përdorimit të përgjithshëm. Prandaj **duhet të bëhen përpjekje për të penguar huazimin e fjalëve nga gjuhë të tjera ose për të hedhur jashtë përdorimit fjalët e huaja, kur për ato kemi fjalë shqipe, plotësisht me të njëjtin kuptim, më të njohura, të përpikta e të qarta për folësit e shqipes**. Veprimtaria

e gjerë e shkrimtarëve, e gazetarëve, e veprimtarëve politikë e shoqërorë, e njerëzve të kulturës e të artit etj. për pastrimin e pasurimin e gjuhës standarde, konkretizohet edhe me zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë shqipe, një pjesë e të cilave janë botuar në librin “Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj” (1998).

Çështja e pastërtisë së leksikut lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen e gjuhës amtare, si tipar themelor i kombësisë, nga çdo përzjerje e huaj, si edhe me kristalizimin e normave të gjuhës standarde në leksik. Në këtë sistem norma letrare, siç e kemi thënë më parë, është më e çlirët, sesa në fonetikë e në gramatikë. Kjo do të thotë që, përveç disa varianteve leksikore (siç janë sinonimet), gjuha standarde pranon edhe fjalë të huaja, të domosdoshme për përmbajtjen e tyre dhe për kërkesat e disa fushave, si terminologjia, ligjërimi shkencor etj. Por është krejt i papërligjur vërshimi pa kufizim i fjalëve të huaja të panevojshme, siç ndodhi në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XX e siç po vijon edhe sot, sidomos në publicistikë e në ligjërimin politiko-shoqëror. Këtu duhet bërë një punë shumë e madhe pastruese e shqipëruese, sepse publicistika ka një peshë të pazëvendësueshme në edukimin e gjithanshëm dhe gjuhësor të popullit, sidomos të brezit të ri.

Prof. E. Çabej shkruan se pastrimi i gjuhës nga mishi i huaj është një detyrë shkencore, njëkohësisht edhe kombëtare. Nuk është aspak shenjë shovinizmi, shqiptari nuk e ka traditë shovinizmin.

Shembullin më klasik, për pasurimin dhe për mbrojtjen e fjalës së gjuhës amtare na e tregon vetë gjuha greke, e cila është shumë ngurruese ndaj fjalëve të panevojshme, edhe pse stile dhe ligjërimi të ndryshme e përballin fjalën greke me fjalën e panevojshme angleze, franceze, gjermane, ruse etj.

Rrugët dhe mjetet për ta bërë këtë pastrim ndaj huazimeve (por nuk duhet të luftojmë çdo fjalë të huaj në gjuhën shqipe) janë. Mundësitë dhe njerëzit gjithashtu, janë. Duhet vetëm punë e përgjegjësi shoqërore e kombëtare. Prof. Miço Samara thekson që “Nga vëzhgimet tona del se rruga kryesore e pasurimit leksikut politiko-shoqëror me njësi të reja ka qenë dhe është formimi i tyre *sipas mënyrës morfologjike*, që do të thotë formimi i fjalëve a i termave me brumin e shqipes sipas mënyrave e tipave të saj të fjalëformimit ose krijimi i tyre me anë të kalkimit (sidomos për disa terma), në përputhje edhe me kërkesat për pastrimin e tij nga huazimet e panevojshme. Formimet e reja të këtij leksiku sipas kësaj mënyre janë në përgjithësi fjalë diturore (të fushës së shkencave politike e shoqërore dhe të ligjërimin libror).¹⁷¹

Po mjaftohemi me dhënien e disa interferimeve të leksikore dhe semantike, ndja të cilave duhet të mbajmë qëndrim, për t’i zëvendësuar, por gjithnjë në mënyrë shkencore dhe asnjënjë, pa rënë në purizëm:

cukunidhe (hithër), cukunis (më djeg hithri, më përcëllon, por edhe më shndërrime kuptimore të figurshme), psonis (bëj pazar, blej), lllagar (i pastër, i kulluar), lllagatos (pastroj, kulloj), dhokan (zdrukth), dhokanis (e lodh, e mërzit), patom (shputa e këmbës: Sa ma ka patomën!), potis (ujit), potistir (ujitëse lulësh etj.), foti (kandil, ndriçues me vajguri), kallafatis (ha, përpjij), skordhan (tarator), kalistir (vegël me presë e me veshë për të prashitur), suflaqe (pite etj. të mbushura me mish, qepë, domate, salcë etj.), proftas (arrij: nuk proftasa – nuk arrita...), palikar (trim), vromë (i pistë, grua e përdalë), skupje (fshesë), skupidhe (të fshirat, mbeturina), qinito (celular), merokamë (ditëpunë) etj.

¹⁷¹ M. Samara, Pasurimi i leksikut politiko-shoqëror me njësi të reja në shqipen e sotme, në SF, 3-4, 2008

KREU IX

SHTOJCË

1. LISTIME TË HUAZIMEVE GREKE NË SHQIPE TË NXJERRA NGA PUNIMET E STUDIUESVE TË NDRYSHËM

a. Huazimet foljore prej greqishtes në shqipe të nxjerra nga J. Kume¹⁷²:

a. 1. Foljet në shqipen standarde, nxjerrë prej “Studimeve gjuhësore” të E. Çabej¹⁷³

anangas (ngacmoj) krahin.
arratisem (mërgoj, largoj)
ciknoset (ziej tepër gjellën)
cimbisem (pickoj)
cimbidh (pickoj)
cingarisem (fërkoj diçka deri sa të skuqet fort)
cingërisem (ngacmoj me dorë ose me fjalë, shpoj me diçka)
cuks (djeg, përcëllon) krahin.
farmakos (helmoj) bised.
feks (shkëlqen)
gremisem (rrëzoj) bised.
honepset (pëlqej) bised.
karfosem (ngul)
kakaris
katandis (çoj në pikë të hallit)
kolis, kolisem (ngjis)
kopanis (rrah rrobat me kopan kur i laj) bised.
kuis
kumbis, kumbisem (mbështes trupin ose kokën)
lipsem (e flak tutje, e përzë, e shporr, e largoj) bised.
lajthis (gaboj pa dashur, ngatërrohem për diçka)

¹⁷² J. Kume, *Ndikimi i greqishtes në sistemin foljor të shqipes*, në “Seminari II Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2008

¹⁷³ Lënda është vjelë nga E. Çabej, *Studime gjuhësore*, I, Prishtinë, 1976; *Studime gjuhësore*, II, Prishtinë, 1976; *Studime gjuhësore*, III, Prishtinë, 1976; *Studime gjuhësore*, IV, Prishtinë, 1977; *Studime gjuhësore*, V, Prishtinë, 1977

llahtaris (friksoj shumë dikë) bised.
llogaris (numëroj ose njehsoj diçka, kontrolloj me mend)
mbodhisem (vonoj, pengoj) krahin.
mirose (parfuj, lyej me vaj të bekuar), *mirose* (përmiërsohem) bised.
molepsem (ndot, i ngjit dikujt një sëmundje)
nanurisë (vë në gjumë foshnjën duke i kënduar)
ormisë (nderq, gatit, rregulloj) krahin.
pikasem (vë re, zbuloj dikë që kërkon të fshihet)
pleksëm (thur, gërshetoj, ngatërroj)
piksem (mpiks, ngjiz)
psonis (blej) bised.
qendis (qëndis një çentro)
qerasem (gostis dikë me pije dhe ëmbëlsira)
qivernis, *qeveris* (drejtoj)
skalis (gdhënd, punoj me daltë gurin) edhe krahin. në rastin e prashitjes p.sh.: Skalitën misrin
sosem (i jap fund diçkaje) bised.
stisë (ngre) bised.
stolis (zbukuroj)
tagjis (ushqej) fig.bised.
taks, *taksem* (premtoj) bised.
tendosem (shtrij)
tromaks (frikësoj) bised.
vithis, *vithisem* (fundost, humbet, shembet)
zalis (bëj që të bie të fikët)
zilepsem (kam zili) bised.

2. Folje nga Studimet etimologjike të E. Çabejt (që nuk përfshihen në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, 1980)

aparjas / heq mënjën, veçoj, heq dorë / nga aoristi *απαρίασα* i foljes *απαριάζω*
apofasis / vendos / nga aoristi *αποφάσισα* i foljes *αποφασίζω*
armenis / nga aoristi i foljes nga gr. e re *αρμενίζω*, *αρμένισα*, kjo prej gr. së vjetër
arnis / mohoj / nga gr. e re *αρνούμαι*
arratis / mërgoj, largoj / nga aoristi *αρατίσα* i foljes së gr. së re *αρατίζω*, *αρατίζομαι*
aspos / zhduk / *αποσώνω* aoristi *απόσωσα*
çunguris / përpyjek dy sende njëri me tjetrin / etimologji dyfishe, fomë onomatopeike me mjete vendase, ku në formimin si folje ka ndikuar folja greke *τσουγκρίζω*
çallapatis / zhubros, rrudh / gr. e re *τσαλαπατώ*, kjo prej aoristit *τσαλαπάτησα*. Fjalë e formuar prej ndaj.turke *çala* dhe gr. *πατώ* (shkel)
cingëris / *τσιγκρίζω* nga aoristi *τσιγκρισα*
cuks / më djeg lëkura, syri / *τσούζω* aoristi *έτσουζα*
dheks / pranoj / të gr.së re *δέχομαι*
dhifis / ngul thellë shikimin, ngul thellë / nga aoristi *βύθισα* i foljes *βυθίζω*
fanitet / më del si hije, e shoh si vegim / *φανερώνω*, *φανέρωσα*
feks / ndrit, shkëlqen / nga aoristi *έεφεξα* i foljes *φέγω*
gremis / rrëzoj / nga aoristi *γκρέμισα*, i foljes *γκρεμίζω*

harakos / heq viza, vizoj / nga aoristi χαράκωσα i foljes χαρακώνω
holas / helmoj, hidhëroj / nga aoristi χόλιασα i foljes χολιάζω
naskiris / nderq, rregulloj / gr. e re ανασκυράω, nga aoristi ανασκύρησα).
ngos, ngosem / ngop, ngij / prej gr.së re αγκώνω (fryj), e cila nëpër dialekte përdoret
për barkun e madh që vjen prej së ngrënit
ormis / gatit, nderq, rregulloj / nga aoristi όρμησα i foljes ορμω, ορμίζω
rufis / thith, surb / nga aoristi ερούφησα i foljes ρουφώ

3. Folje, të nxjerra nga Fjalori etimologjik i Gustav Meyerit¹⁷⁴

adhëres (ngacmoj), ndoshta adhëris nga gr. e re ερεθίζω
adhjasënj (jam i lirë, i ngeshëm) nga gr.e re αδειάζω
aksafna ndaj. (papritur) nga gr.e re άξαφνα
akoma ndaj. (tosk. ende) nga gr.e re ακόμα, ακόμη
ambnis (qetësohem) nga gr.e re αναπνέω
anamesa (mespërmes) nga gr.e re ανάμεσα
anangas (detyroj, ngut) nga gr. e re αναγκάζω
angalas / përqafoj / nga gr.e re αγκαλιάζω
angosinj / mbytem / nga gr.e re αγγώνω
apofasis / vendos, caktoj / nga gr.e re αποφασίζω
armenis / zbarkoj / nga gr.e re αρμενίζω
arravonjas / fejoj / nga gr.e re αρραβωνιάζω
arrnis, arrnisem / mohoj, refuzoj / nga gr.e re αρνούμαι
cëcëris / cicërij / nga gr.e re τσιτσιρίζω
cigaris / shkrij me gjalpë / nga gr.e re τσιγαρίζω
cimbis / pickoj / nga gr.e re τσιμπώ
citos / mbush plot / nga gr.e re τσιτώνω
cpodhisem / pengohem / nga gr.e re μποδίζω
currufiks / djeg në sipërfaqe / nga gr.e re τσουρουφλίζω
çuçris / pëshpëris në vesh / nga gr.e re τσουτσουρίζω
dheks / pranoj / nga gr.e re δέχομαι
dhidhaks / mësoj (të tjerët) / nga gr. e re εδίδαξα
dhjexas / lexoj / nga gr.e re διαβάζω
dhjoris / caktoj / nga gr.e re διορίζω
dhokimas / provoj, kontrolloj / nga gr.e re δοκιμάζω
efharistis / kënaq / nga gr.e re ευχαριστώ
fandaks / kapardisem me diçka, krenari, mburrje, geg. shfaqje fantazmash (gr. e re)
fanepsem, fanarosem / fanitem / nga gr.e re ndoshta ka ndikuar έφεξα nga φέγω
farmakos / helmoj / nga gr. e re φαρμακώνω
feks / ndriçoj / nga gr.e re φέγω, έφεξα
fileps / vë për të ngrënë, qiras / nga gr.e re φιλεύω
filoniqis / grindem, zihem / nga gr.e re φιλονεικώ
foveris / tremb, friksoj, kërcënoj / nga gr.e re φοβερίζω
ftes / bëj faj / nga gr.e re φταίω

fyteps / mbjell / nga gr.e re / φυτεύω, εφύτεια
 gamëlis / leh / nga gr. e re γαυγίζω
 gremis / rrëztoj, shkatërroj / nga gr.e re γκρεμνίζω
 grunis / hungëron derrkuci / nga gr.e re γουρουνίζω
 halas / kalb, prish, shkatërroj / nga gr.e re χαλάνω
 harapsem / shfaqem, dukem / nga gr.e re χαράζει
 holas / trishtohem, mërzitem / nga gr.e re χολή
 heretis / përshëndes / nga gr.e re, χαιρετώ
 kakaris / zëri që lëshon pula / nga gr.e re, κακαρίζω
 kamburjas / përkul, bëj gungë / nga gr.e re, κουμπαριάζω
 karfos / godas, plagos / nga gr.e re, καρφώνω
 katadhikas / dënojt me gjyq / nga gr.e re, καταδικάζω
 katafronis / përbus / nga gr.e re, καταφρόνηση
 katandis / ul poshtë / nga gr.e re, καταντώ
 kllōcis / shkel me këmbë, shkeltoj / nga gr.e re, κλωτσάω
 kolisem / ngjitem, nuk i ndahem dikujt / nga gr.e re, κωλώ
 kopanis / rrah me shkop / nga gr. e re, κοπανώ
 kordhos / bëj krenar, kapardisem / nga gr. e re, κορδώνω
 ksemollojis / pagëztoj / nga gr. e re, εξομολογώ
 ksetaks / kërktoj, hulumtoj / nga gr.e re, εξετάζω
 ksijis / shpjegoj, shtjelloj / nga gr.e re, εξηγώ
 kufis / shurdhoj / nga gr. e re, κουφαίνω
 kuis / për zërin e dërrit e të qenit / nga gr. e re
 kumbisem / mbështetem / nga gr.e re, ακουμπάω
 kupis / vozis me rema / nga gr. e re, κουπί
 lajthis / gabojt, harroj / nga gr. e re λάθος
 lanis / coptoj / nga gr. e re, λιανίζω
 lavos / plagos / nga gr. e re, λαβώνω
 lemonis / jam i mëshirshëm / nga gr. e re, ελεημοσύνη
 leprosem / më zë gërbula / nga gr. e re, λεπρός
 ligjis / përkul / nga gr. e re, λιγίζω
 lipisinj / mishëroj / nga gr. e re
 lipsem / nuk jam i pranishëm, mungoj / nga gr. e re λείπω
 los / tres, shkrij / nga gr. e re, λιώνω
 lufaks / qetësohem / nga gr. e re, λουφάρω
 lurosem / lahem / nga gr. e re λούζομαι
 llahtaris, lahtaris, laftaris / dridhem, trëmbem / nga gr. e re, λαχταρώ
 llogaris / njehsoj, vras mendjen / nga gr. e re, λογαριάζω
 mbinj / ngurtësoj / nga gr. e re
 mbodhis / pengoj / nga gr. e re, μποδίζω
 mirjollojis / qaj duke kënduar një të vdekur / nga gr. e re μοιρολογώ
 miros / lyejt me vaj të bekuar / nga gr. e re μύρος
 moleps / njollos, ngjis një sëmundje / nga gr. e re, μολύνω
 mollojis, mollois / pranoj, rrëfej, tregoj / nga gr. e re ομολογώ
 muhulon / zë myk, kalbet / nga gr. e re μουχλάζω
 mungris / bulurin / nga gr. e re, μουγκρίζω
 nakatos / përziej, ngatërroj / nga gr. e re, ανακατώνω
 ngales / padis / nga gr. e re
 ngjeps / provojt, shijoj / nga gr. e re, γεύση

nomotis / emëroj, quaj / nga gr. e re óνομα
ormis / përgatis, stolis / nga gr. e re, ορμώ
paflatis / llomotis, flas shumë / nga gr. e re, φαφλατάς
papsem / prehem, çlodhem / nga gr. e re, παύω
parakales / lutem / nga gr. e re, παρακαλώ
parastenj / përrjetoj një ngjarje / nga gr. e re,
parigoris / ngushëlloj / nga gr. e re, παρηγορώ
pataks / shtang nga habia / nga gr. e re , πάταξα
pedheps / njoftoj / nga gr. e re, παιδεύω
petasem / i hidhem diku / nga gr. e re, πετάζω
piks, pikem / fortësoj, ngurtësoj / nga gr. e re πήζω
piraks / ngacmoj / nga gr. e re, πειράζω
plakos / sulmoj, i bie përsipër / nga gr. e re, πλακώνω
planeps / mashtroj / nga gr. e re, πλανεύω
plasmonj / bëj, ndërtoj, formoj / nga gr. e re πλάθω
pleks / gërshetoj, thur / nga gr. e re, πλέκω
pohtis / arrij, fitoj / nga gr. e re, αποκτώ
pondis / zhys, fundos / nga gr. e re πόντος
porneps / kurvëroj / nga gr. e re, πορνεία
porseks / dalloj, shquaj, vrej / nga gr. e re, προσέχω
potis / i jap ujë bagëtisë / nga gr. e re, ποτίζω
preps / duhet / nga gr. e re, πρέπει
prodhos / tradhtoj / nga gr. e re, προδίδω
prokops / lulëzoj, përparoj / nga gr. e re, προκόβω
proskonis / pranoj / nga gr. e re ,
provodhonj / dërgoj / nga gr. e re προβοδίζω
psalonj / këndoj në meshë / nga gr. e re, ψέλνω
psarinj / lyej me vaj të shenjtitë / nga gr. e re,
qendis, qindis / qëndis / nga gr. e re, κεντώ
qeras, qiras / jap dhurata, bakshish / nga gr. e re, κερνώ
qerdhes / fitoj / nga gr. e re, κερδίζω
qilis / lëroj tokën / nga gr. e re
qiverris / drejtoj, udhëheq / nga gr. e re, κυβερνάω
rokanis / përryp me zhurmë, zdrukthoj / nga gr. e re, ροκανίζω
rufis / gjerb, surb / nga gr. e re , ρουφάω
rrëmaks / shkretoj / nga gr. e re, ριμάζω
rrohalis / gërhas / nga gr. e re, ροχαλίζω
sevas / ngushëlloj, pajtoj / nga gr. e re, σέβομαι
sihenem / neveris / nga gr. e re, συχαίνομαι
silloi, silloisem / mendim, kujdes / nga gr. e re, συλλογίζομαι
singris / krahasoj / nga gr. e re, συγκρίνω
skalis / gdhend në dru / nga gr. e re , σκαλίζω
sklimuris / kujis, qaj / nga gr. e re
skondaps / shqetësoj / nga gr. e re , σκοντάφτω
skuri, skurisem / ndryshk, ndryshkem / nga gr. e re, σκουριάζει
sos / mbaroj, arrij / nga gr. e re σώνω
stenem / qëndroj drejt / nga gr. e re , στείνω
stolis / vesh, zbukuroj / nga gr. e re , στολίζω
streks, stereks / miratoj, pranoj / nga gr. e re,
tajis / ushqej / nga gr. e re, ταιζώ

taks / caktoj, premtoj / nga gr. e re, τάζω
 tapinos / përrul, poshtëroj / nga gr. e re, ταπεινώνω
 taraksem / turbullohem, shqetësohem / nga gr. e re, ταραζώ
 trallisem / mpihem, më merren mend /
 trifis / ushqej / nga gr. e re τρέφω
 triqimis / trondis, shkatërroj / nga gr. e re, τρικυμία
 tromaks / tremb / nga gr. e re , τρομάζω
 vares / mërzis / nga gr. e re βαριέμαι
 veyjos / miratoj, premtoj, vërtetoj / nga gr. e re βεβαιώνω
 vithis / zhys, mbys / nga gr. e re βυθίζω
 vllasfimis / blasfemoj, mallkoj / nga gr. e re, βλασφημώ
 vromeps / qelbem / nga gr. e re, βρομώ
 zalis / bëj t'i merren mend / nga gr. e re, ζαλίζω
 zepsenj / shaloj, zbukuroj kalin / nga gr. e re ζεύω

Fjalorth i huazimeve greke të shqipes (Λεξικό των ελληνικών δανείων της αλβανικής) të nxjerra nga studimi i Dh. Q. Qiriazit¹⁷⁵

abdhelë / avdellë - **αβδέλλα** një lloj insekti, shushunjë.

adhiqu - **αδικία** padrejtësi.

adhjas - **αδειάζω** boshatis, zbraz, rregulloj. Përdoret në Konispol, Janjar (Sarandë) etj.

afendiko / efendiko pronar, zot i diçkaje, titull që merrnin zakonisht ortodoksët e pasur, punëdhënës; njeri mendjemadh.

aforizmë - **αφορίσμα** aforizëm; shkishërim, ajo gjë që është e mallkuar.

afratë - **αφράτο** lëng zhive që përdorin gratë për fytyrën; diçka e hidhur; përdoret dhe metaforikisht. Shprehje: Kjo ime kunatë është nga goja afratë.

afrato - **αφράτος** i, e butë, i lehtë si shkuma. Shprehje: raki afrato. Përdoret në zonën Rrëzomë - Delvinë.

aftë - **άφθα** ekzantemë ose prishje e gjuhës tek fëmijët e vegjël; temperaturë e lartë; sëmundje e lopëve që shoqërohet me shfaqjen e kisteve në gojë dhe në trup të tyre.

agripni - **αγροπνία** të qenit vigjilent, syhapët; vigjilencë.

aguridhe - **άγουρος** frut i papjekur mirë; në mënyrë të figurshme përdoret dhe për njerëzit.

ajazmë / ajasmë - **αγίασμα** ujë i bekuar dhe i shenjtëruar; ceremonia e bekimit të ujit ose spërkatja me ajasmë.

ajovimë/ajodhimë - **άγιο βήμα** hap i shenjtë, vendi i shenjtë nëpër të cilin ka kaluar një shenjtor; dhoma brenda kishës, në të cilën kryhet mesha nga prifti, hijerore.

akatastasia - **ακαταστασία** parregullsi, çrregullsi. Shprehje: Nuk është Perëndi e akatastasisë, por e paqes.

akoma - **ακόμα** ende. Shprehje: Akoma nuk kuptuat? Akoma nuk është thyer?

¹⁷⁵ Δ. Κ. Κυριάκης, Ελληνικές Επιδράσεις στην Αλβανική (I. Φωνητική και μορφολογική προσαρμογή των ελληνικών δανείων; II. Λεξικό των ελληνικών δανείων της αλβανικής), Θεσσαλονίκη, 2001

akumbis / kumbis - ακουμπώ mbështetem diku, themeloj, prehem; Idiomë: Nuk kumbisin shpresën në trup.

alfavitar - αλφαβητάρι alfabet,; shembull: alfabetar shqip.

alisivë / alsivë - αλισίβα finjë.

allo / alla - άλλος tjetër.

allosua / allasua - άλλο σόι i ndryshëm, i çuditshëm, i veçantë.

amin - αμην pasthirmë, kur lutemi në kishë. Përdoret në dialektin toskë më shumë

amnistia - αμνηστία amnisti.

Anakatos / nakatos – ανακατόνω / νακατόνω shkund, përziej, zë brumin, bëj rrëmujë; përzihem, më përzihet në stomak. Shprehje: nakatosur me gjak; verë anakatosur me zmirnë; brumë që një grua nakatosi me miell; mos e nakatos shtëpinë, ngjan me tallaz deti kur nakatoset etj.

anangas / nangas - αναγκάζω shtyj, nxis, detyroj. Shprehje: u anangasnë nga Shenjti Shpirt; atë çast anangasi Isui nxënësit e tij të hyjnë në varkë.

Anapodha / anapolla - ανάποδα së prapthi, mbrapsht. Përdoret në Korçë, në Gjirokastër, Konispol, Kavajë, Tiranë. Shprehje: Është anapodha me mua.

anapodhjar - αναποδιάρης i mbrapshtë, që fut hundët ngado dhe ngatërron. Përdoret në Gjirokastër, Korçë.

anathema / anatemë - ανάθεμα shkishërim, mallkim. Shprehje: Kemi shtrënguar veten me anathema.

anavas - ανεβάζω rregulloj, vë një punë përpara. Shprehje: U, moj të ligat e mia / u navastë Perëndia.

andis - αντίς / αντί në vend që të. Shprehje: Andis që të rëndojë...është e lehtë fare; andis t'i jepte dorën, i dha të shtyrën; andis të merrtë pulat...mori langoin

andrallis / andrallos / andrallosem - αντραλίζομαι i marr mendjen dikujt, e trullos. Shprehje: E andrallosën atë duke e pyetur për shumë punë.

andrrallë / ndrellë - αντράλα marramendje, trullosje. Shprehje: E zuri andralla; më vjen andrrallë.

anëmi / anem - ανέμη qerthull, shtjellës.

angalias / angalas - αγγαλιάζω përqafoj, shtrëngoj në krahë. Shprehje: Petroja e angalasi atë.

angari - αγγαρεία punë e detyruar pa shpërblim, që nuk fal kënaqësi. Shprehje: Punoj angari, marr angari.

angjinare - αγκινάρα lloj bime e cila përdoret edhe për sallatë.

angjistrë - αγκίστρι grep, çengel. Shprehje: Shko në det dhe hidh angjistrën.

angusë - αγκούσα angështi, siklet, pengesë në frymëmarrje. Përdoret në zonën e Çamërisë, në Gjirokastër, në Kurvelesh etj.

anicirë - ανασίργια rrëngqethje, ndot, shpifje nga diçka. Shprehje: Të vinte anicirë t'i hidhje sytë.

apati - απάθεια apati, limonti, indiferentizëm, shkujdesje. Shprehje: E shoh botën me dëshpërim, tërë apati.

apikas / pikas / pikasje - απεικάζω vë re, vëzhgoj, mendoj, konsideroj, konsistoj, dalloj, veçoj.

apistja - απιστία / απιστεά lloj bime. Shkurre. Përdoret në zonat e Gjirokastrës, në Delvinë dhe në Çamëri gjithashtu dhe si toponim

apokalips - αποκάλυψη zbulim, shfaqje, fetare: shfaqja e mistereve të fshehta të kishës dhe të vullnetit të shenjtë. Shprehje: sikundër më apokalipsi Perëndia; ja me apokalips, ja me të ditur, ja me profeci; sikundër ishte apokalipsi e të shfaqurit e të fshehurës

apollogji - απολογία apologji, shfajësim, përgjigje, ndërveprim

- apostoll / apostull** - **αποστολή** apostull, i dërguari, ai që përhap fjalën e Zotit. Shprehje: fjalët e apostollit / apostonjtë i thanë Zotit
- apuraq** - **απόρρακο / απορράκι** ekstrakti, nxjerrja e fundit të rakisë. Përdoret në zonën e Delvinës.
- araks / raks** - **αράζω** ankorohem, vonohem, shastisem, ndaloj, frenoj. Shprehje: Araksën në liman; Shaniko moj tine, / turpërove Haxhinë, / rakse Abedinë; raksi anijen.
- argas / argasje / argasem** - **αργάζω** përpunoj lëkurë, lëmoj, bëj turshi. Në zonën e Korçës përdoret /argas/, kurse në atë të Gjirokastrës /ergas/
- argat / ergat / argjat** - **αργάτης / εργάτης** punëtor krahu, shërbëtor, zbatues i një pune, punëtor për punë bujqësie. Shprehje: Argati është i zoti për pagë të tij; të marrë ergatë për të korrat e tij.
- argati** - **εργασία** punë me mundim dhe angari.
- argjilë** - **αργίλλα** deltinë, baltë me ngjyrë të hapur, ose të kuqe që përdoret në prodhimin e qeramikës.
- arhimandrit** - **αρχιμανδρίτης** titull hierarkie në kishën ortodokse.
- arhipeshk** - **αρχιεπίσκοπος** kryepeshkopi, i pari i peshkopëve.
- arhond / arhondar / arhondeshë** - **άρχοντας** kryetar, udhëheqës, qeverisës, pasanik, pronar.
- arki / arqi** - **αρχί** i parë, i pari që bëhet në fillim, kur ndodh për herë të parë, parashtesë që vendoset para emrave.
- arkondi** - **αρχοντία** zona në të cilën qeveriste një arkond, pronat e tij.
- arkudhë** - **αρκούδα** ari. Shprehje: Është i fortë sa një ari.
- armate / armatë** - **αρμάτα** stolitë prej floriri që vendosnin gratë, gjerdan i florinjte.
- armatos** - **αρματώνω** armatos, pajis me armë, furnizoj me mjete, me instrumente / armatos me njohuri. Shprehje: Kur i forti i armatosur...; hodhëm në det e armatosën anijet.
- arme** - **αρμιά / αρμαιά** shëllirë, që ruhet në kacek, gjithashtu edhe lakër arme.
- armoni** - **αρμονία** harmoni, melodi.
- aromë** - **άρωμα** aromë, erë e këndshme.
- arqidhjak** - **αρχιδιάκος** i pari i dhjakëve, i atyre që shërbejnë në kishë.
- arqigo** - **αρχηγός** kryetar, udhëheqës. Shprehje: More Spiro arqigoi, s'duron turpe Qeparoi.
- arratis** - **απατίζω / απατός** zhdukem, largohem me shpejtësi nga diku, rrëzohem, etj.
- arravonjas / rovunjas** - **απαβωνιάζω / απαβωνιάζομαι** fejoj; fejothem, premtoj për martesë. Shprehje: E kishte arravonjasur për grua; e rovunjasi vajzën atje.
- arrëti / arreti** - **αρετή** trimëri, forcë. Shprehje: Sa të mira e begati, e urtë, e ditur, e të dëgjuar na ka dhënë, sa mjeshtëri e arrëti, sa vyrtet e forcë e trimëri.
- arsenik / arsenικό** arsenic, lloj ilaçi.
- astrit / ασπίτης** një lloj gjarpri; njeri i shpejtë dhe kurajoz. Shprehje: Astriti është me pika si larash, pak më i vogël dhe ka dhrongalea.
- astrolog** - **αστρολόγος** ai që parashikon të ardhmen duke studiuar yjet, magjistar.
- avellis** - **αβδελίζω** përdoret për kafshët kur këlbazen. Shprehje: Në atë burim mos u jep ujë ka avellë e i avellis.
- avgullon** - **αβγόλαδο** një lloj përzierjeje me vezë, vaj ulliri, etj. Përdoret në fshatrat e malit Tomor, në Berat etj.
- avis / abis** - **άβυσσος** pafundësia e detit / humnerë, hon, greminë. Shprehje: Duke ecur nëpër rrugët e nevojshme të avisit.....në avis të dheut.

avli / avlli - *αυλή* oborr, vend përpara shtëpisë i rrethuar zakonisht me mur; mur që rrethon shtëpinë; vend për të mbajtur bagëtinë. Shprehje: Në avlli të dhenve; vura shkallët në avlli / të shoh syzezën se ku rri.

bucelë - *βουτσέλλα / βουτσέλι* enë prej balte që përdoret për të mbushur ujë, ose lëngje të tjera.

dekati / dhekati - *δεκατιά* taksa e së dhjetës. Shprehje: Dhekati dhe xhelepe s'ka / jemi botë fukara. Përdoret edhe si toponim: Lëmi i Dhekatisë.

dhafnë / dafinë - *δάφνη* bima e dafinës. Përdoret dhe si toponim: Dhahnarea, Mali i Dhahnes, Dhafina, Dhafnareja.

dhaskal - *δάσκαλος* mësues, gjithashtu dhe personi që predikon. Shprehje: Nuk është nxënësi më i madh se dhaskali i tij, as më i zgjuar se i zoti i tij; vjen të paqësorë / "të kuqtë" me "të bardhë" / të heqë mësuesit / të vërë dhaskalë. Përdoret dhe si toponim, Bregu i Dhaskalit.

dhaskaleps - *δασκαλεύω* jap mësim.

dhaskalicë - *δασκαλίτσα* emërtim që përdoret për mësueset e reja, të vogla në moshë ose trupvogla. Përdoret me kuptim thumbues.

dhekare - *δεκάρα* dhjetëshe, monedhë me vlerë 10. Shprehje: Nuk ka një dhekare borxh.

dheks / dheksem - *δέχομαι* pranoj diçka, miratoj. Shprehje: Nuk ma dheks shpirti; most ë dhekstë varri; as më dhekset, as më trekset; nuk dheksen ata të dy.

dhespot - *δεσπότης* titull hierarkie kishtar. Përdoret dhe si toponim: Dhespotia.

dhiakoni - *διακονία* vepër ose shërbim i dhjakut në kishë; ndihmë; shërbim.

dhiatë - *διάτα* dhiata, testament, shkrimi i shenjtë, secili libër i biblës. Shprehje: Sipas Dhiatës së re...

dhidhaks - *διδάσκω* i mësoj dikujt, jap mësim, zotëroj diçka, këshilloj. Shprehje: Një nga ata që dhidhaksën ligjin; dhidhaks të madh dhe të vogël.

dhiplomat - *διπλωμάτης* diplomat, përfaqësues i një shteti i dërguar në një shtet tjetër

dhiplomë - *δίπλωμα* diplomë studimesh, dëftesë studimesh.

dhiqel / diqel - *δικέλλι* vegël punë që ndihmon për të gërmuar, për të punuar tokën.

dhisk - *δίσκος* pjatë e madhe, tabaka e shenjtë e kishës, tabaka me të cilën qerasim në shtëpi.

dhivol - *διβόλι* tokë bujqësore e punuar dy herë. Përdoret në Konispol.

dhjak / dhiakë - *διάκος* shërbyes fetar në kishë.

dhjakonar - *διακονιάρης* lypës, i varfër, person që jeton në kurriz të të tjerëve; njeri dinak, i pabesë dhe shpirtkeq.

dhjozmo - *δύσμος* dhjosmë, lloj bime aromatike që përdoret për gatim.

dhogë / llogë - *σανίδα* dërrasë druri e thatë. Shprehje: Tek dhoga e pusit; mbeti në dhe dhogë, s'lëvizte dot; t'erdhi burri e kërkon bukë / në dhogë është ta ndukë! Bëhem dhogë; nuk shkel në dhogë të kalbur. Përdoret dhe si toponim: Lis i Dhogës.

dhokan - *δοκάνι / παγίδα* çark, grackë. Shprehje: Të mos i vësh dhokan vëllait, është skandal; në dhokan të së paudhit.

dhokar - *δοκάρι* tra.

dhoksas - *δοξάζω* çmoj, adhuroj.

dhomë - *δώμα* korridor, dhomë, zyrë, dhomë tregtie.

dhrahmi - *δραχμή* lloj monedhe që ka pasur Greqia. Shprehje: Që të kishte dhjetë dhrahmi, duhet të humbte një.

dhrakon / dragua - *δράκων / δράκος* dragua, përbindësh i lashtë mitilogjik, që nxirrte flakë nga goja.

dhrakonda - *δράκοντας* dragua, përbindësh mitik i trillimeve popullore, i cili përpin njerëz.

dhrimon / drimua - δρεμόνι / δριμόνι lloj site me vrima të mëdha që shërben për të shoshitur drithërat.

Dhrom / Dhromi - δρόμος kuptimi i parë është fjala rrugë. Gjendet kryesisht si toponim në zonën e Çamërisë, p.sh. Dhromi i Rrëzanjit, Dhromi i Kotgjones, Dhromi i Agjisë.

drapër / drapën - δράπανον / δρεπάνι vegël bujqësore që shërben për të kositur, për të prerë bimët. Përdoret dhe si toponim: Bisht i Dhrapanit.

efharistis / haristisënj - ευχαριστώ falënderoj. Shembull: Si i efharistisi e u nda nga ata, tha që këtë do t'jua thotë të gjithëve.

eksusi - εξουσία pushtet.

eleimonis / leimonis - ελεημονώ mëshiroj. Shprehje: Do të eleimonis atë që për atë kam eleimoni.

eleis - ελεώ jap mëshirë, mëshiroj.

engrat / engrati - εγκράτεια vetëpërmbajtje, gjithashtu dhe njeri i ngathët, i plogësht.

episkop / piskop - επίσκοπος episkop, ofiq i lartë në hierarkinë kishtare.

epitrop / pitrop - επιτροπος epitrop në kishat ortodokse, administrues i një pasurie, kujdestar.

eremit - ερημίτης asket, njeri i vetmuar, eremit, njeri besimtar që jeton i vetmuar dhe i izoluar nga bota.

eretik - αιρετικός që nuk ndjek parimet e kishës, heretik

esperino - εσπερινός meshë, lutje fetare e pasdites.

evangjelizoj - ευαγγελίζομαι këndoj, psal ungjillin tek të tjerët, përhap fjalën e shenjtë. Shprehje: Zoti na thirri neve që t'i evanjelizojmë ata.

evgjit - αιγύπτιος jevg.

fli / fuli / fërli - εulogία naporë, copë buke që hahet në fund të çdo meshe, kulture.

gaforre - καβούρι gaforre

gajas / gajasem / gajasur - γανιάζω kam shumë etje, më thahet gjuha, torturohem, mundohem, lodhem, shkrihem së qeshuri. Shprehje: Gajasa së ecuri; gajasa së foluri; gajasa për ujë; gajasem së qeshuri.

gargalis / argalisem - γαργαλίζω luaj dhe qesh, argëtohem në maksimum

gargarë - γαργάρα gargare, shpëlarje e fytit.

gargaris / gargarisënj - γαργαρίζω bëj gargarë, bëj shpëlarjen e fytit

gastër / ngastër - γάστρα copë, pjesë, një pjesë e caktuar, një zonë, lloj byreku me djathë në zonën Janjar - Konispol, byrek me lakra në zonën e Zagorisë, copë lakrori.

gavo / gavotë / gavat - γκάβος në numrin shumë të sytë, syçakër, ai që shikon vëngër. Shprehje: Hapi gavot; pse nuk i hap mirë gavot. Përdoret në Gjirokastër, në Rrëzomë.

gërlllosem - γρολλώνω mbytem me diçka, zgurdulloj sytë dhe i fiksoj diku, shtrembëroj fytyrën

gërmadhë - γκριμάδια vende të shkreta, të braktisura, shtëpi e braktisur dhe e shkatërruar; gjë pa vlerë, e shkretë; njeri i shkretë. Përdoret në Dhrovjan - Delvinë.

gërnjar / gërnjëtar - γκρινιάρης njeri bezdisës, i prapë, që bezdis me të njëjtat gjëra vazhdimisht

gërnjë / gërrnie / grinjë - γκρίνια bezdisje me fjalë vazhdimisht, duke murmuritur të njëjtat gjëra

gjeraqinë / gjeraçinë / gjerakinë - γερακίνα fajkore, në mënyrë metaforike grua e shpejtë dhe e shkathët. Shprehje: Hapuni moj sorra / se vjen gjeraqina! Bëj konak moj gjeraqinë / për këta miq që po vijnë; e ka nusen gjeraqinë.

gjimar / imar - γημάρι rrip toke i ngushtë që mbjell / korr një punëtor ndërsa kalon. Përdoret në zonat Janjar - Konispol, Delvinë. P.sh. Kam korrur tre imare grurë.

gjimnas / gjimnaz - γυμνάσιο shkollë e edukimit të mesëm.

gjiri / gjini / gjeni - γενέα / γενία / γενεά fis, komb, grup njerëzish me lidhje farefisnore midis tyre, gjini nga ana gramatikore, lloj vepre letrare. Shprehje: Gjak e gjëri; e po lypin në gjenitë e në të njohurit e tyre.

gjiton / jiton - γείτονας komshi. Shprehje: Jitoni që s'do jitoninë; shkova poshtë tek gjitoni / gjitonia.

gjitoni / jitoni - γειτονία / γειτονιά lagje, komshillëku. Shprehje: Gjithë jitoninë e zuri frika...; bënin gjitoni me njëri – tjetrin.

gliko / liko - γλοκό ëmbëlsirë, reçel me të cilin qerasim. Shprehje: Merr glikonë, merr filxhanët; glikotë me qershi, me arrë, me kajsi, me vishnje.

glistër / gëlistrë - γλίστρα një lloj krimb toke.

gomar / gomaricë - γομάρι gomar. Shprehje: Nuk çalon gomari nga veshët; i kanë hedhur trutë e gomarit.

gone - γωνιά / γωνία mjet, vegël pune prej hekuri që përdoret nga muratorët; oxhak, cep.

gramë / gërmë - γράμμα shkronjë e alfabetit, arsimim, edukim, shkrim e lexim. Shprehje: Të shkruara anës me laps të gramës; di gramë, je me katër sy; di gramë, hesap ti Jorgo? Përdoret dhe si toponim: Shpella e Gramës.

gravall / karravalle - γράβαλο vegël bujqësore prej hekuri ose druri, me dhëmbë dhe me bisht të shkurtër, grabujë. Përdoret në zonën Delvinë - Janjar – Konispol.

gremë - γκρεμός vend i pjerrët, që rrëshqet, hon. Përdoret në Berat – Përmet.

gremis / gërmis / gremisem - γρεμίζω rrëzoj / rrëzohem, ul përtokë, rrëzoj përtokë dikë që ecën, përzë, bie nga lart, bie në tokë teksa eci. Shprehje: Gremisi sytë; nga vetiu gremiset; kurbeti i largët të gremiset; gremisi gjysmën e pallatit;

greminë / γκρεμνα është në buzë të greminës

guvë / gufë - γούβα shpellë, guvë; pjesë e pemës së ullirit e cila është bosh

haso / aso - άσσος letra e parë e bixhozit; njeriu që është më i zgjuar dhe bie në sy në krahasim me të tjerët rrotull; njeri me aftësi të veçanta

idholl / idhullë - είδολων idhull, shenjtëri. Shprehje: në emër të ndonjë idhulli, etj..

igumen / gumen - ηγουμένος kryetar i një manastiri. Shprehje: Si gumeni në manastir... Përdoret dhe si toponim: Manastiri i Gumenit.

ikonograf - εικονογράφος ai që pikturon ikonat e kishës.

ikonostas - εικονοστάσιον vendi ku vendosen ikonat e shenjtoreve në kishë.

ikonë - εικόνα ikonë, përngjasim, imitim i një perëndie në kornizë; i venitur, i ngirë dhe pa gjallëri.

ja / javo / javua / jate - για pjesëz me kuptimin 'hajde, eja, ja tek..'. Shprehje: Ja, erdhën engjëjt; ja, unë u dërgoj juve porsì dhëntë në mes të ujqërve; javua këtu, javua atje, sepse ja mbretëria e Perëndisë këtu është.

janero - άγιο νερό ujë i bekuar. Shprehje: Të vish era janero, kapedan vasiliko, përdoret në Damës – Tepelenë.

jatro - γιατρός mjek, doktor. Shprehje në Çamëri, në Gjirokastrë etj. Shprehje: duan jatro; jatro, shëro veten tënde; të të marr jatronë; burrin jatro s'e dua / gjithë ditën jatrops / gjithë natën djalleps; moj Lejli jatreshopullë / në jatrenj na more burrë.

jerak / gjeraq - γεράκι fajkua, skifter; me shpejtësi: e mora rrugën jerak.

jerm - έρημος i vetmuar, i braktisur, i dëshpëruar, në gjendje deliri, në gjendje shushatje.

kacidhe - κασίδα lloj sëmundje flokut të kokës. Përdoret në zonën e Sarandës dhe Delvinës.

kadhron / kadron - καθρόνι dërrasë e hollë druri që përdoret për mobilie ose për të ndërtuar.

kafkë - καύκα totali i kockave të kokës, zhguall i breshkës.

kakaris - **κακαρίζω** kakarisja e pulave, thuhet për një njeri që flet shumë ose qesh duke kakarisur.

kakomir - **κακομοίρης** njeri i dëshpëruar, i mërzitur, mjeran, fatkeq. Shprehje: Poshtë tek manastri / u bezdis kakomiri; Kostë Miri derëziu / ç'të qan fusha dhe vërriu / Kostë miri kakomiri / ç'u ngule tek manastiri.

kaliqe - **καλίγι** sandale me takë të lartë prej druri.

kalive - **καλύβα** tip kasolle e vogël. Shprehje: As shtëpi e as kalive...ca bënë kalive, e ca mbetën jashtë. Përdoret dhe si toponim: Kalive e Pulos, Kalivja e Memikos, Kalivet e Xha Kalliut.

kallafatis - **καλαφατίζω** mbyll vrimat e një bucele, ose anijeje. Përdoret në zonën e Sarandës. Shembull: E kallafatisi punën.

kallam - **καλάμι** kallam, fyell, kallam peshkimi etj.

kallamar - **καλαμάρι** kallamar deti.

kallame - **καλάμη** kërcell i grurit, i drithërave që mbetet në tokë pas korrjes.

kallogre - **καλόγρια** murgeshë, femër e cila nuk martohet dhe jeton e vetmuar. Shprehje: Unë nuk martohem, as nuk rri e ve / as në kishë s'vete, s'bëhem kallogre...; rrobazezë e kallogrinjë / moj për ty prisha shtëpinë...

kallogjer / kallugjer / kllogjër - **καλόγερος** murg që jeton në manastir, njeri që bën jetë të mbyllur, larg njerëzve të tjerë. Shprehje: Mijëra mijëra kallogjerë, në një manastir pa derë. Përdoret gjithashtu dhe si toponim: Kallogjeri, Kallogjera, Kroj i Kllogjrit etj.

kamare - **κάμαρα** dhomë, gjithashtu dhe një lloj rafti i futur i thellë që përdoret për të lënë gjërat, kabinë në një anije. Përdoret dhe si toponim: Kamara, Gurët e Kamares.

kamaros / kamakosem - **καμαρώνω** i gëzohem diçkaje, jam krenar, adhuroj diçka, mburrem. Shembull: Një e vogël e cokërr / me një zorrë nëpër këmbë, kamaros dynjanë të tërë; mos u kamakos moj nuse / të dimë e kujt bijë je!

kamatë / kamatari - **κάματος** interes, kamatë, kamatëvonesë, përqindje nga marrja hua e parave, lodhje tepër e madhe, mundim.

kamille / gamile - **καμήλα** gamile, deve, kafshë e shkretëtirës.

kanakar - **κανακάρης** i dashur, i përkëdhelur.

kandil - **καντήλι**; **kandile / kanile** - **καντήλα / κανδήλα** lloj ndriçuesi i cili ndizet me vaj dhe me fitil, llambë me vaj. Shprehje: Kur me shkon tek porta ime / m'i bëre sytë kandile.

kandër - **κάνθαρος** insekt.

kanistër - **κανίστρα** shportë, kanistër e thurur më kashtë.

kanonis - **κανονίζω** rregulloj diçka, një takim, riformoj diçka.

kapistër - **καπίστρι** kapistër që shërben për të mbajtur kafshët në zgjedhë, të lidhura, nën kontroll.

kapule - **καπούλι** një mori gjërash të vendosura një mbi një.

karavidhe - **καραβίδα** karavidhe, gjallesë deti; njeri që fut hundët në punët e të tjerëve duke i bezdisur.

karekllë - **καρέκλα** karrige.

karficë - **καρφίτσα** karficë, lloj kapëse që shërben për të mbërthyer; paramanë; bizhuteri.

karfos / karfosem - **καρφώνω** kap me karficë diçka, mbërthej, kallëzoj dikë, e tradhtoj duke e kallëzuar, qep rrallë.

karkallosem / kallkanosem - **καρκαλώνω** ngrij së ftohti, ndiej shumë të ftohtë. Shprehje: U karkallosëm nga të ftohtit...

karkanxhol - **καλικάντζαρος** sipas të thënave popullore, besohet se kjo është një qenie demoniake që shfaqet ditën e Shfaqjes së Zotit.

kaselë / karsellë - **κασέλα / καρσέλα** tip kutie, sëndyku që shërben për të mbajtur gjëra, rroba, bizhuteri, etj.

kataklizmo - **κατακλυσμός** përmbytje shumë e madhe ujërash, kataklizmë, një e keqe shumë e madhe, shkatërrim.

katandis / καταπτώ përfundoj në diçka të pakëndshme, bie poshtë ekonomikisht ose moralisht, drejtoj një situatë që përfundon për keq, ndaloj, pushoj, arrij diku. Shprehje: U katandis kokoshi një thelë; pa shtëpi e pa katandi.

kataval / katavalem - **καταβάλλω** fitoj mbi diçka, luftoj për diçka dhe fitoj, zihem, dobësohem fizikisht.

katua / katoi - **κατώγι** bodrum ose qilar në të cilin mbahen kafshët ose veglat e punës, kotec për pulat.

kavadhël - **καβάδι** lloj fustani i gjatë, për gra dhe burra, karakteristikë për zonën e Përmetit.

konizmë / konismë - **εικόνισμα** ikonë, pikturë shenjtorësh. Shprehje: Njerëzit që janë bërë me konizmë të Perëndisë. Përdoret dhe si toponim në zonën e Konispolit.

kseftilis - **εξευτελίζω** ofendoj dikë, i ul moralin dikujt.

ksemolois / ksomollojis - **εξομολογούμαι / ξομολογούμαι** pranoj, pohoj, rrëfej mëkatet e mia, rrëfëhem. Shprehje: Ksemollojisni njëri - tjetrit fajet; duhet të ksemollojisesh të paktën një herë në vit.

lihadhë / Dihalë - **διχάλα** vegël bujqësore. Përdoret më së shumti si toponim: Qafa e Dihalës, Dhrihala, Dhrihala e Shtogut, Lihadha.

llaka - llaka - **καλά καλά** fjalë pa kuptim, fjalë pa fund. Shprehje: Filluat llaka-llaka ju tani!

mbodhis - **εμποδίζω** pengoj, ndaloj diçka të ndodhë. Shprehje: Kush nxiton shumë, mbodhiset; shko në çesmë e mos u mbodhis / moj e holla si filiz.

naforë - **αναφορά** buka e bekuar në kishë gjatë meshës

nakar - **ανάκαρο** zili. Shprehje: ndiej nakar; e kam nakar

nakatomeno - **ανακατωμένος** e përzier, e ngatërruar

nasqiris - **ανασκορίζω** rregulloj, sistemoj, pastroj shtëpinë. Shprehje: nasqirisi shtëpinë. Përdoret në Përmet, Libohovë, Gjirokastër

ndes / ndez - **αντένω / ντένω** takoj dikë, ngatërrohem me dikë, përzihem me dikë, rastis një pengesë. Shprehje: Ndesa me një njeri të lik; për ca ditë e për ca javë / na ndesi nusja me barrë; mos u ndesësh me atë burrë; është keq kur ndes njeriu me një të lik.

ndërliks / ndërlikoj - **εντολίσσω** mbështjell, mbuloj, ngatërrohem, mpleksem.

ngardhos / ngardhios - **εγκαρδιώνω** shkaktoj inat, shkaktoj një zënkë. Përdoret në zonën e Katundit, të Përmetit, Elbasan dhe në Dukat e Vlorë.

palare / paljare - **απαλαριά** pjatë prej balte që përdoret në kishë. Përdoret në Elbasan, Berat, Vlorë, Devoll, Tiranë, Dibër

pandeh - **απαντέχω** pres, kujtoj, kam shpresë a besim, kam qëllim, supozoj, mendoj. Shprehje: Ajo pandehu se...; s'e kisha pandyer kurrë; e pandehu për të vëllanë; pandehu se kishte të drejtë.

pizili / bizili / gizili - **επιζήλεια** zili, smirë. Shprehje: Mos ja bëj për pizili, po jepi dhe atij; jua bënte pizili.

rocakis - **αποτσακίζω** kthej, bezdis, e pësoj keq.

roganik / boganik / baganik - **απογονία** kulaç të cilin e thyejnë në kokën e fëmijës së porsalindur ditën e tretë të pagëzimit. Shprehje: Dhëntë Perëndia edhe me një babanik.

qeli - **κελί** dhomë e murgut ose murgeshës, dhomë e burgut.

qeramidhe - **κεραμίδα** tjegull, qeramidhe që shërben për të mbuluar çatitë e shtëpive.

qëndis / qendis - **κεντώ** qëndis.

- radhë - ἀράδα** radhë, rresht, herë. Shprehje: *Vij me radhë nëpër vendet e Galatisë; një radhë u vonua; ishte një nga radha jonë; me ndonjë punë të radhës tënde.*
- radhiko - ἀραδικός** e përbashkët, si gjithë të tjerat, jo e zgjedhur. Shprehje: *Nuk i kemi radhiko. Përdoret në Jug.*
- thamaks / famaks - θαυμάζω** surprizoj, habit, lë pa fjalë. Përdoret në zonat e Gjirokastrës, Sarandës, Delvinës. Shembull: *U thamaksën burra e gra...*
- thambos - θαμπώνω** verboj, habit. Shprehje: *Zoti i thambosi ata.*
- thaps - θάβω** e kall ne dhe, e shtie në gropë, e varros; e kollofit, ha me babëzi.
- thavmë / thagmë - θαύμα** mrekulli, nishan / shenja, diçka e papritur. Shprehje: *Ç' ishte kjo thagmë?... / këto janë thavmat e tij... Përdoret në zonat e Sarandës, Gjirokastrës, Çamërisë etj.*
- theatro / thjatro / theatër - θέατρο** teatër. Shembull: *Na bëre thjatro...*
- themel / themelim - θεμέλιο** themel, bazë, bazament, mbështetje. Shprehje: *është edhe besa themeli i punëve që shpresojmë...*
- themelos - θεμελιώνω** vë themele, mbështes, siguroj. Shembull: *E themelosi mirë...*
- themë - θέμα** temë, çështje.
- theollog / teolog - θεολόγος** teolog, ai që studion veprat dhe besimet fetare.
- theori - θεωρία** teori.
- thile - θηλιά** lak, leqe, vrimë e kopsës. Përdoret në zonat e Gjirokastrës. Shembull: *Një pa pullë e pa thile, shkallët me gocile...*
- thilikos - θηλοκώνω** mbërthej, bëj thilique.
- thilique / filique / filik - θηλόκι** kopsë, vrimë e kopsës.
- thimjamë / thjamë - θυμίαμα** thimjamë, lëndë që kur digjet lëshon aromë të këndshme, përdoret në kishë. Shembuj: *Të shkova tek varri, rënke erë thimjamë...*
- thorak / tarozgë - θωράκιον** lloj mburoje metalike, e cila mbronte luftëtarët në luftë.
- thoropullë - θυροπούλα** dritare. Përdoret në zonën e Libohovës dhe Gjirokastrës.
- thërrime - θρόμμα** thërrimet e bukës, copat e vogla të bukës / djathit, copë e vogël i diçkaje, sasi e vogël. Shprehje: *Është rritur me thërrime; kush ha bukë, bën edhe thërrime.*
- thrumë / trumzë - θρούμπη / θύμβρα** lloj bime. Përdoret në zonat e Delvinës, Himarës, dhe përgjithësisht në jugun e vendit. Përdoret dhe si toponim: *Çuka me Thruma, Qafa e Thrumaresë.*
- vais - βαγίζω** përkulem, pjerretsohem, varet/anon nga njëri krah; pjerretësi, përkulje. Përdoret në zonën e Përmetit
- valanidh / valanith / valangjith - βαλανίδι** lende lisi ose dushku. Përdoret dhe si toponim në zonën e Delvinës, në Himarë, në Vlorë, Berat, Radhimë, etj. P.sh.: *Mali i Valanidhit, Shtrunga e Valanidhit, Valanidhi Haliqes, etj.*
- ballsamos - βαλσαμώνω** krip peshkun, vë në shëllirë, tymos mishin, balsamos.
- vangjelist - ευαγγελιστής** dhjak ose prift i cili ka shkruar një ndër katër librat e shenjtë, evangjelist, ai që lexon biblën në kishë.
- vangjelizmo - ευαγγελισμός** festë ortodokse, Festa e Vangjelizmoit që festohet në 25 mars. Shprehje: *Ikni ikni o shtërpinj, se erdhi vangjelizmoi, se u therr e u shoi, me kordhën të ngjeshur.*
- vardha / varda - βάρδα** pasthirrmë, ki kujdes! ruaju! mënjano! shporru!
- vare - βαριά / βαρέα** diçka që është shumë e rëndë; çekiq në përmasa shumë të mëdha, që përdoret për të çarë drutë që përdoren për zjarr. Përdoret në zonën e Elbasanit dhe në dialektin toskë.
- varelë / varjelë - βαρέλα** voze, fuci e përmasave të mëdha

varikua - βαρικός vend që ka shumë lagështirë, vend moçalor, vend me baltë. Përdoret më shumë si toponim në zonën e Çamërisë, psh: Varikua, Burimi i Varikoit, Livadhet e Varikeve

varkë - βάρκα mjet lundrimi, varkë. Përdoret dhe emri i prejardhur nga kjo varkëtar

vasilikua - vasilikoi bimë që ka aromë të mirë, borzilok. Shprehje: Duke marrë erë në basilikua; o dega vasilikua, manxuranësë në i thua...; del ujit vasilikonë.

vastagua / vastagoi / vastak - βασταγαριά tufë lulësh ose frutash të cilat varen në degën e tyre, kur i këpusim bashkë me bisht, bistak rrushi.

velzevul - βερζεβούλης njeri hileqar, ngacmues, i prapë. Si emër i përveçëm ka kuptimin e udhëheqësit të djajve. Përdoret dhe në kuptim metaforik.

verboz - ελλέβορος lloj bime me veti kuruese, bimë medicinale.

vërkollak / vurkollak / vrुकullak - βρικόλακας / βουρκόλακας njeri i vdekur i cili ngrihet nga varri dhe shkakton dëme dhe shkatërrime, fantazmë e tmerrshme, vampir. Shprehje: Imzot, të të vijë keq / mos më le këtu me pleq / se më duken vërkolleq / mos më lër këtu me plaka / se më duken vërkollaka.

vernig / vernik - βερνίκι lloj boje, ngjyrë e cila është e shndritshme, që shkëlqen si argjend.

vidhë – βίδα pajisje mekanike; gjendje psikike, çrregullim, tronditje psikike, çmenduri. Shprehje: Ka luajtur nga vidhat; ka një vidhë mangët; i gjej / liroj / shtrëngoje vidhat; e zunë vidhat; është me vidha.

vidhismë / vithimë / vithizmë - βύθισμα vend i cili ka pësuar rrëshqitje, hon, greminë. Shprehje: I dha vajzës një të shtyrë më një vithimë, më një hon... Përdoret dhe si toponim: Vithizma, Vithismat

vidhos - βιδώνω procesi i rrotullimit të vidhës, vidhos.

vilar / vilazë - βηλάρη një sasi e caktuar pëlhurë, një top pëlhurë / rrip i qëndisur. Shprehje: i kam vrakat të qëndisura me villare të zi; një vilazë pëlhurë, ose një vilazë letre. Përdoret në zonat e Kolonjës, Korçës, Gjirokastrës, në Shqipërinë e veriut, në Malësinë e Madhe

violi - βιολί vegël muzikore, me katër korda, organ muzikor i një orkestre. Shprehje: Vuri vjolitë / hop evgjitët; shtatë net e shtatë ditë / nuk pushuanë vilitë.

vistar / visar - βεστιάριον / βιστάριον thesar, pasuri e madhe. Shprehje: Mos i dëshiro as kaun, as vistarin...

vithis - βυθίζω shkatërroj - shkatërrohem, rrëzohem, shemb - shembem, bie në gjumë letargjik, përmbysët. Shprehje: Ditën kthis, natën vithis; qëlluan dhe e vithisën; u vithistë, e zëntë mali.

bibli - βιβλικός që ka të bëjë ose i referohet Biblës.

vjas - βιάζω nxitoj, përshpejtoj. Përdoret në zonën e Delvinës, Lazaratit, Zagorisë: Hiqe vallen rëndë - rëndë.../ hiqe vallen më javash... / dale dale mos e vjas.../

vllaps / laps - βλάβω / βλάπω prish, bezdis, shqetësoj, ndiej të vjella, dëmtoj, shkatërroj, ndiej dobësi për dikë, etj. Shprehje: Lapste fëmija për të ëmën...; lapsa nga ky njeri..

vllastar / vlastar / lastar - βλαστάρι kërcell i njomë i një peme / bime; përdoret gjithashtu në mënyrë metaforike për një fëmijë të vogël; trup i ri dhe i gjatë. Shprehje: Trëndafil - o me lastarë...

vllavje / evllavi - ευλάβεια respektim, frikë nga Perëndia.

vllojis - ευλογώ jap bekimin, uratën; bekoj.

vodhis - ενοδίζω mbaj erë, kundërmoj erë. Shprehje: Të vodhiste buza lule manushaqe / të vodhiste gusha trëndafille prilli. Përdoret më shumë në zonën e Konispolit.

vole - βόλι katër njësi, katër copë frutash; një sasi e kufizuar frutash. Përdoret në zonën e Dibrës

voli - **βολή** lëshim i një guri ose i plumbit nga arma; lehtësi, mundësi, të qenit kollaj; hedhja e zareve në tavëll; shans, gjuajtje. Shprehje: Gjej volinë; një voli e mirë; i erdhi volia.

vraka - **βράκα** veshje e gjerë burrash ose grash.

vrakazon / frakazon - **βρακοζώνα** pantallona burrash, të cilat nga pjesa e gjurit dhe poshtë vijnë të puthitura pas këmbës. Përdoret në zonën e Gjirokastrës dhe të bregdetit

Vrinë - **βρόνα** vend me bimësi të dendur dhe me shumë burime ujore. Gjendet i përdorur si toponim, emri i një vendi afër Butrintit.

vrís / Vris - **βρύση** çezmë, burim uji natyror. Shprehje në zonën e Borshit dhe të Labërisë: Rakinë e bëre vris. Përdoret mjaft si toponim: Vris, Burimet e Vrisit, Rrepet e Vrisit, Arat e Vrise.

vrromë - **βρόμα** papastërti, aromë e keqe, femër e pamoralshme, femër e përdalë.

vulaks / vurlaksem - **βουλιάζω** fundos, shkatërroj, spastroj dhe në mënyrë metaforike ndihem e dobët fizikisht

vulë / vula - **βούλλα** vulë, shenjë, pullë, stampë, shenjë dalluese. Përdoret në fjali dhe në mënyrë metaforike, kur bie nga pozita, ose i vë fundin diçkaje, p.sh. E humbi vulën; është me vulë; i ra vula; i vuri vulën diçkaje; i humbtë vula! etj

vulër - **βούλερη** barishtore e egër. Përdoret edhe si toponim: Vuleri.

vulis - **βουλίζω** zhytem, zhyt, fundosem. Shprehje: Pa e shpiem në lumë, pa e vulisim...; në xhenem i vulisi; ti moj varka mavronis / Bilalin mos e vulis. Si emër përdoret dhe si toponim, Burimi i Vulistrave, Përroi i Vulistrës, Kroi i Vulistrës

vulos - **βουλλώνω** vulos, vë vulën, mbyll, ngjit me pullë, shënoj, bëj shenjë; i jap fund, vendos, përfundoj.

furçë - **βούρτσα** fshirëse veshjesh, furçë për të larë dhëmbët, ena në të cilën tundet qumështi. Në zonën e Janjar - Konispol përdoret dhe me kuptimin e një ene të djathit.

vurk / vurg - **βούρκος** vend plot baltë, tokë moçalore, moçalishte. Përdoret edhe si toponim: Vurg (afër Delvinës), Vurg i Agait, Vurgjet.

vuv - **βουβός** memec, shurdhmemec. Përdoret më shumë si toponim në zonën e Çamërisë, si Vuvonja, Vuva, Shkëmbi i Vuvës.

vunos - **βουβώνω / βουβός** bëhem pa fjalë, më mbyllet goja, bëhem memec

zali - **ζάλη** gjendje dobësie, të qenit pa qejf, pa fuqi, gjendja e të fiktit. Shprehje: Më bie zali.

zalis / zalisem - **ζαλίζω** shushat, më vjen të këputur, të fiktë, trondit dikë.

zanë / zanëz - **ζάβα** mburojë me hekura e luftëtarëve.

zigur / ziur - **ζυγούρι** qengj i vogël 2-vjeçar. Përdoret në zonën e Çamërisë, në Konispol etj. Shprehje: Shkojnë djemtë si zigurë...

zilar / ziliqar - **ζηλειάρης** njeri që ka zili, ka smirë.

zileps - **ζηλεύω** kam smirë për dikë, kam inat dikë. Shprehje, fjali: Se mos zilepsësh gruan e fqinjit.

zili - **ζήλεια** smirë, inat për diçka që nuk e ke. Shprehje: Zilia juaj ka anangasur shumë...

ziq / zij - **ζύγι** lloj peshoreje, kandar. Shprehje: Ua nxjerr fjalët me grep të ziqit.

zograf / zugraf - **ζωγράφος** piktor. Shprehje: moj e nisur, e stolisur / cila zografkë të ka nisur...

zografis - **ζωγραφίζω / ζωγραφώ** pikturoj. Shprehje: Zogë e zografisur / pajën e bitisur...

zorkadhe / sorkadhe - **ζαρκάδι** sorkadhe, lloj kafshe. Shprehje: Moj sorkadhe qafëgjata / ku të zuri sonte nata?

Toponomastikë

Allonaqi - *αλωνάκι* në shqip është toponim, në Çamëri, Qaf' e Allonaqit

amigd hale / amid hale - *αμυγδαλέα* përdoret në zonën e Borshit, në Çamëri, në bregdet, kryesisht si toponim me pak ndryshim: Margalidhe, Mirgale, Mal' i Mirgalesë, Bregu i Mirgalesë, Qaf' e Mingladhesë

Armiro - *αρμιρός* toponim, vend pranë Butrintit

Onomastikë

Areti - *Αρετή* emër i përveçëm

Dhimitër / Dhimo / Mitro / Miço / Mitër - *Δημήτριος* emër i përveçëm, emër shenjtori.

Gjithashtu: shëmitër Shën Dhimitri

Dhoqinë - *Ευδοκία* emri i motrës së Kostandinit, sipas baladës së vëllait të vdekur.

Dhrakule - *δρακούλης* në gjuhën shqipe përdoret shumë si toponim, në zonën Horraj / Kurvelesh.

Toponomastikë

Gjirokastër - *Αργυρόκαστρο* qytet në Shqipërinë e jugut

Ilia / Shëndëlliu - *Ηλίας* emër i përveçëm, festohet si emër ortodoks, është dhe emër kishe

Karavasta - *καραβοστάσι* Karavasta, emri i lagunës afër Vlorës, Laguna e Karavastasë, toponim.

Leusë - *Ελευσα* emër i një fshati në zonën e Përmetit.

Mborje - *Εμπορία* toponim, emër fshati, gjithashtu dhe i një vendbanimi të lashtë mesjetar, afër Korçës.

Todhër - *Θεόδωρος* emër i përveçëm mashkulli. Përdoret shumë dhe si toponim, Shtodhër, Shëndodhër, Shëntodhër, etj.

Zigo - *ζυγός* në shqip përdoret më shumë si toponim, psh. Ara e Zigojit, Lëm i Zigoit, Zhigonjë.

2. LISTIME TË HUAZIMEVE SHQIPE NË GREQISHTE TË NXJERRA NGA PUNIMET E STUDIUESVE TË NDRYSHËM

(Λεξικό των ελληνικών δανείων της αλβανικής) të nxjerra nga studimi i
Dh. Q. Qiriazit¹⁷⁶

Huazimet (interferime) shqipe në greqishte i gjejmë në të folmet greke në jug të Shqipërisë dhe në përgjithësisht në veri të Greqisë. Nuk përjashtohen interferimet dhe në mjedise të tjera kua ka ka pasur dhe ka bashkësi shqipfolëse, si në Peloponez etj. Në këtë syth jemi ndalur në të folmet jugore të Shqipërisë. Në huazimet nga shqipja në të folmet greke në jug të Shqipërisë kanë ndikuar faktorë të ndryshëm, si faktorë ekonomikë, historikë, social, psikologjikë, administrativë, shtetërorë, arsimorë etj. Në mënyre graduale, të padukshme, por pa ndërprerje është zhvilluar ndikimi i shqipes në këto të folme dhe anasjelltas, ndikimit të greqishtes mbi të folmet jugore shqipe. Kështu, shumë fjalë të përdorimit të përditshëm që janë huazuar nga greqishtja në shqipe ashtu si dhe shumë fjalë që kanë hyrë nga shqipja në greqishte nuk kanë fituar të drejtën për të përdorur e për t'u shtrirë në mbarë gjuhët, por kanë mbetur vetëm në një përdorim lokal.

Nga sa paraqitet në fjalorth, del qartë se ndikimi i shqipes në të folmet greke në jug të Shqipërisë ka qënë më i madh në fjalorin që lidhet me jetën shtëpiake, me leksikun bujqësor e atë blegtoral. Në fushat e tjera ndikimi ka qënë më i vogël.

I. Emra

μπίμτσα, -η em. bodrum për mbajtjen e djathit.

ντιβάνι, -το as. kolltuk në dhomën e ndenjjes, lloj ballkoni me parmakë prej druri zakonisht në katin e dytë

πράκι, -το em. pragu i derës së shtëpisë zakonisht prej guri.

ρεζές, -ο em. shufër prej druri ose metalike për të mbyllur derën e shtëpisë

σεργκέβι, -το em. sergjen; dërrasë e ngushtë, e vendosur te muri i shtëpisë për enë kuzhine

e sende të tjera.

τσατί, -το em. çati.

χαλές, -ο em. nevojtorje; fig. njeri i keq.

γιατάκι, το em. dyshek.

γιοργκάβι, -το em. jorgan.

γιούκι, -το as. paja e nuses. (velenxat, jorganet, kuvertat, etj)

γκίζα, -η em. gjizë (lloj bulmeti),

τα γκίζωσε. f. ngatërrestar.

γκουλιάστρα, -η em. gulashtra e qumështit të deles

καπίστρι, -το em. kapistër

κουβάς, -ο em. kovë.

κουκουρέτσι, -το em. kukurec.

¹⁷⁶ Δ. Κ. Κυριάκης, Ελληνικές Επιδρασεις στην Αλβανική (I. Φωνητική και μορφολογική προσαρμογή των ελληνικών δανείων; II. Λεξικό των ελληνικών δανείων της αλβανικής, Θεσσαλονίκη, 2001

- κουλούφι,-το** em. këllëf; mbulesë lëkure ose metali për thika ose për shpata: mbulesë për dhëmbë
- κρόδα,-η** em. fjalë me dy kuptime, pisllek, kore buke.
- λαπάς -ο** em. llapa çorbë e trashë e bërë me oriz ose patate për fëmijët e vegjël
- λατσό,-το** em. llaco (të ngrënit mirë)
- λεκάνη,-η** em. enë e madhe e rrumbullakët.
- μούλα,-η** em. mullë, stomaku i qengjit ose i kecit që përthahet dhe përdoret për të bërë djathin: τοιμάζει τη μούλα για το τυρί; fig. njeri i fortë, i shëndetshëm: παιδί με μούλα.
- μπινάρι,- το** em. tra i hollë.
- μπινάς,-ο** em. themeli i një ndërtese.
- μπόλικος,-ο,-** mb. me bollëk, i mjaftueshëm.
- μπουλμέτι,-το** em. bulmet, (djathi, gjalpi, kosi etj.)
- μπούλωμα,-το** em.. mbulesë
- μπουλώνομαι**, vetv. mbulohem
- μπουλώνω**, kal., mbuloj diçka
- νταγιάκι,-το** em. dajak, rrahje me shkop
- τα ντεψιά** από το φούρο.
- ντουάνι,-το** em. duhani si bimë.
- ντραμουζάνα,-η** em. damixhan.
- ντρουμπέκι το** em. dybeku i qumështit.
- οπίγκα,-η** em. οι οπίγκες sh. opinga (këpucë)
- πεσκέσι,-το** em. dhurata për dasmë, ditëlindje etj.: του πάει καλό πεσκέσι. * μόγινε πεσκέσι nuk më ndahet.
- πέτουρο,-το** as. zakon. sh. petë për byrek, baklava etj. ψημένα πέτσουρα.
- πόντζι,-το** as. ρονçi: φιάσε μου ένα πόντζι.
- ποστακή,-η** f. poste: έστρωσε την ποστακή στο τζάκι.
- ποτούρι,-το** as. pantallona.
- πούπα,-η** f. pantofla, pupa të bëra me cohë ose me lesh që përdorin fëmijët, por edhe të rriturit brenda shtëpisë: άσπρεσ πούπεσ .
- προύσα,-η** f. prushi: έγινε προύσα (Dr. P.); fig. skuqja e fytyrës nga një sëmundje, nga turpi etj.: τόγιναν τα μάγουλα προύσα. (dr.p.). përd. ndaj. plot, shumë.: του βγήκαν σπυριά προύσα (Dr. P.) kemi edhe tipin μπρούσα (Dr. S.)
- ράγκαλα,-το** as. rranguallat: το σπίτι είναι γεμάτο ράγκαλα.
- σαγιάκι,-το** as. shajaku: καινούργιο σαγιάκι.
- σιλήρα,-η** f. qumësht i trashë me kripë, ndonjëherë edhe me djathë: σιλήρα κατσουπίσα; gjellë shumë e kripur: φαγητό σιλήρα. * αυτός είναι σιλήρας, për kopracin.
- σούφρα,-η** f. shkopë i hollë dhe elastic nga degëzat pemësh: σούφρα από κρανιά; goditja me shufër: το δωκε μερκές σούφρες. * βρήκε το σουφρά στρωμένο i gjeti të gjitha gati nga prindërit.
- ταγή,-η** f. tagjija që përdoret për kafshët e trasha: έδωκε ταγή τ'αλόγου.
- τέντζερη,-η** f. tenxherja: μπακιρένια τέντζερη. * βρήκε η τέντζερη το καπάκι, me kuptim të keq për dy njerëz që kanë gjetur njëri-tjetrin, që kanë të njëjtin karakter etj.
- τζουράπι,-το** as. çorape: γυναικεία τζουράπια (Dr. P.) kemi edhe tipin τσουράπι dhe τσερέπι (Dr. S.)
- τζούφα,-η** f. tufë fijesh për zbukurimin e shtëpisë, të pajës së nuses, në spinga me majë të kthyer lart etj. κόκκινες τζούφες.
- τουμάνι,-το** as. zakonisht pantallonat prej leshi që mbanin fashatarët: μαύρο τουμάνι.
- τσανάκι,-το** as. çanak: τρώε παπάρα στο τσανάκι. * το παλιό τσανάκι njeri i ulët dhe pa karakter.
- τσάφκα,-η** f. flixhan i madh: τσικνισμένο γάλα.

τσιρόνι,-το as. peshk i vogël: τιγανίζεί τσιρόνια. * έγινε τσιρόνι u dobësua shumë, u bë si cironka.

τσιπά,-η f. kapëse e hollë metalike për dropullite e objekte të tjera: δώσε μου μιά τσιπά .

τσιτώμα,-το as veprim i foljes citono.

τσιτωμένος,-ο mb. një diçka që është ngulur: οι φούσκες είναι τσιτωμένες.

τσιτώνομαι, vetv . ngulitem: τσιτώθηκα καλά .

τσιτώνω, kal. ngul, fut thellë: τσιτώνω τα παλούκια.

τσοκάνι,-το as. çekan: πελεκάει τις πέτρες με το τσοκάνι. * τσοκάνι του κεφαλιού kur fëmijët i bëhen shqetësim i panadshëm për prindrit etj.

τσοκανίζω και **τσοκανάω,** kal. gdhënd gurët, punoj duke e goditur me çekan: τσοκανάει τις μυλόπετρες; fig. ndëshkoj, rrah dikë: του τσοκάνησε το κεφάλι.

τσοκάνισμα,-το as. veprime sipas kuptimeve të foljes çokanao.

τσουρέκι,-το as. çyrek: ζεστό τσουρέκι.

φίρα,-η f. humbja që pëson në peshë një prodhim: το κρέας έκαμε φίρα.

φιρός, -ο mb. diçka që nuk është e plotë në peshë: μου ' φερε το αλευρί φιρό; kur njeri nuk mbush barkun: άφησε φιρή την κοιλιά του.

φούρκα,-η f. shkop i tashë me një bigë në krye që përdoret si mbështetje në kasolle, pemëtari etj.: φούρκες για το φραντζάτο. * έγινε φούρκα u zëmërua shumë.

ακουνά,- η f. bojë kuqërreme që përdoret nga femrat për të lyer flokët. në droppull ditën e ëjnte para dasmës çohej kënjaja nga shtëpia e dhëndrit në shtëpinë e buses: θα πάμε την ακουνά.

βιλάρι,-το as . rrip i gjatë i ngushtë i diçkaje: έκοψε το πανί βιλάρια.

γιακάς,-ο m. jaka: ποκάμισο με γιακά; φουστάνι χωρίς γιακά.

καραμπογιά,-η f. bojë e zezë, që në këngën popullore, ia kërkonte gruaja burrit që ndodhej në kurbet për të ngjyer flokët: στείλε μου γυαλί και χτένι και караμπογιά καύμένη.

Tiparet morale të njeriut

αζντιμένος,-η, -ο mb. që është i papërmbajtur e i çthurrur: αζντιμένο παιδί (Dr. P.); i tërbuar, i harbuar (për kafshët): αζντιμένο άλογο (Dr. P.)

αϊντισμένος, -ο mb. shif αζντιμένος. (Dr. P.)

αντραλωμένος,-ο mb. që ka plot telashe: φαίνεται αντραλωμένος; që i merren mëndtë: είναι αντραλωμένος θα πέσει.

ατζαμής,- ισσα,- ικο mb. i rapjekur: είναι τόσο ατζαμής ακόμα.

γινατεμένος,-η, -ο mb. ai që është i zëmëruar: είναι γινατεμένος.

γκριτζανός, -ο mb. që është i hollë dhe i hijshëm: γκριτζανή κοπέλα; një send i hollë si buka, lakrori etj .: γκριτζανή λιπανή.

ζαμπραάνης,- α,- ικο mb. njeri që bredh rrugëve kot: ο ζαμπράνης δε στρώνεται στη δουλειά.

τζαντάρης,-α,- ικο mb. njeri ose kafshë me huqe: τζαντάρικο παιδί; τζαντάρια φοράδα.

ζβαριάρης,-ρα,- ρικο mb. ai që zvaritet në jetë i ngathët: όλη του τη ζωή ζβαριάρης. kemi edhe tipin ζβαριλάσ.

ζβαρόκωλη,-η përd. mb. ai që zvaritet me prapanicën, që i varet fustani: φύγε μωρή ζβαρόκωλη.

ζουζάρι,-το as. ai që nuk rritet nga ana trupore, shkurtabiq: έμεινε ζουζάρι.

ζουλάπι,- το as. që është dinak, që vepron me paramendim: μου την έριξε ζουλάπι.

ζουλουμκιάρης,-ρα,- ρικο mb. ai që shkakton dëme, zullume: τα πλήρωσε ο ζουλουμκιάρης.

- καπανταής,- ο m.** *karadaiu: τήρα πως ταράζεται ο καπαντας.*
- κεφιλής,-ισσα,-ικο mb.** *qejfli: κεφιλής γέρος; që ka shumë qejf diçka: κεφιλής για τη μουσική;*
përd. em. sipas kuptimeve të mbiemrit: κεφιλήτισσα για γλυκά.
- κιμπάρης,-ρα,-ικο mb.** *që nuk e ul dinjitetin e tij: ο Μήτσος είναι κιμπάρικος.*
- κομπούρας,-ο përd. mb.** *për njeriun kokëfortë, kokëtrashë: είναι κομπούρας από τη γνώμη.*
- λαφαζάνος,-α mb.** *pa gjininë asnjënëse. llafazan – e: λαφαζάνα γυναίκα.*
- λιανέτης,-ο m.** *njeri i keq, shejtan: είναι λιανέτης.*
- μιστρέτης,-ω, ικο mb.** *njeri ngatërrestar, grindavec: μη μιλάς με το μιστρέτσι.*
- μουκαέτης,- ισσα mb.** *ai që neglizhon për diçka, që e lë pas bërë ose e lë në harresë: δεν έγινα μουκαέτης να σε βρώ.*
- μουντζούρης, -ω, - ικο mb.** *i vrejtur: δεν μπορείς να μιλήσεις με το μουντζούρη.*
- μουντζουρωμένος, -η, -ο mb.** *i bërë me njolla më fytyrë: μουντζουρωμένα μούτρα; i turpëruar: μουντζουρωμένος από τις γκάφες.*
- μπατάλα,-η f.** *një vajzë që mbetet e ramartuar: έμεινε μπατάλα.*
- μπανταλός,-ή -ό mb.** *i metë ose i trashë nga mendja: μπανταλός άντρας; që nuk ka asnjë gjykim të shëndoshë, që nxitohet dhe flet të parjekura: μπανταλά λόγια.*
- μπανταζής, - ο m.** *badakçiu: μη ανακατώνεσαι με το μπανταζή.*
- μπαριάκι, - το as.** *që ka trup të gjatë: μπαριάκι για κρούσκος.*
- μπατάκας,- ο m.** *njeri i ulët dhe i ndyrë: ο μπατάκας του χωριού.*
- μπελιατζίτικος, -η, -ο mb.** *njeri i bezdishëm, që të shkakton belara: φυλάξου, είναι μπελιατζίτικος.*
- μπερμπάτης, - ισσα, - ικο mb.** *beribat. vetëm për njerëzit: το παιδί του έγινε μπερμπάτης.*
- μπιρμπίλι, -το as.** *bilbili; përd. mb. njeri që flet shpejt e bukur: είναι μπιρμπίλι από το στόμα ;*
përd. mb. njeri llafazan: πάψε μωρέ μπιρμπίλι.
- μπίρμπας,- ο përd. mb.** *ai që bën jetë të shthurrur, me qefe: όλη του τη ζωή μπίρμπας.*
- μπιτισμένος,-η, -ο mb.** *i humbur, i raafitë: μπιτισμένος άνθρωπος.*
- μπούτσιρος,- η, -ο mb.** *trim, pucarak; όμορφος: μπούτσιρη κοπέλα.*
- μπούφος, - ο përd. mb.** *fig . njeri i trashë: είναι μπούφος ο καϋμένος.*
- μπουχαβιασμένος,-η, -ο mb.** *μπουχαβιασμένα μάτια (Dr. P.) kemi dhe tipin*
- μπροухαβιασμένος,-η,-ο**
- μούχαβος,-η, - ο mb.** *që nuk ka shëndet dhe ka të ënjtur dhe zverdhur fytyrën*
- μπρεσκάρης,-ρα, - ρικο mb.** *fëmi e dobët: μπρεσκάρικο παιδί. (Dr. P.); bostan me bark: μπρεσκάρικο αγγούρι. (Dr. P.)*
- νισάνι,- το as.** *me përd. mb. që shquhet për bukuri, sjellje etj.: παιδί νισάνι; keq. që nuk shquhet për vyrtytet e mësipërme: τι λέσ μωρέ νισάνι.*
- νourένιος, - α, - ο mb.** *që është shumë i bukur: νourένια γυναίκα.*
- νούρι,-το as.** *me përd. mb. që është i bukur: νούρι παιδί; νούρι κοπέλα.*
- νταμπλαρωμένος,-η, - ο mb.** *i rafat, i raafitë: δεν έκαμε προκοπή ο νταμπλαρωμένος.*
- νταρντάλω, f.** *me përd. mb. νταρντάλω γυναίκα (Dr. P.)*
- ντερέκας,- ο m.** *fig. ai që i përngjan direkt, i gjatë dhe i pamendë: ο ντερέκας δε βάζει γνώμη.*
- ντερέκι,- το as.** *ai që është mbështetja e shtëpisë: ο λ. είναι ντερέκι του σπιτιού.*
- ντερντεμένος,-η, -ο mb.** *që ka kaluar halle, që ka pasur dhe merake: πέρασε χάλια ο ντερντεμένος.*
- ντερτίλης,-ισσα,-ικο mb.** .
- ντουντούκας,-ο m.** *me përd. mb. njeri i gjatë dhe i pamend.: ο ντουντούκας*

- ντουντούμης, - ο m.** njeri i trashë nga mendja: φύγε ωρέ ντουντούμη.
- ντουφιάρης, -ρα, - ικο mb.** që shpërthen nga zemërimi i madh: ντουφιάρα νύφη.
- πατσαβούρα, -η f.** leckë që përdoret në kuzhinë: έπιασε τον τέντζερη με τις πατσαβούρες; një letër, një dokument ose një gazetë pa vlerë: υπέγραψαν μια πατσαβούρα.; fig. njeri i ulët dhe pa karakter: κατάντησε πατσαβούρα.
- πιστιόλας, - ο m.** me përd. mb. njeri kokëgdhë: ο πιστιόλας, ο άντρας της.
- πούφκας, - ο m.** me përd. mb. njeri fricak, ruftë: τι περιμένεις από τον πούφκα .
- ραχατιλής, - ο m.** me përd. mb. që i pëlqen rehatia: ο ραχατιλής δεν κουνιέται.
- ρεμουλατζής, - ο m.** rrëtmujaxhiu: είναι μεγάλος ρεμούλατζής.
- σακατζής, - ο m.** me përd. mb. (shakaxhis, ο) që i pëlqen shakaja: σακατζής γέρος.
- σαλακούμης, -ω, - μικο mb.** ai që i varen rrobat këndeje andej: δε διορθώνεται ο σαλακούμης. (Dr. P.)
- σπλακούτης, -ισσα, ικο mb.** shif. σαλακούμης, - ω, - ικο . r.
- σειτάνης, -α, - ικο mb.** që është i djallëzuar: σειτάνα γυναίκα.
- σέρτης, - ισσα, - ικο mb.** që punohet me vështirësi: σέρτισσα λαμαρίνα; që është i fortë në shije, në të pirë: σέρτικο καπνό; fig. i vrazhdët, jo i afrueshëm, jo i shtruar (për njerëzit që si pasojë nuk shëndoshen); σέρτικο παιδί; që nuk shtrohet me lehtësi (për kafshët): σέρτικο άλογο.
- σικλιτισμένος, -η, - ο mb.** që është shumë i mërzitur i brengosur: φαίνεται σικλιτισμένος.
- σκεμποκέφαλος, -η, - ο mb.** kokëshkëmb, i trashë: σκεμποκέφαλο παιδί .
- σκόκας, - ο m .** me përd. mb. që s' ka kokë, i ramend: δεν ακού μωρέ σκόκα . (Dr. P.) kemi edhe tipin σκόπας (shkopas) nga shkopi (Dr. S.)
- σοϊλής, -ισσα, - ικο mb.** që ka prejardhjen e tij nga një familje e mire: σοϊλίτισσα γυναίκα; fig. për një mashkull me organ shumë të zvilluar: σοϊλής άντρας.
- σουράτι, -το as.** keq. njeri me surrat të ndyrë, i keq në shpirt: χάσου μωρέ σουράτι.
- ταμακιάρης, -ρα, - ρικο mb.** që nuk ngopet kurrë në të ngrënë, për plaçka, në punë: δε χορταίνει ο ταμακιάρης; ταμακιάρης στη δουλειά .
- τοργιασμένος, -η, - ο mb.** që humbi toruan në punë, që nuk di ç' të bëjë: τοριασμένο παιδί.
- τσαμαρόκω, - η f.** me përd. mb. e praptë, e çakindisur: τσαμαρόκω κοπέλα.
- τσαμπάζης, - ο m.** ai që shet dhe blen kuaj a kafshë të tjera me qëllim fitimi: τρομερός τσαμπαζής; keq . njeri që përpiqet t'ua hedh të tjerve për të fituar sa më shumë për vete: φυλάζου από τον τσαμπάζη.
- τσανάκι, - το as.** me përd. mb. për njeriun e ulët dhe pa cipë: είναι παλιό τσανάκι.
- τσιρόνι, το as.** fig . për njeriun e dobët: έμεινε τσιρόνι.
- φιριφίου mb.** thjeshtligj mospërf. fare i parjukur e mendjelehtë: είναι φιριφίου από τη γνώμη.
- χαλές, - ο m.** me përd. mb. njeri i ndyrë, me ndërgjegje të prishur: έγινε χαλές; që nxjerrë fjalë të ndyra nga goja: είναι χαλές από το στόμα.
- χοϊλής, - ο m.** ai që ka huqe të mira ose të këqija: ο χοϊλής δεν τραβάει χέρι από τα χούγια του.
- χουμπούρι, - το përd. mb.** i humbur: χουμπούρι άντρας. (Dr. S.)

Tiparet fizike të njeriut

γκιόξι, - το as . στήθος, το: τι γκιόξι που σόχει . * δουλεύει με γκιόξι punon me forcë, me vrull; με ανοιχτό γκιόξι; έβαλε το γκιόξι στη δουλειά, punon për të kapërcyer çdo pengesë e vështirësi; χτυπάει το γκιόξι του με τις γροθιές, pendohet.

γκότζα *përd. mb. përdoret përpara një emri për të treguar një tipar cilësor në shkallë të lartë: γκότζα γυναίκα; γκότζα σπίτι etj.*

γκούσα, *η f. pjesa e përparme dhe pak e dale e qafës së njerëzve ose kafshëve: του κρέμονται οι γκούσες; άσπρη γκούσα; qesja e disa shpendëve, ku qëndron ushqimi para se të kalojë në organet e tretjes: η γκούσα του κούρκου. * πίαστηκαν γκούσα με γκούσα, shumë afër dhe me inat.*

ζουζάρι, - *το as. njeri me trup të shkurtër: φύγε μωρέ ζουζάρι.*

ζβέρκος, *ο m. zverk: τον έπιασε από το ζβέρκο. * του ανέβηκε στο ζβέρκο e nënshtrou.*

καφκάλα, - *η f. kokë e madhe: καφκάλα που σόχει.*

κάφαλο, - *το as. truri i kokës, mendja: δεν του κόβει το κάφαλο.*

κίόρης, - *ρω, - ρικο mb. i verbër: κίόρικο άλογο; fig. i pavëmendshëm, i shushatur: δε βλέπει ο κίόρης κόκα, - η f. koka: δεν ακούει η κόκα του. me ironi (Dr. P.)*

κουρίζι, - *το as. shpatullat: το σπασε το κουρίζι. (Dr. P.); gungë me shpinë: του μεγάλωσε το κουρίζι. * δε βαστάει το κουρίζι του që nuk ka aftësi të bëjë punë, që nuk mund të ngarkohet me diçka tjetër.*

λιόκια, - *τα as. e përdorshme në shumësin për bolet: τον χτύπησε στα λόκια.*

μπίθα, - *ο m. bytha: να μου φάς το μπίθα. për raste zemërimi ose ironie.*

μπίστα, - *η f. bishti në fund të kurrizit të kafshëve: κοντί μπίστα; pjesë e hollë që bashkon gjethen, frytin ose lulen me kërcellin: κόβει τισ μπίστες; pjesë e një vegle zakonisht prej druri që mbahet nga njeriu: η μπίστα του τσοκανιού.*

μπλέτσος, - *ο, -α, -ο mb. i zhveshur: έμεινε μπλέτσος.*

μπλετσουνάρης, - *ρα, - ρικο mb. zmadhim i kuptimit të mbiemrit blecos; fig. i varfër: έμεινε μπλετσουνάρης.*

τσότσκα, - *η f. pjesa e sipërme e kokës me largim nga kuptimi i shqipes: τον βάρωσε ο ήλιος στη τσότσκα; kokë e qethur tërësisht: του βγήκε η τσότσκα.*

νταμάρι, - *το as. damarët e trupit të njeriut: του βγήκαν τα νταμάρια στα πόδια; shtresat e gurit në guroret: βρήκαμε καλό νταμάρι; vijat nëntokësore të ujit: κόπηκε το νταμάρι της βρύσης; fig. prirje ose dhunti: έχει νταμάρι για μουσικόσ. * έχει ένα νταμάρι τρέλλας, ka një dammar marëzie.*

πάλτσα, - *η f. palca e eshtrave të njeriut ose të kafshëve: έβγαλε την πάλτσα απο τα κόκκαλα;*

fig. shumë thellë kryesisht për shiun ose për të ftohtë të madh që deportojnë në trupin e njeriut: του μπήκε το κρύο ωσ την πάλτσα.

σακάτης, - *α, - ικο mb. i gjymtuar: σακάτης από το πόδι. * σακάτης από το μυαλό sakat nga truri, që nuk i pret.*

τακάτι, - *το as. fuqi, forcë δεν έχει τακάτι.*

ταμπάνι, - *το as. shputa e këmbës: ταμπάνι με καμάρα; shualli i kërucës: γερό ταμπάνι; fig. mbështetja e fortë: σπίτι με ταμπάνι. dmth me bazë ekonomike të fortë. * άνθρωπος με ταμπάνι me karakter të fortë.*

τελετίνι, - *το as. me përd. mb. njeriu i dobët shumë: έγινε τελετίνι, si lëkura telatinë.*

τζουλούφρι, - *το as. tufë flokësh të përdredhur që zakonisht varet mbi ballë ose anës: της κρέμεται ένα τζουλούφρι.*

τσενωμένος, - *η, - ο mb. njeri i dobët nga ana shëndetësore: τσενωμένο παιδί.*

τσέτσης, - *ο m. me përd. mb. njeri i vogël në moshë ose në trup të pakët: είναι τσέτσης. (Dr. P.);*

fig. me gjykim të dobët mendor: τσέτσης από τη γνώμη.

τσιλιμί, - *το as. fëmijë i vogël: είναι τσιλιμί ακόμα; me pak mend: κουβεντιάζει σαν τσιλιμί.*

τσιπά, - *η f. njeri me ose pa sedër: άνθρωπος χωρίς τσίπα.*

τσόκος, -ο m. organ i mashkullit. (Dr. P.)

τσότσο, -η, -ο mb. me trup të vogël: τσότσο κορμί; një sasi e vogël: τσότσο αλεύρι; me rak mend: τσότσο μυαλό.

τσουρούκης, -ισσα, -ικο mb. njeri me cen, i gjymtuar: έμεινε τσουρούκης από το χέρι; fig. me dëmtim në tru: είναι τσουρούκης από τη γνώμη.

Sëmundjet

γκούσα, -η f. mjek. fryrja e gjëndrave tiroide: της βγήκε η γκούσα.

νταμπλάς, -ο m. damllaja: τον βάρωσε ο νταμπλάς.

πίκα, -η f. damllaja: πικά που να σε βαρέσει.

σακατιλίκι, το as. pasojë e gjymtimit të trupit: τον έφαγε το σακατιλίκι.

τσένο, -ο m. në kuptimin e përgjithshëm të sëmundjes: έχει τσένο, që shëndeti i tij nuk përmirësohet.

Lidhjet farefisnore

βλαμηλίκι, -το as. lidhja e ngushtë dhe e përzetshme midis një të riut që kur martohet me një te tij, bëhet në dasëm. vllamis dmth drejtuesi i dasmës.

βλάμης, -ο m. (vllamis, ο) drejtuesi i dasmës: ο βλάμης θα πάρει τη νόφη στο χορό.

γκέγκας, -ο m. banori i Gegërisë: είναι γκέγκας.

κρούσκα, -η f. krushka: φρόνιμη κρούσκα.

κρουστιά, -η f. συμπεθεριά: έκαμαν κρουστιά.

κρούσκος, -ο m. krushku: πάμε στον κρούσκο; njeri i pashëm: είναι κρούσκος.

μίκια, -η f. nga mikësja, por që nënkupton gruan shqiptare me çitjane të zeza: ήρθαν οι μίκες από το Λαζαράτι.

νίνι, -η f. nëna: η νίνι του θωμά. (Dr. P.)

τάτας, -ο m. i ati: έβγα θύγω μ'έβγα, βγαίνω τάτα βγαίνω. (K. pop.) kur përcillet nusja nga shtëpia e të atit; e përdorshme për të respektuar një xhajë ose një dajë: ο τάτα Μήτσος.

φαμπίλια, -η f. οικογένεια: καλή φαμπίλια; lidhjet e ngushta midis njerëzve: είναι σαν μιά φαμπίλια.

φαμπιλής, -ισσα, -ικο mb. ai që kujdeset për familjen e tij: φαμπιλής άντρας.

Gjendja sociale e njerëzve

αγάς, -ο m. (aás, ο) agai si pronar tokash: ο αγάς του Λιμποχόβου iron. ai që sillet si aga: μας έγινε αγάς του σπιτιού.

κεχαγιάς, -ο m. kujdestari i një pronari: ο κεχαγιάς του μπέη; iron. ai që sillet në familje ose në shoqëri si qehaja: κεχαγιά θα σε κάνω.

κολαούζος, -ο m. udhërrëfyes: χωριό που φαίνεται δε θέλει κολαούζο. spiun: φυλάζου, είναι κολαούζος.

μουχτάρης, -ο m. kryeplaku i fshatit: δίκαιος μουχτάρης.

μπαστί, -το as. me përd. mb. fëmija ilegale: μπαστί το κακόμοιρο; iron. i djallzuar: σε γελάει το μπαστί.

μπάστος, -ο m. me përd. mb. fëmija ilegale: το μπαστί.

Organizimi shoqëror e shtetëror

μπίστος, -α, -ο mb. ai që vjen i fundit në punë, në mësim, në gara etj.: έφτασε ο μπίστος.

ντολίμασης -ο mb. ο ντολιμάσης να ζει, να χαίρεται, πίνω και ορισμό.

σκούρτα, -η f. short që hidhet me fije druri, shkurtëza: ρίχνομε τις σκούρτες.

σκούρτης, -ο m. muaji: Φλεβάρης.

Sistemi financiar

αγαλίτικο, -το as. detyrimi ndaj agait për përdorimin e pronës së tij: φόρτωσα το αγαλίτικο.

βεργί, -το as. vergji: δεν έχει να πληρώσει το βεργί.

ταξιντάρης, -ο m. mbledhës i taksave: φοβερός ταξιντάρης.

τζελέπι, το as. taksa mbi bagëtitë.

Terminologji ushtarake

κομπούρα, -η f. kobure e madhe: ασημένα κομπούρα.

κομπούρας, -ο m. me përd. mb. kokëfortë, i ragdhëndur: είναι κομπούρας.

κομπούρι, -το as. kobure: καμαρώνει με το κομπούρι.

πάλα, -η f. shpatë lufte me një ose dy pagesa: έζωσε την πάλα.

πάλα . κάνει πάλα rri pa bërë gjë, e kalon kohën pa u lodhur, bën qejf.

τσέτα, -η f. çeta: η τσέτα του τσερτσιζή.

τσεφτές, -ο m. armë zjarri për gjah: καλός τσεφτές.

Lodra

μπίζι, -το i palak. loja biz, që zakonisht luhet në dimër: παίζομε το μπίζι.

Zejtari

γκαλντερίμι, -το as. n rrugë e shtruar me gurë: τα γκαλντερίμια του κάστρου.

ζανάτι, -το as. zeje, mjeshtri, profesion: διάλεξε καλό ζανάτι. * πόσα έχει το ζανάτι edhe iron, dmth ka shumë sekrete që e di mire ai që e ushtron prej kohësh dhe e zotëron mirë.

ζανατσής, -ο as. επαγγελματίας: παλιός ζανατσής; mjeshër me provojë të madhe: έχεις να κάνεις με ζανατσής.

καλαϊ, -το as. kallaji: το κόλλησε με καλαϊ. * του βγήκε το καλαϊ: i doli boja në shesh kush është me të vërtetë.

καλαϊζώ kal. lyej ose ngjit me kallaj: καλαϊζώ τ'αγγειά του σπιτιού.

καλαϊσμένος, -η, -ο mb. një send i kallisur.

καλαντζής, -ο m. mjeshtri i kallaisjes.

κοπάτσα, -η f. rrahje me koraçe: θα σου δώσω μιά κοπάτσα.

μπατζαριό, -το as. baxhoja: τυρί από μπατζαριό.

μπατζιος, -ο m. τυροκομείο.

μπατζοτζής, -ο m. ai që punon bulmetin në baxho.

ναλμπάνης, -ο m. ai që mbath kafshët thundrake: καλίγωσε το άλογο στο ναλμπάνη.

νταούλι, -το as. ai që u ënjt ose fry si daulla nga të qarit ose nga të rrahurit: έγινε νταούλι στο κλάψιμο; përd. mb. ai që është kokëfortë: τόχει νταούλι το κεφάλι.

ντερέκι, -το as. tra për të mbajtur dyshemënë, stinë etj: έβαλε ντερέκια στο πάτωμα.

οπίγκα, -η f. oringa: οι οπίγκες του τζομπάνου.

οπιγκάρης, -ο m. ai që bën oringa.

πραβάξι, -το as . korniza e derës ose e dritares.

παρμάκι, -το as . rradhë shufrash që vihen në shkallë ose në ballkon: όμορφα παρμάκια.

τεγέλι, -το as. tegeli: στραβό τεγέλι.

τσιφλωμα, -το as. veprim i foljesτσιφλώνω.

τσιφλωμένος, -η, -ο mb . i ciftuar: τσιφλωμένο πιάτο.

τσιφλώνομαι, vetvet. më hiqet një cifël, dëmtohem në sipërfaqe: τσιφλώθηκε η σουπιέρα.

τσιφλώνω, kal. ciftloj: τσίφλωσε τον τοίχο.

τσοκάνι, -το as. çekani si vegël dore: το τσοκάνι του μάστορα. (E . Çabej jep dy mundësi për prejardhjen e fjalës: a) prej turkishtes, b) prej sllavishtes. Për këtë të dytën ai mendo se duhet të parapëlqehet. * τσοκάνι του κεφαλιού . kur një pjesëtar i familjes i shqetëson së tepërmi të tjerët.

τσοκανίζω και τσοκανάω kal. çokanis gurët ose anët e tyre: τσοκανάει τις πέτρες; jokal. i bie çokut të derës, trokas në portë me çok ose me dorë: τσοκανάει την πόρτα; fig. e rrah dikë, e qortoj: του τσοκάνισε το κεφάλι.

τσοκάνισμα, -το as.b veprim i foljes çokanao.

φλοκοτός, -η, -ο mb. i bërë me flokë: φλοκοτή βελέντζα.

Tregtia

αλισβερίσι, -το as. shitblerja: παίρνεται με αλισβερίσι; tregti e pandershme, dallavere: κάνει αλισβερίσα.

δευτέρι, -το as. fletore shënimesh: στο χαρτί και στο δευτέρι, μες το δέξιο του χέρι. kën. pop.;

kryesisht fletorja e bakallit: το δευτέρι με τα βερεσίδια. * άνοιζε τα δευτέρια hari llogaritë e vjetra, mosmarveshjet etj.; τον ζέγραψε από το δευτέρι, nuk e llogarit më si mik, si shok; κλείστε αυτά τα δευτέρια, mbyllni mosmarveshjet e vjetra etj.

ζενγκίνης, -ο m. i pasur: έγινε ζενγκίνης.

καντάρι, -το as. peshore me bisht të shkallëzuar: το βόλι του κανταριού. * δε σηκώνει το καντάρι që nuk vlen të merret parasysh; θα βάλομε το καντάρι και δε θα βάλομε το καντάρι, kur ndajmë diçka për afërsisht dhe s'ka nevojë të peshohet ose të numërohet një për një.

καούλι, -το as. kaulli: αγόρασε με το καούλι.

καρβάνι, -το as. varg kafshësh me plaçka të shoqëruara nga qiraxhinj: μεγάλο καρβάνι στο δρόμο; varg njerëzish ose automjetesh që lëvizin në një drejtim: καρβάνι γυρίζουν οι γυναίκες απο τον κάμπο.

κατσίδα, -η f.monedhë me vlerë 20 para: δεν έχει ούτε μιά κατσίδα; lloj sëmundjeje si zgjebja në kokë: τον έπιασε η κατσίδα στο κεφάλι.

κατσιδιάρης, -ρα, -ρικο mb. ai që nuk ka as edhe një kacidhe, i varfër: κατσιδιάρης ο καημένος.

κουσούρι, -το as. të holla që i kthen shitësi kur plaçka kushton më pak: του γύρισε κουσούρι; një gjë e papritur, një hall: τον έπιασε κουσούρι; e metë, ves, gabime: έχει πολλά κουσούρια. * δεν τ'άφηκε το κουσούρι ia numëroi të gjitha.

κελεπίρι, -το as. një send, një e pirë ose e ngrënë që merret falas: του αρέσει το κελεπίρι; përd. ndaj. përfitimi i diçkaje pa paguar ose punuar: το 'χει κελεπίρι.

κελεπιρτζής, -ο m. ai që i pëlqen qelepëri: μεγάλος κελεπιρτζής.

ματραπαζιλίκι, -το as.

ματραπάζης, -ο ai që blen mallra dhe i shet me çmime të larta: έπεσε στα χέρια του ματραπάζη.

μπανταζής, -ο m. bataksi: αχόρταγος μπανταζής.

μπανταξιλίκι, -το as. sjellje bataksiu: κάνει μπανταξιλίκια.

μπεντιαβά, ndaj. falas: δουλεύει μπεντιαβά; shumë lirë: το πούλησε μπεντιαβά; fig. ai që flet ose dëgjon bediana: κρένει μπεντιαβά.

μπόρτζι, -το as. hua: παλιό μπόρτζι; fig. detyrim moral ndaj dikujt: ξεπλήρωσα το χρέος μου απέναντί του. * έχει χρέος να..., a) είναι έτοιμος να ... b) είναι σε θέση να ..., μου το 'καμε το μπόρτζι dikush ka përsëritur disa here një sjellje të padurueshme kështu që nuk mund të përmbahem karshi tij; του βγήκε από το μπόρτζι, bëri gjithçka që i takonte, e paralajmëroj me kohë.

μπορτζιλής, -ο m. huamarrësi; fig. ai që ka një detyrim moral ndaj dikujt: είναι μπορτζιλής στους γονείς του.

τσαμπαζηλίκι, -το as. runa e xhambazit: κάνει τσαμπαζηλίκια; zakon. sh. bised. dallavere: παίρνεται με τσαμπαζηλίκια.

τσαμπάζης, -ο m. ai që shet dhe blen kuaj a kafshë të tjera për të nxjerrë fitime, ai që stërvit kuajt xanxarë:

τσαμπάζης αλόγων; keq. ai që bën dallavere: παζάρια του τσαμπάζη; përd. mb. sipas kuptimit 2 të emërit: τσαμπάζης άνθρωπος.

6. Bujqësia

A. Mjetet e punës

ζάκα, -η f. thes për ta mbushur me grurë, miser, etj.: γέμισε τη ζάκα.

ζβάρρα, -η f. lesa për të copëtuar plisat në arë: δέσε τη ζβάρρα; ndaj. kur tërheq dikë a diçka duke e zvarritur: τον πήρε ζβάρρα.

κορύτα, -η f. govatë e gjatë ku hedhin ujë për bagëtitë: γέμισε η κορύτα; gropë me ujë: τα ζώα πίνουν νερό στις κορύτρες.

κόσα, -η f. kosa që përdoret për kositjen e barit: τροχάει την κόσα.

κοτσέκι, -το as. ndërtesë ku mblidhej misri i agallarëve, i monastireve et j.: ζεφλίζουν καλαμπόκια στο κοτσέκι.

κουσί, -το as. enë e rrumbullakët prej llamarine që përdoret zakonisht për qumësht: βράζει το γάλα στο κουσί.

Emra bimësh dhe të prodhimeve të tyre

γκοριτσά, -η f. (goriça, i). dardhë e egër: είναι φορτωμένη η γκοριτσά.

γκορίτσι, -το as. fruti i goricës: ένα σακκούλι γκορίτσα; fig. ai që e ka kokën si goricet, i parjekur: το 'χει γκορίτσι το κεφάλι.

μάνες, -οι f. e përdorshme në shumësin për manaferrat: έμασαν μάνες στ'άμπελια. (Dr. P.) kemi edhe tipin μάντζες(maxes) ter.

μανουσάκι, -το as. manushaqja: μοσχοβολούν τα μανουσάκια.

μπαρμπαρόζι, -το as. barbaroza: έριζε μπαρμπαρόζι στο γλυκό.

μπερεκέτι, -το as. prodhimi buqësor në grurë, miser etj.: έμασαν το μπερεκέτι στον κάμπο; fig. fryt, dobi: δουλειά χωρίς μπερεκέτι.

τρεντελίνα, -η f. trëndelinë si bimë: μυρωδιά τρεντελίνας. * έμεινε τρεντελίνα, mbeti pa asnjë lek. έγινε τρεντελίνα, u dobësua shumë.

τσαϊρι, -το as. çairi: κοσίζει το τσαϊρι. * έφαγε το τσαϊρι του (efaje to çairi tou), u plak, shkon drejt vdekjes.

Karakteri i punës

κασαϊζω, kal. kreh e pastroj kalin, lopën etj.: *κασαϊζει το άλογο.*

κασαϊζεται, pës. e. κασαϊζω .

κασάισμα, -το as. *veprimi sipas kuptimeve të foljeve κασαϊζω και κασαϊζεται.*

κοσίζω, kal. *kosit barin me kosë: κοσιζει το χασίλι; fig. shfaros në masë njerëz në luftë etj.: τους κοσισε το περιβόλι.*

κόσισμα, -το as. *veprimi i foljes κοσιζω.*

ταιζω, kal. *i jap tagji kafshës: ταιζει τ'άλογο; fig. ushqej mire fëmijën: το ταιζει καλά το παιδί.*

τάισμα, -το as. (*taizma, to*). *veprim i foljes ταιζω.*

Të ndryshme

γκαμπά, ndaj. *që zë shumë vend nga volume i madh: το φόρτωσεσ γκαμπά.*

ζούριγμα, -το as. *veprim sipas kuptimeve të foljes ζουρίζω και ζουρίζομαι.*

ζουριγμένος, -η, -ο mb. *tokë e djegur nga vара e madhe: ζουριγμένο χωράφι; bukë e përcëlluar: ζουριγμένο ψωμί.*

ζουρίζομαι, vetv. *zhuritem nga zjarri, nga vара etj: ζουρίχτηκε ο κάμπος; fig. i sëmurë që ka temperatur të lartë: ζουρίχτηκε από τον πυρετό.*

ζουρίζω, kal. *e thaj, e djeg dikë: ο ήλιος ζούριξε τον κάμπο; e djeg, e përcëlloj: ο φούρος ζούριξε το ψωμί; temperatura që djeg të sëmurin: οι θέρμες ζούριζαν το παιδί.*

καυκάλια, -τα as. *në shumësin për fletët e kallirit të misrit që mbeten pas këputjes së tij dhe që*

i përngjajnë kafkës së njeriut: τα γελάδια βοσκάνε στα καυκάλια.

λούτσα, -η f. *vend me baltë të hollë, baltë e hollë: μπήκε στη λούτσα; si topor. pjesë e fushës që mban ujë e mbetet baltë: οργώνει λούτσεσ; si ndaj. ai që u lag shumë nga shiu: έγινε λούτσα.*

σκάρπα, -η f. *degë të holla e të thata për të ndezur zjarrin: μαζεύει σκάρπες.*

τζούφα, -η f. *tufë në majën e kërcellit të misrit: βγήκαν οι τζούφες στο καλαμπόκι.*

τσατάλι, -το as. *degë që ndahet nga trungu, bisk; pjesë e dale në majë anash një sendi: το κλίμα έβγαλε πολλά τσατάλια.*

Kafshë shtëpiake

ζαγάρι, -το as. *qen gjahu: καλό ζαγάρι; fig. rrugaçi, njeri pa cipë: τι περιμένεις απ' αυτό το ζαγάρι.*

ζέμπα, -η f. *dele ose dhi me qime të zeza: θα σφάξομε τη ζέμπα. (Dr. P.)*

λιάρος, -α, -ο mb. *kafshë shtëpiake e larmë: λιάρο βόϊδι.*

ματσί, -το as. *këlysh maceje: παίζει με το ματσί.*

μούσκα, -η f. *mushka: ζατζάρα μούσκα.*

μπάλιοσ, -α, -ο mb. *qen ose ka me një ballë të bardhë në turi: δέσε το μπάλιο.*

μπέϊκα, -η f. *dele me turi ngjyrë bezh: μπέϊκα προβατίνα.*

μπούζος, -ο m. *qen që ka buzër të zeza.*

ντόσα, -η f. *femra e derrit: γέννησε η ντόσα; fig. grua e trashë: έγινε ντόσα; fig. femër e pandershme: η πάλιο ντόσα.*

ρόσα, -η f. shpend shtëriak: αυγό από ρόσα.

σήβο, -το as. kalë ose pelë e bardhemë ose e përhimë: σήβο άλογο. (Dr. P.)

τσαγκάδι, -το as. dele ose dhi pa qengj ose kec. për një dele ka edhe tipin η τσαγκάδα. për delet në shumësin τα τσαγκάδια.

Kafshë të egra

γκιώνης, -ο m. shpend grabitqar: η φωνή του γκιώνη.

κατσουλάτρα, -η f. shpend me kaçul në kokë.

λελέκι, το as. lejleku si shpend shtegtar: ήρθαν τα λελέκια.

μπιρμπίλι, -το as. zogu bilbili: κελαϊδάει το μπιρμπίλι; fig. ai ose ajo që flet shumë: μπιρμπίλι από το στόμα.

ρόσα, -η f. shpend i egër: βάρεσε τρείς ρόσες στον κάμπο.

τσακάλι, -το as. kafshë grabitqare: κατέβηκαν τα τσακάλια; fig. njeri i egër që ulurin: ουρλιάζει σαν το τσακάλι.

λάλα, -η f. (llalla, i). krimb i madh që rron nëpër pemët: σκότωσε μιá λάλα.

Sende, lëndë

κατράνι, -το as. katrani si lëng i trashë që nxirret nga nafta, qymyrguri etj: μυρωδιά από κατράνι; përd. mb. që është shumë i zi ose shumë i flliqur: κατράνι μαλλιά; κατράνι ρούχα; fig. përd. mb. njeri shumë i keq: έχει την καρδιά κατράνι.

σκέμπι, -το as. shkëmbi: βουνό με σκέμπια; përd. mb. njeri kokëfortë: το 'χει το κεφάλι σκέμπι.

σουπέλα, -η f. (Dr. P.) dhe σουπέλα f. (Dr. S.) shkëmb: οι σουπέλες της Δολιανής.

τσακίλι, -το as. gurë të thyer për të shtruar rrugët: σωρός με τσακίλι.

Fenomenet e natyrës

κιαμέτι, -το as. shtëngatë, fortunë, përmbytje: που βγήκες με τούτο το κιαμέτι (pu vjites me tuto to qiameti).

μούζγκος, -ο m. errësirë, gjëndja kur erret: έγινε μούζγκος.; fig. i vrazhdë: κάθετα σαν μούζγκος.

μούζγκωμα, -το as. veprimi dhe rrjedhimi i folies μουζγκώνω, kur erret: θα ρθω με το μούζγκωμα.

μουζγκώνει, vetv. pavet. zë e ngrysët: πήρε να μουζγκώσει vrenjtet, erret (koha, qelli etj): μούζγκωσε ο καιρός.

μπόρα, -η f. mot i keq, fortunë: μεγάλη μπόρα; fatkeqësi që kalon njeriu në jetë: πέρασε μεγάλες μπόρες.

χαβάς, -ο m. kohë, klimë: καλός χαβάς.

Sipërfaqja e tokës

μουσάς, -ο m. mushaja: ο μουσάς του χωριού.

στίγκα, -η f. shtegu si vend i ngushtë për të kaluar: πέρασε από τη στίγκα; fig. rast i volitshëm: μόρθε στη στίγκα.

τορός, -ο m. gjurmë që lë në tokë njeriun ose kafshën: βρήκε τον τορό του λύκου.
χασίλι, -το as. tokë që lihet e pa punuar për rritjen e barit: κοσίζουν τα χασίλια.

Folklori

τζίντα, -η f. xhindja: βγήκαν οι τζίντες στο μέγα λάκο.

Emra konkretë dhe abstraktë

αβάζι, -το as. diçka që përsëritet dhe bëhet e mërzitshme: το ίδιο αβάζι.

αντέτι, -το as. zakon: όσο για αντέτι.

αντρέλα, -η f. kokëçarja: έχει πολλές αντρέλες.

αρέντα, -η f. rendje, vrap: αρέντα που σου κάνει.

βίτσκες, -οι f. në shumë, shkelm që hedhin kafshët: ρίχνει βίτσκες; fig. zakonisht për fëminë që kundërshton dhe këmbëngul në të tij: όλο ένα βίτσκες .

γαϊρέτι, -το as. guxim: ο άρρωστος έχει γαϊρέτι.

γινάτι, -το as. zemërimi: το γινάτι βγάνει μάτι. fj. u.

γκαζέπι, -το as. përd. ndaj. kur diçka bëhet jashtë mase: έπσεσε βροχή γκαζέπι.

γκεπούρα, -τα as. (gjepura, ta) e përdorshme në shumësin. fjalë boshe: κοπανάει γκέπουρα.

γκίρντισμα, -το as. veprimi sipas kuptimeve të foljeve γκίρντιζω και γκίρντιζομαι.

γκουντούλημα, -το as. gudulisja, veprimi sipas kuptimeve të foljeve γκουντουλιέμαι dhe γκουντουλώ.

γουρσουζουλιά, -η f. ogur vetëm në kuptimin e keq, që paralajmëron një të keqe, që ka sjellur një fatkeqësi: έφερε γουρσουζουλιά στο σπίτι.

δούρημα, -το as. veprim i foljes δουρώ (υπομένω) nga duroj.

ζαλαχιό, -το as. zhurmë, rrëmuje: έγινε μεγάλο ζαλαχιό.

ζάντζα, -η f. huq i keq, ves: έχει ζάντζες.

ζάπωμα, -το as. përvetësim, rrëmbim: ζάπωμα που σου κάνει.

ιλές, -ο m. dredhi, mashtrim: το κάνει με ιλέ. (Dr. P.) γάλα με ιλέ.

καμπούλι, -το as. i fal diku një gabim: της τόκαμε καμπούλι.

καράρι, -το as. vendim për një çështje, rrugëzgjdhje: με τα πολλά έδωσε καράρι;

qëndrueshmëri, qetësi: τόφερε σε καράρι; masa; sasia a shkalla e duhur: το κάθε τι με καράρι. * δεν του βρίσκεις καράρι a) nuk qetësohet dot (për një njeri); b) nuk rregullohet dot (për një punë)

κιοσές, -ο m. kënd: στον κιοσέ του μαγειριού (ston qoshe tu majirju); fig. në vëndin tend: κάτσε στον κιοσέ σου.

κόκεμα, -το as. marrja në nishan, zgjedhja e diçkaje sipas kuptimeve të foljes κοκεύω (Dr. P.).

κορμπάνι, -το as. fli, therror: να σου γίνω κορμπάνι.

κουρμπέτι, -το as. mërgim: πήγε στο κουρμπέτι (pije sto kurbeti).

κουρμπετλής, -ο m. ai që shkon në kurbet: γύρισε ο κουρμπετλής.

λεζέτι, -το as. shije e kënshe: τρώς με λεζέτι; njeriut që i shkon ose nuk i shkon diçka: λόγια χωρίς λεζέτι.

μάρα, -η f. marazi: έχω μάρα και 'καῦμο.

μαράζι, -το as. marazi τ'όρχεται μαράζι brengë: πέθανε από μαράζι.

μειντάνι, -το as. shesh: ... πούνε σάδια και μειντάνια. * τον έβγαλε στο μειντάνι.

μεσελές, -ο m. tregim dëfryes me gojë: όλο μεσελέδες μολογάει.

- μουκαετιά, -η f.** neglizhencë, mosproekurim për diçka: από τη μουκαετία του έμεινε ανύπαντρος.
- μπίτισμα, -το as.** përfundimi i një pune: με το μπίτισμα της δουλειάς.
- μπράχτισμα, -το as.** veprim sipas kuptimeve të foljes μπραχτίζω.
- νάμι, -το as.** emri për të mire a për të keq, që i del dikujt: έχει νάμι καλό.
- νταγιάκι, -το as.** rrahje me shkop, qortim i rëndë: θέλει ένα νταγιάκι.
- ντέγκλια, -τα as.** e përdorshme në shumësin për fjalë bohe pallavra: άφησε αυτά τα ντέγκλια.
- ντερμάνι, -το as.** mjet shërimi, shpëtimi, rrugëzgjidheje: κάνε μου ντερμάνι.
- ντόκρα, -τα as.** e përdorshme në shumësin. gjepura, pallavra: μιλάει ντόκρα. (Dr. P.)
- ντούφι, -το as.** zemërim i madh, inati: έβγαλε το ντούφι του.
- πάλα, -η f.** qefi: κάνει πάλα.
- παμπεσά, -η f.** rabesia: του την έριξε παμπεσά.
- πρόφκες, -οι f.** e përdorshme në shumësin për gjepura: κάνει πρόφκες.
- σακάς, -ο m.** fjalë për të qeshur: κάνει σακάδες; sjellje jo e matur, kuptim i përcipt i gjërave: σου φαίνεται σακάς.
- σαλτανέτι, -το as.** stolisja e tepëruar e personit dhe e shtëpisë: ζάει με σαλτανέτια; sjellja për t'u dukur: όλο σαλτανέτια είναι τος.
- σαματάς, -ο m.** shamatë, καυγάς: ζέσπασε μεγάλος καυγάς.
- σειρι, -το as.** soditje për t'u zbavitur: πάμε για σειρι στη χαρά.
- σελαμέτι, -το as.** shpëtim nga një gjendje e vështirë: τον έβγαλε στο σελαμέτι.
- σιχαρίκι, -το as.** lajm i gëzuar: μόφερε καλό σιχαρίκι.
- σκούμπα, -η f.** shkuma që fërmohet në sipërfaqen e ujit, të qumështit a të një lëngu tjetër: έφαγε σκούμπα στη στρουγαράτσα; grumbull fluskash që formohen me tretjen e sapunit në ujë: γέμισε το σκαφίδι με σκούμπες; shkumë që u del në gojë njerëzve dhe kafshëve: του σκούμπιασε το στόμα. (Dr. P.)
- σόρτι, -το as.** mënyrë për të ndarë diçka: έριζαν το σόρτι.
- ταμπιέτι, -το as.** (tabieti, to).
tabiati: καλό ταμπιέτι (kallo tabieti).
- τζεβάπι, -το as.** përgjigje: περίμενε τζεβάπι.
- τορός, -ο m.** vëmendja në punë: έχασε τον τορό του.
- φλετούρημα, -το as.** veprimi dhe gjendja sipas kuptimeve të foljes φλετουράω.
- χάκι, -το as.** e drejta që i takon njerit: πληρώθηκε με το χάκι του; hakmarrje: πήρε το χάκι του.
- χαλάλι, -το as.** diçka që e meriton: χαλάλι να του γίνει.
- χατήρι, -το as.** përkrahje e padrejtë: μπήκε στη δουλειά με χατήρι; i bëj dikujt qefin: τόκαμε το χατήρι.
- χούμπωμα, -το as.** veprimi dhe gjendja e foljes χουμπώνω.

II. Folje

- αζντίζω, kal.** e përkëdhel tepër, e çthur (zakonisht për fëmijët): τ'άζντισε το παιδί.
- αρντεύω, kal.** rend, vraproj: αρντεύει στους δρόμους.
- γινατεύω, kal.** bëj tjetrin me inat: τον γινάτεψε με τα λόγια του; jokal. marrë me inat: γινάτεψε από τη στάση του.
- γκιρντίζομαι, jokal.** lodhem shumë, mundohem, rraskapitem: γκιρντίστηκε όσο να φιάκει το σπίτι. (Dr. P.)
- γκιρντίζω, kal.** i shkaktoj humbje material dikujt: γκίρντισε τους γονείς του στα έξοδα; fig. i shkaktoj dikujt shqetësime psikike: την εγκίρντισε τη μάνα του με τα λόγια (Dr. P.)
- γκουντουλιέμαι, vetv.** gudulisem: γκουντουλιέται εύκολα.

- γκουντουλάω**, kal . *gudulis*: τον γκουντούλησε στην μασχάλη.
δουράω, *jokal . duroj*: δουράει τον πόνο; δουράει το κρύο.
ζαγαρεύω, *jokal . sillem poshtë e lart rrugëve si zagar*: ζαγαρεύει στους δρόμους.
ζαμπρανεύω, *jokal . sorollatem rrugëve si rrugas*: ζαμπρανεύει χωρίς δουλειά.
ζαπόνω, kal. *përvetësoj, shtie në dorë*: ζάπωσε μάλι τόπο.
ζβαρίζομαι, kal . *zvarrit arrën në lesë*: ζβαρίζεται το χωράφι; *tërheq diçka përtokë*: ζβαρίζει τη ζάκα; *fig. lë një punë ose një çështje pa e mbaruar*: τις ζβαρίζει τις δουλειές.
ζβαρίζομαι, *vetv. vet III. (zvarizome)* . *fig. hiqem zvarë*: ζβαρίζεται στη ζωή του .
καπαρντίζομαι, *jokal . mburrem, krekosem*: καπαρντίζεται ο διάβολος; *çasti që fryhet buka para rjekjes etj .:* καπαρντίστηκε η μογάτσα .
κοκεύω, kal. *marr në shenjë*: κόκεψε το πουλί. (Dr. P.); *e zgjodhi vajzën ose një fjalë të goditur*: την κόκεψε την κοπέλα.
μοκιάζω, *vetv . mykem*: μόκιασε το φαϊ. *nuk përdoret emri si veprim i foljes, por vetëm mbiemri*: μοκιασμένος, -η, -ο; μοκιασμένο ψωμί .
μουζγκώνει, *vetv. zë e ngriset*: μούζγκωσε, έλα να φύγομε.
μπιρμπιλίζω, *jokal . që flet shumë*: μπιρμπιλίζει όλη μέρα.
μπιτιζω, kal. *mbaroj, kryej*: μπιτίσε τη δουλειά.
μπουχαβιάζω, *vetv. enjtem, mbuhavitem*: του μπουχάβιασαν τα πόδια.
μπραχτίζω, kal. *largohem prej një vendi ose prej dikujt*: μπράχτισε τους ανθρώπους του; μπράχτισε τη δουλειά.
νταρνταλάω και νταρνταλίζω, *jokal.dhe kal. flas pa pushim, flas gjëpura*: νταρνταλίζει πολλά.
ντεγκντιζω, kal. *e dërgoj një njeri nga larg she për sendet e përpjas diku*: τον ντέγκντισαν στην εξορία; *poiqs çërei pou to ντέγκντισε το ψαλίδι*.
ντερτιάζω, kal. *bëj një njeri me brengë*: ντέρτιασε τη μάνα του.
ντουμανιάζω, *jokal. largohem si tym*: ντουμανιάσε όζω από το σπίτι.
πατιρτιζω, kal. *dëmtoj, prish*: πατίρντισε τον κάμπο με τα πρόβατα.
πουσπουρίζω, kal. dhe *jokal. flas me zë të ulët*: πουσπουρίζω κάτω από τα δόντια; *fig. merrem me thashetheme*: πουσπουρίζει στα σοκκάκια.
σικλετιζομαι, *vetv. shqetësohem, kam siklete*: σικλετήστηκε από την αρρώστια τη μητέρας.
σικλετιζω, kal. *bëj tjetrin me brengë, me siklete*: σικλετιζεί τους γονείς του.
σκουμπιάζω, *jokal. shkumëzoj*: σκουμπιάζει το νερό στο καζάνι. (Dr. P.) ; *nxjerr shkumë nga goja*: του σκούμπιασε το στόμα.
τοργιάζω, *jokal. humbas vëmendjen në punë, s' di çtë bëjë*: ti τοργιάζεις έτσι;
τσενώνω, kal. *e bëj me cen*: τον τσένωσε η αρρώστια.
τσουλουφρίζομαι, *vetv. veta III. i digjen cullufet e flokëve të kokës, i pendëve të pulës etj.:* της τσουλουφρίστηκαν τα μαλλιά; *fig. diçka që digjet ose piqet në sipërfaqe si mishi, byreku etj.:* τσουλουφρίστηκε το κρυγάσι.
τσουλουφρίζω, kal. *djeg cullufet e flokëve ose pendët e shpendëve etj.:* τσουλούφρισε τα φτερά; *fig. djeg diçka në sipërfaqe, përcëlloj*: ο φουρτζής τσουλούφρισε το αρνί.
τσουρουκεύομαι, *vetv. veta III dëmtohet si pëlhurë etj. kështu që pjesa që mbetet nuk mjafton*: τσουρουκεύτηκε το πανί.
τσουρουκεύω, kal. *dëmtoj një send saqë pjesa që mbetet nuk mjafton*: τσουρούκευες το ατλάζι.
φλετουράω, *jokal. fluturoj në ajër me krahë ose me ndihmën e një force shtytëse*: φλετουράει το πουλί; φλετουράει το αεροπλano; *fig. jam shumë i gëzuar*: φλετουράει από

την χαρά του; vet. vet III fig. përhapet andej këndej, merr krahtë: του φλετουράει η γνώμη.

χουμπώνω, vetv. skuqem nga turpi: χούμπωσε από τη ντροπή του.

III. Ndajfolje

γκιόλι shumë i lagur: έγινε γκιόλι.

ίτσου asprak, fare: μη θιαμαίνεσαι ίτσου; asnjëherë: δεν έρχεται ίτσου.

κολάι me lehtësi: δεν τόχω κολάι.

κουτουρού ra dobi: μιλάει κουτουρού; ra bërë asgjë, ra runë: κάθεται κουτουρού; ra ndonjë qëllim: τόκαμε κουτουρού; ra ndonjë shkak: τον έδειρε κουτουρού; përd. mb. sipas kuptimeve 1, 3 të ndajfoljes: δουλειά κουτουρού, κουτουρού λόγια.

Κρούπα ndotje e madhe: τα τσάβαλα κρούπα.

Λούτσα që laget shumë nga shiu: γύρισε λούτσα από τον κάμφο.

*Μεζί me vështirësi, me shumë mundim: μεζί κουνιέται; me përprjekje të mëdha: μεζί του γιόμισα τη γνώμη; pothuajse hiç, shumë pak: μεζί ακούεται. * μεζί τόχω (το παιδί μου), e dua shumë.*

Μπάρα barabar, njësoj: μπάρα σου και μπάρα μου. shp. p. edhe μπάρα-μπάρα, për të përforsuar

kuptimin e ndajfoljes: με το στόμα μπάρα-μπάρα με τα χέρια κρατημάρα.

Μπριντζί për një runë a diçka që shkonë shumë mire: οι δουλειές πάνε μπριντζί; shumë i mire: παιδί μπριντζί.

Ντίγκα plot e përplot: γέμισε το καλύβι ντίγκα.

Ντομοσντό ratjetër: θάρθω ντομοσντό; fj. ndër. kuptohet vetvetiu: ντομοσντό είναι έτοιμοι για γλέντι.

Ντουμάνι me shpejtësi si tymi, me vrap: έφυγε ντουμάνι.

Παμπέσικα në mënyrë të rabesë: τον σκότωσε παμπέσικα.

Πατιρντί dëm i rëndë: έκαμε μεγάλο πατιρντί.

Ρεβάνι mënyra e vrapimit të kuajve jo me shumë shpejtësi dhe bukur: έμαθε τ'άλογο ρεβάνι;

nxitimimi ose shpejtimi për të bërë diçka ose për të vajtur diku: έφυγε ρεβάνι για το σπίτι.

Σκραπ asgjë: δε μαθαίνει σκραπ.

Τελέφι raskapitja në runë: έγινε τελέφι.

Τσαπράζικα ai që flet shtrembët, mbrapsht: μιλάει τσαπράζικα.

Τσίκα një pjesë e vogël nga diçka: δώσε μου τσίκα ψωμί.

Τσούλα rri me kokë ulur, urtë: κάθεται τσούλα.

Χάσα mohon diçka: το πιάνει χάσα το χρέος.

IV. Pjesëza

Ντότι në fjali dëftore mohuese: δεν το κάνω ντότι; në fjali pyetëse ose kushtore: το κάνεις ντότι; αν τον έπιανα ντότι, ήξερα εγώ.

PËRFUNDIME

1. Gjatë kontakteve historike, ekonomike e kulturore, populli grek dhe shqiptar kanë dhënë e marrë ndërmjet tyre dhe *gjurmët e këtyre marrëdhënieve me drejtim dykahësh pasqyrohen edhe në gjuhë*. Marrëdhëniet e shqipes me greqishten janë shumë komplekse dhe shtrihen në një periudhë shumë të gjatë kohore. Ato kanë nisur ndoshta që në fazën paraetnike të këtyre gjuhëve në djepin parabolkanik të tyre dhe kanë vijuar pa ndërprerje në periudhën etnike deri në ditët tona.

Në shqipe dhe në greqishte, krahas shtresës së njësive vetjake, dallohet edhe një shtresë elementesh të huaja që kanë interferuar brenda tyre, të njohura edhe si *huazime*. Huazimet përbëjnë një dukuri të zakonshme për të gjitha gjuhët. Ato prekin të gjitha rrafshet gjuhësore: *fonetikën, morfologjinë, leksikun dhe sintaksën*. Por rrafshi që preket drejtpërdrejt dhe më shumë nga ky proces, është *leksiku*.

Për analizuar shkencërisht dhe me saktësi huazimet dhe procesin e huazimit leksikor ose *interferimet leksiko-semantike* (në të gjithë përbërësit e vet: *fjalë, njësi frazeologjike dhe kuptime*) duhet të kemi parasysh edhe llojin e lidhjeve dhe të marrëdhënieve ndërmjet këtyre dy gjuhëve, sepse *detyra e parë që shtrohet para studiuesve që merren me marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-greke, është të dallojnë lidhjet e afri në rrafshin indoevropian nga marrëdhëniet e huazimit*.

Punimi *Rreth interferencave leksiko-semantike të greqishtes në shqipe* ka marrë në shqyrtim një lëndë të bollshme leksikore dhe semantike nga të dyja gjuhët, duke e parë atë në shumanshmërinë e vet, së pari duke u mbështetur në kritere të mirëfillta gjuhësore, por pa përjashtuar edhe ato jashtëgjuhësore.

Marrëdhëniet huazuese, që zbulohen si interferime leksiko-semantike, për mendimin tonë kanë lidhje të drejtpërdrejtë me tezën e relativizmit gjuhësor. R. Hudson, shprehet se “*një aspekt i relativitetit mund të demonstrohet fare lehtë, sepse në disa gjuhë mund të individualizojmë disa njësi që, pa dyshim, shprehin kuptime që në gjuhë të tjera nuk shprehen. Kjo mund të vërehet në vështirësitë e përkthimit nga gjuha në gjuhë, që janë të lidhura me kultura të ndryshme, dhe, si rrjedhim, kanë emra për një gamë të ndryshme zakonesh, objektesh, institucionesh e kështu me radhë.*”

Shqipja (edhe greqishtja) ka marrë fjalë të huaja, nëse *ato shënonin një nocion të ri* (kanë hyrë nga greqishtja së bashku me nocionin), *nëse shënonin një nuancë a ngjyrim të ri kuptimor*, që nuk e shënonin barasvlerësit e shqipes ose *nëse e kërkonte një stil i caktuar* (sidomos termat ndërkombëtarë). Kjo do të thotë që fjala në gjuhën shqipe (por edhe në greqishte) *nuk ka hyrë qysh fillim me të gjithë strukturën kuptimore, por vetëm me një kuptim dhe zakonisht me atë kryesorin*.

2. Duke u mbështetur të dhëna e studime të shumta ritrajtohet dukuria se shqipja dhe greqishtja, si gjuhë të popujve në kontakt gjeografik e historik *kanë qenë të hapura ndaj njëra-tjetrës, por potencialiteti i tyre dhënës dhe marrës nuk ka qenë i njëjtë, i barabartë dhe reflektiv*. Kjo ka kushtëzime të ndryshme, *si statusi politik, statusi ekonomik, statusi shoqëror, statusi ushtarak, statusi kulturor, statusi regjilioz etj. i*

popullit dhe i gjuhës që ai mbart, statusi rajonal e ndërkombëtar i gjuhës, koha e dokumentimit dhe shkalla e përpunimit i saj etj.

Duke u nisur nga gjendja e huazimeve në të dy gjuhët, mund të flitet për dy grupe interferimesh leksiko-semantike: **për huazime** (interferime leksiko-semantike) **të greqishtes në shqipe** dhe **për huazime** (interferime leksiko-semantike) **të shqipes në greqishte**.

a. **Huazimet nga greqishtja formojnë një grup paradigmatic të mëvetësishëm, brenda shtresës së huazimeve të shqipes.** Ato kanë tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve, së pari gjuhëtarë, por edhe historianë, arkeologë, etnologë, sociologë etj. Punimi ka synoi **trajtimin e tyre në një rrafsh sinkronik, përmes kundrimeve leksikore e semantike, pa rënë në trajtime etimologjike** (këto janë lënë me vetëdije jashtë trajtimit). Për të arritur një nivel shkencor të kënaqshëm analizash, ffillimesh, argumentimesh dhe përfundimesh për këto lloj interferencash, **është shfrytëzuar një literaturë e mjaftueshme dhe e domosdoshme në të dyja gjuhët si dhe në gjuhë të tjera ku teoritë gjuhësore dhe konceptet për fushën ku jemi ndalur janë të një shkalle të lartë përpunimi.** Duhet të pohojmë se në greqishte gjendet një literaturë e jashtëzakonshme shkencore, që zbulon studimet e panumërta që janë bërë për këtë gjuhë, në të gjitha rrafshet dhe për një periudhë shumë të gjatë kohore. Ato fillojnë që gati para 3.000 vjetësh. Por duhet të theksojmë se në këtë literaturë shkencore shumë voluminoze, për shumë shekuj, **gati - gati mungojnë studime të veçanta, sidomos ato nga gjuhëtarë të mirëfilltë, për marrëdhëniet e greqishtes me shqipen.** Kjo gjendje është kapërcyer disi në shekullin XX, sepse si do të shohim gjatë shtjellimit të punimi, ato janë shtuar, madje janë dhe studime serioze. E kundërta ndodh me studimet në shqipe. **Ato u kanë kushtuar dhe vazhdojnë t'u kushtojnë një vend të posaçëm marrëdhënieve të gjuhës shqipe me greqishten.** Kjo është shoqëruar edhe me hartimin e një numri të madh fjalorësh njëgjuhësh dhe dygjuhësh (greqisht-greqisht, shqip-shqip, shqip-greqisht dhe greqisht-shqip).

b. Punimi është ndalur në një numër të vogël fjalësh shqipe në greqishte dhe në strukturat e tyre kuptimore. Është pohuar disa herë se, ndryshe nga **studimet për huazimet greke në shqipe** (që janë të shumta dhe shteruese), **studimet për huazimet shqipe në greqishte janë në një numër të vogël.** Albanologë shqiptarë dhe të huaj janë shprehur **për karakterin dhënës** të shqipes dhe në greqishte, ndërkohë që gjuhëtarët grekë e pranojnë me rezerva karakterin **marrës të greqishtes nga gjuha shqipe.** Kjo shpjegohet edhe nga arsye jashtëgjuhësore, duke mos besuar në karakterin dhënës të shqipes si një gjuhë me dokumentim dhe përpunim relativisht të vonë.

3. Faktet gjuhësore tregojnë se shqipja **ka marrë më shumë prej greqishtes sesa ka dhënë.** Numri i fjalëve që shqipja i ka dhënë jo vetëm greqishtes (**në shekuj**), por edhe gjuhëve të tjera ballkanike (rumanishtes, serbishtes etj.) është rreth 70, si: *botë (shtamë), lerë (zhul), kulpër, venjë (dëllinjë), dhiza (dhi, kec), larë (pullë a njollë me ngjyra të ndryshme).* Por gjendja e huazimeve shqipe në greqishte nuk është kjo. Prof. E. Çabej thotë “*se kur të vështrohen marrëdhëniet e shqipes me gjuhët fqinje në tërësinë e tyre, do të pranohet që roli dhënës i kësaj gjuhe ndaj atyre gjuhëve është çmuar disi nën shkallën reale që i përket...*”

Studimet nga gjuhëtarë grekë në shekullin e 20-të e kanë vërtetuar me fakte gjuhësore këtë parashikim të profesorit. Studiuesi Dhori Qiriaz, që është marrë për një kohë të gjatë me huazimet shqipe në greqishte thekson se “*mendojmë se në të folmet e greqishtes ka ende lëndë të pazbuluar të shqipes, kryesisht të sferës materiale, gjë që do të tregohet më poshtë në mënyrë bindëse... Me shoshitjen më të mirë të lëndës dialektore të greqishtes së re është e sigurt se do të rritet edhe numri i fjalëve me etimon shqip.*

Sipas këtij studiuesi *shtrirja gjeografike e lëndës së shqyrtuar, tregon se shqipja ka lënë gjurmë më të thella në të folmet e Epirit, Thesalisë dhe të Atikës, dhe disi më të kufizuara në pjesët e tjera të territorit grek. Të shënueshme janë prurjet nga zona e Thesalisë dhe e Volosit, ku, siç dihet, gjatë mesjetës dhe më vonë pati zbritje masive të elementit arbëror. Elemente të shqipes kanë depërtuar edhe në argonë e qyteteve etj.*”

Megjithatë shumica e fjalëve shqipe në greqishte, që **shpesh krijojnë raporte distribucioni komplementar me fjalët vendëse**, zakonisht, **kanë mbetur në leksikon periferik, dialektor**. Këtë e tregon edhe mosparaqitja e tyre si zë i veçantë leksikografik edhe në një fjalor të tipit të madh, si ai J. Babinjotit (Γ. Μπαμπινιοτη; *Λεξικό της νεοελληνικής γλώσσας*, Αθηνών, 2002), por edhe në fjalorët që janë hartuar nga leksikografë shqiptarë si N. Gjini (N. Γκίνη, *Ελληνο - Αλβανικό Λεξικό (Fjalor greqisht - shqip)*, Ιωαννίνων, 1993) etj.

Madje, ka raste kur fjalë të shqipes, si **κοπέλα / kopile**, në fjalorët shpjegues a etimologjikë të greqishtes trajtohet si e huazuar nga latinishtja dhe jo nga shqipja.

Megjithatë ndjekja e zhvillimeve semantike dhe leksikore (polisemia dhe formimi i fjalëve të reja) tek fjalët që kanë hyrë nga shqipja në greqishte është interesante. Ne jemi ndalur edhe në këtë aspekt dhe fjalët shqipe të interferuara kanë pasur dhe kanë jetën e tyre me zhvillime, edhe pse të cungëta. P.sh.fjala **λέρα (η) / lerë e shipes** (por që nuk jepet në etimologjinë e fjalorëve nga shqipja) në greqishte ka 3 kuptime dhe ka formuar disa fjalë të reja: **λέρα (η)** {λερών} (καθημ.) **1.** η βρομιά, η ακαθαρσία: *κάποιοι αλητοτουρίστες φορούσαν παντελόνια γεμάτα ~ ΣΥΝ. ρύπος ANΤ. καθαριότητα, πάστρα. 2.* (συνεκδ.) η βρόμικη κηλίδα, ο λεκές. **3.** (μτφ.-κακός.) πρόσωπο με κακή διαγωγή, πονηρός, απατεώνας: *μπλέχτηκε με μια ~ από τον Πειραιά || Πρόσεχε τον αυτόν! Είναι ~ ΣΥΝ. παλιάνθρωπος, κακοήθης, χυδαίος. [ΕΤΥΜ μεσν. < λερώνω (υποχωρητ.)].*

λερός, -ή, -ό αυτός που είναι λερωμένος: ~ *πουκάμισο | σεντόνια ΣΥΝ. ακάθατος, ρυπαρός, κηλιδωμένος ΣΥΝ. καθарός, αρρύπαντος, παστρικός. [ΕΤΥΜ. < μτγν. όλερός “ακάθατος, νοθευμένος” (με αποβολή τού άτονου αρχικού φωνήεντος) < αρχ. όλος “μελάني τής σουπιάς”, από συμφυρμό των λ. θολός και ορός “υπόλειμμα γάλακτος”. Κατ' άλλη άποψη, προέρχεται από *salos (I.E. *sal-), πβ. λατ. saliva “σάλιο”, αρχ. γερμ. salo κ.ά.].*

λερώνω ρ. μετβ. κ. αμετβ. (λέρω-σα, -θηκα, -μένος} ♦ (μετβ.) **1.** κάνω (κάποιον/κάτι) ακάθατο, βρόμικο: *λέρωσε τη μπλούζα του με σάλτσα || ~ το πάτωμα | τους τοίχους | τα χέρια μου | τα ρούχα μου ΣΥΝ. βρομίζω, ρυπαίνω, λεκιάζω ANΤ. Καθαρίζω. ΦΡ. λερώνω τα χέρια μου διαπράττω (κάτι) κακό, παράνομο, ανήθικο κ.λπ.: δεν θα λερώσω εγώ τα χέρια μου κάνοντας παρανομίες” || λέρωσε τα χέρια του με το αίμα τού αδελφού του (βλ. λ. αίμα) 2.* (μτφ.) σπιλώνω την τιμή, την υπόληψη (κάποιου), τον προσβάλλω ηθικά: *με το βαρύ παράπτωμα του λέρωσε το όνομα τής οικογένειας του || μακριά απ'αυτό το πρόσωπο όπου αγγίζει, λερώνει! ΣΥΝ. ντροπιάζω, στιγματίζω 3.* (αμετβ.) λερώνομαι, βρομίζω: *τα ανοιχτόχρωμα ρούχα λερώνουν εύκολα 4. λερώνει! σε επιγραφές, για να προειδοποιείται το κοινό να μην αγγίζει μια βρόμικη ή φρεσκοβαμμένη επιφάνεια 5.* (μεσοπαθ. *λερώνομαι*) (για μωρό ή ηλικιωμένο) κάνω επάνω μου την ανάγκη μου, τα κάνω πάνω μου - **λέρωμα** (το). [ΕΤΥΜ. μεσν.< λερός]

4. Lloji më pranueshëm i huazimeve është ai kur fjala ka hyrë në gjuhë së bashku me konceptin, pra kur shfaqen **si huazime historiko-kulturore**. Por shqipja ka huazuar edhe fjalë greke për koncepte për të cilat ka pasur fjalët e veta në përdorim, që dalin pra **si huazime gjuhësore**. Huazimet (interferimet) leksiko-semantike greke shfaqen brenda leksikut të shqipes si një grup i mëvetësishëm **paradigmatik me karakteristika të**

dallueshme, mund të formojnë grupe të ndryshme paradigmatiche. Klasifikimet mund të mbështeten në kritere të ndryshme, si *huazime leksikore* dhe *huazime frazeologjike*, *huazime të plota* dhe *huazime strukturore (kalke)*, *huazime leksikore* dhe *huazime semantike*, *huazime historike* dhe *huazime bashkëkohore*, *huazime të drejtpërdrejta* dhe *huazime të tërthorta*, *huazime të ngulitura* dhe *huazime të pangulitura*, *huazime shkrimore* dhe *huazime gojore*, *huazime të gjalla* dhe *huazime fosile* etj.

Duke u mbështetur në konceptin se struktura leksikore e një gjuhe nënkupton dy klasa njësishe: *klasën e fjalëve* dhe *klasën e njësive frazeologjike (që janë barasvlerëse të fjalëve)*, punimi është ndalur drejtpërdrejt në huazimet (interferimet) në këto dy klasa të mëdha leksikore e semantike. Duhet të themi se bashkë me fjalët e huazuara kanë hyrë në gjuhën *shqipe edhe disa prapashtesa prej burimit grek*, të cilat u janë shtuar edhe temave të fjalëve prej burimi jogrek, si *-it: gjirokastr-it; -jot: himar-jot; -omë: balt-omë; -is: kallaj-is; -os: ajr-os etj.*

5. Huazimi *i fjalëve* nga greqishtja në gjuhën shqipe *është bërë në rrethana të caktuara dhe në periudha kohore të ndryshme.* Huazimet greke në shqipe u përkasin tri periudhave të mëdha kohore: huazime nga greqishtja e vjetër (që shqipja i ka trashëguar nga nëna e vet (ilirishtja jugore), huazime nga greqishtja mesjetare a bizantine dhe huazime nga greqishtja e re (këtu do të përfshijmë edhe huazimet që kanë hyrë në shqipe në fundshekullin e kaluar dhe në këtë fillimshekulli).

Kontaktet mijëravjeçare ndërmjet dy popujve, atij shqiptar dhe më atë grek, kanë bërë që huazimet të gjenden në të gjitha fushat, pavarësisht se në një fushë më shumë e në një tjetër më pak. Kështu, ato i gjejmë gati në të gjitha *fushat leksiko-semantike të mundshme.* Në punim gjenen qindra e qindra shembujsh me huazime të grupuara në tri fusha kryesore leksikore: *në fjalë të leksikut të përgjithshëm, në terma* dhe *në njësi frazeologjike.* Secila prej tyre është interseksionuar në dhjetëra nënfusha leksikore, terminologjike dhe frazeologjike. Vend jo të vogël në zënë dhe fushat semantike, ndajshitesore, fjalëformuese etj. P.sh., *sipas marrëdhënie paradigmatiche fjalëformuese* me fjalën *frikë* dhe nga derivatet e saj në Fjalorin e gjuhës shqipe (2006) kemi një fushë leksikore me 21 leksema: *frik kal., fríkem vetv., fríkur (i, e) mb., frikác,-e mb., frikacák,-e mb. frikakéq,-e mb., frikamán,-e mb., frikanjós,-e mb. frikash,-e mb. frik/ë,-a f., fríkës,-e mb., frikës/ój kal., -óva, -úar, frikësóhem vetv. frikësím,-i m. sh. -e(t); frikësúar (i, e) mb.; frikësúes,-e mb., frik/ój kal., -óva, -úar; frikóhem vetv., frikúar (i, e) mb., fríksh/ëm (i,-me (e) mb., frikshëm ndajf.*

Fushat semantike organizohen sipas lidhjeve semantike të kushtëzuara e të pakushtëzuara (organizimi polisemik, organizimi sinonimik, organizimi antonimik, organizimi hiponimik, organizimi metonimik, organizimi fjalëformues etj.).

6. Në përgjithësi huazime leksikore nga greqishtja e vjetër u përkasin fushave shoqërore, të bimësisë etj., si *fier, lakër, mokër, pjepër, presh, qershi* etj., kurse ato nga greqishtja e kohës bizantine dhe e kohës së re, kanë hyrë sidomos në jetën shoqërore, në artizanat, në botën shtëpiake, në kopshtari etj., si *avlli, fis, flamur, lajm, mëndafsh, oreks, i pastër, pronë, tipar, stolis, trastë, trëndafil* etj. Përgjithësisht këto huazime *i përkasin fondit të përgjithshëm leksikor të mbarë shqipes*, janë bërë pjesë organike e pasurisë së shqipes dhe karakterizohen *nga zhvillime të shumta semantike, fjalëformuese, stilistikore* etj. Por në shqipe kanë hyrë nga greqishtja e re edhe dhjetëra fjalë të tjera, që i gjejmë në fjalorët shpjegues kombëtarë të shqipes, që tregojnë se *kanë shtrirje në mbarë shqipen*, por që shpesh shoqërohen me elementin *krahin.* (fjalë krahinore). Kjo tregon së pari gjendjen e tyre, hapësirën ku shfaqen, por edhe prirjen e përdorimit, d.m.th., edhe në qoftë se kanë një hapësirë të kushtëzuar përdorimi, ato u drejtohen të gjithë përdoruesve të shqipes dhe kanë karakter normativ. Vetë pasqyrimi në këta fjalorë bëhet tregues i kësaj prirjeje. Këtu do të përmendim fjalë të tilla, si:

dhjakonar (lypës, dinak), mbodhis (vonoj, pengoj), mbodhisem (vonohem), farmakos (helmoj), feks (shkëlqen), honeps (pëlqej), kopanis (rrah rrobat me kopan kur i laj), pleks (thur, gërshetoj, ngatërroj), piks (mpiks, ngjiz), psonis (blej), tromaks (frikësoj), zileps, zilepsem (kam zili) etj.

Huazimet e hershme janë në numër të vogël, kurse huazimet nga greqishtja e re janë më të shumta, edhe pse një numër shumë i madh i tyre, nuk janë të ngulitura dhe mbeten në leksikon dialektor a periferik.

Gjithashtu në shqipe ka interferime leksikore greke (huazime) që kanë mbetur në leksikon pasiv apo në leksikon dialektor të shqipes, kurse formimet e reja leksikore dhe zhvillimet semantike që kanë ndodhur në këto formime, kanë hyrë në leksikon normativ. P.sh. *llahtar / llahtarë* në shqipe që i përgjigjet emrit *λαχτάρα (η)* në greqishte, i përket shtresës së fjalëve që bëjnë pjesë në leksikon bisedor, kurse *llahtari* është trajta e pranuar si standard.

7. Huazimet (interferimet) leksikore nga greqishtja mund të jenë *të ngulitura* dhe *të pangulitura (barbarizma)*. Shkalla e ngulitjes së fjalës së huazuar varet nga vlera që ka ajo fjalë në gjuhë; si rregull, sa më i rëndësishëm të jetë funksioni i fjalës së huazuar (sepse mund të japë një koncept të ri ose të bëjë një dallim kuptimi), aq më shumë ka nevojë gjuha për të, prandaj aq më thellë futet ajo fjalë në përbërjen leksikore të gjuhës, në sistemin fjalëformues, në sistemin semantik etj. Ato fitojnë vlera shumë të rëndësishme, si *vlera semantike, vlera emocionuese, vlera stilistike, vlera sintagmatike, vlera paradigmatiche vlerë a aftësi zëvendësuese (substitutive)*.

8. Fjalët e huazuara nga një gjuhë, kështu edhe nga greqishtja, *hyjnë në gjuhën marrëse zakonisht me kuptimin kryesor, që mund të jetë ose jo fillestar, apo historik*. Zhvillimet semantike ndodhin më vonë. Nëse ne ndeshemi me një fjalë të huazuar që ka më shumë se një kuptim, zakonisht, pranohet se kuptimet e prejardhura (kuptimet dytësore, kuptimet e figurshme etj.), të jenë zhvillime të brendshme të shqipes. Kjo dukuri shumë e rëndësishme mund të ndiqet te të gjitha fjalët që nuk janë terma. Analizat kanë treguar se është krejtësisht e natyrshme *që struktura kuptimore e fjalës që ka hyrë si huazim në shqipe prej greqishtes, të mos jetë e njëjtë apo e barasvlershme me atë të fjalës në greqishte*. P. sh te fjala *greminë* në shqipe kemi tri kuptime, kurse te ajo në greqishte kemi një kuptim.

Gremín/ë,~a f. sh. ~a, ~at. 1. Vend (grope, përrua etj.) i thellë me anë të thepisura, zakonisht në mal, në mes shkëmbinjve etj.; humnerë, hon. 2. *fig.* Shkatërrim i plotë, humbje, zhdukje. 3. *fig.* Hendek i thellë që ndan forcat a grupet e ndryshme shoqërore, dallim i madh. * **Ra në greminë** pësoi një humbje a fatkeqësi të madhe. **E hodhi në greminë dikë** i shkatërroi jetën, e çoi në një gjendje shumë të keqe. **Është në buzë të greminës (të humnerës)** është në prag të shkatërrimit të plotë ose të një humbjeje a fatkeqësie të madhe.

γκρεμός κ. γκρεμνος κ. (λόγ.) κρημνός (ο) το επικίνδυνα απότομο και βαθύ χάσμα, το βάραθρο: ο ~ έχασκε κάτω από τα πόδια τους || το αμάξι έπεσε στον - ΣΥΝ. βάραθρο, άβυσσος· ΦΡ. (α) στο χείλος τού γκρεμού (i) (κυριολ.) στην άκρη μιας απότομης, βραχώδους επι- φάνειας (ii) (μτφ.) στα πρόθυρα τής καταστροφής, λίγο πριν από την ολοκληρωτική συντριβή: όταν ανέλαβε την εξουσία η οικονομία βρι- σκόταν ~ (β) (μτφ.) **μπρος γκρεμός | βαθύ και πίσω ρέμα** για οριακές καταστάσεις αδιεξόδου, όταν έχει κανείς να επιλέξει μεταξύ δύο εξί- σου δυσάρεστων εναλλακτικών λύσεων | δεδομένων κ.λπ.: *Και τώρα τι να κάνω; ~! Η πληρώνω και μένω αδέκαρος ή δεν πληρώνω και πάω φυλακή!* [ETYM μεσν. < γκρεμνός (το γκ- αντί κ- από τη συνεκφορά τής λ. με την αιτ. τού άρθρου: τόν κρημνό) < αρχ. κρημ-νός < θ. krem-, εκτετα- μένη

βαθμ. πρώτης συλλαβής τής δισύλλαβης ρίζας *krema-*, η οποία απαντά στο ρ. *κρέμαμαν* βλ. κ. *κρεμώ*].

9. Duke u mbështetur në strukturën leksikore të shqipes, shohim se ajo ka huazuar nga greqishtja edhe ***njësi frazeologjike***. Greqishtja është gjuha e një kulture të lashtë dhe si e tillë ajo ka zhvilluar që herët prirjen për përdorimin gjerësisht të frazeologjisë. Për më tepër, është përfutur një sistem i zhvilluar i njësive frazeologjike që bën të mundur përdorimin e tyre me ngjyime të ndryshme stilistike.

Gjuha shqipe ka në përdorim njësi që lidhen me frazeologjinë e greqishtes dhe është e kuptueshme, që vëmendja jonë do të përqendrohet te grupi paradigmatic që është formuar me ***kalkim*** apo me ***kuazikalkim*** (*pothuajse kalkim*). Përmes një konceptimi taksonimik këtë grup paradigmatic e ndajmë në dy nëngrupe, që në vetvete mund të ndahen më tej:

a. Nëngrupi që përfshin ***njësi frazeologjike kalke që janë përkthyer nga greqishtja fjalë për fjalë***, si: *mollë sherri* etj. Disa kalke kanë dalin me një përdorim dysh. P.sh. në shqipe kemi njësinë *nga alfa tek omega* që i ruan lidhjet drejtpërdrejt me njësinë e greqishtes duke pasur një kalkim të pjesshëm, por edhe njësinë *nga a-ja tek zh-ja* ku procesi i kalimit është i plotë.

b. Nëngrupi ***me njësi frazeologjike kalke, që nuk janë përkthyer fjalë për fjalë***. Në përbërje të këtyre njësive kemi dy a më shumë fjalë emërtuese, ku njëra fjalë i përket leksikut të përgjithshëm të gjuhës, ndërsa tjetra është një emër i përveçëm që lidhet zakonisht me botën mitologjike, historike, filozofike, politike, kulturore, letrare etj. të Greqisë, si *molla e Adamit*, *guri i Sizifit*, *vuajtjet e Tantalit* etj.

Në gjuhën shqipe kanë hyrë nga greqishtja drejtpërdrejt apo tërthorazi nga gjuhët të tjera, sidomos nga ato me status ndërkombëtar, ***shumë njësi frazeologjike, që lidhen me ligjërimin e shkruar***. Në frazeologjinë e këtij tipi është fiksuar së pari ***mendësia mitologjike dhe përvoja e pasur historike e popullit grek***, por në të pasqyrohen thënie që me shndërrimet e figurshme lidhen me punën dhe veprimtarinë e përditshme, me mënyrën e jetesës dhe kulturën e njerëzve dhe që gjuha shqipe i ka marrë, sepse vetë populli shqiptar si mbartës i kësaj gjuhe ka shumë gjëra të përbashkëta me atë grek.

a. Kanë prejardhje ***nga mitologjia e pasur e grekëve të lashtë***: *pastroj ahuret e Augjias*, *filli i Arianës*, *nga maja e Olimp*, *pëlhura e Penelopës*, *kutia e Pandorës*, *zjarri i Prometeut*, *bashka e artë*, *shpata e Damokleut*, *thembra e Akilit*, *kalë Troje* etj.

b. me burim biblik: *gjykimi i Solomonit*, *si Shën Thomai mosbesues*, *molla e Adamit*, *mollë e ndaluar*, *pesha e kryqit*, *udha kryqit*, *toka e premtuar*, *arka e Noes* etj.

c. me burim nga filozofia, letërsia etj: *fluturim pindarik*, *dashuri platonike*, *ironi sokratike*, *gjithçka rrjedh*, *i thur ditirambe*, *kohë e artë* etj.

d. Me burim nga gjeografia, historia: *si fitore e Pirros*; *këtu është Rodi*, *këtu kërce*; *si beteja e Termopileve*; *vrapim Maratone* etj.

Një dukuri interesante që lidhet me njësitë frazeologjike, është prania në të dy gjuhët, por edhe në një hapësirë shumë më të gjerë ballkanike, e qindra e mijëra ***njësive frazeologjike paralele***, që kanë përmbajtje të njëjtë, por shpesh edhe strukturë ndërtimore e leksikore të njëjtë apo gati të njëjtë në të dy gjuhët. Këtu ***nuk mund të flasim për karakterin dhënës apo marrës të shqipes a të greqishtes***, por mbështetim mendimin e shprehur në *Parathënien e Fjalorit frazeologjik ballkanik* (Tiranë, 1999) se në bashkësinë gjuhësore ballkanike, të krijuar në një trevë historikisht të lashtë të bashkekzistencës së popujve që i kanë shtuar afritë gjuhësore tipologjike edhe me ndikime të ndërsjella, nga Sanfeldi, Çabej etj., është llogaritur që të jenë krijuar 400-500 njësi frazeologjike paralele, por që sipas autorëve të fjalorit e vërteta është se pasuria që ekziston e kalon dhjetëfishin e këtij numri. Këto njësi janë me burim popullor dhe mund të lidhen me fusha nga më të larmishmet dhe me entitete të

ndryshme, të botës materiale dhe shpirtërore dhe në ngjizjen e tyre kanë luajtur rol të veçantë faktorët jashtëgjuhësorë, si gjeo-historikë, psikologjikë, ekonomikë, etno-kulturorë, mitologjikë etj. Këtu po përmendim disa nga këto njësi, si: *me dorë në zemër* / *με το χέρι στην καρδιά*; *fërkon duart* / *τρίβει τα χέρια του*; *i doli nga hundët (për hundësh)* *διόκα* / *του βγαίνει από τη μύτη κάτι*; *iu lidh gjuha* / *του δέθηκε η γλώσσα*; *iu pre gjuha* / *του κόπηκε η γλώσσα*; *i dolën sytë (jashtë, nga vendi)* / *του βγήκαν τα μάτια(έξω)*; *(rri) me duar lidhur* / *(κάθεται) με τα χέρια δεμένα(στη μέση)*; *e ka gjuhën të gjatë* / *έχει μακριά γλώσσα* etj.

10. Në shqipe gjejmë shumë fjalët ndërkombëtare me burim grek, që i takojnë më shumë terminologjisë. Ato janë përvetësuar më lehtë, kanë zënë vend më shpejt në gjuhë dhe janë më të qëndrueshme. Edhe ato kanë pësuar ndryshime në formë sepse shqipja i përpunuar këto fjalë sidomos në rrafshin fonetik dhe në atë morfologjik (eptimor, si lakim dhe si zgjedhim) ashtu si fjalët e veta. Një problem interesant është se **termat nuk janë huazuar nga greqishtja drejtpërdrejt, por tërthorazi. Ato u përkasin fushave të ndryshme të dijës, të shkencës, të teknikës dhe të artit.** Shkencat shqiptare përgjithësisht janë shkencë të reja dhe terminologjinë shkencore e kanë marrë nga shkencat e vendeve perëndimore. Këto në vetvete i kanë ndërtuar termat mbi bazën e greqishtes së vjetër dhe të latinishtes, një proces që vazhdon sot e kësaj dite. Kështu pjesa dërrmuese a termave kanë hyrë në shekullin XX në shqipe nga italishtja, anglishtja, frëngjishtja, ruseshtja dhe nga gjermanishtja.

10. Meqenëse Greqia shtrihet në jug të Shqipërisë, kuptohet që ndikimet më të mëdha nga greqishtja në leksikon, në frazeologjinë, në semantikën etj. të shqipes **do të gjendeshin në hapësirat kontaktuese dhe sidomos në toskërishte dhe në të folmet kufitare.** Ndaj një pjesë e madhe e huazimeve leksikore nga greqishtja ka mbetur në të folme anësore si dialektizma a si krahinorizma, që së shumti nuk gjen pasqyrim në fjalorët shpjegues kombëtarë të shqipes, por që mund të gjenden në përdorimin e përditshëm në dialekt apo edhe të pasqyruara në fjalorët dialektorë e krahinorë. Kjo gjendje gjuhësore bie në sy në mjediset shqipfolëse në jug të Shqipërisë, që janë mbartës të dialektit të toskërishtes dhe që lidhen drejtpërdrejt gjeografikisht me popullin grek të Greqisë Veriore. Por është me vend të theksojmë **izomorfia** e emërtimeve (pavarësisht se sillen si terma) dhe e njësive frazeologjike (me vlerat e tyre shënuese, shprehëse, emocionore dhe stilistikore që mbartin), tregon se janë kapërcyer jo vetëm kufijtë gjeografikë shtetërorë dhe krahinorë e dialektorë të njohjes e të përdorimit, por edhe kufijtë shoqërorë brenda shoqërisë shqipfolëse. Ato përdoren tashmë jo vetëm nga shtresat me arsim të lartë, por edhe nga një masë shumë e madhe njerëzish, e kushtëzuar kjo edhe nga lëvizjet emigruese dhe shtimi i jashtëzakonshëm i kontakteve gjuhësore e kulturore ndërmjet dy popujve.

11. Huazimet nga greqishtja, ashtu si dhe fjalët e huazuara nga gjuhë të tjera duke hyrë në shqipe, **kanë pësuar ndryshime në formë e në përmbajtje**, pra, shqipja i ka marrë fjalët e huaja dhe i ka përpunuar sipas ligjeve të veta. Fjalët e huaja vijnë në zhvillohen në truallin e saj, bëhen njësi të fjalorit të saj dhe u nënshtrohen kushteve konkrete historike, që përcaktojnë zhvillimin e leksikut të gjuhës shqipe në përgjithësi; ato bëhen edhe tema prodhuese: *llogaris, llogaritje, i llogaritur, llogari, llogaritar, i llogaritshëm* etj. Fjalët jo të parme të formuara në këtë mënyrë janë formime të shqipes dhe nuk mund të quhen huazime.

a. Në ndryshimet që ndodhin gjatë kalimit nga greqishtja në shqipe, dukuria më e njohur në huazimet bashkëkohore është **dukuria fonetike e rënies së tingujve të temës së fjalës.** Rënia e tingujve ndodh zakonisht në ballë të fjalës. Kjo e ka shpjegimin se shumë nga këto fjalë (për të mos thënë që të gjitha, kanë hyrë në ligjërimin e folur ku

mbizotëron ligji i ekonomisë gjuhësore, dhe rënia e tinguj është një formë e shprehjes së këtij ligji. Këtu po përmendim raste të shumta të aferezës, si: *ανακατόνω* / *anakatos*, *nakatos* (nakatos botën, ngatërron botën); *αναγκάζω* / *anangas* (e ka anangasur plagën); *αγκούσα* / *anguse* (peshë nga ushqimi: u ngusa, hëngra tej mase, më rëndon stomaku nga të ngrënët) etj.

b. Mund të ketë ndërrime fonemore, si *dhokan* / *rrokan* (zdrukth), *dhokanis* / *rrokanis* (zdrukthoj, gdhend) etj.

c. Ndryshimet mund të jenë në rrafshin semantik, zakonisht me ndërrim kuptimi: *skordhan* – *hudhër* – *tarator* (*gatesë me kos*, *hudhra*, *tranguj*, *vajulliri*, *kripë*) etj. Kjo nuk është dukuri e panjohur në shqipe. Kështu fjala *skilo* në greqishte shënon *qenin*, kurse në shqipe shënon *dhelprën* dhe ka edhe zhvillime semantike se pse shënon edhe një njeri dhelparak (dinak, si dhelpra).

d. Jo rrallë herë fjalët pa konotacion, kur kanë hyrë në shqipe, e humbasin asnjansinë dhe fitojnë ngjyrimë, shpesh tallëse: *palikar* (në greqisht *trim*), në të folmet shqipe jugore përdoret me tallje për dikë që kërkon të hiqet si trim (kemi një të ashtuquajtur *enantiosemi*), ashtu si ka ndodhur me fjalën *dhaskal*, e cila në greqishte shënon mësuesin, kurse në shqipe është e markuar me konotacion.

e. Ka raste kur huazimi ka hyrë në sintagma që janë kthyer në njësi frazeologjike, si *καλημέρα* / *kalimera* – mirëdita (**Nuk dua t'ia dëgjoj kalimerën / nuk dua ta takoja ta dëgjoj, nuk dua të kem më lidhje me të*).

f. Ndonjë huazim nga greqishtja, madje nga greqishtja e re, mund ta mënjanojë fjalën e vjetër shqipe dhe mund të fitojë në shqipe dhe aftësi për zhvillime të brendshme kuptimore, për formime fjalësh të reja, për përdorime stilistikore etj. kështu ka ndodhur me fjalën shqipe *agër* dhe fjalën e huazuar nga greqishtja *gomar*.

12. Në huazimet nga greqishtja, sidomos të fjalëve që kanë hyrë herët është e njohur edhe *dukuria e zhvillimit të kuptimit*. Sipas tri rrugëve të lëvizjes së brendshme kuptimore, që njihen edhe në shqipe e në greqishte (por edhe në gjuhë të tjera), ne i ndeshim ato që të gjitha në strukturat kuptimore të huazimeve nga greqishtja: *zgjerim kuptimi*, *ndërrim kuptimi*, *ngushtim kuptimi*. Nëse ne ndalemi te fjalët e mëposhtme vërejmë këto raporte kuptimore fjalë në greqishten e sotme / fjalë në shqipen e sotme: *πάστρα (η)* / *pastërti,-a* 1:3; *παστρέύω* / *pastrój* 1:10; *παστρικός* / *pastríkós* 4:16. Vetëm me vështrimin e parë zbulojmë se shqipja shfaqet menjëherë si gjuhë polisemike (për të tria fjalët që formojnë një fushë semantike fjalëformuese, kemi 6 kuptime në greqishte dhe 29 kuptime në shqipe, pra në shqipe kemi 23 kuptime më shumë, ose gati 5-fishin e kuptimeve të fjalëve në greqishte).

Në qoftë se në strukturën kuptimore të fjalëve *ndeshen kuptime të njëjta a të afërta, kjo ka të bëjë me zhvillime paralele*, të veçanta në secilën gjuhë, duke u bërë tregues i të përbashkëtave që kanë dy popujt fqinj në botën materiale dhe shpirtërore.

Lëvizja kuptimore e brendshme del si kondensim semantik dhe ai tregon *se shqipja dhe greqishtja kanë prirje të forta sintetizimi si në strukturë, ashtu edhe në brendi*. Lëvizjet kuptimore bëhen sipas disa figurave gjuhësore, që në gjuhësi e në stilistikën letrare janë quajtur *trope*. Figurat gjuhësore në vetvete nuk janë të veçanta për çdo gjuhë, as për shqipen, porse shfaqja e tyre konkrete, në fjalë të ndryshme, ka veçanti për secilën gjuhë. Si trope më kryesore, më të zakonshme, do të përmendim *metaforën*, *metoniminë*, *sinekdokën*. Tek fjala *shkop*, huazim nga greqishtja e vjetër, kemi procese të ndryshme të lëvizjes kuptimore që shfaqet si zgjerim i aftësisë shënuese të fjalës që ka hyrë me kuptimin e parë nga kjo gjuhë: Kuptimi 2, 3, 4, 7 dhe 9 kanë lindur përmes metaforizimit (me tropin *metaforë*, kemi ngjashmëri fizike), kurse kuptimi 5, 6 dhe 8 kanë lindur përmes metonimizimit (me tropin *metonimi*, kemi mjetin për pasojën). **SHKOP,~I m. sh. ~INJ, ~ÍNJTË**. 1. Një cope dru i hollë e i gjatë, që

shërben për t'u mbështetur kur ecim, për të goditur a për punë të tjera. 2. Mjet a send i hollë, i gjatë e i rrumbullakët prej druri, prej gome etj., që përdoret për qëllime të ndryshme. 3. Bastun. 4. Kunj i drunj të që bashkon shtizën e parmendës me veshët. 5. *fig. bised.* Një e qëlluar me dajak a me dru, goditje. 6. *fig. bised.* Qortim i rëndë; detyrim me force, dhunë; kërcënim. 7. *vet. sh.* Dy thupra të vogla që përdoren zakonisht në vendet e Azisë Lindore e Juglindore për të ngrënë gjellë të ndryshme. 8. *fig. keq.* Njeri i trashë nga mendja, hu. 9. *përd. mb.* Shumë i dobët (nga trupi).

Zhvillimet semantike ndodhin gjatë përdorimeve të fjalëve për një kohë të gjatë dhe në lidhje të shumta e të larmishme sintagmatike. Shumë shpesh këto lidhje mund të ngurtësohen dhe krijohen në këtë mënyrë njësi frazeologjike. Shumë nga fjalët që kanë hyrë në shqipe nga greqishtja kanë formuar dhe motivuar njësi të tilla. P.sh., me fjalën *gomar* kemi me dhjetëra njësi frazeologjike (rreth 30 që janë në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, por edhe po kaq që janë në ligjërimin e shkujdesur dhe që nuk janë pasqyruar në këtë fjalor) që janë zhvillime semantike të gjuhës shqipe. ***Zhvillime të brendshme të shqipes mund të jenë dhe krijimi i shumë emërtimeve të pathjeshta***, mbi bazën e e një huazimi nga greqishtja: ***Bisht gomari bot. shih te BISHT,~I. Çuç gomari zool. shih te ÇUÇ,~I. Ferrë (gjemb) gomari bot. shih te FERR/Ë,~A. Lule gomari bot. shih te LUL/E,~JA. Vesh gomari bot. veshgomar.***

13. Leksiku i një gjuhe zhvillohet e ndryshon paprerë. Kështu ndodh dhe me leksikon e shqipes. Ai është përpunuar dhe përpunohet, është pasuruar dhe pasurohet vazhdimisht dhe duke iu përgjigjur më mirë kërkesave të zhvillimit ekonomik, shoqëror e kulturor vendit. Ai është plotësuar dhe është i hapur për plotësime me fjalë e shprehje e kuptime të krijuara rishtas apo dhe me huazime sapo këtë e kërkon vetë marrëveshja gjuhësore në shoqëri. ***Gati të gjitha huazimet greke në shqipe*** (të leksikut të përgjithshëm a të atij terminologjik, huazimet greke të hershme a të reja, huazimet që i përkasin gjithë shqipes a huazimet dialektore, huazimet e ligjërimeve të shkruara a tyre bisedore etj.) kanë krijuar ***grupe paradigmatiche fjalëformuese, duke përfshirë brenda tyre fjalë me prejardhje, me përbërje, me nyjëzim, me konversion*** etj.

Le të marrim mbiemrin ***i pastër***, nga i cili janë formuar fjalë me prejardhje:

- me parashtesim: ***papástër (i, e)***;
- me prapashtesim: ***pastri, pastërti, pastërtor, pastroj***;
- me përbërje: ***zemërpástër, shpirtpástër, gjakpástër***.
- me konversion: ***zemërpastërt-i (em.)***

Nga folja jo e parme (e pathjeshtë) ***pastroj*** janë krijuar ***pastrohëm, pastrim, pastrues, pastruese, i pastruar*** etj.

Këto fjalë jo vetëm ruajnë në strukturën e vet, temën fjalëformuese minimale (rrënjën) ***i pastër***, por krijojnë secila strukturën përgjegjëse kuptimore, që mbart sema (përbërës kuptimorë) që lidhen drejtpërdrejt me një kuptim, me disa kuptime ose me të gjithë strukturën kuptimore të mbiemrit

14. ***Huazimet në shqipe kanë hyrë nga ligjërimet e folura dhe nga ato të shkruara***. Në rrugën e dytë do të veçonim interferimet nga vepra filozofike, shkencore, publicistike, letrare etj. dhe më drejtpërdrejt ***nga fjalorët dhe gramatikat e greqishtes***. Fjalorët jo vetëm kanë ndihmuar në zotërimin e gjuhëve (të greqishtes nga shqiptarët dhe të shqipes nga grekët), por duke qenë regjistruar historikë të huazimeve, janë bërë një burim i patjetërsueshëm për studime gjuhësore. Leksikografia shqipe në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore pati si drejtim kryesor edhe hartimin e fjalorëve dygjuhësh, një numër i madh i të cilëve erdhi në leksikografinë shqipe në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XX dhe në këto vite të shekullit XXI.

Duhet të theksojmë se ne të gjithë lëndën që kemi interpretuar e kemi marrë nga fjalorët shpjegues apo dygjuhësh, të botuar në Shqipëri a në Greqi (apo jashtë tyre). Kjo do të thotë se jo të gjitha lëvizjet semantike, apo formimet e fjalëve nga huazimet përkatëse dhe që gjallojnë në gjuhën e folur greke a në atë shqipe gjenden të pasqyruara në këto vepra. Ato kanë të regjistruar vetëm një pjesë të kësaj pasurie.

a. Statusi i sotshëm ndërkombëtar i greqishtes dhe ai i shqipes nuk janë të barasvlershëm, së pari, sepse greqishtja është gjuhë e një populli dhe e një kulture që kanë përcaktuar rrjedha në zhvillimet evropiane dhe më tej. Duhet të pranojmë gjithashtu se edhe leksikografia dygjuhëshe e greqishtes është shumë më e pasur sesa ajo e shqipes, si në sasi veprash, edhe si gjeografi gjuhësh. Leksikografia greke ka një histori rreth 3.000-vjeçare, me një fond prej qindra e mijëra fjalorësh, kurse leksikografia shqipe ka vetëm një histori gati 400-vjeçare. Fund e krye punimi është mbështetur në veprat leksikografike më përfaqësuese të të dyja gjuhëve. Megjithatë, ne jemi realistë kur pohojmë se në këtë leksikografi, kemi një zbrazëti shqetësuese për llojin e fjalorëve *greqisht – shqip* dhe *shqip – greqisht*, të hartuar nga leksikografë të mirëfilltë grekë apo nga qarqet akademiko-universitare brenda territorit të shtetit grek.

b. Interferimet leksikore nga greqishtja, ***në leksikun e përgjithshëm të gjuhës shqipe***, kur kjo e kishte fjalën e saj, kanë ndodhur në rrjedhë të shekujve, dhe kur gjuha shqipe, krejt ndryshe nga greqishtja, nuk ishte e përpunuar në shkallën e duhur në të gjitha nënsistemet e veta. Interferimi ndodhte edhe për shkakun se shqipja akoma nuk kishte një fjalor shpjegues që të pasqyronte dhe të kodifikonte pasurinë e saj leksikore e semantike dhe që të realizonte ndër të tjera funksionin kryesor, atë informues. Kjo mundësi interferuese nuk është e njëllotë sot, kur gjendja është krejt ndryshe, sepse shqipja është më e mbyllur ndaj tyre. P.sh., në të folmet dialektore përdoret fjala *gajdhur* (*gomar, agër*), por shqipja standarde, e përpunuar dhe e kodifikuar, nuk e ngreh në normë këtë huazim a interferim leksikor bashkëkohor (siç bën me fjalën *pras –presh* etj.). Në punim jemi ndalur gjerësisht në pasqyrimin e a mospasqyrimin e huazimeve leksikore, semantike e frazeologjike në fjalorët shpjegues normativë apo në ata të hartuar nga individë të ndryshëm.

Përmes dhjetëra e dhjetëra shembujsh janë parë tri grupe njësisish: *huazime nga greqishtja që kanë zënë vend në leksikun normativ; huazime që janë pasqyruar në fjalorë shpjegues, por që markohen si fjalë krahinore, dialektore etj.; huazime që nuk janë pasqyruar në këta fjalorë dhe që mund të ndahen në dy grupe: një pjesë e tyre mund të përfshihen në këto vepra sepse sjellin vlera të reja, kurse një pjesë do të mbeten në leksikun pasiv e në atë krahinor-dialektor.*

Në fjalorët shpjegues të shqipes fjalët e huazuara nga greqishtja jepen jo vetëm sipas ligjërimeve, por edhe sipas stileve, duke na dhënë shumë fjalë terma, por edhe kuptime terminologjike me shpjegime të plota. Kur këto fjalë gjenden në të shumë fjalorë, ato kthehen nga terma në fjalë që njihen nga një rreth i gjerë përdoruesish, ndodh i ashtuquajtur i proces i ***shterminologjizimit***.

Kjo gjendje e huazimeve greke në shqipe në fjalorët shpjegues pasqyrohet në të gjithë fjalorët dygjuhësh ku shqipja është gjuhë e parë (edhe shqip-greqisht). Përgjithësisht këta fjalorë janë hartuar pas vitit 1972 dhe veçanërisht, pas vitit 1980, vit kur u hartua *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe. Makrostrukturat e tyre, por edhe mikrostrukturat për fjalësin në shqip, janë mbështetur te ky fjalor.* Kjo do të thotë se ***edhe huazimet greke që janë bërë pjesë e leksikut të shqipes së ditëve tona të pasqyruara në këtë fjalor, janë pasqyruar patjetër edhe në fjalorët dygjuhësh ku shqipja është gjuhë e parë.*** Këtë e tregojnë në mënyrë të tërthortë *parathëniet* e secilës

vepër, në të cilat pohohet janë mbështetur së pari në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, i hartuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

c. *Një hapësirë e rëndësishme leksikografike, për të parë hyrjen e huazimeve greke në shqipe është dhe leksikografia që lidhet me botën e arbëreshëve të Italisë.* Për mbijetesë arbëreshëve u është dashur të bëjnë të tyren edhe italishten, apo sikundër thonë ata *gjuhën e bukës*, e cila më pas ka ndikuar në mënyrë të dukshme në të gjitha sistemet e këtyre të folmeve. Por, për të shprehur ndjenjat e tyre *me fanatizëm* ruajnë dhe përdorin *gjuhën e zemrës*. Për vetë karakterin konservues të arbërishtes si gjuhë e zemrës, në fjalorët që lidhen me këtë të folme (apo me të folmet e arbëreshëve) mund të shohësh se shumë huazime leksikore kanë hyrë në mbarë shqipen dhe një pjesë nga shqiptarët që u larguan nga Moreja (Peleponez, Greqi). Vepra më e plotë që lidhet me leksikun e të folmeve arbëreshe është *Fjalor i arbëreshëve të Italisë*, të hartuar prej Emanuele Giordanos. Ne kemi dhënë disa fjalë nga greqishtja që gjenden në këtë fjalor. Ato i takojnë jo vetëm leksikut dialektor, por edhe atij të përgjithshëm. Një pjesë e tyre janë edhe terma ndërkombëtarë, ashtu si një pjesë e madhe i përkasin leksikut aktiv dhe janë pjesë e pandshme e të folurit të përditshëm në mjediset arbëreshe. Duhet të theksojmë se shumë huazime kanë hyrë si emra dhe në procesin e zhvillimit historike ato kanë krijuar çerdhe paradigmatiche fjalëformuese sipas ligjeve të shqipes dhe me mjetet fjalëformuese (ndajshitesat e shqipes): *adhazmu, ajazëm, alisidhe, anagllusia, anahoria, angosia, apathia, argalia, argomë, arhjimandrit, armuridhe, dhaskal, dhaskalia, dheksëm, dhespotia, dhiks, dhiksënj, dhilpë, dhokondrea, dhokar, dhokasënj, dhrimon, dhomatiqia, dhrom, dhrosia, epakurisënj, evangjelizonj, fanadksem, fallopjasënj, faneksënj, faraksem, firasem, psonisënj, farmak, farmakosem, jatrúa, jatreprsënj, kakamaqia, kakamaqasënj, kalimera, kallogre, kallogjer, kallojer, lefteria, lefteronj, lefterosënj, lipidhjasënj, lloizmoja.*

15. Ndryshe ndodh me termat në përdorim. Gjuha shqipe shumicën e tyre e ka kodifikuar, e ka standardizuar dhe e ka pasqyruar në fjalorë terminologjikë (madje edhe në fjalorë filologjikë). Por është për t'u habitur që në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, që ka qenë në vartësi të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, asnjë fjalor terminologjik (kur janë hartuar rreth 60 të tillë), nuk e ka fjalësin në greqisht ose nuk mbështetet në terminologjinë e përpunuar nga shkenca gjuhësore greke.

16. Shqipja në ditët e sotme i ka rritur shumë kontaktet me greqishten, kjo për shumë arsye, ndër të cilat do të veçonim se në Greqi punojnë si emigrantë ekonomikë rreth 600.000 shqiptarë. Ata ndodhen në një gjendje bilinguizmi, me shqipen si gjuhë të zemrës dhe me greqishten si gjuhë të bukës. Në leksikun e këtyre shqipfolësve gjejmë shumë greqizma si, *qinito, endaksi, signomi, efaristo, gjiro, psomi, nero, paidhaqe, buzuaqi* etj., fjalë të cilat fatkeqësisht i gjejmë të përdorura dhe në Shqipëri ku nuk kemi situatë bilinguizmi. Këtu duhet të bëhet punë e vazhdueshme që shqipatërt të ruajnë gjuhën e tyre, por edhe të mënjanojnë hyrjen e fjalëve të panevojshme (si *qinito, afendiko, merokamë, lefta* etj.)

Situata bilingue (dygjuhësie) i quajtur ndryshe *Gjeobilinguizmi shqiptaro-grek* ka ekzistuar dhe ekziston edhe në zonat në jug të Shqipërisë, por në 20 vitet e fundit dhe më gjerë. Është i njohur ndikimi i shqipes në të folmet greke në këto zona. Ne jemi ndalur për këtë dukuri disa herë gjatë punimit. Studiuesi Shkurtaç, Gj. shkruan se "Gjeobilinguizmi shqiptaro-grek rezulton të jetë nga më të hershmet takime të shqipes me një gjuhë të huaj, përderisa, siç dihet, iliro-shqiptarët dhe grekët janë dy popujt më të lashtë të Gadishullit të Ballkanit..." Dhe më poshtë vazhdon "Në mënyrë të veçantë do të ishte me interes një studim i thelluar i leksikut të të folmeve të tilla si ajo e

Bregdetit të Poshtëm, e Sarandës, e përgjithësisht e të folmet e skajit jugor të Shqipërisë, ku takimi i shqipes me greqishten ka qenë dhe është pasojë, jo vetëm e afërsisë gjeografike të dy popujve, por edhe e fqinjësisë së një pjese të caktuar të toskërishtes jugore me greqishten e enklavave të diasporës greke në Dropull dhe gjetkë. Kjo fushë mjerisht, deri më sot ka mbetur pothuaj djerr.”

Pas viti 1991, për këtë autor, në Minoritetin Etnik Grek në Shqipëri, kemi një ekuilibër të ri gjuhësor. Te ky minoritet **“ekziston një brez i ri** tek i cili përdorimi i gjuhës amtare është perfekt dhe shumë autoritar ndaj gjuhës zyrtare. Kemi **një brez të mesëm** i cili në rast se nuk ka zhvilluar kontakte të ngushta me shtetin amë dhe ka ruajtur kontaktet tradicionale me shoqërinë shqiptare, gjuha amtare është inferiore ose në pozita të barabarta ndaj gjuhës zyrtare dhe **një brez i tretë** që i përket moshës së tretë ku gjuha amtare është zotëruese. Dhe këtu duhet bërë një punë e kujdesshme, nga familja, shkolla etj. që në ligjërimin e greqishtfolëve të mods hyjnë fjalë shqipe të panevojshme.

Në punim janë dhënë me qindra e qindra fjalë (edhe si Fjalorth), qoftë si huazime (interferime) greke në shqipe, qoftë si huazime (interferime) shqipe në greqishte. Ato kanë vlerë të jashtëzakonshme për studime, por një pjesë e tyre duhet të mënjnohen.

17. Sipas disa studiuesve fjalët e huaja e pasurojnë gjuhën, sipas të tjerëve ato e prishin dhe prandaj duhen nxjerrë të gjitha nga përdorimi. Në këtë çështje duhet mbajtur një qëndrim i drejtë dhe i mbështetur shkencërisht. Ndaj huazimeve greke në shqipe duhen mbajtur qëndrim shkencor, të mos ngacmohen ato që janë bërë pjesë e pandashme e leksikut të shqipes me zhvillimet e shumta, të jemi të hapur ndaj terminologjisë ndërkombëtare me burim grek, por të mos lejojmë hyrjen e huazimeve të panevojshme në leksikun normativ, sidomos ato që gjenden në të folmet dialektore, ato që po futen sot nga kontaktet e shumta ndërmjet popujve, kur për ato ka barasvlerës në shqipe. Shembullin më klasik, për pasurimin dhe për mbrojtjen e fjalës së gjuhës amtare na e tregon vetë gjuha greke, e cila është shumë ngurruese ndaj fjalëve të panevojshme, edhe pse stile dhe ligjërime të ndryshme e përballin fjalën greke me fjalën e panevojshme angleze, franceze, gjermane, ruse etj. Po mjaftohemi me dhënien e disa interferimeve të leksikore dhe semantike, ndaj të cilave duhet të mbajmë qëndrim, për t’i zëvendësuar, por gjithnjë në mënyrë shkencore dhe asnjënjëse me fjalën shqipe, pa rënë në purizëm: *cukunidhe (hithër), cukunis (më djeg hithri, më përcëllon, por edhe më shndërrime kuptimore të figurshme), psonis (bëj pazar, blej), llagar (i pastër, i kulluar), llagaros (pastroj, kulloj), dhokan (zdrukth), dhokanis (e lodh, e mërzit), patom (shputa e këmbës: Sa ma ka patomën!), potis (ujit), potistir (ujitëse lulësh etj.), foti (kandil, ndriçues me vajguri), kallafatis (ha, përpij), skordhan (tarator), kalistir (vegël me presë e me veshë për të prashitur), suflaqe (pite etj. të mbushura me mish, qepë, domate, salcë etj.), proftas (arrij: nuk proftasa – nuk arrita...), palikar (trim), vromë (i pistë, grua e përdalë), skupje (fshesë), skupidhe (të fshirat, mbeturina), qinito (celular), merokamë (ditëpunë) etj.*

Probleme:

1. Shqipja dhe greqishtja janë gjuhë të hapura ndaj proceseve huazuese ndaj njëra tjetrës, por shkalla e huazimit kushtëzohet nga faktorë gjuhësorë e jashtëgjuhësorë të shumtë. Shqipja ka huazuar shumë herë më shumë fjalë nga greqishtja se sa kjo nga shqipja (kujtojmë se Gustav Majer pranon 840 të tilla, edhe pse studimet e mëvonshme një pjesë të tyre ia kthyen shqipes.

2. *Studimet për huazimet greke në shqipe gati janë shteruese*. Por nuk është kjo gjendje edhe *në studimet greke për huazimet shqipe në greqishte*. Studimet e shekullit XX dhe këtë fillim shekulli janë zgjeruar dhe kanë sjellë lëndë të re për një numër shumë më të madh (nga E. Çabej e të tjerë, pranohen mbi 60), për shtrirjen e tyre gjeografike, për dendurinë e përdorimit dhe për vendin në fjalorë të ndryshëm.

3. Në studimet e ndryshme, sidomos në ato për huazimet shqipe në greqishte, duhet të dallojmë fjalët shqipe nga fjalët që mund të kenë hyrë përmes shqipes në greqishte, por që janë huazime sidomos sllave dhe turke.

4. Huazimet mbizotëruese në shqipe prej greqishtes janë huazimet fjalë dhe frazeologji; fjalët kanë hyrë me kuptimin e tyre kryesor. Kemi raste shumë të rralla për të mos thënë, nuk kemi fare, interferime kuptimeve jo të para të fjalëve greke në strukturën e fjalëve shqipe. Kjo kërkon studim të mëtejshëm.

5. Duhet ndërmarrë ekspedita të herëpashershme të përbashkëta leksikologjike, dialektologjike, etnolinguistike etj. në Shqipëri dhe Greqi, me masën e profesionistëve dhe me masën studentore, për të parë bërë grumbullime sistemore, shkencore dhe të plota për interesimet leksikore e semantike në të dy gjuhët, në zonat ku mbizotëron gjeobilinguizmi shqiptaro-grek (në Shqipëri) dhe në zonat ku mbizotëron gjeobilinguizmi greko-shqiptar (në Greqi).

6. Ndaj huazimeve greke në shqipe duhen mbajtur qëndrim shkencor, të mos ngacmohen ato që janë bërë pjesë e pandashme e leksikut të shqipes me zhvillimet e shumta, të jemi të hapur ndaj terminologjisë ndërkombëtare me burim grek, por të mos lejojmë hyrjen e huazimeve të panevojshme në leksikun normativ, sidomos ato që gjenden në të folmet dialektore, ato që po futen sot nga kontaktet e shumta ndërmjet popujve, kur për ato ka barasvlerës në shqipe.

7. Në fjalorët terminologjikë, mendojmë se krahas 4-5 gjuhëve në të cilat paraqitet lënda, të futet edhe greqishtja, ashtu si dhe latinishtja, meqenëse janë gjuhët mbi të cilat ndërtohen termat dhe sistemet terminologjike sot në botë.

BIBLIOGRAFIA

- Altimari, F. 2001. «Mësimdhënia e gjuhëve minoritare në realitetin gjuhësor arbëresh», në *Kërkime universitare*. Gjirokastër. 5.
- Andrioti, N.. 1992. *Fjalor etimologjik i greqishtes së re*. Selanik.
- Andriotis, N. 1951. *Ετυμολογικό Λεξικό της Κοινής Νεοελληνικής*. Θεσσαλονίκη.
- Ανδριώτη, Ν. 1971. *Ετυμολογικό λεξικό*, Selanik.
- Ashta, K. 1962. «Vëzhgim historik në Fjalorin e parë të shqipes, Frang Bardhi, 1635», në *Shkodra*. 1.
- Ashta, K. 1964. 1965. 1966. *Leksiku i plotë i veprës së Gjon Buzukut (1555)*, “BSHIPDSH”, 4; Fjalor, 1988
- Ashta, K. 1968. *Disa fjalë të leksikut të arbërishtes*. BIPDSH. 7.
- Ashta, K. 1988. *Leksiku i plotë i veprës së Gjon Buzukut (1555)*. Fjalor.
- Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*. 2008. Napoli.
- Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane*. 1990. Tiranë.
- Babinotis, G. 1985. *Eisagogi stin simasiologia*. Athina.
- Bajrami, B. 2009. «Ndikimi i huazimeve në leksikun e shqipes», në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, për letërsinë dhe për kulturën shqiptare*. Prishtinë. 27/1,
- Barka, P. 2001. *Zhvillimet ekonomiko-shoqërore e kulturore në Shqipëri dhe mjedisi dygjuhësor*, në *Kërkime universitare*. Gjirokastër. 5.
- Beci, B. 2004. «Tiparet e përbashkëta të gjuhëve ballkanike në dritën e të dhënave të gjuhës shqipe», në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, për letërsinë dhe për kulturën shqiptare*, Prishtinë. 22/2
- Bellusci, A., *Ricerche e studi tra gli arbërori dell'Ellade*, Cosenza, 1994.
- Βελούδης, Γ. 1995. *Στοιχεία τοπικής λογικής και σημασιολογίας*, Θεσσαλονίκη.
- Βηλαράς, Ι. 1935. *Ο Αρβανίτης Άπαντα*, Αθήνα.
- Βλαστού, Π. 1999. *Συνώνυμα και συγγενικά*, Αθήνα.
- Bici, V. 2001. *Çështje të gjuhësisë në shkollat e pakicave*, Tiranë.
- Bici, V. 2001a. *Vështrim kritik mbi tekstet mësimore që realizojnë arsimimin dygjuhësor të fëmijëve të pakicave*, në “*Kërkime universitare*”, Gjirokastër, 5.
- Bokshi, B. 2005. *Rruga e formimit të fleksionit të sotmë të shqipes*. Prishtinë.
- Γεωργοπαπαδάκου, Α. 1984. *Το μεγάλο λεξικό της νεοελληνικής γλώσσας*, μονοτονικό, botimi i parë, Athinë.
- Γεωργοπαπαδάκου, Α., Βαρμάζη, Ν., Γεωργιάδη, Κ., Δαρδιώτη, Γ., Ζαφείρη, Χ., Κακαρόγλου, Ε., Σακελλαριάδη, Γ., 1984. *Το μεγάλο λεξικό της Νεοελληνικής Γλώσσας Μονοτονικό (Δημοτικής)*, Αθήνα.
- Γιάνναρη, Α. 1962. *Λεξικόν Γέρμανο – Ελληνικόν*, Αθήνα.
- Γιοχάλας, Τ. 1985. *Στοιχεία Ελληνο-Αλβανικής Γραμματικής και Ελληνο-Αλβανικοί Διάλογοι*, Θεσσαλονίκη.
- Γιοχάλας, Τ. 1999 *Υδρα Β, Αησμονημένη γλώσσα*, Αθήνα.
- Γιοχάλας, Τ. 2006. *Υδρα Α, Αησμονημένη γλώσσα*, Αθήνα.
- Γκίνη, Ν. 1993. *Ελληνο - Αλβανικό Λεξικό (Fjalor greqisht - shqip)*, Ιωάννινα.
- Γκίνη, Ν. 1998. *Αλβανο - Ελληνικό Λεξικό (Fjalor shqip – greqisht)*, Ιωάννινα.
- Çabej, E. 1984. «Për pastërtinë e gjuhës shqipe», në *Gjuha shqipe*. 3. Prishtinë.
- Çabej, E. ????? «Problemi i burimit të popullit shqiptar e të gjuhës shqipe», *Studime gjuhësore*. Prishtinë.

- Çabej, E. 1962. «Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në Gadishullin Ballkanik në dritën e gjuhës dhe të emrave të vendeve», në *BUSH, SSSH. 1*.
- Çabej, E. 1969. «Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre», në *Konferenca II e Studimeve Albanologjike. III*.
- Çabej, E. 1974. «Për historinë e strukturës dialektore të shqipes», në *Dialektologjia shqiptare. II*. Tiranë.
- Çabej, E. 1976. «Disa probleme themelore të historisë së vjetër shqipe», në *Studime gjuhësore. Prishtinë, III*.
- Çabej, E. 1976a. «Huazimet greke të “Marrëdhëniet e shqipes në periodën e saj historike (Hyrje në historinë e gjuhës shqipe)», në *Studime gjuhësore. III*. Prishtinë.
- Çabej, E. 1976b. *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. II*. Tiranë.
- Çabej, E. 1976c. *Studime etimologjike në fushë të shqipes, bleu II*. Tiranë.
- Çabej, E. 1976d. *Studime gjuhësore. I*, Prishtinë.
- Çabej, E. 1976e. *Studime gjuhësore. II*, Prishtinë.
- Çabej, E. 1976f. *Studime gjuhësore. III*. Prishtinë.
- Çabej, E. 1977. «Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve», *Studime gjuhësore. Prishtinë*.
- Çabej, E. 1977a. «Tekstet e vjetra shqip dhe disa kriteret rreth botimit të tyre», në *Studime gjuhësore. VI*. Prishtinë.
- Çabej, E. 1977b. «Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në Gadishullin Ballkanik në dritën e gjuhës dhe të emrave të vendeve». *Studime Gjuhësore. IV*. Prishtinë.
- Çabej, E. 1977c. *Ilirishtja dhe shqipja*, në *Studime Gjuhësore. Prishtinë*.
- Çabej, E. 1977d. *Studime gjuhësore. IV*. Prishtinë.
- Çabej, E. 1977e. *Studime gjuhësore. V*. Prishtinë.
- Çabej, E. 1982. *Studime etimologjike në fushë të shqipes, bleu I*. Tiranë.
- Çabej, E. 1987. *Studime etimologjike në fushë të shqipes, bleu III*. Tiranë.
- Çabej, E. 1988. *Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe. Studime gjuhësore*. Tiranë.
- Çabej, E. 1994. *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit*. Tiranë.
- Çabej, E. 1996. *Studime etimologjike në fushë të shqipes, bleu IV*. Tiranë.
- Çabej, E. 2002. *Studime etimologjike në fushë të shqipes, bleu VI*. Tiranë.
- Çabej, E. 2006. *Studime etimologjike në fushë të shqipes, bleu VII*. Tiranë.
- Castellan, G. 1996. *Histori e Ballkanit*. Tiranë.
- Çeliku, M. 2009. «Vepra “për pastërtinë e gjuhës shqipe, Fjalor, 1988, dhe fjalët e huaja në përdorim», në *Çështje të shqipes standarde*. Tiranë.
- Cruse, A. D. 1986. *Lexical Semantics*, Cambridge.
- Delijorgji, S.
- Delijorgji, S. 2011. «Niko H. Gjini dhe leksikografia shqiptaro-greke», në *Albanohellenica. 4*.
- Demiraj, Sh. 1986. *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Demiraj, Sh. 1988. *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë.
- Demiraj, Sh. 1988a. *E. Çabej, një jetë kushtuar shkencës*, Tiranë.
- Demiraj, Sh. 1996. *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Demiraj, Sh. 1999. *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmive të shqipes*. Tiranë.
- Demiraj, Sh. 2003. *Gjuha shqipe, probleme dhe disa figura të shquara të saj*. Tiranë.
- Demiraj, Sh. 2004. *Gjuha amtare në Bregdetin Jugor shqiptar gjatë shekujve*, në “Himara në shekuj”. Tiranë.
- Demiraj, Sh. 2004. *Gjuhësi ballkanike*. Tiranë.

- Demiraj, Sh. 2008. «Roli i Eqrem Çabejt në zhvillimin e Albanologjisë», në *Studime albanologjike*, I, Gjuhë. Tiranë.
- Demiraj, Sh. 2008a. *Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët*, Tiranë.
- Desnickaja, A. 1972. *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Prishtinë.
- Dhima, Th. 2001. «Vështirësi të kalimit të nxënësve minoritarë nga cikli i ulët në atë të lartë dhe probleme të të mësuarit të gjuhës shqipe», në *Kërkime universitare*, Gjirokastër, 5.
- Dizdari, T. 2005. *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë.
- Dodbiba, L. 1967. «Leksiku i sotëm detar i shqipes dhe elementet e tij të pahuazuara». *SF*. 1.
- Dodi, A. 1998. «Gjuha letrare shqipe përballë rreziqeve që e kërcënojnë», në *Letërsia shqipe dhe gjuha letrare*. Prishtinë.
- Dodi, A. 2004. «Shqipja si gjuhë ballkanike në vështrimin e gjuhësisë sasiore», në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*. Prishtinë. 22/2
- Drettas, G. 2004. «Shqiptarët dhe grekët në veprën e Jakob Philip Fallmerayer», në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, për letërsinë dhe për kulturën shqiptare*, Prishtinë. 22/2.
- Duro, A. 1982. «Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë në shqipen e sotme», në *Studime filologjike*, 4.
- Duro, A. 1989. *Për zëvendësimin e fjalës së huaj*, revista “Gjuha jonë”, 3.
- Duro, A. 1989a. *Sistemet terminologjike në gjuhën e shkencës dhe të teknikës*, në *Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, III, Tiranë.
- Duro, A. 1995 «Probleme të shqipërimit të terminologjisë në kohën tonë», në *Studime filologjike*, 4.
- Duro, A. 2001. *Terminologjia si sistem*, Tiranë.
- Duro, A. 2002. «Probleme të përpunimit të terminologjisë dhe të përdorimit të saj në ligjërim», në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, 1, 20. Prishtinë.
- Duro, A. 2009. *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë.
- Δημητράκου, Δ. 1998. *Μέγα Λεξικόν της Ελληνικής Γλώσσας*, Αθήνα.
- Δούγα-Παπαδοπούλου, Ε. – Τζιτζιλής, Χρ. 2006. *Το γλωσσικό ιδίωμα της Πιερίας, Θεσσαλονίκη*.
- Faveirial, Zh. K. 2004. *Historia e Shqipërisë*, Tiranë.
- Feka, Th. 1986. «Vëzhgime mbi leksikon terminologjik, në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” 1980», *SF*, 2.
- Feka, Th. 2005. *Rreth fjalorëve dialektorë të gjuhës shqipe*, në “Leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë.
- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. 1980. Tiranë
- Fjalor i gjuhës shqipe*. 1954. Tiranë.
- Fjalor i gjuhës shqipe*. 2006. Tiranë.
- Fjalor i shqipes së sotme*. 1984. Tiranë.
- Fjalor i shqipes së sotme*. 2002. Tiranë.
- Fjalor i termave të gjuhësisë (shqip – rusisht – frëngjisht – anglisht – gjermanisht – italisht)*. 1975. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Fjalor sinomik i gjuhës shqipe*. 2004. Tiranë.
- Floqi, K. 1933, 1935, 1936. *Pellazgë dhe helenë. Nji krahasim midis greqishtes dhe shqipes (studim etnologjik e linguistik)* në “Hylli i Dritës”.
- Frang Bardhi, 400-vjetori i lindjes*. 2007. Prishtinë.

- Φίλου, Σ. Μ. 2000. *Τα Τζουμερκοχώρια*, Αθήνα.
- Gazulli, N. 2007. *Fjalorth i ri*. Tiranë.
- Giordano, E. 2000 (1963) *Fjalor i arbëreshëvet të Italisë*.
- Gjinari, J. 1966. «Sprovë për një ndarje dialektore të gjuhës shqipe», në *SF*, 4.
- Gjinari, J. 1968. «Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe», në *SF*, 4.
- Gjini, N. 1971. *Fjalor shqip – greqisht*. Tiranë.
- Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë* (akte të Konferencës...). 1988. Tiranë.
- Haxhidhaqi, A.– Qiriazi, Dh. Q. 2008. «Qëndrime të emigrantëve shqiptarë ndaj bilinguizmit të fëmijëve», në *Albanohellenica*, 3. Athinë.
- Hoffmann, O., Debrunner, A. 1994. *Ιστορία της ελληνικής γλώσσας*. Θεσσαλονίκη.
- Hoxha, S. 2004. «Çështje të marrëdhënieve të shqipes me gjuhët fqinje nën dritën e elementeve të saj në këto gjuhë», në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, për letërsinë dhe për kulturën shqiptare*. Prishtinë. 22/2
- Hudson, R. 2002. *Sociolinguistika*. Tiranë.
- Hysa, E. 2004. *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*. Tiranë.
- Islamaj, Sh. 1985. *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*. Prishtinë.
- Ismajli, R. 2004. «Ballkanistika dhe prejardhja e shqipes», në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, për letërsinë dhe për kulturën shqiptare*. Prishtinë. 22/2
- Jani, J. 2001. «Ndikimet e gjuhës shqipe në tekstet shkollore të gramatikave të gjuhës greke», në *Kërkime universitare*, Gjirokastër. 5.
- Jorgaqi, K. 2002 «Mbi veprimtarinë e planifikuar leksikore për zëvendësimin e fjalëve të huaja», në *Konferenca shkencore Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot*. Tiranë.
- Jorgaqi, K. 2003. «Vështrim mbi drejtshkrimin e disa fjalëve me prejardhje të huaj në gjuhën shqipe», në *Konferenca shkencore Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot* Tiranë.
- Jorgaqi, K. 2008. *Sportel i hapur i shqipes*. Tiranë.
- Joseph, B. D. 2011. «The Albanian Source for a Greek Folk Usage», në *Albanohellenica*, 4.
- Kastrati, J. 2004. «Teodor Kavaljoti – paraardhës i gjuhësisë së krahasuar ballkanike me Fjalorin greqisht – arumanisht – shqip», në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, për letërsinë dhe për kulturën shqiptare*. Prishtinë. 22/2.
- Kole, J. 1984. «Mbi disa ndërkombëtarizma në gjuhën shqipe». në *SF*. 3.
- Komlev, N. G. 1969. *Komponenty soderzhatelnoj struktury slova*. Moskva.
- Konda, S. 1964. *Shqiptarët dhe problemi pellazgjik*, Tiranë.
- Kostallari, A. 1972. «Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes», në *Studime mbi leksikun e mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*. I. Tiranë.
- Kostallari, A. 1972a. «Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese», në *Studime mbi leksikun e mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*. I. Tiranë.
- Kostallari, A. 1972b. «Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme», në *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhë shqipe*. 2. Tiranë.
- Kostallari, A. 1972c. «Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”», në *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*. 2. Tiranë.
- Kostallari, A. 1977. «Fjalë me strukturë kuptimore të gjërë», *SF*, 1.
- Kostallari, A. 1986. «Diaspora e sotme shqiptare dhe gjuha letrare kombëtare e njësuar», *SF*, 3.
- Kostallari, A. 1988. «Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë», në *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*. Tiranë.

- Kostallari, A. 1989. «Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare», në *Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*. III. Tiranë.
- Kostallari, A. 1990. «Baza popullore shqipe dhe i ashtuquajturit purizëm», në *SF*, 2.
- Kostallari, A., 1972. Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë, në *Studime mbi leksikun e mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*. I. Tiranë.
- Kriaras, E. 1995. *Νέο Ελληνικό Λεξικό*. Αθήνα.
- Kristoforidhi, K. 1904. *Λεξικόν τῆς Ἀλβανικῆς Γλώσσης*. Athina.
- Kristoforidhi, K. 1961. *Λεξικόν Ἀλβανο - Ἑλληνικόν (Fjalor shqip – greqisht)*. Tiranë.
- Kullaqis, G. 1993. *Το Μεγάλο Ετυμολογικό Λεξικό της Νεοελληνικής Γλώσσας*, Athinë.
- Kume, J. 2008. «Ndikimi i greqishtes në sistemin foljor të shqipes», në *Seminari II Ndërkombëtar i Albanologjisë*. Tetovë.
- Kume, J. 2008a. «Për huazimet greke në shqipe», në *Studime albanologjike*. I. Gjuhë. Tiranë.
- Kume, J. 2009. «Globalizmi dhe marrëdhëniet sociolinguistike shqiptaro-greke», në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, për letërsinë dhe për kulturën shqiptare*. Prishtinë. 27/1.
- Καλαντζάκος, Α. 1995. *Λεξικό ρουμελιώτικης λαϊκής γλώσσας*, Αθήνα.
- Καμαρινου, Κ. 1998. *Αγγλοελληνικό και Ελληνοαγγλικό Λεξικό*, Αθήνα.
- Κουμανούδη, Σ. 1972. *Λεξικόν Λάτινο- Ελληνικόν*, Αθήνα.
- Κριαρά, Ε. 1995. *Νέο Ελληνικό Λεξικό της Σύγχρονης Δημοτικής Γλώσσας*, Αθήνα,
- Κυριαζής, Δ. Κ. 2001. *Ελληνικές Επιδράσεις στην Αλβανική (I. Φωνητική και μορφολογική προσαρμογή των ελληνικών δανείων; II. Λεξικό των ελληνικών δανείων της αλβανικής)*, Θεσσαλονίκη (Punim doktrate i pabotuar).
- Lafe, E. 1972. «Mbi disa terma të klasifikimit të fjalëve sipas përbërjes strukturore dhe sipas fjalëformimit», në *SF*. 1.
- Lafe, E. 1992. «Pastërtia e gjuhës në kohën tonë si detyrë gjuhësore dhe kombëtare», në *Konferenca “Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot”*. Tiranë.
- Lafe, E. 2003. «Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional», në *Konferenca shkencore Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”*. Tiranë.
- Latifi, L. 2006. *Mbi huazimet turke në gjuhën shqipe krahasuar me gjuhët e tjera të Ballkanit*. I. Tiranë.
- Leka, F. 1972. «Aspekte të zhvillimit të terminologjisë tekniko-shkencore pas çlirimit», në *Studime mbi leksikun dhe formimin fjalëve në gjuhën shqipe*. II. Tiranë.
- Leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë*. 2005. Tiranë.
- Lika, E. 2003. *Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe*. Tiranë.
- Liopsis, N. 2008. «Disa karakteristika themelore të të folmeve arvanite të Lakonisë – shqyrtim krahasues me të folmet e tjera arvanite dhe toskërishten jugore», në *Albanohellenica*. 3. Athinë.
- Lloshi, Xh. 2003. *Shqipja, gjuhë e hapur dhe dinamike*, në “Konferenca shkencore Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”, Tiranë.
- Lloshi, Xh. 2005. *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë,
- Lloshi, Xh. 2005a. *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë.
- Lloshi, Xh. 2010. *Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve shqip - latinisht, latinisht – shqip*, Shkup.
- Lyons, J. 1977. *Structural Semantics*. Cambridge.
- Λεξικό της Κοινής Νεοελληνικής*. Θεσσαλονίκη, 1998
- Λεξικό της Νέας Ελληνικής Γλώσσας*, Αθήνα: Πελεκάνος. 1998

- Λεξικόν της νέας ελληνικής γλώσσας, ορθογραφικόν και ερμηνευτικόν*, Αθήναι, 1998
- Λιάπης, Κ. 1996. *Το γλωσσικό ιδίωμα του Πηλίου*, Βόλος.
- Λιόσης, Ν. 2011. *Vërejtje etimologjike për arvanishten, Albanohellenica*. 4.
- Mandala, M. 2005. «Gjurmime leksikografike në mjedisin arbëresh të Sicilisë», në *Leksikografia shqiptare, trashëgimi dhe perspektivë*. Tiranë.
- Mann, S. 1992. *An Historical Albanian Dictionary*, Prishtinë.
- Mansaku, S. 2004. «Probleme të historisë së gjuhës shqipe në dritën e marrëdhënieve të saj me greqishten», në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, për letërsinë dhe për kulturën shqiptare*, Prishtinë. 22/2
- Mansaku, S. 2007. «Tradita e shkrimit të shqipes dhe “Formula e pagëzimit”», *SF*, 3-4.
- Mansaku, S. 2008. «Objektivitet shkencor dhe qëndrim kombëtar në veprën e E. Çabejt», në *Studime albanologjike*, I, Gjuhë, Tiranë.
- Marku, L. 2009. *Ελληνο - Αλβανικό Λεξικό (Fjalor greqisht - shqip)*. Tiranë.
- Memisha, V. 2006. «Rreth shndërrimit të togfjalëshit të lirë në njësi frazeologjike», *SF*, 3-4.
- Memisha, V. *Rreth vargut fjalëformues folje – emër veprimi – mbiemër prejpjesor në fjalorët shpjegues të shqipes*, në “Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005
- Memisha, V. 1999. *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastrë.
- Memisha, V. 2004. «Paradigma të veçanta fjalëformuese në leksikun dialektor të shqipes», në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Prishtinë, 22, 2.
- Memisha, V. 2007 «Rreth emrave të formuar me parashtesën **-mos** në gjuhën shqipe», në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, për letërsinë dhe për kulturën shqiptare*. Prishtinë, 25/2
- Memisha, V. 2007a. «Rreth një fjalori shkurtesash në gjuhën shqipe», në *Seminari Ndërkombëtar të Albanologjisë*. Ohër.
- Memisha, V. 2007b. *Mbiemrat prejpjesorë në shqipe dhe në greqishte*, në *SF*, 3-4.
- Memisha, V. 2008. «Participial Adjectives in Albanian and Greek», në *Albanohellenica*, 3, Athinë.
- Memisha, V. 2009. «Rreth fjalorëve shqip-greqisht dhe greqisht – shqip», në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, për letërsinë dhe për kulturën shqiptare*. Prishtinë, 27/1
- Memisha, V. 2009a. *Termet togfjalësha në fjalorët shpjegues të shqipes*, në Konferenca mbarëkombëtare “Terminologjia e shqipes: dukuri dhe probleme”, Tiranë.
- Memisha, V. 2010. «Rreth hapësirave huazuese të shqipes sot në nënsistemin leksiko-semantik», *kumtesë në Seminarin XXIX ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Prishtinë.
- Memushaj, R. 1989. *Morfonologji e eptimit të gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë.
- Memushaj, R. 2001. «Legjislacioni shqiptar për gjuhët e pakicave», në *Kërkime universitare*, Gjirokastrë, 5.
- Memushaj, R. 2004. «Patronimia e Himarës», në *Himara në shekuj*, Tiranë.
- Memushaj, R. 2008. *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë.
- Mërkuri, N. 2000. *Kërkime etnolinguistike tek emërtimet e bimësisë*. Tiranë.
- Meyer, G. 2007. *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*. Tiranë.
- Miçoni, H. – Rrapi, N. 2011. «Intereferenca gjuhësore tek fëmijët bilingjë simulantë shqiptaro-grekë», në *Albanohellenica*. 4.
- Μήτση, Π. Ι. 2002. *Θεσπρωτικό γλωσσικό ιδίωμα (Λεξιλόγιο από τα Κατωχώρα Φιλιππών)*, Έκδοση Λαογραφικού Μουσείου Φοινικίου Ηγουμενίτσας.

- Μητσόπουλου, Γ. 1999. *Λεξικό παροιμιακού λόγου*, Αθήνα.
- Μπαμπινιώτη, Γ. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας, με σχόλια για τη σωστή χρήση των λέξεων ερμηνευτικό, ετυμολογικό, ορθογραφικό, συνωνυμών – αντιθετών, κύριων ονομάτων, επιστημονικών ορών, ακρωνυμίων; με αξιοποίηση του γλωσσικού αρχείου Αθηνών*, 2002
- Μπαμπινιώτης, Γ. 1998. *Λεξικό της Νέας Ελληνικής*, Θεσσαλονίκη.
- Ναço, Μ. «Letërsia dygjuhëshe e autorëve të minoritetit grek dhe ndikime të ndërsjella», në *Kërkime universitare*. Gjirokastër. 5.
- Ndreca, Μ. 2000. *Fjalor fjalësh dhe shprehjesh të huaja*. Prishtinë.
- Nuhiu, V. 2002. *Të shënuarit e emrave të huaj në gjuhën shqipe*, në “Konferenca shkencore *Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot*”, Tiranë.
- Osmani, T. 1987. *Histori e alfabetit të gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Ostrogorski, G. 1997. *Historia e Perandorisë Bizantine*. Tiranë.
- Οικονόμου, Κ. Ε. 1997. *Η αλβανική γλωσσική επίδραση στα ηπειρώτικα ιδιώματα*. Εταιρεία Ηπειρωτικών Μελετών, Ιωάννινα.
- Palmer, R. F. 1988. *Semantics*. Cambridge.
- Pasho, H. 1986. «Një vështrim mbi dukuritë kuptimore në terminologjinë e ekonomisë». *SF*. 3.
- Pasho, H. 2005. *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe nga rilindja deri në vitet 80^{-të} të shekullit XX*. Tiranë.
- Pedersen, H. 2003. *Studime për gjuhën shqipe*. Prishtinë.
- Poçi, S. 2001. «Vllëhët (arumunët) e Shqipërisë dhe gjuha e tyre», në *Kërkime universitare*. Gjirokastër. 5.
- Παπακωνσταντίνου, Φ. 1995. *Ανθρώπινο χρέος, Εκδόσεις Δωδώνη*, Αθήνα – Ιωάννινα.
- Παπαφίλη, Κ. 1997. *Λεξικό Άλβανο - Ελληνικό (Fjalor shqip – greqisht)*, Αθήνα.
- Παπαφίλη, Κ. 1997a. *Λεξικό Έλληνο - Αλβανικό (Fjalor greqisht - shqip)*, Αθήνα.
- Παυλίδου, Θ. *Επίπεδα γλωσσικής ανάλυσης*, Θεσσαλονίκη, 1995
- Qiriazi, Dh. Q. 1999. «Huazimet greke në shqipen e sotme», në *Albanohellenica*. 1. Athinë.
- Qiriazi, Dh. Q. 2004. «Bilinguizmi dhe marrëdhëniet e greqishtes me shqipen në veprën e prof. Çabejt», në *Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare*, Tiranë.
- Qiriazi, Dh. Q. 2011. «Rreth marrëdhënieve të së folmes greke të Himarës me të folmet e tjera të greqishtes së re», në *Albanohellenica*. 4.
- Riza, S. 1996. *Fillimet e gjuhësisë shqiptare*. Prishtinë.
- Rrokaj, Sh. 2002. *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, Tiranë.
- Rrokaj, Sh. 2003. «Hartimi i fjalorëve dhe i gramatikave thesare, një mundësi më shumë për pasurimin e gjuhës standarde shqipe», në *Konferenca shkencore “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot”*, Tiranë.
- Rrokaj, Sh. 2007. «Dy fjalë për hartimin e Fjalorit», në *Çështje të gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Rrokaj, Sh. 2007a. «Huazimet në gjuhën shqipe», në *Çështje të gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Rrokaj, Sh. 2007b. *Shqipja standarde në pragun e shekulli të ri*, në “Çështje të gjuhës shqipe”. Tiranë.
- Samara, M. 1985. *Çështje të antonimisë në gjuhën shqipe*. Tiranë.
- Samara, M. 1991. *Mbi tiparet e leksikut politiko-shoqëror*, në “Studime filologjike”. 1.
- Samara, M. 1998. *Fjalor i antonimeve në gjuhën shqipe*. Tiranë.
- Samara, M. 2005. *Histori e gjuhës letrare shqipe*. Tiranë.
- Samara, M. 2008. «Pasurimi i leksikut politiko-shoqëror me njësi të reja në shqipen e sotme», në *SF*. 3-4.
- Samara, M. 2008a. *Rreth leksikut politike shoqëror në gjuhën shqipe*. Tiranë.

- Savoja, L. 2001. *Edukimi gjuhësor në gjuhën e pakicës*, në “Kërkime universitare”, Gjirokastër. 5.
- Shkurtaç, Gj. 1996. «Nga gjeografia gjuhësore te dialektologjia urbane», në *Studime albanologjike*. I. Tiranë.
- Shkurtaç, Gj. 2001. *Onomastikë dhe etnolingistikë*. Tiranë.
- Shkurtaç, Gj. 2004. *Dialektologjia*. Tiranë.
- Shkurtaç, Gj. 2004a. *Etnografia e të folurit të shqipes*. Tiranë.
- Shkurtaç, Gj. 2007. *Kundërime gjuhësore*. Tiranë.
- Shkurtaç, Gj. 2009. *Sociolingistikë e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Shuteriqi, Dh. 1976. *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*. Tiranë.
- Sinani, H. 2001. *Fjalor greqisht-shqip (Ελληνο-Αλβανικό Λεξικό)*. Tiranë.
- Spiro, A. 1999. «Mbi drejtshkrimin shqip të emrave me prejardhje greke», në *Albanohellenica*, Athinë. 1.
- Spiro, A. 2008. «Huazime në të folmet e krahinës së Delvinës dhe të Sarandës», në *Albanohellenica*. 3. Athinë.
- Spiro, A. 2010. *Shqip*. Athinë: Alcaeus.
- Spiro, A. 2011. «Semalektet e Epirit dhe roli i gjuhëve fqinje në formësimin e fjalorit të tyre», në *Albanohellenica*. 4. Athinë.
- Stamatakos G. 1971. *Λεξικόν της Νέας Ελληνικής Γλώσσας*, Αθήνα.
- Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*. 1972. I.
- Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*. 1972. II.
- Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*. 1989. III.
- Studime rreth historisë së gjuhës shqipe*. 1973. Tiranë.
- Suciu, C.-L. – Doraci, M. 2008. *Izoglosa frazeologjike në gjuhën greke shqipe dhe rumune; vështrim krahasues me bazë gjymtyrët e trupit të njeriut*, në *Albanohellenica*, 3, Athinë.
- Σταματάκου, Ι. 1952. *Λεξικόν της νέας ελληνικής γλώσσας*, I, II, III, Αθήνα.
- Σύγχρονον λεξικόν της ελληνικής γλώσσας*, Αθήνα, 1961
- Σύρκου, Α. 2006. *Το μεγαρικό γλωσσικό ιδίωμα (Λεξικογραφική μελέτη)*, Νήσος, Αθήνα
- Tamo, A. 2005. *Mësimdhënia dhe të nxëniet*, Tiranë.
- Terpo, V. 2001. «Arsimimi dygjuhësor në shkollat e pakicave greke», në *Kërkime universitare*, Gjirokastër, 5.
- Thomai, J. 1972. «Mbi mënyrën e pasqyimit të sistemit të kuptimeve dhe të përdorimit të fjalëve në “Fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe”», *Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*. II. Tiranë.
- Thomai, J. 1972a. «Zhvillimi i teorisë dhe i praktikës leksikografike shqiptare pas Çlirimit», në *Studime mbi leksikon e mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*. II. Tiranë.
- Thomai, J. 1973. «Një shtresim i leksikut nga pikëpamja e normës letrare», në *Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës*. 1.
- Thomai, J. 1981. «Tipat themelore të derivacionit semantik në gjuhën shqipe». *SF*. 3.
- Thomai, J. 1984. «Rreth semantikës së foljeve veprare, pësore e vetvetore në gjuhën shqipe», *GjJ*, 3.
- Thomai, J. 1988. «Rreth shtresimit historik të leksikut të shqipes sipas studimeve të prof. E. Çabejt», *SF*. 3.
- Thomai, J. 1988a. «Tipare të gjuhës së shtypit në kohën tonë», në *Gjuha letrare kombëtare dhe epoka jonë*. Tiranë.
- Thomai, J. 1992. *Teksti dhe gjuha*, Tiranë.
- Thomai, J. 1996. «Sinonimia në fjalorin frazeologjik», në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*. XVIII. Tiranë.

- Thomai, J. 2001. *Leksiku dialektor e krahinor në gjuhën shqipe*. Tiranë.
- Thomai, J. 2004. «Rreth një korpusi frazeologjik ballkanik», në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, për letërsinë dhe për kulturën shqiptare*. Prishtinë, 22/2.
- Thomai, J. 2004a. *Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe*. Tiranë.
- Thomai, J. 2005. «Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë», në *Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë*. Tiranë.
- Thomai, J. 2005a. «Shqipja standarde dhe leksikografia shqiptare», në *Konferenca shkencore – Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*. Tiranë.
- Thomai, J. 2009. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Thomai, J. 2009a. *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*. Tiranë.
- Thomai, J., Lloshi, Xh., Hristova, R., Qiriazati, K., Melonashi, A. 1999. *Fjalori frazeologjik ballkanik*. Tiranë.
- Topalli, K. 1995. *Theksi në gjuhën shqipe*. Tiranë.
- Topalli, K. 1996. *Për historinë e hundorësisë së zanoreve në gjuhën shqipe*, Tiranë.
- Topalli, K. 1998. *Zhvillimi historik i diftongjeve të shqipes*. Tiranë.
- Topalli, K. 2000. *Shndërrime historike në sistemin zanor të gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Topalli, K. 2002. *Shndërrime historike në sistemin zanor të gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Topalli, K. 2003. *Fërkimoret e afrikatet e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Topalli, K. 2004. *Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Topalli, K. 2007. *Fonetikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Topalli, K. 2007a. «Nyja joshquese e shqipes». *SF*. 3-4.
- Topalli, K. 2008. *Evolucioni historik i përemrave të shqipes*. Tiranë.
- Toska, T. 2009. «Sprovë për një grupim të frazeologjive nga pikëpamja referenciale, në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, për letërsinë dhe për kulturën shqiptare*, Prishtinë, 27/1.
- Totoni, M. 1971. «Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit», në *Dialektologjia shqiptare*. I. Tiranë.
- Triantafillidhi, M. 1992. *Neoelleniki grammatiku*, Athina.
- Τεγόπουλος – Φυτράκης. 1992. *Ελληνικό Λεξικό*, Αθήνα.
- Udhëzues për mbledhjen e fjalëve dhe të shprehjeve të gjuhës shqipe*. 1989. Tiranë.
- Ullman, S. 1963. *The Principles of Semantics*. Oxford.
- Xhuvani, A. - Çabej, E. 1956. *Parashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Xhuvani, A. - Çabej, E. 1956. *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Xhuvani, A. - Çabej, E. 1962. *Parashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Xhuvani, A. - Çabej, E. 1962. *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë.